| <p>4.3. rastet kur mallrat e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, nuk kanë statusin doganor të mallrave kosovare;</p> <p>5. Rregullat procedurale për sigurimin dhe verifikimin e dëshmisë se statusit doganor të mallrave kosovare, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> <p style="text-align: center;">Neni 110 Humbja e statusit doganor të mallrave kosovare</p> <p>1. Mallrat kosovare bëhen mallra jo kosovare në rastet e mëposhtme:</p> <p>1.1. kur ato largohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës, për aq kohë sa nuk zbatohen rregullat për transitin e brendshëm;</p> <p>1.2. kur ato janë vendosur në procedurën e transitit të jashtëm, në procedurën e strehimit ose procedurën e përpunimit të brendshëm, për aq sa e lejon legjislacioni doganor;</p> <p>1.3. kur ato janë vendosur nën një procedurë të përdorimit të</p> | <p>article do not have the Customs status of Kosovo goods;</p> <p>5. The procedural rules for the provision and verification of the proof of the Customs status of Kosovo goods, are determined with Minister of Finance sublegal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 110 Loss of Customs status of Kosovo goods</p> <p>1. Kosovo goods shall become non-Kosovo goods in the following cases:</p> <p>1.1. Where they are taken out of the Customs territory of the Republic of Kosovo, insofar as the rules on internal transit do not apply;</p> <p>1.2. where they have been placed under the external transit procedure, a storage procedure or the inward processing procedure, insofar as the Customs legislation so allows;</p> <p>1.3. Where they have been placed under the end-use procedure and are either subsequently</p> | <p>4.2. uslove za olakšavanje provere carinskog statusa domaće robe;</p> <p>4.3. slučajevi kada roba iz stava 3. ovog člana nema carinski status domaće robe;</p> <p>5. Proceduralna pravila za obezbeđivanje i verifikaciju dokaza o carinskom statusu domaće robe utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.</p> <p style="text-align: center;">Član 110 Gubitak carinskog statusa domaće robe</p> <p>1. Domaća roba postaje strana roba ako je:</p> <p>1.1. izneta sa carinskog područja Republike Kosova, ako se ne primenjuju pravila o unutrašnjem tranzitu;</p> <p>1.2. stavljena u postupak spoljnog tranzita, postupak skladištenja ili postupak aktivnog</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>veçantë përfundimtar dhe më pas janë braktisur në dobi të shtetit ose shkatërruar duke lënë mbeturina;</p> <p>1.4. kur deklarata doganore për lëshimin e mallrave për qarkullim të lirë anulohet pas lëshimit të mallrave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 111 Mallrat kosovare që largohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Kosovës</p> <p>1. Në rastet e përcaktuara në nën paragrafët 2.2 deri 2.5 të Nenit 152, mallrat mbajnë statusin e tyre doganor si mallra kosovare vetëm nëse ky status është përcaktuar nën kushtet dhe mënyrat e parashikuara me legjislacionin doganor.</p> <p>2. Në raste të veçanta, mallrat kosovare mund të lëvizin, pa qenë objekt i një procedurë doganore, nga një pikë në një pikë tjetër të territorit doganor të Republikës së Kosovës si dhe përkohësisht jashtë këtij territori pa ndryshuar statusin e tyre doganor.</p> <p>3. Rastet kur statusi doganor i mallrave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, nuk ndryshon, përcaktohen me akt nënligjor</p> | <p>abandoned to the State, or are destroyed and waste remains;</p> <p>1.4. Where the declaration for release for free circulation is invalidated after release of the goods.</p> <p style="text-align: center;">Article 111 Kosovo goods leaving the Customs territory of the Republic of Kosovo temporarily</p> <p>1. In the cases referred to in sub paragraphs 2.2 to 2.5 of Article 152, goods shall keep their Customs status as Kosovo goods only if that status is established under certain conditions and by means laid down in the Customs legislation</p> <p>2. In specific cases, Kosovo goods may move, without being subject to a Customs procedure, from one point to another within the Customs territory of the Republic of Kosovo and temporarily out of that territory without alteration of their Customs status.</p> <p>3. The cases where the Customs status of goods referred to in paragraph 2 of this Article is not altered, are determined with government sublegal act on the proposal of the ministry responsible for finance.</p> | <p>oplemenjivanja, ako carinski propisi to dozvoljavaju;</p> <p>1.3. stavljena u postupak upotrebe u posebne svrhe i je naknadno ustupljena državi, ili je uništena, a ostao je otpad;</p> <p>1.4. carinska deklaracija za stavljanje robe u slobodan promet poništena nakon puštanja robe.</p> <p style="text-align: center;">Član 111 Domaća roba koja privremeno napušta carinsko područje Republike Kosova</p> <p>1. U slučajevima iz člana 152. podstav 2.2 do 2.5, roba zadržava carinski status domaće robe samo ako je taj status utvrđen pod određenim uslovima i u skladu sa carinskim propisima.</p> <p>2. U posebnim slučajevima, domaća roba može, bez promene carinskog statusa, da se kreće od jedne tačke do druge u carinskom području Republike Kosova i</p> |
|---|---|--|

të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa.

KAPITULLI II VENDOSJA E MALLRAVE NËN NJË PROCEDURË DOGANORE

Nënkapitulli I Dispozita të përgjithshme

Neni 112

Deklarata doganore e mallrave dhe mbikëqyrja doganore e mallrave Kosovare

1. Të gjitha mallrat e destinuar për t'u vendosur nën një procedurë doganore, me përjashtim të procedurës së zonës së lirë, mbulohen nga deklarata doganore e duhur për procedurën përkatëse.
2. Në raste të veçanta, të ndryshme nga ato të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 7, një deklaratë doganore mund të depozitohet duke përdorur mënyra të ndryshme nga teknikat elektronike të përpunimit të dhënave.
3. Mallrat kosovare të deklaruar për eksport, transit të brendshëm ose përpunim të brendshëm, janë objekt i mbikëqyrjes doganore që nga momenti i pranimit të

CHAPTER II PLACING GOODS UNDER A CUSTOMS PROCEDURE

Subchapter 1 General provisions

Article 112

Customs declaration of goods and Customs supervision of Kosovo goods

1. All goods intended to be placed under a Customs procedure, except for the free zone procedure, shall be covered by a Customs declaration appropriate for the particular procedure.
2. In specific cases, other than those referred to in paragraph 3 of Article 7, a Customs declaration may be lodged using means other than electronic data-processing techniques.
3. Kosovo goods declared for export, internal transit or outward processing shall be subject to Customs supervision from the time of acceptance of the declaration referred to in paragraph 1 until such time as they are taken out of the Customs territory

privremeno van tog područja, a da ne bude stavljena u carinski postupak.

3. Slučajevi kada se carinski status robe iz stava 2. ovog člana ne menja, utvrđuje se podzakonskim aktom Vlade na predlog Ministarstva nadležnog za finansije.

GLAVA II STAVLJANJE ROBE U CARINSKI POSTUPAK

Odeljak I Opšte odredbe

Član 112

Carinska deklaracija za robu i carinski nadzor domaće robe

1. Sva roba za koju postoji namera da se stavi u carinski postupak, osim u postupak slobodne zone, mora da bude obuhvaćena deklaracijom za taj carinski postupak.
2. U posebnim slučajevima, osim u slučajevima navedenim u članu 7. stav 3. ovog zakona, carinska deklaracija se može

| | | |
|--|--|---|
| <p>deklaratës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni deri në momentin që ato largohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës ose, kur braktisen në dobi të shtetit, shkatërrohen apo deklarata doganore anulohet.</p> <p>4. Rastet kur një deklaratë doganore mund të depozitohet duke përdorur mënyra të ndryshme nga teknikat elektronike të përpunimit të dhënave sipas paragrafit 2 të këtij Neni, përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa.</p> <p>5. Rregullat procedurale për depozitim të deklaratës doganore për rastet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> <p style="text-align: center;">Neni 113 Zyrat doganore kompetente</p> <p>1. Ministri përkatës për Financa me akt nënligjor përcakton, vendndodhjen, orarin e punës dhe kompetencat e zyrave të ndryshme doganore të vendosura në territorin e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Përveç kur parashihet ndryshe, zyra doganore kompetente për vendosjen e mallrave nën një procedurë doganore është</p> | <p>of the Republic of Kosovo or are abandoned to the State or destroyed or the Customs declaration is invalidated.</p> <p>4. Cases where a Customs declaration may be lodged using means other than electronic data-processing techniques in accordance with paragraph 2 of this article, are determined by Government of Republic sublegal act. on the proposal of the ministry responsible for finance.</p> <p>5. Procedural rules for lodging the Customs declaration in the cases referred to in paragraph 2 of this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 113 Competent Customs offices</p> <p>1. Minister of Finance by sublegal act shall determine the condition, location, working hours and competence of the various Customs offices situated in the territory of Republic of Kosovo.</p> <p>2. Except where otherwise provided, the competent customs office for placing the goods under a customs procedure shall be the customs office responsible for the</p> | <p>podneti upotrebom drugih sredstava, a ne tehnikom elektronske obrade podataka.</p> <p>3. Domaća roba deklarirana za izvoz, unutrašnji tranzit ili pasivno oplemenjivanje podleže carinskom nadzoru od trenutka prihvatanja deklaracije iz stava 1. ovog člana do trenutka dok ne napusti carinsko područje Republike Kosova, dok ne bude ustupljena državi ili uništena ili dok se carinska deklaracija ne poništi.</p> <p>4. Slučajevi kada se carinska deklaracija može podneti upotrebom drugih sredstava, a ne tehnikom elektronske obrade podataka prema stavu 2. ovog člana, određuju se podzakonskim aktom Vlade na predlog Ministarstva nadležnog za finansije.</p> <p>5. Proceduralna pravila za podnošenje carinske deklaracije za slučajeve iz stava 2. ovog člana, utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.</p> <p style="text-align: center;">Član 113 Nadležne carinarnice</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>zyra doganore përgjegjëse për vendin ku mallrat paraqiten në Doganë.</p> <p>3. Rregullat procedurale për përcaktimin e zyrave doganore, të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin 2 të këtij Neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli II</u> <u>Deklaratat doganore standarde</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 114 Përmbajtja e një deklarate doganore standarde</p> <p>1. Deklarata doganore standarde përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për zbatimin e dispozitave që rregullojnë procedurën doganore për të cilën mallrat janë deklaruar.</p> <p>2. Rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës standarde sipas këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit të Financave.</p> <p style="text-align: center;">Neni 115 Dokumentet mbështetëse</p> | <p>place where the goods are presented to customs.</p> <p>3. Procedural rules for determining the competent Customs offices other than the one referred to in paragraph 1 of this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.</p> <p style="text-align: center;"><u>Subchapter II</u> <u>Standard Customs declaration</u></p> <p style="text-align: center;">Article 114 Content of a standard Customs declaration</p> <p>1. Standard Customs declarations shall contain all the particulars necessary for application of the provisions governing the Customs procedure for which the goods are declared.</p> <p>2. The procedural rules for lodging the standard Customs declaration referred to in this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 115 Supporting documents</p> <p>1. The supporting documents required for the application of the provisions</p> | <p>1. Ministar finansija podzakonskim aktom utvrđuje uslove, lokacije, vreme rada i nadležnosti carinarnica na teritoriji Republike Kosova.</p> <p>2. Nadležna carinarnica za stavljanje robe u carinski postupak jeste carinarnica odgovorna prema mestu na kom se roba doprema, osim ako nije drugačije predviđeno.</p> <p>3. Proceduralna pravila za određivanje carinarnica, osim onih iz stava 1. ovog člana, utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.</p> <p style="text-align: center;"><u>Odeljak II</u> <u>Redovne carinske deklaracije</u></p> <p style="text-align: center;">Član 114 Sadržaj redovne carinske deklaracije</p> <p>1. Redovna deklaracija sadrži sve podatke neophodne za primenu odredaba koje uređuju carinski postupak za koji se roba deklarirše.</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>1. Dokumentet mbështetëse të kërkuara për zbatimin e dispozitave që rregullojnë procedurën doganore për të cilën janë deklaruar mallrat, duhet të jene në posedim nga deklaruesi dhe t'u vihen në dispozicion Doganës në momentin kur depozitohet deklarata doganore.</p> <p>2. Dokumentet mbështetëse u vihen në dispozicion Doganës kur kjo kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose kur është e nevojshme për qëllime të kontrolleve doganore.</p> <p>3. Në raste të veçanta, operatorët ekonomikë mund të përpilojnë dokumentet mbështetëse, me kusht që të jenë të autorizuar nga Dogana për këtë qëllim.</p> <p>4. Rregullat për dhënien e autorizimit të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij Neni, përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa.</p> <p>5. Rregullat procedurale për vënien në dispozicion të dokumenteve mbështetëse, të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli III</u></p> | <p>governing the Customs procedure for which the goods are declared shall be in the declarant's possession and at the disposal of the Customs at the time when the Customs declaration is lodged.</p> <p>2. Supporting documents shall be provided to the Customs where legislation in force so requires or where necessary for Customs controls.</p> <p>3. In specific cases, economic operators may draw up the supporting documents provided they are authorized to do so by the Customs.</p> <p>4. Laying down the rules for granting the authorization referred to in paragraph 3 of this article, are determined by Government sublegal act on the proposal of the ministry responsible for finance.</p> <p>5. The procedural rules on the making available of the supporting documents referred to in paragraph 1 of this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.</p> <p style="text-align: center;"><u>Sub chapter III</u> <u>Simplified customs declaration</u></p> | <p>2. Proceduralna pravila za podnošenje redovne deklaracije prema ovom članu utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.</p> <p style="text-align: center;">Član 115 Prateće isprave</p> <p>1. Prateće isprave neophodne za primenu odredaba kojima se uređuje carinski postupak za koji se roba deklarise u posedu su deklaranta i na raspolaganju Carini u vreme kada se podnosi deklaracija.</p> <p>2. Prateće isprave se dostavljaju carinskom organu ako se zahteva prema propisima Republike Kosova ili ako su neophodne za carinsku kontrolu.</p> <p>3. U posebnim slučajevima, privredni subjekti mogu sastaviti prateće isprave pod uslovom da su za to dobili odobrenje od Carine.</p> <p>4. Vlada Republike Kosova podzakonskim aktom propisuje uslove za davanje odobrenja iz stava 3. ovog člana na predlog Ministarstva nadležnog za finansije.</p> |
|--|---|---|

Deklaratat doganore të thjeshtëzuara

Neni 116

Deklarata e thjeshtëzuar

1. Dogana mund të pranoj që një person të vendosë mallrat nën një procedurë doganore në bazë të një deklarate të thjeshtëzuar, e cila mund të anashkalojë paraqitjen e disa të dhënave, sipas përcaktimeve të nenit 114 ose të dokumenteve mbështetëse, sipas përcaktimeve të nenit 115.
2. Përdorimi i rregullt i deklaratës së thjeshtëzuar të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni autorizohet nga Dogana.
3. Kushtet për dhënien e autorizimeve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa.
4. Rregullat procedurale për depozitimimin e deklaratës së thjeshtëzuar sipas këtij Neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.

Neni 117

Deklarata plotësuese

Article 116 Simplified declaration

1. The Customs may accept that a person has goods placed under a Customs procedure on the basis of a simplified declaration which may omit certain of the particulars referred to in Article 114 or the supporting documents referred to in Article 115.
2. The regular use of a simplified declaration referred to in paragraph 1 shall be subject to an authorization from the Customs.
3. The conditions for granting the authorization referred to in paragraph 2 of this article, are determined by Government sublegal act, on the proposal of the ministry responsible for finance.
4. The procedural rules for lodging the simplified declaration referred to this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.

Article 117 Supplementary declaration

1. In the case of a simplified declaration pursuant to Article 116 or of an

5. Proceduralna pravila za stavljanje na raspolaganje pratećih dokumenata iz stava 1. ovog člana, utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.

Odeljak III

Pojednostavljene carinske deklaracije

Član 116

Pojednostavljena deklaracija

1. Carina može da prihvati da lice stavi robu u carinski postupak na osnovu pojednostavljene deklaracije koja ne sadrži neke podatke navedene u članu 114. ovog zakona ili da uz nju ne priloži neke od isprava iz člana 115. ovog zakona.
2. Redovnu upotrebu pojednostavljene deklaracije iz stava 1. ovog člana odobrava carinski organ.
3. Uslovi za izdavanje ovlašćenja iz stava 2. ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom Vlade na predlog Ministarstva nadležnog za finansije.

| | | |
|---|---|---|
| <p>1. Në rastin e një deklarate të thjeshtëzuar, sipas përcaktimeve të nenit 116 ose evidentimit në regjistrat e deklaruesit, sipas përcaktimeve të nenit 125, deklaruesi depoziton në zyrën doganore kompetente brenda një afati të caktuar, një deklaratë plotësuese, e cila përmban të dhënat e nevojshme për procedurën doganore përkatëse.</p> <p>2. Në rastin e një deklarate të thjeshtëzuar sipas përcaktimeve të nenit 116, dokumentet mbështetëse të nevojshme duhet të jenë në posedim të deklaruesit dhe në dispozicion të Doganës brenda një afati kohor të caktuar.</p> <p>3. Deklarata plotësuese mund të jetë e një natyre të përgjithshme, periodike ose përmbledhëse.</p> <p>4. Depozitimi i deklaratës plotësuese nuk është i detyrueshëm në rastet e mëposhtme:</p> <p>4.1. kur mallrat vendosen nën procedurën e magazinës doganore;</p> <p>4.2. në raste të tjera të veçanta.</p> | <p>entry in the declarant's records pursuant to Article 125, the declarant shall lodge a supplementary declaration containing the particulars necessary for the Customs procedure concerned at the competent Customs office within a specific time-limit.</p> <p>2. In the case of a simplified declaration pursuant to Article 116, the necessary supporting documents shall be in the declarant's possession and at the disposal of Customs within a specific time-limit.</p> <p>3. The supplementary declaration may be of a general, periodic or recapitulative nature.</p> <p>4. The obligation to lodge a supplementary declaration shall be waived in the following cases:</p> <p>4.1. Where the goods are placed under a customs warehousing procedure;</p> <p>4.2. in other specific cases.</p> <p>5. Customs may waive the requirement to lodge a supplementary declaration where the following conditions apply:</p> | <p>4. Proceduralna pravila za podnošenje pojednostavljene deklaracije prema ovom članu utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.</p> <p style="text-align: center;">Član 117 Dopunska deklaracija</p> <p>1. U slučaju upotrebe pojednostavljene deklaracije iz člana 116. ovog zakona ili evidentiranja u poslovnim knjigama deklaranta u skladu sa članom 125. ovog zakona, deklarant je dužan da nadležnoj carinarnici, u određenom roku, podnese dopunsku deklaraciju koja sadrži podatke neophodne za dati carinski postupak.</p> <p>2. U slučaju upotrebe pojednostavljene deklaracije iz člana 116. ovog zakona, neophodne prateće isprave zadržava deklarant i na raspolaganju su Carini u određenom roku.</p> <p>3. Dopunska deklaracija može biti opšta, periodična ili zbirna.</p> <p>4. Od obaveze podnošenja dopunske deklaracije može se odustati u sledećim slučajevima:</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|--|--|
| <p>5. Dogana mund të mos kërkoj depozitim e një deklarate plotësuese kur zbatohen kushtet e mëposhtme:</p> <p>5.1. deklarata e thjeshtëzuar ka të bëjë me mallra, vlera dhe sasia e të cilave është nën nivelin e pragut statistikor;</p> <p>5.2. deklarata e thjeshtëzuar i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për procedurën doganore përkatëse; dhe</p> <p>5.3. deklarata e thjeshtëzuar nuk është bërë me anë të evidentimit në regjistrat e deklaruesit.</p> <p>6. Deklarata e thjeshtëzuar, referuar nenit 116, ose evidentimit në regjistrat e deklaruesit sipas përcaktimeve të nenit 125, dhe deklarata plotësuese, konsiderohen që përbëjnë një akt të vetëm e të pandashëm që hyn në fuqi, respektivisht, në datën kur deklarata e thjeshtëzuar është pranuar sipas përcaktimeve të nenit 120 dhe në datën në të cilën mallrat janë regjistruar në regjistrat e deklaruesit.</p> <p>7. Për qëllime të nenit 59, vendi ku depozitohet deklarata plotësuese</p> | <p>5.1. the simplified declaration concerns goods the value and quantity of which is below the statistical threshold;</p> <p>5.2. The simplified declaration already contains all the information needed for the Customs procedure concerned; and</p> <p>5.3. The simplified declaration is not made by entry in the declarant's records.</p> <p>6. The simplified declaration referred to in Article 116 or the entry in the declarant's records referred to in Article 125, and the supplementary declaration shall be deemed to constitute a single, indivisible instrument taking effect, respectively, on the date on which the simplified declaration is accepted in accordance with Article 120 and on the date on which the goods are entered in the declarant's records.</p> <p>7. The place where the supplementary declaration is to be lodged for the purposes of Article 59, to be the place where the Customs declaration has been lodged.</p> | <p>4.1. ako se roba stavlja u postupak carinskog skladištenja;</p> <p>4.2. u drugim slučajevima.</p> <p>5. Carina može odustati od zahteva za podnošenjem dopunske deklaracije pod sledećim uslovima:</p> <p>5.1. ako se pojednostavljena deklaracija odnosi na robu čija su vrednost i količina ispod nivoa statističkog praga;</p> <p>5.2. ako pojednostavljena deklaracija sadrži sve informacije koje su potrebne za dati carinski postupak; i</p> <p>5.3. ako pojednostavljena deklaracija nije sačinjena evidentiranjem u poslovnim knjigama deklaranta.</p> <p>6. Pojednostavljena deklaracija iz člana 116. ovog zakona ili evidentiranje u poslovnim knjigama deklaranta iz člana 125. ovog zakona i dopunska deklaracija čine celinu na koju se primenjuju propisi koji važe na dan prihvatanja pojednostavljene deklaracije u skladu sa</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>konsiderohet vendi ku është depozituar deklarata doganore.</p> <p>8. Me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa përcaktohen :</p> <p>8.1. afatet kohore të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, brenda të cilave depozitohet deklarata plotësuese;</p> <p>8.2. afatet kohore të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, brenda të cilave dokumentet mbështetëse duhet të jenë në posedim të deklaruesit;</p> <p>8.3. rastet e veçanta kur depozitimi i deklaratës plotësuese nuk është i detyrueshëm, sipas nën paragrafit 4.2 të këtij Neni.</p> <p>9. Rregullat procedurale për depozitimin e deklaratës plotësuese sipas këtij Neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> <p><u>Nënkapitulli IV</u></p> | <p>8. By sublegal act on the proposal of the ministry responsible for finance are determined:</p> <p>8.1. The specific time-limit referred to in the first paragraph 1 of this Article within which the supplementary declaration is to be lodged;</p> <p>8.2. the specific time-limit referred to in the second paragraph of this Article, within which supporting documents are to be in the possession of the declarant;</p> <p>8.3. the specific cases where the obligation to lodge a supplementary declaration is waived in accordance with subparagraph 4.2 of this Article.</p> <p>9. The procedural rules for the supplementary declaration referred to this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.</p> <p><u>Sub chapter IV</u> <u>Provisions applying to all customs declarations</u></p> <p>Article 118</p> | <p>članom 120. ovog zakona i na dan kada se roba evidentira u poslovnim knjigama deklaranta.</p> <p>7. Mesto na kom je podneta dopunska deklaracija smatra se mestom nastanka carinskog duga, u skladu sa članom 59. ovog zakona.</p> <p>8. Podzakonskim aktom Vlade na predlog Ministarstva nadležnog za finansije određuju se:</p> <p>8.1. rokove iz stava 1. ovog člana u kojima se podnosi dopunska izjava;</p> <p>8.2. rokove iz stava 2. ovog člana u kojima deklarant mora da ima u posedu prateću dokumentaciju;</p> <p>8.3. posebni slučajevi kada podnošenje dopunske deklaracije nije obavezno, shodno podstava 4.2 ovog člana.</p> |
|---|--|--|

Dispozita të zbatueshme për të gjitha deklaratat doganore

**Neni 118
Depozitimi i deklaratës doganore**

1. Pavarësisht zbatimit të paragrafit 1 të nenit 117, një deklaratë doganore mund të depozitohet nga çdo person që mund të paraqesë të gjitha informacionet të cilat kërkohen për zbatimin e dispozitave që rregullojnë procedurën doganore për të cilën janë deklaruar mallrat. Ky person duhet të jetë gjithashtu në gjendje të paraqesë mallrat në fjalë ose të bëjë të mundur paraqitjen e tyre në Doganë.
2. Megjithatë, kur pranimi i një deklarate doganore imponon obligime të veçanta mbi një person të caktuar, kjo deklaratë bëhet nga ai person apo nga përfaqësuesi i tij.
3. Deklaruesi duhet të jetë i vendosur në territorin doganor të Republikës së Kosovës.
4. Përjashtimisht nga ajo që është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij Neni, për deklaruesit e mëposhtëm nuk kërkohet të jenë të vendosur brenda territorit doganor të Republikës së Kosovës:

Lodging a Customs declaration

1. Without prejudice to paragraph 1 of Article 117, a Customs declaration may be lodged by any person who is able to provide all of the information which is required for the application of the provisions governing the Customs procedure in respect of which the goods are declared. That person shall also be able to present the goods in question or to have them presented to customs.
2. However, where acceptance of a Customs declaration imposes particular obligations on a specific person, that declaration shall be lodged by that person or by his or her representative.
3. The declarant shall be established in the Customs territory of the Republic of Kosovo.
4. By way of derogation from paragraph 3 of this article, the following declarants shall not be required to be established in the Customs territory of the Republic of Kosovo:
 - 4.1. Persons who lodge a Customs declaration for transit or temporary admission;

9. Proceduralna pravila za podnošenje dopunske deklaracije prema ovom članu utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.

Odeljak IV
Odredbe koje se primenjuju na sve carinske deklaracije

Član 118
Podnošenje carinske deklaracije

1. Ne isključujući primenu odredbe člana 117. st. 1. ovog zakona, carinsku deklaraciju može da podnese svako lice koje može da pruži sve informacije koje su potrebne za primenu odredaba kojima se uređuje carinski postupak za koji se roba deklarirše i koje mora da bude u mogućnosti da dopremi robu ili da organizuje da se roba dopremi carinarnici.
2. Ako prihvatanje carinske deklaracije nameće posebne obaveze za određeno lice, deklaraciju mora da podnese to lice ili njegov zastupnik.
3. Deklarant mora biti poslovno nastanjen u carinskom području Republike Kosova.

| | | |
|--|--|--|
| <p>4.1. personat, të cilët depozitojnë një deklaratë doganore transiti apo import të përkohshëm;</p> <p>4.2. personat, të cilët depozitojnë kohë pas kohe një deklaratë doganore, përfshirë deklaratat për përdorimin e veçantë përfundimtar ose përpunim e brendshëm, me kusht që Dogana të konsideroj këtë deklaram të arsyeshëm;</p> <p>4.3. personat që janë të vendosur në një vend kufitar me territorin doganor të Republikës se Kosovës dhe që paraqesin mallra te cilave u referohet deklarata doganore në një doganë kufitare me vendin kufitar të sipërpërmendur, me kusht që ai vend kufitar, në cilin janë vendosur personat, u jep përfitime reciproke personave të vendosur në territorin doganor te Republikës se Kosovës.</p> <p>5. Deklarata doganore duhet të vërtetohet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 119 Depozitimi i një deklarate doganore para paraqitjes së mallrave</p> | <p>4.2. Persons, who occasionally lodge a Customs declaration, including for end-use or inward processing, provided that the Customs consider this to be justified;</p> <p>4.3. persons who are established in a country the territory of which is adjacent to the Customs territory of the Republic of Kosovo, and who present the goods to which the Customs declaration refers at a border Customs office adjacent to that country, provided that the country in which the persons are established grants reciprocal benefits to persons established in the Customs territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>5. Customs declarations shall be authenticated.</p> <p style="text-align: center;">Article 119 Lodging a Customs declaration prior to the presentation of the goods</p> <p>1. A Customs declaration may be lodged prior to the expected presentation of the goods to customs. If the goods are not presented within thirty (30) days of lodging</p> | <p>4. Izuzetno od stava 3. ovog člana, deklarant ne mora biti poslovno nastanjen u carinskom području Republike Kosova, ako:</p> <p>4.1. podnosi deklaraciju za tranzit ili privremeni uvoz;</p> <p>4.2. povremeno podnosi deklaraciju, uključujući i deklaraciju za upotrebu u posebne svrhe ili aktivno oplemenjivanje, pod uslovom da Carina smatra to opravdanim;</p> <p>4.3. je poslovno nastanjen u zemlji, odnosno teritoriji koja se graniči sa carinskim područjem Republike Kosova, a robu na koju se deklaracija odnosi, doprema carinarnici na granici, odnosno administrativnoj liniji sa tom zemljom, pod uslovom da ta zemlja, u kojoj je on poslovno nastanjen odobrava recipročne povlastice licima poslovno nastanjenim u carinskom području Republike Kosova.</p> |
|--|--|--|

1. Një deklaratë doganore mund të depozitohet para paraqitjes së prishme të mallrave në Doganë. Në qoftë se mallrat nuk paraqiten brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e depozitimit të deklaratës, deklarata doganore konsiderohet sikur të mos ishte depozituar.

2. Rregullat procedurale për depozitim të deklaratës doganore sipas këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.

Neni 120 **Pranimi i një deklarate doganore**

1. Deklaratat doganore, të cilat përmbushin kushtet e përcaktuara në këtë Kapitull, pranohen menjëherë nga Dogana, me kusht që mallrat, të cilave ato u referohen, të jenë paraqitur në Doganë.

2. Data e pranimit të deklaratës doganore nga Dogana, përveç kur parashihet ndryshe, është data që do të përdoret për zbatimin e dispozitave që rregullojnë procedurën doganore për të cilën mallrat janë deklaruar dhe për të gjitha formalitetet e tjera të importit apo eksportit.

of the Customs declaration, the Customs declaration shall be deemed not to have been lodged.

2. The procedural rules for lodging a Customs declaration in accordance with this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.

Article 120 **Acceptance of a Customs declaration**

1. Customs declarations which comply with the conditions laid down in this Chapter shall be accepted by the Customs immediately, provided that the goods to which they refer have been presented to customs.

2. The date of acceptance of the Customs declaration by the Customs shall, except where otherwise provided, be the date to be used for the application of the provisions governing the Customs procedure for which the goods are declared and for all other import or export formalities.

3. The procedural rules for accepting a Customs declaration as referred to this Article, including the application of those rules in the cases referred to in Article 124,

5. Carinska deklaracija mora biti overena.

Član 119 **Podnošenje carinske deklaracije pre doremanja robe**

1. Carinska deklaracija može biti podneta pre očekivanog doremanja robe carinarnici. Ako se roba ne dopremi u roku od trideset (30) dana od dana podnošenja deklaracije, smatra se da deklaracija nije podneta.

2. Proceduralna pravila za podnošenje carinske deklaracije prema ovom članu utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.

Član 120 **Prihvatanje carinske deklaracije**

1. Carina odmah prihvata deklaraciju koja je podneta u skladu sa odredbama iz ove glave, pod uslovom da je roba za koju se podnosi deklaracija dopremljena carinarnici.

2. Datum prihvatanja carinske deklaracije od strane Carine, osim ako nije drukčije propisano, je datum koji se koristi

3. Rregullat procedurale për pranimin e një deklarate doganore, sipas këtij Neni, përfshirë dhe zbatimin e rregullave për rastet e parashikuara në nenin 124, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.

Neni 121
Ndryshimi i një deklarate doganore

1. Deklaruesi përmes aplikimit i lejohet të ndryshojë një apo më shumë të dhëna në deklaratën doganore pasi deklarata doganore është pranuar nga Dogana. Ndryshimi nuk e bën deklaratën doganore të zbatueshme për mallra tjera nga ato që janë deklaruar fillimisht në të.

2. Asnjë ndryshim i tillë nuk mund të lejohet kur kërkesa bëhet pasi Dogana:

2.1. ka informuar deklaruesin që mallrat do të ekzaminohen;

2.2. ka konstatuar se të dhënat në deklaratën doganore janë të pasakta;

2.3. i ka lëshuar mallrat.

and are determined by Minister of Finance sublegal act.

Article 121
Amendment of a Customs declaration

1. The declarant shall, upon application, be permitted to amend one or more of the particulars of the Customs declaration after that declaration has been accepted by customs. The amendment shall not render the Customs declaration applicable to goods other than those which it originally covered.

2. No such amendment shall be permitted by customs where it is applied for after any of the following events:

2.1. have informed the declarant that they intend to examine the goods;

2.2. have established that the particulars of the Customs declaration are incorrect;

2.3. have released goods.

3. Upon application by the declarant, within three (3) years of the date of acceptance of the Customs declaration, the

za primenu odredaba koje regulišu carinski postupak za koji je roba deklarirana i za sve druge uvozne ili izvozne formalnosti.

3. Proceduralna pravila za prihvatanje carinske deklaracije, prema ovom članu, uključujući primenu pravila za slučajeve predviđene članom 124, utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.

Član 121
Izmena carinske deklaracije

1. Deklarant može na sopstveni zahtev, posle prihvatanja deklaracije, uz odobrenje Carine, da izmeni ili dopuni jedan ili više podataka u carinsku deklaraciji. Izmene deklaracije se ne mogu odnositi na drugu robu, osim one koju je prvobitno obuhvatala.

2. Izmena deklaracije se neće odobriti ako je zahtev za izmenu podnet nakon što je Carina:

2.1. obavestio deklaranta da namerava da izvrši pregled robe;

| | | |
|---|---|---|
| <p>3. Me aplikim nga deklaruesi, brenda tre (3) vjetëve nga data e pranimit të deklaratës doganore, mund të lejohet ndryshimi i deklaratës doganore pas lëshimit të mallrave, me qëllim që deklaruesi të përmbushë obligimet e tij ose saj të lidhura me vënien e mallrave nën procedurën doganore përkatëse.</p> <p>4. Rregullat procedurale për ndryshimin e deklaratës doganore pas lëshimit të mallrave sipas paragrafit 3 të këtij Neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> <p style="text-align: center;">Neni 122 Anulimi i një deklarate doganore</p> <p>1. Dogana, në bazë të aplikimit nga deklaruesi, anulon një deklaratë doganore, tashmë të pranuar, në rastet e mëposhtme:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. kur vlerëson se mallrat do të vendosen menjëherë në një procedurë tjetër doganore;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. kur vlerëson se, si rezultat i rrethanave të veçanta, vendosja e mallrave nën procedurën doganore</p> | <p>amendment of the Customs declaration may be permitted after release of the goods in order for the declarant to comply with his or her obligations relating to the placing of the goods under the Customs procedure concerned.</p> <p>4. The procedural rules for amending the Customs declaration after the release of the goods in accordance with paragraph 3 of this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 122 Invalidation of a Customs declaration</p> <p>1. Customs shall, upon application by the declarant, invalidate a Customs declaration already accepted in either of the following cases:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. where they are satisfied that the goods are immediately to be placed under another Customs procedure;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. Where they are satisfied that, as a result of special circumstances, the placing of the goods under the Customs procedure for which they were declared is no longer justified.</p> | <p style="padding-left: 40px;">2.2. utvrdio da su podaci čija se izmena traži netačni;</p> <p style="padding-left: 40px;">2.3. pustio robu deklarantu.</p> <p>3. Na zahtev deklaranta, u roku od tri (3) godine od dana prihvatanja deklaracije, izmena deklaracije može da se odobri posle puštanja robe kako bi deklarant ispunio svoje obaveze u vezi sa stavljanjem robe u određeni carinski postupak.</p> <p>4. Proceduralna pravila za izmenu carinske deklaracije nakon puštanja robe iz stava 3. ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.</p> <p style="text-align: center;">Član 122 Poništavanje carinske deklaracije</p> <p>1. Carina na zahtev deklaranta, poništava prihvaćenu deklaraciju u nekom od sledećih slučajeva:</p> |
|---|---|---|

nën të cilin ishin deklaruar, nuk është më e arsyeshme.

2. Pavarësisht paragrafit 1 të këtij neni, kur Dogana ka informuar deklaruesin që mallrat do të ekzaminohen, aplikimi për anulimin e deklaratës doganore nuk pranohet para se të jetë kryer ekzaminimi.

3. Deklarata doganore nuk anulohet pasi mallrat janë lëshuar, përveç kur parashihet ndryshe.

4. Rastet kur një deklaratë doganore anulohet pas lëshimit të mallrave sipas paragrafit 3 të këtij Neni, përcaktohet me akt nënligjor të Qeverisë, me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa.

Nënkapitulli V **Thjeshtësimet tjera**

Neni 123

Thjeshtësimi i përpilimit të deklaratës doganore për mallrat që klasifikohen në nënkrere të ndryshme tarifore

2. However, where the Customs have informed the declarant of their intention to examine the goods, an application for invalidation of the Customs declaration shall not be accepted before the examination has taken place.

3. Customs declaration shall not be invalidated after the goods have been released unless where otherwise provided.

4. The cases where the Customs declaration is invalidated after the release of the goods, as referred to paragraph 3 of this Article are determined by sublegal act of Government on the proposal of the ministry responsible for finance.

Subchapter V **Other simplification**

Article 123

Simplification of the drawing-up of Customs declarations for goods falling under different tariff subheadings

1. Where a consignment is made up of goods falling within different tariff subheadings, and dealing with each of those goods in accordance with its tariff subheading for the purpose of drawing-up

1.1. ako ocenjuje da će roba odmah biti stavljena u drugi carinski postupak;

1.2. ako ocenjuje da, zbog posebnih okolnosti, stavljanje robe u carinski postupak za koji je deklarirana nije više opravdano.

2. Ako je Carina obavestila deklaranta o svojoj nameri da pregleda robu, zahtev za poništavanje deklaracije neće se prihvatiti dok se pregled ne obavi.

3. Carinska deklaracija se ne može poništiti nakon puštanja robe deklarantu, osim u slučajevima kada je drukčije propisano.

4. Slučajevi kada se carinska deklaracija poništi nakon puštanja robe u skladi sa stavom 3. ovog člana, određuju se podzakonskim aktom Vlade na predlog Ministarstva nadležnog za finansije.

Odeljak V

1. Kur një ngarkesë është e përbërë nga mallra, që u përkasin nënkrerëve të ndryshëm tariforë dhe përpilimi i deklaratës doganore për secilin prej këtyre mallrave, sipas nënkrerëve të tyre tariforë, do të kërkonte punë dhe shpenzime në shpërpjesëtim me detyrimet e importit dhe eksportit për t'u paguar, Dogana në bazë të aplikimit nga deklaruesi, mund të pajtohet që detyrimet doganore në import dhe eksport të aplikohen mbi të gjithë ngarkesën, bazuar në nënkreun tarifor të mallit, i cili ka nivelin tarifor më të lartë të detyrimit doganor në import apo eksport.

2. Dogana refuzon përdorimin e thjeshtësimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Neni për mallra që janë objekt i ndalesave ose kufizimeve, ose i detyrimeve të akcizës kur klasifikimi i saktë është i nevojshëm me qëllim të zbatimit të masave.

3. Masat për përcaktimin e nënkrerëve tarifor për zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë përkatës për Financa.

Neni 124 Zhdoganimi qendror

1. Dogana, mund të autorizoj një person të depozitojë në zyrën doganore

the Customs declaration would entail a burden of work and expense disproportionate to the import or export duty chargeable, the Customs may, upon application by the declarant, agree that import or export duty be charged on the whole consignment on the basis of the tariff subheading of the goods which are subject to the highest rate of import or export duty.

2. Customs shall refuse the use of the simplification referred to in paragraph 1 of this article to goods subject to prohibitions or restrictions or excise duty where the correct classification is necessary to apply the measure.

3. Measures for the determination of the tariff subheading for the application of paragraph 1 of this Article, are determined by Minister of Finance sublegal act.

Article 124 Centralized clearance

1. Customs may authorize a person to lodge at a Customs office responsible for the place where such person is established, a Customs declaration for goods which are presented to Customs at another Customs office.

Ostala pojednostavljenja

Član 123

Pojednostavljenje carinske deklaracije za robu iz različitih tarifnih oznaka

1. Ako se uvozi ili izvozi pošiljka koja se sastoji od robe koja se svrstava u više tarifnih oznaka, a postupanje sa svakom od te robe u skladu sa njenom tarifnom oznakom, da bi se sačinila deklaracija, bi iziskivalo rad i troškove nesrazmerne uvoznim ili izvoznim dažbinama koje bi trebalo platiti, Carina može, na zahtev deklaranta, dozvoliti da se uvozne ili izvozne dažbine obračunaju za celu pošiljku na osnovu tarifne oznake robe sa najvišom stopom carine na uvozu ili izvozu.

2. Carina neće odobriti pojednostavljenje iz stava 1. ovog člana za robu koja je predmet zabrana ili ograničenja ili naplate akcize, ako je pravilno svrstavanje neophodno za primenu te mere.

3. Mere za utvrđivanje tarifnih oznaka za primenu stava 1. ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija.

| | | |
|---|---|--|
| <p>përgjegjëse për vendin ku është vendosur personi, një deklaratë doganore për mallrat të cilat janë paraqitur në një zyrë tjetër doganore.</p> <p>2. Zyra doganore, në të cilën është depozituar deklarata do të:</p> <p>2.1. mbikëqyr vendosjen e mallrave nën procedurën doganore përkatëse;</p> <p>2.2. kryen kontrollet doganore për verifikimin e deklaratës doganore, sipas përcaktimeve të nën paragrafëve 1.1 dhe 1.2 të nenit 127.</p> <p>2.3. kur është e arsyeshme, kërkon që zyra doganore, në të cilën janë paraqitur mallrat, të kryejë kontrollet doganore për verifikimin e deklaratës doganore, të përcaktuar në nën paragrafët 1.3 dhe 1.4 të nenit 127.</p> <p>2.4. kryen formalitetet doganore për rikthimin e shumës së detyrimit të importit ose eksportit që i korrespondon cilit do borxhi doganor.</p> | <p>2. Customs office at which the Customs declaration is lodged shall:</p> <p>2.1. supervise the placing of the goods under the Customs procedure concerned;</p> <p>2.2. carry out the customs controls for the verification of the Customs declaration, referred to in sub paragraphs 1.1 and 1.2 of Article 127;</p> <p>2.3. where justified, request that the Customs office at which the goods are presented carry out the Customs controls for the verification of the Customs declaration referred to in sub paragraphs 1.3 and 1.4 of Article 127; and</p> <p>2.4. Carry out the customs formalities for the recovery of the amount of import or export duty corresponding to any Customs debt.</p> <p>3. Customs office at which the Customs declaration is lodged and the Customs office at which the goods are presented shall exchange the information necessary for the verification of the</p> | <p style="text-align: center;">Član 124 Centralizovano carinjenje</p> <p>1. Carina moŹe da odobri licu, da carinsku deklaraciju za robu podnese carinarnici nadleŹnoj prema mestu gde je to lice poslovno nastanjeno, a roba se doprema drugoj carinarnici.</p> <p>2. Carinarnica u kojoj je podneta deklaracija duŹan je da:</p> <p>2.1. nadzire stavljanje robe u određeni carinski postupak;</p> <p>2.2. sprovodi carinske kontrole radi provere deklaracije, iz člana 127 podstav 1.1 i 1.2 ovog zakona;</p> <p>2.3. zahteva, ako je opravdano, da carinarnica kojoj je roba dopremljena sprovede carinske kontrole radi provere deklaracije iz člana 127 podstav 1.3 i 1.4; i</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>3. Zyra doganore në të cilën është depozituar deklarata doganore dhe zyra doganore në të cilën paraqiten mallrat, shkëmbejnë informacionin e nevojshëm për verifikimin e deklaratës doganore dhe për lëshimin e mallrave.</p> <p>4. Zyra doganore, në të cilën janë paraqitur mallrat, përveç kontrolleve të saj të lidhura me mallrat që sjellën ose largohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës, kryen kontrollet doganore, të përcaktuara në nën paragrafin 3.3 të këtij Neni, dhe i njofton zyrës doganore, në të cilën është depozituar deklarata doganore rezultatet e kontrollit.</p> <p>5. Zyra doganore, në të cilën depozitohet deklarata doganore, lëshon mallrat në përputhje me nenin 132 dhe 133, duke marrë në konsideratë:</p> <p>5.1. rezultatet e kontrolleve të saj për verifikimin e deklaratës doganore;</p> <p>5.2. rezultatet e kontrolleve të kryera nga zyra doganore, në të cilën janë paraqitur mallrat, për verifikimin e deklaratës doganore dhe të kontrolleve që lidhen me mallrat që sjellën ose largohen nga</p> | <p>Customs declaration and for the release of the goods.</p> <p>4. Customs office at which the goods are presented shall, without prejudice to its own controls pertaining to goods brought into or taken out of the Customs territory of the Republic of Kosovo, carry out the Customs controls referred to in subparagraph 3.3 of this article and provide the Customs office at which the Customs declaration is lodged with the results of these controls.</p> <p>5. Customs office at which the Customs declaration is lodged shall release the goods in accordance with Articles 132 and 133, taking into account:</p> <p>5.1. The results of its own controls for the verification of the Customs declaration;</p> <p>5.2. The results of the controls carried out by the Customs office at which the goods are presented for the verification of the Customs declaration and the controls pertaining to goods brought into or taken out of the Customs territory of the Republic of Kosovo.</p> | <p>2.4. sprovodi carinske formalnosti za naplatu uvoznih ili izvoznih dažbina koje odgovaraju carinskom dugu.</p> <p>3. Carinarnica kojoj se podnosi deklaracija i carinarnica kojoj se roba doprema razmenjuju informacije neophodne za proveru carinske deklaracije i za puštanje robe.</p> <p>4. Carinarnica kojoj se roba doprema, pored kontrola koje vrši u vezi sa robom unetom u carinsko područje Republike Kosova ili iznetom iz njega, sprovodi i carinske kontrole iz stava 3.3 ovog člana i rezultate tih kontrola dostavlja carinarnici kojoj se deklaracija podnosi.</p> <p>5. Carinarnica kojoj je podneta deklaracija pušta robu u skladu sa odredbama član 132. i 133, uzimajući u obzir:</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 166 Largimi i mallrave nga një zonë e lirë</p> <p>1. Pavarësisht zbatimit të legjislacionit të fushave të tjera të ndryshme nga fusha doganore, mallrat në një zonë të lirë mund të eksportohen ose ri eksportohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës</p> | <p style="text-align: center;">Article 166 Taking goods out of a free zone</p> <p>1. Without prejudice to legislation in fields other than customs, goods in a free zone may be exported or re-exported from the Customs territory of the Republic of Kosovo, or brought into another part of the</p> | <p style="text-align: center;">Član 166 Iznošenje robe iz slobodne zone</p> <p>1. Ne isključujući primenu drugih propisa iz carinske oblasti, roba iz slobodne zone može se izvesti ili ponovo izvesti sa carinskog područja Republike</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>ose sjellën në një pjesë tjetër të territorit doganor të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Për mallrat që largohen nga zona e lirë në pjesë të tjera të territorit doganor të Republikës së Kosovës zbatohen nenet 95 deri në 107.</p> <p style="text-align: center;">Neni 167 Statusi doganor</p> <p>1. Kur mallrat e larguara nga një zonë e lirë sjellën në një pjesë tjetër të territorit doganor të Republikës së Kosovës ose vendosen nën një procedurë doganore, ato konsiderohen si mallra jo kosovare, përveç kur provohet statusi i tyre doganor si mallra kosovare.</p> <p>2. Megjithatë, për qëllim të aplikimit të detyrimit të eksportit dhe licencave të eksportit ose të masave të kontrollit të eksportit të përcaktuara në politikat bujqësore ose tregtare, mallra të tilla do të konsiderohen si mallra kosovare, përveç kur përcaktohet që ato nuk kanë statusin doganor të mallrave kosovare.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI IV PËRDORIMI I VEÇANTË</p> <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli I</u></p> | <p>Customs territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Articles 95 to 107 shall apply to goods taken out of a free zone into other parts of the Customs territory of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: center;">Article 167 Customs status</p> <p>1. Where goods are taken out of a free zone into another part of the Customs territory of the Republic of Kosovo or placed under a Customs procedure, they shall be regarded as non-Kosovo goods unless their Customs status as Kosovo goods has been proven.</p> <p>2. However, for the purposes of applying export duty and export licenses or export control measures laid down under the common agricultural or commercial policies, such goods shall be regarded as Kosovo goods, unless it is established that they do not have the Customs status of Kosovo goods.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER IV SPECIFIC USE</p> <p style="text-align: center;"><u>Sub chapter I</u></p> | <p>Kosova ili uneti na drugi deo carinskog područja Republike Kosova.</p> <p>2. Odredbe član 95 do 107 primenjuju se na robu iznetu iz slobodne zone u druge delove carinskog područja Republike Kosova.</p> <p style="text-align: center;">Član 167 Carinski status robe</p> <p>1. Ako se roba iznese iz slobodne zone na drugi deo carinskog područja Republike Kosova ili stavi u carinski postupak, smatra se stranom robom, osim ako njen carinski status kao domaće robe nije bio dokazan.</p> <p>2. Radi primene izvoznih dažbina, izvoznih dozvola ili izvoznih kontrolnih mera utvrđenih poljoprivrednom ili trgovinskom politikom, takva roba se smatra domaćom robom, osim ako nije utvrđeno da nema carinski status domaće robe.</p> <p style="text-align: center;">GLAVA IV POSEBNA UPOTREBA</p> |
|---|--|---|

| <u>Importi i përkohshëm</u> | <u>Temporary admission</u> | |
|---|--|---|
| <p align="center">Neni 168 Fusha e zbatimit</p> | <p align="center">Article 168 Scope</p> | <p align="center"><u>Odeljak I</u> <u>Privremeni uvoz</u></p> |
| <p>1. Nën procedurën e importit të përkohshëm, mallrat jo kosovare të destinuar për riekспорт, mund të jenë objekt i përdorimit të veçante në territorin doganor të Republikës së Kosovës, me lirim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimi i importit dhe pa iu nënshtruar:</p> <p>1.1. pagesave të tjera të përcaktuara sipas dispozitave përkatëse tjera në fuqi;</p> <p>1.2. masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në, ose nga territori doganor i Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Procedura e importit të përkohshëm mund të përdoret vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:</p> <p>2.1 mallrat nuk janë të destinuar të pësojnë asnjë ndryshim, përveç zhvlerësimit normal për shkak të përdorimit të tyre;</p> | <p>1. Under the temporary admission procedure non-Kosovo goods intended for re-export may be subject to specific use in the Customs territory of the Republic of Kosovo, with total or partial relief from import duty, and without being subject to any of the following:</p> <p>1.1. other charges as provided for under other relevant provisions in force;</p> <p>1.2. commercial policy measures, insofar as they do not prohibit the entry or exit of goods into or from the Customs territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The temporary admission procedure may only be used provided that the following conditions are met:</p> <p>2.1. the goods are not intended to undergo any change, except normal depreciation due to the use made of them;</p> | <p align="center">Član 168 Oblast primene</p> <p>1. U postupku privremenog uvoza strana roba namenjena ponovnom izvozu može biti predmet posebne upotrebe na carinskom području Republike Kosova, sa potpunim ili delimičnim oslobođenjem od plaćanja uvoznih dažbina i ne podleže:</p> <p>1.1. drugim dažbinama koje se plaćaju pri uvozu u skladi u skladu sa propisima;</p> <p>1.2. merama trgovinske politike, ako se njima ne zabranjuje ulazak robe na carinsko područje Republike Kosova ili izlazak iz njega.</p> <p>2. Postupak privremenog uvoza može se koristiti ako su ispunjeni sledeći uslovi:</p> <p>2.1. roba nije namenjena podvrgavanju bilo kakvoj izmeni, osim normalnom smanjenju vrednosti usled njene upotrebe;</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>2.2 është e mundur të sigurohet që mallrat e vendosura nën procedurë mund të identifikohen, me përjashtim të rasteve kur duke pasur parasysh natyrën e mallrave ose përdorimin e parashikuar mungesa e masave identifikuese nuk mund të shkaktojë asnjë shkelje të procedurës ose, në rastin e përmendur në nenin 150, është e mundur të verifikohet përputhshmëria me kushtet e përcaktuara për mallrat ekuivalente;</p> <p>2.3 mbajtësi i procedurës është i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Kosovës, përveç kur parashihet ndryshe;</p> <p>2.4 kur plotësohen kërkesat për lirim të plotë ose të pjesshëm të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor.</p> <p>3. Përdorimi i veçantë nga paragrafi 1 i këtij neni dhe kërkesat nga nën paragrafi 2.4 i këtij neni, përcaktohen me akt nënligjor të Qeverisë me propozim të ministrisë përgjegjëse për financa.</p> | <p>2.2. it is possible to ensure that the goods placed under the procedure can be identified, except where, in view of the nature of the goods or of the intended use, the absence of identification measures is not liable to give rise to any abuse of the procedure or, in the case referred to in Article 150, where compliance with the conditions laid down in respect of equivalent goods can be verified;</p> <p>2.3. the holder of the procedure is established outside the Customs territory of the Republic of Kosovo, except where otherwise provided;</p> <p>2.4. the requirements for total or partial duty relief laid down in the Customs legislation are met.</p> <p>3. The specific use referred to in paragraph 1 of this article and the requirements referred to in subparagraph 2.4 of this article, are determined by sublegal act of Government on the</p> | <p>2.2. moguće je obezbediti da se roba koja je stavljena u postupak privremenog uvoza može identifikovati, osim ako, imajući u vidu prirodu robe ili predviđenu upotrebu, zbog odsustva mera za identifikaciju neće doći do zloupotrebe postupka ili, u slučaju iz člana 150. ovog zakona, ako se poštovanje uslova utvrđenih za ekvivalentnu robu može proveriti;</p> <p>2.3. nosilac postupka je poslovno nastanjen van carinskog područja Republike Kosova, osim ako nije drugačije predviđeno;</p> <p>2.4. ispunjeni su uslovi za potpuno ili delimično oslobođenje od plaćanja dažbina utvrđeni carinskim propisima.</p> <p>3. Podzakonskim aktom Vlada na predlog Ministarstva nadležnog za finansije propisuje se slučajevi posebne upotrebe iz stava 1. ovog člana i uslove navedene u podstav 2.4 ovog člana.</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p style="text-align: center;">Neni 169</p> <p style="text-align: center;">Afati kohor gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën procedurën e importit të përkohshëm</p> <p>1. Dogana përcakton afatin kohor, brenda të cilit mallrat e vendosura nën procedurën e importit të përkohshëm ri eksportohen ose i nënshtrohen një procedure doganore pasuese. Ky afat duhet të jetë i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të autorizimit të miratuar.</p> <p>2. Përveç kur parashihet ndryshe, afati kohor maksimal gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën procedurën e importit të përkohshëm për të njëjtin qëllim dhe nën përgjegjësinë e të njëjtit mbajtës të autorizimit, është njëzetekatër (24) muaj, madje edhe kur procedura ishte shkarkuar duke i vendosur mallrat nën një procedurë tjetër të posaçme dhe më tej duke i vendosur ato përsëri nën procedurën e importit të përkohshëm.</p> <p>3. Kur, në rrethana të veçanta, përdorimi i autorizuar nuk mund të arrihet brenda afatit kohor të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Dogana mund të zgjat afatin kohor për një periudhë të arsyeshme,</p> | <p>proposal of the ministry responsible for finance.</p> <p style="text-align: center;">Article 169</p> <p style="text-align: center;">Period during which goods may remain under the temporary admission procedure</p> <p>1. Customs shall determine the period within which goods placed under the temporary admission procedure must be re-exported or placed under a subsequent Customs procedure. Such period shall be long enough for the objective of authorized use to be achieved.</p> <p>2. Except where otherwise provided, the maximum period during which goods may remain under the temporary admission procedure for the same purpose and under the responsibility of the same authorization holder shall be twentyfour (24) months, even where the procedure was discharged by placing the goods under another special procedure and subsequently placing them under the temporary admission procedure again.</p> <p>3. Where, in exceptional circumstances, the authorized use cannot be achieved within the period referred to in paragraphs 1 and 2 of this article, the Customs may grant an extension, of</p> | <p style="text-align: center;">Član 169</p> <p style="text-align: center;">Rok u kom roba može ostati u postupku privremenog uvoza</p> <p>1. Carina određuje rok u kome se roba stavljena u postupak privremenog uvoza mora ponovo izvesti ili staviti u novi carinski postupak. Taj rok mora biti dovoljno dug da svrha odobrene upotrebe može da se ostvari.</p> <p>2. Osim ako nije drugačije predviđeno, maksimalan rok tokom kojeg roba može ostati u postupku privremenog uvoza za iste svrhe i pod odgovornošću istog nosioca odobrenja je dvadeset četiri (24) meseca, čak i ako je postupak okončan stavljanjem robe u drugi poseban postupak i njenim naknadnim stavljanjem, ponovo, u postupak privremenog uvoza.</p> <p>3. Ako se, u izuzetnim okolnostima, odobrena upotreba ne može postići u roku iz st. 1. i 2. ovog člana, Carina može</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>kundrejt një aplikimi të arsyetuar nga ana e mbajtësit të autorizimit.</p> <p>4. I tërë afati kohor, gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën procedurën e importit të përkohshëm, nuk kalon dhjetë (10) vjet, përveç në rast të një situatë të paparashikuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 170 Shuma e detyrimit të importit në rastin e importit të përkohshëm me lirim të pjesshëm nga detyrimi i importit</p> <p>1. Shuma e detyrimit të importit, për mallrat e vendosura nën procedurën e importit të përkohshëm me lirim të pjesshëm nga detyrimi i importit, vendoset në masën tre (3) % të shumës së detyrimit të importit, të pagueshme për këto mallra nëse ato do të ishin lëshuar në qarkullim të lirë në datën, në të cilën ato janë vendosur nën procedurën e importit të përkohshëm.</p> <p>2. Kjo shumë sipas paragrafit 1 të këtij neni është e pagueshme për çdo muaj ose pjesë të muajit, gjatë të cilit mallrat janë vendosur nën procedurën e importit të përkohshëm me lirim të pjesshëm nga detyrimi i importit.</p> | <p>reasonable duration of that period, upon justified application by the holder of the authorization.</p> <p>4. The overall period during which goods may remain under the temporary admission procedure shall not exceed ten (10) years, except in the case of an unforeseeable event.</p> <p style="text-align: center;">Article 170 Amount of import duty in case of temporary admission with partial relief from import duty</p> <p>1. The amount of import duty in respect of goods placed under the temporary admission procedure with partial relief from import duty shall be set at three (3) % of the amount of import duty which would have been payable on those goods had they been released for free circulation on the date on which they were placed under the temporary admission procedure.</p> <p>2. That amount as referred in article 1 of this article shall be payable for every month or fraction of a month during which the goods have been placed under the temporary admission procedure with partial relief from import duty.</p> | <p>odobriti razumno produženje tog roka, na obrazložen zahtev nosioca odobrenja.</p> <p>4. Ukupni rok tokom kojeg roba može ostati u postupku privremenog uvoza ne može biti duži od deset (10) godina, osim u slučaju nepredviđenog događaja.</p> <p style="text-align: center;">Član 170 Iznos uvoznih dažbina u slučaju privremenog uvoza sa delimičnim oslobođenjem od plaćanja uvoznih dažbina</p> <p>1. Iznos uvoznih dažbina za robu stavljenu u postupak privremenog uvoza sa delimičnim oslobođenjem od plaćanja uvoznih dažbina je tri (3) % od iznosa uvoznih dažbina koji bi trebalo da se plati na tu robu da je stavljena u slobodan promet na dan kada je stavljena u postupak privremenog uvoza.</p> <p>2. Iznos iz stava 1 ovog člana se naplaćuje se za svaki mesec ili za deo meseca u kojem se roba nalazila u postupku privremenog uvoza sa</p> |
|--|--|--|

3. Shuma e detyrimit të importit nuk kalon atë që duhej të ishte e pagueshme, në qoftë se mallrat në fjalë do të ishin lëshuar në qarkullim të lirë në datën, në të cilën ato janë vendosur nën procedurën e importit të përkohshëm.

Nënkapitulli II
Përdorimi i veçantë përfundimtar

Neni 171
Procedura e përdorimit të veçantë përfundimtar

1. Nën procedurën e përdorimit të veçantë përfundimtar, mallrat mund të lëshohen në qarkullim të lirë me përjashtim nga detyrimi ose me një reduktim të nivelit të detyrimit, për shkak të përdorimit të tyre specifik.

2. Kur mallrat janë në një stad prodhimi, që ekonomikisht lejon parashikimin e vetëm përdorimit të veçantë përfundimtar, Dogana mund të vendos në autorizim kushtet nën të cilat mallrat konsiderohen se janë përdorur për qëllimet e parashikuara për zbatimin e përjashtimit të detyrimit ose reduktimin e nivelit të detyrimit.

3. The amount of import duty shall not exceed that which would have been payable if the goods in question had been released for free circulation on the date on which they were placed under the temporary admission procedure.

Sub chapter II
End-use

Article 171
End-use procedure

1. Under the end-use procedure, goods may be released for free circulation under a duty exemption or at a reduced rate of duty on account of their specific use.

2. Where the goods are at a production stage which would allow economically the prescribed end-use only, Customs may establish in the authorisation the conditions under which the goods shall be deemed to have been used for the purposes laid down for applying the duty exemption or reduced rate of duty.

delimičnim oslobađanjem od uvoznih dažbina.

3. Iznos uvoznih dažbina koje se naplaćaju ne može biti veći od iznosa koji bi trebalo platiti da je roba bila stavljena u slobodan promet na dan kad je bila stavljena u postupak privremenog uvoza.

Odeljak II
Upotreba u posebne svrhe

Član 171
Postupak upotrebe robe u posebne svrhe

1. U postupku upotrebe u posebne svrhe, roba može biti stavljena u slobodan promet uz oslobođenje od plaćanja uvoznih dažbina ili uz nižu stopu carine radi njene upotrebe u posebne svrhe.

2. Ako je roba u fazi proizvodnje u kojoj bi se samo propisana upotreba u posebne svrhe mogla ekonomično primeniti, Carina u odobrenju može utvrditi uslove pod kojima se roba smatra upotrebljenom za svrhe za koje je propisana primena oslobođenja od plaćanja uvoznih dažbina ili niža stopa carine.

| | | |
|---|---|--|
| <p>3. Kur mallrat janë të përshtatshme për përdorim të përsëritur dhe Dogana e konsideron të arsyeshme me qëllim shmangien e keqpërdorimeve, mbikëqyrja doganore vazhdon për një afat që nuk kalon dy (2) vjet pas datës së përdorimit të tyre të parë për qëllimet e parashikuara për zbatimin e përjashtimit nga detyrimi apo reduktimin e nivelit të detyrimit.</p> <p>4. Mbikëqyrja doganore për procedurën e përdorimit të veçantë përfundimtar përfundon në rastet e mëposhtme:</p> <p>4.1. kur mallrat janë përdorur për qëllimet e përcaktuara për aplikimin e përjashtimit të detyrimit ose reduktimin e nivelit të detyrimit;</p> <p>4.2. kur mallrat largohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës, janë shkatërruar ose braktisur në favor të Shtetit;</p> <p>4.3. kur mallrat janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara për aplikimin e përjashtimit të detyrimit ose reduktimin e nivelit të detyrimit dhe për to është paguar detyrimi i importit.</p> | <p>3. Where goods are suitable for repeated use and the Customs consider it appropriate in order to avoid abuse, Customs supervision shall continue for a period not exceeding two (2) years after the date of their first use for the purposes laid down for applying the duty exemption or reduced rate of duty.</p> <p>4. Customs supervision under the end-use procedure shall end in any of the following cases:</p> <p>4.1. where the goods have been used for the purposes laid down for the application of the duty exemption or reduced rate of duty;</p> <p>4.2. where the goods have been taken out of the Customs territory of the Republic of Kosovo, destroyed or abandoned to the State;</p> <p>4.3. where the goods have been used for purposes other than those laid down for the application of the duty exemption or reduced duty rate and the applicable import duty has been paid.</p> | <p>3. Ako je roba pogodna za višekratnu upotrebu i Carina to smatra odgovarajućim kako bi se izbegla zloupotreba, carinski nadzor se nastavlja tokom perioda koji ne prelazi dve (2) godine od datuma njene prve upotrebe za svrhe utvrđene za primenu oslobođenja od plaćanja uvoznih dažbina ili niže stope carine.</p> <p>4. Carinski nadzor u postupku upotrebe u posebne svrhe završava se u sledećim slučajevima:</p> <p>4.1. ako je roba upotrebljena za svrhe utvrđene za primenu oslobođenja od plaćanja uvoznih dažbina ili niže stope carine;</p> <p>4.2. ako je roba izneta sa carinskog područja Republike Kosova, uništena ili ustupljena državi;</p> <p>4.3. ako je roba upotrebljena za druge svrhe, osim onih utvrđenih za primenu oslobođenja od plaćanja uvoznih dažbina ili niže stope</p> |
|---|---|--|

5. Kur kërkohet një normativ i prodhimit, për procedurën e përdorimit të veçantë përfundimtar zbatohet neni 172.

6. Mbeturina dhe skrapit që rezultojnë nga punimi ose përpunimi i mallrave, sipas përdorimit të veçantë përfundimtar të parashikuar, dhe humbjet nga mbeturina natyrore konsiderohen si mallra që i përkasin përdorimit të veçantë përfundimtar të parashikuar.

7. Mbeturina dhe skrapit që rezultojnë nga shkatërrimi i mallrave të vendosura nën procedurën e përdorimit të veçantë përfundimtar konsiderohen si mallra të vendosura nën procedurën e magazinimit doganor.

KAPITULLI V PËRPUNIMI

Nënkapitulli I Dispozita të përgjithshme

Neni 172 Normativi i prodhimit

1. Përveçse kur një normativ i prodhimit është i specifikuar në legjislacionin vendor që rregullon fusha

5. Where a rate of yield is required, Article 172 shall apply to the end-use procedure.

6. Waste and scrap which result from the working or processing of goods according to the prescribed end-use and losses due to natural wastage shall be considered as goods assigned to the prescribed end-use.

7. Waste and scrap resulting from the destruction of goods placed under the end-use procedure shall be deemed to be placed under the Customs warehousing procedure.

CHAPTER V PROCESSING

Sub chapter I General provisions

Article 172 Rate of yield

1. Except where a rate of yield has been specified in national legislation governing specific fields, the Customs shall set either

carine, a uvozne dažbine koje se primenjuju na robu su plaćene.

5. Ako se zahteva normativ, član 172. ovog zakona primenjuje se i na postupak upotrebe u posebne svrhe.

6. Ostaci i otpaci koji su rezultat obrade ili prerade robe u skladu sa propisanom upotrebom u posebne svrhe i gubici usled prirodnih otpadaka smatraju se robom kojoj je određena upotreba u posebne svrhe.

7. Ostaci i otpaci koji su rezultat uništavanja robe stavljene u postupak upotrebe u posebne svrhe smatraju se stavljenim u postupak carinskog skladištenja.

GLAVA V OPLEMENJIVANJE

Odeljak I Opšte odredbe

Član 172 Normativ

| | | |
|--|--|--|
| <p>specifike, Dogana vendos ose normativin e prodhimit, ose normativin mesatar të normativit të operacionit të përpunimit apo, kur është e përshtatshme, metodën e përcaktimit të këtij normativi.</p> <p>2. Normativi i prodhimit ose normativi mesatar përcaktohet duke u mbështetur në rrethanat aktuale, në të cilat operacionet e përpunimit janë kryer ose do të kryhen. Normativi mund të ndryshohet, kur është e përshtatshme, në përputhje me nenin 18.</p> | <p>the rate of yield or average rate of yield of the processing operation or where appropriate, the method of determining such rate.</p> <p>2. The rate of yield or average rate of yield shall be determined on the basis of the actual circumstances in which processing operations are, or are to be, carried out. That rate may be adjusted, where appropriate, in accordance with Article 18.</p> | <p>1. Osim u slučajevima u kojima je normativ preciziran propisima koji uređuju posebne oblasti, Carina utvrđuje normativ ili prosečan normativ radnji prerade ili, po potrebi, metod određivanja takvog normativa.</p> <p>2. Normativ ili prosečan normativ određuju se na osnovu stvarnih okolnosti u kojima se radnja prerade sprovodi ili treba da se sprovede. Normativ se, po potrebi, može prilagoditi, u skladu sa članom 18. ovog zakona.</p> |
| <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli II</u> <u>Përpunimi i brendshëm</u></p> <p style="text-align: center;">Neni 173 Fusha e zbatimit</p> | <p style="text-align: center;"><u>Sub chapter II</u> <u>Inward processing</u></p> <p style="text-align: center;">Article 173 Scope</p> | <p style="text-align: center;"><u>Odeljak II</u> <u>Aktivno oplemenjivanje</u></p> |
| <p>1. Pavarësisht zbatimit të nenit 150, mallrat jo kosovare mund të përdoren në territorin doganor të Republikës së Kosovës nën procedurën e përpunimit të brendshëm, në një apo më shumë operacione përpunimi, pa iu nënshtruar:</p> <p>1.1. detyrimin të importit;</p> <p>1.2. pagesave të tjera të përcaktuara me dispozitat tjera përkatëse në fuqi;</p> | <p>1. Without prejudice to Article 150, under the inward processing procedure non-Kosovo goods may be used in the Customs territory of the Republic of Kosovo in one or more processing operations without such goods being subject to any of the following:</p> <p>1.1. import duty;</p> <p>1.2. other charges as provided for under other relevant provisions in force;</p> | <p style="text-align: center;">Član 173 Oblast primene</p> <p>1. Ne isključujući primenu odredbe člana 150. ovog zakona, u postupku aktivnog oplemenjivanja strana roba može se upotrebiti na carinskom području Republike Kosova u jednoj ili više radnji prerade, a da ta roba ne podleže:</p> <p>1.1. plaćanju uvoznih dažbina;</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>1.3. masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Procedura e përpunimit të brendshëm mund të përdoret në raste të ndryshme nga riparimi dhe shkatërrimi, vetëm kur, pavarësisht përdorimit të aksesoreve të prodhimit, mallrat e vendosura nën procedurë mund të identifikohen në produktet e përpunuara.</p> <p>3. Në rastin e përmendur në nenin 150, procedura lejohet të përdoret atëherë kur mund të verifikohet përputhja me kushtet e përcaktuara për mallrat ekuivalente.</p> <p>4. Përveç paragrafëve 1 deri 3 të këtij neni, procedura e përpunimit të brendshëm mund të përdoret edhe për mallrat e mëposhtme:</p> <p>4.1. mallrat që kanë për synim të i nënshtrohen operacioneve për të siguruar përputhjen e tyre me kërkesat teknike për lëshimin e tyre për qarkullim të lirë;</p> | <p>1.3. commercial policy measures, insofar as they do not prohibit the entry or exit of goods into or from the Customs territory of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The inward processing procedure may be used in cases other than repair and destruction only where, without prejudice to the use of production accessories, the goods placed under the procedure can be identified in the processed products.</p> <p>3. In the case referred to in Article 150, the procedure may be used where compliance with the conditions laid down in respect of equivalent goods can be verified.</p> <p>4. In addition to paragraphs 1 to 3 of this article, the inward processing procedure may also be used for any of the following goods:</p> <p>4.1. goods intended to undergo operations to ensure their compliance with technical requirements for their release for free circulation;</p> | <p>1.2. drugim dažbinama koje se plaćaju pri uvozu, u skladu sa posebnim propisima;</p> <p>1.3. merama trgovinske politike, ako se njima ne zabranjuje ulazak robe na carinsko područje Republike Kosova ili izlazak iz tog područja.</p> <p>2. Postupak aktivnog oplemenjivanja može se primeniti u slučajevima različitim od popravke i uništenja samo ako se, ne dovodeći u pitanje upotrebu dodatne proizvodne opreme, roba koja je stavljena u postupak može prepoznati u dobijenim proizvodima.</p> <p>3. U slučaju iz člana 150. ovog zakona, postupak se može primeniti ako se poštovanje uslova utvrđenih za ekvivalentnu robu može proveriti.</p> <p>4. Pored slučajeva iz stava 1 do 3 ovog člana, postupak aktivnog oplemenjivanja se takođe može primeniti i na:</p> <p>4.1. robu namenjenu ispitivanju kako bi se osigurala njena usklađenost sa tehničkim</p> |
|---|---|--|

4.2. mallrat të cilat duhet të u nënshtrohen formave të zakonshme të trajtimit, në përputhje me nenin 149.

Neni 174
Afati i shkarkimit

1. Dogana përcakton afatin kohor brenda të cilit shkarkohet procedura e përpunimit të brendshëm, në përputhje me nenin 146.

2. Afati kohor nga paragrafi 1 i këtij neni fillon nga data, në të cilën mallrat jo kosovare janë vendosur nën procedurë dhe caktohet duke marrë në konsideratë edhe kohën e nevojshme për të kryer operacionet e përpunimit dhe të shkarkimit të procedurës.

3. Dogana mund të autorizoj shtyrje të afatit kohor të përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, për një periudhë të arsyeshme, në baze të një aplikimi të arsyetuar nga mbajtësi i autorizimit.

4. Autorizim mund të specifikoj që një afat kohor, i cili fillon gjatë një muaji kalendarik, tremujori ose gjashtëmujori, përfundon në ditën e fundit të muajit kalendarik, tremujorit ose gjashtëmujorit pasues.

4.2. goods which have to undergo usual forms of handling in accordance with Article 149.

Article 174
Period for discharge

1. Customs shall specify the period within which the inward processing procedure is to be discharged, in accordance with Article 146.

2. Period from paragraph 1 of this article shall run from the date on which the non-kosovo goods are placed under the procedure and shall take account of the time required to carry out the processing operations and to discharge the procedure.

3. Customs may grant an extension, of reasonable duration, of the period specified pursuant to paragraph 1 of this article, upon justified application by the holder of the authorization.

4. The authorization may specify that a period which commences in the course of a month, quarter or semester shall end on the last day of a subsequent month, quarter or semester respectively.

zahtevima za njeno stavljanje u slobodan promet;

4.2. robu koja treba da se podvrgne uobičajenim oblicima postupanja u skladu sa članom 149.

Član 174
Rok za okončanje postupka

1. Carina određuje rok u kojem postupak aktivnog oplemenjivanja treba da se okonča, u skladu sa članom 146.

2. Rok iz stava 1. ovog člana teče od dana kada je strana roba stavljena u postupak, a određuje se uzimajući u obzir vreme potrebno za obavljanje radnje prerade i okončanje postupka.

3. Carina može odobriti razumno produženje roka utvrđenog u skladu sa stavom 1. ovog člana, na obrazložen zahtev nosioca odobrenja.

4. Odobrenjem se može predvideti da se rok koji počinje da teče u toku meseca,

5. Në raste të eksportimit paraprak, në përputhje me nën paragrafin 4.3 të Nenit 150, në autorizim specifikohet afati kohor, brenda të cilit mallrat jo kosovare deklarohen për procedurën e përpunimit të brendshëm, duke marrë në konsideratë kohën e nevojshme për blerjen dhe transportin drejt territorit doganor të Republikës së Kosovës.

6. Afati kohor i përcaktuar në paragrafin 5 të këtij Neni, vendoset në muaj dhe nuk duhet të kalojë gjashtë (6) muaj. Afati fillon nga data e pranimit të deklaratës së eksportit në lidhje me produktet e përpunuara, të përfutuara nga mallrat ekuivalente korresponduese.

7. Me kërkesë nga mbajtësi i autorizimit, afati prej gjashtë (6) muaj, i përcaktuar në paragrafin 5 të këtij Neni, mund të zgjatet edhe pas skadimit të tij, me kusht që afati total të mos kalojë dymbëdhjetë (12) muaj.

Neni 175
Ri eksportimi i përkohshëm për përpunim të mëtejshëm

Në bazë të aplikimit, Dogana mund të autorizoj që disa ose të gjitha mallrat e vendosura nën procedurën e përpunimit të

5. In the case of prior export in accordance with sub paragraph 4.3 of Article 150, the authorization shall specify the period within which the non-Kosovo goods shall be declared for the inward processing procedure, taking account of the time required for procurement and transport to the Customs territory of the Republic of Kosovo.

6. The period referred to in the paragraph 5 shall be set in months and shall not exceed six (6) months. It shall run from the date of acceptance of the export declaration relating to the processed products obtained from the corresponding equivalent goods.

7. At the request of the holder of the authorization, the period of six (6) months referred to in paragraph 5 of this article may be extended, even after its expiry, provided that the total period does not exceed twelve (12) months.

Article 175
Temporary re-export for further processing

Upon application, the Customs may authorize some or all of the goods placed under the inward -processing procedure, or

kvartala ili polugodišta završava poslednjeg dana narednog meseca, kvartala ili polugodišta.

5. U slučaju prethodnog izvoza u skladu sa članom 150 podstav 4.3 ovog zakona, odobrenjem se utvrđuje rok u kome strana roba mora biti deklarirana za postupak aktivnog oplemenjivanja, uzimajući u obzir vreme potrebno za nabavku i prevoz do carinskog područja Republike Kosova.

6. Rok iz stava 5. ovog člana utvrđuje se u mesecima i ne sme da prelazi šest (6) meseci. Rok počinje da teče od dana prihvatanja izvozne deklaracije za dobijene proizvode izrađenih od ekvivalentne robe.

7. Na zahtev nosioca odobrenja rok od šest (6) meseci iz stava 5 ovog člana može se produžiti, čak i nakon isteka, pod uslovom da ukupni rok ne prelazi dvanaest (12) meseci.

Član 175
Privremeni ponovni izvoz robe radi daljeg oplemenjivanja

brendshëm apo produktet e përpunuara të ri eksportohen përkohësisht, për qëllim të përpunimit të mëtejshëm jashtë territorit doganor të Republikës së Kosovës, në përputhje me kushtet e përcaktuara për procedurën e përpunimit të jashtëm.

Nënkapitulli III
Përpunimi i jashtëm

Neni 176
Fusha e zbatimit

1. Nën procedurën e përpunimit të jashtëm, mallrat kosovare mund të eksportohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Kosovës për të iu nënshtruar operacioneve të përpunimit. Produktet e përpunuara që rezultojnë nga këto mallra mund të lëshohen në qarkullim të lirë me lirim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimi i importit kundrejt një aplikimi nga mbajtësi i autorizimit ose nga çdo person tjetër i vendosur në territorin doganor të Republikës së Kosovës, me kusht që ky person të ketë marrë miratimin e mbajtësit të autorizimit dhe kushtet e autorizimit të jenë përmbushur.

2. Përpunimi i jashtëm nuk lejohet për mallrat e mëposhtme:

the processed products, to be temporarily re-exported for the purpose of further processing outside the Customs territory of the Republic of Kosovo, in accordance with the conditions laid down for the outward processing procedure.

Sub chapter III
Outward processing

Article 176
Scope

1. Under the outward processing procedure Kosovo goods may be temporarily exported from the Customs territory of the Republic of Kosovo in order to undergo processing operations. The processed products resulting from those goods may be released for free circulation with total or partial relief from import duty upon application by the holder of the authorization or any other person established in the Customs territory of the Republic of Kosovo provided that that person has obtained the consent of the holder of the authorization and the conditions of the authorization are fulfilled.

2. Outward processing shall not be allowed for any of the following goods:

Na zahtev lica, carinski organ može odobriti da deo robe ili sva roba stavljena u postupak aktivnog oplemenjivanja ili dobijeni proizvodi, budu privremeno ponovo izvezeni radi daljeg oplemenjivanja van carinskog područja Republike Kosova, u skladu sa uslovima utvrđenim za postupak pasivnog oplemenjivanja.

Odeljak III
Pasivno oplemenjivanje

Član 176
Oblast primene

1. U postupku pasivnog oplemenjivanja domaća roba može biti privremeno izvezena sa carinskog područja Republike Kosova radi podvrgavanja radnjama prerade. Proizvodi koji nastanu u postupku pasivnog oplemenjivanja mogu se staviti u slobodan promet sa potpunim ili delimičnim oslobođenjem od plaćanja uvoznih dažbina, na zahtev nosioca odobrenja ili drugog lica poslovno nastanjenog na carinskom području Republike Kosova, pod uslovom da je to lice dobilo saglasnost nosioca odobrenja i da su uslovi iz odobrenja ispunjeni.

| | | |
|--|---|---|
| <p>2.1. mallrat, eksporti i të cilave krijon kthim ose shlyerje të detyrimit të importit;</p> <p>2.2. mallrat, të cilat, para eksportimit, ishin lëshuar në qarkullim të lirë me një përjashtim të detyrimit ose reduktim të nivelit të detyrimit për shkak të përdorimit të tyre të veçantë përfundimtar dhe nëse qëllimet e përdorimit të veçantë përfundimtar nuk janë përmbushur, përveçse kur këto mallra duhet të u nënshtrohen operacioneve të riparimit;</p> <p>2.3. mallrat, eksporti i të cilave shpien në pagesën e subvencioneve të eksportit;</p> <p>2.4. mallrat, për të cilat është dhënë një përparësi financiare e ndryshme nga shuma e kthyer sipas nën paragrafit 2.3 të këtij neni, në kuadër të politikës bujqësore për shkak të eksportimit të tyre;</p> <p>3. Dogana përcakton afatin kohor, brenda të cilit mallrat e eksportuara përkohësisht duhet të riimportohen në territorin doganor të Republikës së Kosovës në formën e produkteve të përpunuara dhe të lëshohen në qarkullim të lirë, në mënyrë</p> | <p>2.1. goods the export of which gives rise to repayment or remission of import duty;</p> <p>2.2. goods which, prior to export, were released for free circulation under a duty exemption or at a reduced rate of duty by virtue of their end-use, for as long as the purposes of such end-use have not been fulfilled, unless those goods have to undergo repair operations;</p> <p>2.3. goods the export of which gives rise to the granting of export refunds;</p> <p>2.4. goods in respect of which a financial advantage other than refunds referred to in subparagraph 2.3 of this article is granted under the agricultural policy by virtue of the export of those goods.</p> <p>3. Customs shall specify the period within which goods temporarily exported must be re-imported into the Customs territory of the Republic of Kosovo in the form of processed products, and released for free circulation, in order to be able to</p> | <p>2. Pasivno oplemenjivanje se ne dozvoljava za domaću robu:</p> <p>2.1. čijim izvozom se stiče pravo na povraćaj ili otpust uvoznih dažbina;</p> <p>2.2. koja je, pre izvoza, stavljena u slobodan promet sa oslobođenjem od plaćanja dažbine ili sa nižom stopom carine radi njene upotrebe u posebne svrhe, sve dok svrha takve upotrebe nije ispunjena, osim ako se radnja prerade odnosi na popravku;</p> <p>2.3. čijim izvozom se stiče pravo na dodelu izvoznih naknada;</p> <p>2.4. čijim izvozom se stiče pravo na dodelu drugih finansijskih pogodnosti, različitih od onih iz podstava 2.3 ovog člana, odobrenih u skladu sa poljoprivrednom politikom radi njihovog izvoza.</p> <p>3. Carina određuje rok u kojem se roba koja je privremeno izvezena mora</p> |
|--|---|---|

që të mundësohet përfitimi nga lirimi i plotë ose i pjesshëm nga detyrimi i importit. Dogana mund ta shtyj afatin kohor, për një kohëzgjatje të arsyeshme, në bazë të aplikimit të arsyetuar nga mbajtësi i autorizimit.

Neni 177
Mallrat e riparuar falas

1. Kur Doganës i dëshmohet që mallrat janë riparuar falas, në bazë të një obligimi kontraktual ose ligjor që rrjedh nga garancioni, ose për shkak të ekzistencës së një defekti material apo prodhimi, mallrat mund të përfitojnë lirim të plotë nga detyrimi i importit.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet kur defekti i prodhimit ose material është konstatuar që në momentin e lëshimit të parë për qarkullim të lirë të mallrave në fjalë.

Neni 178
Mallrat e riparuar ose ndryshuara në kontekst të marrëveshjeve ndërkombëtare

1. Lirim i plotë nga detyrimi importues sigurohet për produktet e përpunuara që rezultojnë nga mallrat e vendosura nën

benefit from total or partial relief from import duty. They may grant an extension, of reasonable duration, of that period, upon justified application by the holder of the authorization.

Article 177
Goods repaired free of charge

1. Where it is established to the satisfaction of the Customs that goods have been repaired free of charge, either because of a contractual or statutory obligation arising from a guarantee or because of a manufacturing or material defect, they shall be granted total relief from import duty.

2. Paragraph 1 of this article shall not apply where account was taken of the manufacturing or material defect at the time when the goods in question were first released for free circulation.

Article 178
Goods repaired or altered in the context of international agreements

1. Total relief from import duty shall be granted to processed products resulting from goods placed under the outward

ponovo uvesti na carinsko područje Republike Kosova u obliku dobijenih proizvoda i staviti u slobodan promet, kako bi mogla imati pogodnosti u obliku potpunog ili delimičnog oslobođenja od plaćanja uvoznih dažbina. Carina može odobriti razumno produženje tog roka, na obrazložen zahtev nosioca odobrenja.

Član 177
Roba popravljena bez plaćanja

1. Ako se Carini dokaže da je roba popravljena bez plaćanja zbog ugovorene ili zbog zakonom propisane garantne obaveze ili zbog proizvodnog nedostatka ili oštećenja materijala, ta roba može biti stavljena u slobodan promet s potpunim oslobođenjem od plaćanja uvoznih dažbina.

2. U slučaju kad su proizvodni nedostatak ili oštećeni materijal bili ustanovljeni u vreme prvog stavljanja robe u slobodan promet odredba stava 1. ovog člana ne primenjuje se.

Član 178
Roba koja je popravljena ili zamenjena na osnovu međunarodnog sporazuma

| | | |
|--|--|---|
| <p>procedurën e përpunimit të jashtëm, kur vërtetohet nga Dogana, se:</p> <p>1.1. Këto mallra janë riparuar ose ndryshuar në vendin ose territorin jashtë territorit doganor të Republikës së Kosovës, me të cilin Republika e Kosovës ka lidhur marrëveshje ndërkombëtare që ofron një lirim të tillë, dhe</p> <p>1.2. Kushtet për lirim nga detyrimi i importit të përcaktuara në marrëveshjen sipas nën paragrafit 1.1 janë përmbushur.</p> <p>2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk zbatohet për produktet e përpunuara që rezultojnë nga mallrat ekuivalente sipas nenit 150 dhe produktet zëvendësuese sipas Nenit 179 dhe 180.</p> <p style="text-align: center;">Neni 179 Sistemi i shkëmbimit standard</p> <p>1. Nën sistemin e shkëmbimit standard, një produkt i importuar – produkti zëvendësues, mund të zëvendësojë një produkt të përpunuar, në përputhje me paragrafët 2 deri 6 të këtij neni.</p> | <p>processing procedure where it is established to the satisfaction of the customs that:</p> <p>1.1. those goods have been repaired or altered in a country or territory outside the customs territory of the Republic of Kosovo with which the Republic of Kosovo has concluded an international agreement providing for such relief; and</p> <p>1.2. the conditions for the relief from import duty laid down in the agreement referred to in subparagraph 1.1 are fulfilled.</p> <p>2. Paragraph 1 shall not apply to processed products resulting from equivalent goods as referred to in Article 150 and to replacement products as referred to in Articles 179 and 180.</p> <p style="text-align: center;">Article 179 Standard exchange system</p> <p>1. Under the standard exchange system an imported product -replacement product may, in accordance with paragraphs 2 to 6 of this article replace a processed product.</p> | <p>1. Potpuno oslobođenje od plaćanja uvoznih dažbina odobrava se za prerađene proizvode koji su dobijeni od robe koja je stavljena u postupak pasivnog oplemenjivanja, ako se, na način prihvatljiv za Carina, utvrdi:</p> <p>1.1. da je ta roba popravljena ili izmenjena u državi ili carinskoj teritoriji van carinskog područja Republike Kosova, s kojima je Republika Kosova zaključila međunarodni sporazum, kojim je predviđeno takvo oslobođenje;</p> <p>1.2. da su ispunjeni uslovi za oslobođenje od plaćanja uvoznih dažbina utvrđeni u sporazumu iz podstav 1.1 ovog stava.</p> <p>2. Stav 1. ovog člana ne primenjuje se na prerađene proizvode koji su dobijeni od ekvivalentne robe iz člana 150. ovog zakona i na proizvode za zamenu iz člana 179. i 180.</p> <p style="text-align: center;">Član 179 Sistem standardne zamene</p> <p>1. U sistemu standardne zamene uvozeni proizvod- proizvod za zamenu, u</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>2. Dogana, në bazë të aplikimit, autorizon përdorimin e sistemit të shkëmbimit standard kur operacioni i përpunimit përfshin riparimin e mallrave kosovare me defekte, të ndryshme nga ato që janë objekt i masave të politikës bujqësore ose i rregullimeve specifike të zbatueshme për mallra të caktuara, të përfituara nga përpunimi i prodhimeve bujqësore.</p> <p>3. Produktet zëvendësuese kanë të njëjtin kod tetë shifror të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, të njëjtën cilësi tregtare dhe të njëjtat karakteristika teknike si mallrat me defekte, nëse këto të fundit do të ishin nënshtruar riparimit.</p> <p>4. Kur mallrat me defekte janë përdorur përpara eksportit, produktet zëvendësuese duhet gjithashtu të jenë të përdorura.</p> <p>5. Megjithatë, Dogana nuk kërkon zbatimin e paragrafit 4 të këtij Neni, nëse produkti zëvendësues është dhënë falas, për shkak të një obligimi kontraktor a ligjor nga garancioni ose për shkak të ekzistencës së një defekti material ose të prodhimit.</p> | <p>2. Customs shall, upon application authorize the standard exchange system to be used where the processing operation involves the repair of defective Kosovo goods other than those subject to measures laid down under the agricultural policy or to the specific arrangements applicable to certain goods resulting from the processing of agricultural products.</p> <p>3. Replacement products shall have the same eight-digit Combined Nomenclature code, the same commercial quality and the same technical characteristics as the defective goods had the latter undergone repair.</p> <p>4. Where the defective goods have been used before export, the replacement products must also have been used.</p> <p>5. Customs shall, however, waive the requirement set out in the paragraph 4 of this article if the replacement product has been supplied free of charge, either because of a contractual or statutory obligation arising from a guarantee or because of a material or manufacturing defect.</p> | <p>skladu sa st. 2 do 6 ovog člana, može biti zamenjen obređenim proizvodom.</p> <p>2. Carina, na zahtev lica, odobrava upotrebu sistema standardne zamene ako radnje prerade uključuju popravku domaće robe koja nije predmet mera utvrđenih poljoprivrednom politikom ili posebnih aranžmana primenjivih na određenu robu koja je rezultat oplemenjivanja poljoprivrednih proizvoda.</p> <p>3. Proizvodi za zamenu moraju imati istu osmocifrenu oznaku Kombinovane nomenklature robe, isti kvalitet i iste tehničke karakteristike koje bi roba sa nedostacima imala da je bila podvrgnuta popravci.</p> <p>4. Ako je roba sa nedostacima korišćena pre izvoza i proizvodi za zamenu moraju biti korišćeni.</p> <p>5. Carina može dozvoliti izuzetke od primene stava 4. ovog člana ako se proizvodi za zamenu isporučuju besplatno na osnovu ugovorene ili zakonske garantne obaveze ili zbog proizvodnog nedostatka robe ili oštećenog materijala.</p> |
|--|---|---|

6. Dispozitat, të cilat zbatohen për produktet e përpunuara, zbatohen edhe për produktet zëvendësuese.

Neni 180
Importimi paraprak i produkteve
zëvendësuese

1. Dogana sipas kushteve të përcaktuara, në bazë të aplikimit të personit përkatës autorizon importimin e produkteve zëvendësuese para eksportimit të mallrave me defekte.

2. Në rastin e importimit paraprak të produkteve zëvendësuese, depozitohet një garancion që mbulon shumën e detyrimeve doganore të cilat do të ishin të pagueshme nëse mallrat me defekte nuk do të eksportoheshin në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni.

3. Mallrat me defekte eksportohen brenda një afati prej dy (2) muaj nga data, në të cilën Dogana pranon deklaratën për lëshim në qarkullim të lirë të produkteve zëvendësuese.

4. Kur, në rrethana të veçanta, mallrat me defekte nuk mund të eksportohen brenda afatit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, Dogana mund të shtyj afatin për një

6. The provisions which would be applicable to the processed products shall apply to the replacement products.

Article 180
Prior import of replacement products

1. The Customs shall, under the conditions they lay down, upon application by the person concerned, authorize replacement products to be imported before the defective goods are exported.

2. In the event of such prior import of a replacement product, a guarantee shall be provided, covering the amount of the import duty that would be payable should the defective goods not be exported in accordance with paragraph 3 of this article.

3. The defective goods shall be exported within a period of two (2) months from the date of acceptance by the Customs of the declaration for the release for free circulation of the replacement products.

4. Where, in exceptional circumstances, the defective goods cannot be exported within the period referred to in paragraph 3 of this article, Customs may grant an extension, of a reasonable duration, of that period, upon justified

6. Odredbe koje se primenjuju na dobijene proizvode primenjuju se na proizvode za zamenu.

Član 180
Prethodni uvoz proizvoda za zamenu

1. Carinski organ, na zahtev lica, može odobriti da se pod propisanim uslovima proizvodi za zamenu uvezu pre nego što se roba sa nedostacima izveze.

2. U slučaju prethodnog uvoza proizvoda za zamenu, mora se položiti obezbeđenje, koje obuhvata iznos uvoznih dažbina koji bi trebalo da se plati ako se roba sa nedostacima ne izveze u skladu sa stavom 3. ovog člana.

3. Roba sa nedostacima se mora izvesti u roku od dva (2) meseca od dana kada carinski organ prihvati deklaraciju za stavljanje u slobodan promet proizvoda za zamenu.

4. Ako, u izuzetnim okolnostima, roba sa nedostacima ne može biti izvezena u roku iz stava 3. ovog člana, Carina može

periudhë të arsyeshme, në bazë të aplikimit të arsyetuar të mbajtësit të autorizimit.

**PJESA E TETË
MALLRAT QË LARGOHEN
NGA TERRITORI
DOGANOR I REPUBLIKËS
SË KOSOVËS**

**KAPITULLI I
FORMALITETET PARA
DALJES SË MALLRAVE**

**Neni 181
Depozitimi i një deklarate para nisjeje**

1. Mallrat që largohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës, mbulohen nga një deklaratë e para nisjes, e cila depozitohet në zyrën doganore kompetente, brenda një afati kohor specifik përpara se mallrat të largohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës.

2. Obligimi i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk zbatohet:

application by the holder of the authorization.

**PART EIGHT
GOODS TAKEN OUT OF
THE CUSTOMS
TERRITORY OF THE
REPUBLIC OF KOSOVO**

**CHAPTER I
FORMALITIES PRIOR TO THE
EXIT OF GOODS**

**Article 181
Lodging a pre-departure declaration**

| <p>llogaritjen dhe pagesën e akcizës, evidentimin e stokeve, qëllimin e përdorimit, dërgesat, pranimin, posedimin dhe lëvizjen e produkteve akcizore dhe mbajtjen e shënimeve.</p> <p>3. Dogana mund të kontrollojë regjistrat tregtar, kontabilitetin, evidencat teknologjike dhe të tjera, dokumentet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me biznesin e obliguesve akcizor ose obliguesve për pagesë të akcizës, personave që posedojnë ose tregtojnë sende të tatueshme dhe çdo personi tjetër që është i angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në biznes ose në mënyra të tjera të përfshirë në aktivitete me produkte të tatueshëm.</p> <p>4. Dogana kryen mbikëqyrjen nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni duke zbatuar dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>5. Për të përcaktuar saktësinë e llogaritjes të pagesës së akcizës, Dogana mund të kryejë kontrole në objektet e shitjes, dyqane, magazina dhe objekte tjera dhe vendet ku bëhet shitja, magazinimi, prodhimi dhe strehimi i produkteve që i nënshtrohen dispozitave të këtij Kodi.</p> | <p>excise calculation and payment, stock registering, intended use, deliveries, receptions, possessions and movement of taxable items and keeping of notes.</p> <p>3. Customs may control the commercial registers, accounting, technological and other registers, documents and data, which have to with the business of person liable for excise or other persons liable for excise payment, persons possessing or trading taxable items and every other person engaged directly or indirectly in the business or other ways involved in handling tax objects.</p> <p>4. Customs shall perform the supervision from paragraphs 1, 2 and 3 of this article by implementing provisions of this Code and other legislation in force.</p> <p>5. In order to determine the calculation and excise payment accuracy, Customs may perform inspections in objects for sale, stores, warehouses and other facilities and places where sale, warehousing and holding of products is subjected to this Code.</p> | <p>popisom zaliha, namenskim korištenjem, otpremama, primitcima, raspolaganjem i kretanjem predmeta oporezivanja te vođenjem evidencija.</p> <p>3. Carina može proveravati trgovačke, knjigovodstvene, tehnološke i druge evidencije, dokumente i podatke koji se odnose na poslovanje akciznih obveznika ili obveznika plaćanja akcize, osoba koje poseduju ili obavljaju promet s predmetima oporezivanja i svake druge osobe koja je izravno ili neizravno poslovno ili na drugi način uključena u radnje s predmetima oporezivanja.</p> <p>4. Carina vrši nadzor, iz stava 1, 2. i 3. ovoga člana, primenom odredbi ovoga Zakonika i drugih važećih zakona.</p> <p>5. Radi utvrđivanja pravilnosti obračuna i uplate akcize Carina može provoditi nadzor/kontrolu u prodajnim objektima, prodavnicama, skladištima i drugim objektima i mestima gdje se obavlja prodaja, skladištenje, proizvodnja i čuvanje proizvoda koji su predmet uređenja ovoga Zakonika.</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>6. Nëse gjatë kontrollit konstatohet se obliguesi akcizor ose obliguesi për pagesën e akcizës nuk i mban shënimet e përcaktuara me këtë Kod ose i mban ato në mënyrë të parregullt dhe për këtë arsye nuk është e mundur të përcaktohet akciza, Dogana urdhëron regjistrimin e të gjithë produkteve të tatueshëm që gjenden në hapësirën e kontrollit.</p> <p>7. Dogana me vendim mund t'i ndalojë përkohësisht obliguesit akcizor ose obliguesit për pagesën e akcizës kryerjen e mëturjeshme të aktiviteteve nëse:</p> <p>7.1. nuk llogarit, llogarit gabim ose nuk paguan akcizë;</p> <p>7.2. nuk ka dokumentacion për produktet e tatueshme të prodhuar, pranuar, dërguar, dorëzuar dhe shitur;</p> <p>7.3. nuk i mban shënimet e parapara ose i mban shënimet në mënyrë jo të plotë ose nuk i dorëzon raportet e përcaktuara;</p> <p>7.4. nuk disponon ose nuk ofron qasje në dokumentacionin për obligim të pagesës së akcizës dhe</p> | <p>6. If during control comes to the ascertainment that person liable for excise or the person liable for excise payment doesn't keep notes determined by this Law or holds them irregularly and due to this reason excise is impossible for determination, Customs shall order the list of all taxable items located within the control space.</p> <p>7. Customs by decision may temporarily ban the person liable for excise or person liable for excise payment to perform further activities if:</p> <p>7.1. they do not calculate, or wrongly calculate or do not pay the excise;</p> <p>7.2. there is no documents for the produced, received, dispatched, delivered and sold taxable items;</p> <p>7.3. doesn't hold notes as defined; holds the notes incompletely or fails to submit the defined reports;</p> <p>7.4. doesn't possess or does not provide access to the documentation for excise payment</p> | <p>6. Ako se tokom kontrole utvrdi da akcizni obveznik ili obveznik plaćanja akcize ne vodi evidencije propisane ovim Zakonikom ili ih neuredno vodi i da zbog toga nije moguće utvrditi akciznu obvezu, Carina će naložiti popis svih zatečenih predmeta oporezivanja koji se nalaze u prostoru gde se vrši kontrola.</p> <p>7. Carina može rešenjem akciznom obvezniku ili obvezniku plaćanja akcize privremeno zabraniti daljnje obavljanje delatnosti, ako:</p> <p>7.1. ne obračunava, netačno obračunava ili ne uplaćuje akcizu;</p> <p>7.2. ne poseduje dokumentaciju o proizvedenim, primljenim, otpremljenim, isporučenim i prodanim predmetima oporezivanja;</p> <p>7.3. ne vodi propisane evidencije ili evidencije vodi nepotpuno ili ne dostavlja propisane izveštaje;</p> <p>7.4. ne poseduje ili ne da na uvid dokumentaciju o akciznoj obvezi za uplatu te o uplaćenju akcizi, kao</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>për akcizën e paguar, si dhe dokumentacionin relevant të biznesit dhe dokumentacionin financiar.</p> <p>8. Vendimi nga paragrafi 7 i këtij neni do të ekzekutohet me plumbosjen me shenja doganore në objekte afariste, magazina, impiante, pjesë të impianteve, makinerive, pajisjeve ose lokaleve të tjera dhe pamundësimin e përdorimit të impianteve, pajisjeve dhe pajisjeve të tjera për punë ose në mënyra të tjera të përshtatshme.</p> <p>9. Ndalesa nga paragrafi 7 i këtij neni do të zgjasë derisa të hiqen arsyet për të cilat është shqiptuar ndalesa.</p> <p>10. Nëse edhe pas gjashtë (6) muajve nga dita e ekzekutimit të vendimit nga paragrafi 7 i këtij neni nuk hiqen arsyet për të cilat është shqiptuar ndalimi i përkohshëm për aktivitete të mëtutjeshme, Dogana mund t'i konfiskoj dhe shesë produktet e tatueshme.</p> <p>11. Në rastin nga paragrafi 8 i këtij neni, Dogana me vendim do ta fshij obliguesin akcizor ose obliguesin për pagesën e akcizës nga regjistri i obliguesve të akcizës. Regjistrimi i serishëm në regjistrin e obliguesve të akcizës është i mundur nëse</p> | <p>liability and for the paid excise, as well as other relevant tax-judiciary business documents and financial documents.</p> <p>8. The decision from paragraph 7 of this article will be executed by sealing with customs seals the business facilities, warehouses, and manufactories, parts of manufactories, machineries, other equipment or facilities and by disabling them to use the manufactories, equipment and others for work or other appropriate ways.</p> <p>9. The ban from paragraph 7 of this article will continue until reasons for which the imposed the ban, are removed.</p> <p>10. If even after six (6) months from the date of decision execution from paragraph 7 of this article the reasons for what the temporary ban is imposed are not removed for further activities, Kosovo Customs may seize and sell the taxable items.</p> <p>11. In the event from paragraph 8 of this article, Kosovo Customs by decision will delete from the persons liable for excise registry or persons liable for excise payment from the persons liable for excise registry. Re-registration in the registry for</p> | <p>i drugu porezno-pravno relevantnu poslovnu i finansijsku dokumentaciju.</p> <p>8. Rešenje iz stava 7 ovoga člana izvršava se pečaćenjem poslovnih prostorija, skladišta, pogona, dela pogona, postrojenja, opreme ili drugih prostorija te onemogućavanjem korištenja postrojenja, uređaja i druge opreme za rad odnosno na drugi pogodan način.</p> <p>9. Zabrana iz stav 7. ovoga člana traje do uklanjanja razloga zbog kojih je zabrana izrečena.</p> <p>10. Ako i nakon šest (6) meseci od dana izvršnosti rešenja iz stava 7. ovoga člana ne budu uklonjeni razlozi zbog kojih je izrečena privremena zabrana daljnjeg obavljanja delatnosti, Carina može oduzeti i prodati predmete oporezivanja.</p> <p>11. Carina će u slučaju iz stava 8. ovoga člana rešenjem brisati akciznog obveznika ili obveznika plaćanja akcize iz registra akciznih obveznika. Ponovno upisivanje u registar akciznih obveznika moguće je ako u trenutku podnošenja</p> |
|--|--|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>në momentin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim, nuk ka të evidentuara borxhe të pa paguara publike dhe nëse nuk ekzistojnë arsyet nga paragrafi 7 i këtij neni.</p> <p>12. Dogana me vendim i ndalon përkohësisht një personi juridik ose fizik kryerjen e aktiviteteve të mëtuajtshme nëse:</p> <p>12.1. nuk lejon ose pengon zbatimin e kontrollit doganor ose të akcizës;</p> <p>12.2. prodhon, operon ose kryen aktivitete me produkte të akcizës në territorin doganor të Republikës së Kosovës pa regjistrim përkatës dhe/ose pa regjistrim në regjistrin e obliguesve akcizor dhe/ose pa marrë autorizimin e duhur në përputhje me dispozitat të këtij Kodi;</p> <p>12.3. ndërmerr veprime që kanë karakteristikat e keqpërdorimit të drejtave në lëvizjen ose asgjësimin e sendeve të tatueshme;</p> | <p>persons liable for excise is possible at the moment of submitting the request for registration the applicant doesn't register the paid debts from public profits and if reasons from article 7 of this Article cease to exist.</p> <p>12. Customs by decision shall temporarily ban the legal or natural person from further activities if in case:</p> <p>12.1. they do not allow or obstructs the application of customs or excise control;</p> <p>12.2. manufactures, operates or performs activities with excise products in the territory of Republic of Kosovo without registration in court or other certain registry and/or without registration in the persons liable for excise registry and/or without appropriate approval/authorization in accordance to provisions of this Code;</p> <p>12.3. undertakes actions that have the characteristics of misusing the rights in movement or destruction of taxable items;</p> | <p>prijave za upis podnositelj nema evidentiranih dospjelih dugova s naslova javnih davanja te ako ne postoje razlozi iz stava 7. ovoga člana.</p> <p>12. Carina rešenjem pravnoj ili fizičkoj osobi privremeno zabranuje daljnje obavljanje delatnosti ako:</p> <p>12.1. ne dopusti ili onemogućava provedbu carinske ili akcizne kontrole;</p> <p>12.2. proizvodi, posluje ili obavlja delatnost s akciznim proizvodima na carinskoj teritoriji Republike Kosovo bez upisa u sudski ili drugi odgovarajući registar i/ili bez upisa u registar akciznih obveznika i/ili bez dobijanja odgovarajućeg ovlašćenja prema odredbama ovoga Zakonika;</p> <p>12.3. poduzima radnje koje imaju obilježja zloupotrebe prava u kretanju ili raspolaganju predmetima oporezivanja;</p> |
|--|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>12.4. shet, blen, strehon, prodhon, posedon ose disponon produkte me akcizë në territorin doganor të Republikës së Kosovës ose në një mënyrë tjetër posedon produktet e akcizës në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me këtë Kod;</p> <p>12.5. publikon shitjen ose ofertën e produkteve të akcizës, tregtimi i të cilave nuk lejohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe/ose publikon ndërmjetësimin në tregti ose posedimin tjetër të produkteve të akcizës në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me këtë Kod.</p> <p>13. Vendimi nga paragrafi 12 i këtij neni zbatohet përshtatshëm si në paragrafin 8 të këtij neni dhe sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të tatueshme, pajisjeve dhe instrumenteve të tjera për prodhimin, përpunimin, transportin, shitjen, reklamimin dhe ruajtjen e sendeve të tatueshme, për të cilën zyrtari doganor është i detyruar të lëshojë vërtetim.</p> <p>14. Ndalimi nga paragrafi 12 i këtij neni zgjat deri në shuarjen e shkaqeve për të cilat është shqiptuar ndalimi, dhe së paku tridhjetë (30) ditë nga dita e nxjerrjes së vendimit.</p> | <p>12.4. sells, purchases, holds/deposits, manufactures, possesses or has excise products in the territory of Republic of Kosovo or another way possesses excise products contrary to the terms determined by this Code;</p> <p>12.5. advertises/publishes or offers excise products, trading of which is not permitted as per provisions of this Code and/or advertises/publishes trade intermediation or possession of other excise products contrary to the terms determined by the Code;</p> <p>13. Decision from paragraph 12 of this article shall be executed by proper application of paragraph 8 of this article and temporary sequestration of taxable items, equipment and other devices for manufacturing, processing, transport, sale, advertisement and holding of taxable items, for which the authorized customs officer is obligated to issue a certificate.</p> <p>14. The ban from paragraph 12 of this article continues until the causes for which the ban was imposed cease to exist and at least 30 days from the date of decision being issued.</p> | <p>12.4. prodaje, kupuje, skladišti, proizvodi, poseduje ili raspolaže akcizne proizvode na carinskoj teritoriji Republike Kosovo ili na drugi način raspolaže akciznim proizvodima protivno uslovima propisanim ovim Zakonikom.</p> <p>12.5. reklamira prodaju ili ponudu akciznih proizvoda čiji promet prema odredbama ovoga Zakonika nije dopušten i/ili oglašava posredovanje u prometu ili drugom raspolaganju akciznim proizvodima protivno uslovima propisanim ovim Zakonikom.</p> <p>13. Rešenje iz stava 12. ovoga člana izvršava se odgovarajućom primenom stava 8. ovoga člana i privremenim oduzimanjem predmeta oporezivanja, uređaja i druge opreme za proizvodnju, preradu, prevoz, prodaju, reklamiranje i skladištenje predmeta oporezivanja, o čemu je ovlašćeni carinski službenik dužan izdati potvrdu.</p> <p>14. Zabrana iz stava 12. ovoga člana traje sve do uklanjanja razloga zbog kojih je zabrana izrečena, a najkraće trideset (30) dana od dana izdavanja rešenja.</p> |
|---|---|---|

15. Për rastet nga paragrafi 12 i këtij Neni nëse konstatohet veprimi ose kryerja e aktiviteteve të paligjshme, Dogana për rregullimin e duhur të situatës dhe nëse është në proporcion me qëllimin e synuar, mund të konfiskoj, shesë ose shkatërrojë produktet e tatueshme, makineritë dhe pajisje të tjera të prodhimit, përpunimit, transportit, shitjes, reklamimit dhe ruajtjes.

16. Për rastet nga paragrafi 7 i këtij neni, nëse kjo është në proporcion me qëllimi rregullimin e duhur të situatës, Dogana mund të urdhërojë heqjen e parregullsive të identifikuar me mbikëqyrje dhe të caktojë një afat të duhur brenda të cilit parregullsitë duhet të korrigjohen.

Neni 230

Ruajtja e dokumentacionit dhe marrja e mostrave për analiza dhe testime

1. Për efekt të mbikëqyrjes, obliguesi akcizor është i detyruar të ruaj faturat e lëshuara dhe të pranuar, dokumentet shoqëruese të akcizës, deklaratat doganore, dokumentet në bazë të cilave ka përfituar lirim nga pagesa e akcizës, raportet dhe të gjitha dokumentet e tjera kontabël që kanë të bëjnë në çfarëdo mënyre me prodhimin, magazinimin, importin dhe eksportin e

15. In the event of cases mentioned in paragraph 12 of this article, comes to the ascertainment that illegal action or commitment of activities, Kosovo Customs for appropriate regulation of action and if in proportion with the intended purpose, may seize and sell or destroy the taxable items, machineries and other equipment for manufacturing, processing, transport, sale, advertisement and maintenance.

16. In the events mentioned in paragraph 7 of this article, Customs, if in proportion with the purpose having to be achieved, may order to remove the identified irregularities with supervision and appoint an appropriate period within which the irregularities will be corrected.

Article 230

Documentation storage and samples taking for analysis and testing

1. For the effect of supervision, the person liable for excise is obliged to store the invoices issued and received, accompanying excise documents, customs declarations, documents based on which he profited exemption from excise payment, reports and all other accounting documents having to do with any way of production, storage, import and export of excise

15. Ako se u slučajevima iz stava 12. ovoga člana utvrdi nezakonito postupanje ili obavljanje delatnosti, Carina može radi pravilnog uređenja postupanja, i ako je to srazmerno svrsi koja se želi postići, oduzeti te prodati ili uništiti predmete oporezivanja, uređaje i drugu opremu za proizvodnju, preradu, prevoz, prodaju, oglašavanje / reklamiranje i skladištenje istih.

16. U slučajevima pomenutim u stavu 7. ovoga člana Carina može, ako je to srazmerno svrsi koja se želi postići, narediti otklanjanje nadzorom utvrđenih nepravilnosti i odrediti primereni rok u kojem nepravilnosti treba otkloniti.

Član 230

Čuvanje dokumentacije i uzimanje uzoraka za analizu i ispitivanje

1. Za efekte vršenje nadzora/kontrole, akcizni obveznik je dužan čuvati izdane i primljene račune, prateće akcizne dokumente, carinske deklaracije, dokumente putem kojih je ostvario oslobođenje od plaćanja akcize, izveštaje i sve druge knjigovodstvene dokumente koji se na bilo koji način odnose na proizvodnju, skladištenje, uvoz i izvoz

| | | |
|---|--|--|
| <p>produkteve të akcizës dhe të produkteve tjera që i nënshtrohen këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi me të cilin përshkruhet tatimimi i produkteve të akcizës, të cilat janë të rëndësishme për llogaritjen dhe pagesën e akcizës, brenda një periudhe gjashtë (6) vjeçare pas përfundimit të vitit me të cilin vit kanë të bëjnë këto dokumente.</p> <p>2. Në procesin e vërtetimit të fakteve relevante për tatimin, Dogana mund të ekzaminon produktet e akcizës dhe produktet e tjera që i nënshtrohen këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi që rregullojnë tatimin e produkteve të akcizës, mund të marrë mostra për analiza ose testime të tjera të përshtatshme dhe nga obliguesi akcizor dhe personat e tjerë tek të cilët gjenden këto produkte mund të kërkojnë paraqitjen e faturave, fletë dërgesave, fletë dorëzimeve, dokumenteve përcjellëse, dokumenteve komerciale, tregtare, zyrtare dhe të tjera, si dhe dëshmitë të tjera të nevojshme për vërtetimin e saktë dhe të plotë të fakteve në procedurën e mbikëqyrjes.</p> <p>3. Rregullat për marrjen dhe ruajtjen mostrave, transportin, analizimin si dhe kostot e marrjes së mostrave përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës të Financave.</p> | <p>products and other products that are subject to this Code and other laws in force by which taxation and excise products calculation is described, which are important for excise calculation and payment, within a six years (6) period after the ending of the year with what year these documents have to do.</p> <p>2. In the process of verifying relevant tax facts, Customs may inspect the excise products and other products subject to this Code and other laws in force regulating the taxation on excise products, may take samples for analysis and other suitable testing and may require from the person liable for excise and other individuals where these products are found, to submit invoices, waybills, delivery forms, accompanying documents, commercial documents, trade, official and other evidences necessary for accurate and complete verification of facts in the supervision procedure.</p> <p>3. The regulation of sample collection, transport, analysis and cost of sample collection is determined by the act of the relevant Ministry of Finance.</p> | <p>akciznih i drugih proizvoda koji su predmet uređenja ovoga Zakonika i drugih važećih zakona koji su na snazi kojima je propisano oporezivanje akciznih proizvoda, a koji su bitni za obračunavanje i plaćanje akcize, u vremenskom roku od šest (6.) godina nakon isteka godine na koju se ti dokumenti odnose.</p> <p>2. U postupku utvrđivanja činjenica bitnih za oporezivanje Carina može pregledati akcizne i druge proizvode koji su predmet uređenja ovoga Zakonika i i drugih važećih zakona na snazi kojima je propisano oporezivanje akciznih proizvoda, može uzeti uzorke za analizu ili drugo odgovarajuće ispitivanje te od akciznog obveznika i drugih osoba kod kojih se oni nalaze, može tražiti dostavu računa, otpremnica, izdatnica, popratnica, komercijalnih dokumenata, trgovačkih, službenih i drugih isprava te drugih dokaza potrebnih za pravilno i potpuno utvrđivanje činjenica u postupku nadzora.</p> <p>3. Pravila za uzimanje uzoraka i skladištenje uzoraka, transport, analizu i troškove uzimanja uzoraka utvrđuju se podzakonskim aktom Ministra Financija.</p> |
|---|--|--|

| <p style="text-align: center;">Neni 231 Keqpërdorimi në lëvizjen ose disponimi me produkte të akcizës</p> | <p style="text-align: center;">Article 231 Abusing the movement or disposal of excise products</p> | <p style="text-align: center;">Član 231 Zloupotreba u kretanju ili raspolaganju akciznim proizvodima</p> |
|---|---|--|
| <p>1. Keqpërdorim i së drejtës për të lëvizur ose disponuar me produkte të akcizës është çdo sjellje e personave që janë në çfarëdo mënyre të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në lëvizjen ose disponimin me produkte të akcizës që synon:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. fshehjen e qëllimit të vërtetë, qëllimit ose bazës aktuale të lëvizjes ose disponimin me produkte të akcizës;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. shmangien e pagesës së akcizës ose përfitimeve të tjera publike, duke përfshirë krijimin e kushteve për shmangien e pagesës së akcizës ose përfitimeve të tjera publike;</p> <p>2. Personat të cilët në çfarëdo mënyre janë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në lëvizjen ose disponimin me produkte të akcizës do të konsiderohen se keqpërdorin të drejtën për të lëvizur dhe disponuar me produkte të akcizës, nëse:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. hyjnë në transaksione juridike fiktive ose transaksione në</p> | <p>1. By way of misusing the right to move or dispose excise goods means every action of persons that are involved in any way directly or indirectly in movement or disposal of excise goods with intention to:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. conceal the real purpose, destination or actual base of movement or disposal of excise goods;</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. evasion of excise payment or other public profits, including creating conditions to evade the excise payment or other public profits;</p> <p>2. Persons who in any way are involved directly or indirectly in movement or possession of excise goods will be deemed to abuse with their right to move or possess excise goods, if they:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. enter in fictitious legal transactions or transactions in</p> | <p>1. Zloupotrebom prava u kretanju ili raspolaganju akciznim proizvodima smatra se svako postupanje osoba koje su na bilo koji način direktno ili indirektno uključene u kretanje ili raspolaganje akciznim proizvodima koje je usmereno na:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. prikrivanje stvarne namere, cilja ili osnove kretanja ili raspolaganja akciznim proizvodima.</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. izbjegavanje plaćanja akcize ili drugih javnih davanja, uključujući i stvaranje uslova za izbjegavanje plaćanja akcize ili drugih javnih davanja.</p> <p>2. Osobe koje su na bilo koji način direktno ili indirektno uključene u kretanje ili raspolaganje akciznim proizvodima, smatra će se da zloupotrebljavaju pravo na kretanje i raspolaganje akciznim proizvodima, ako:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1. sklapaju fiktivne ili prividne pravne poslove u vezi s</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>dukje në lidhje me lëvizjen ose disponimin me produkte të akcizës ose marrin pjesë në lidhjen, mbylljen ose ekzekutimin e këtyre transaksioneve juridike në çfarëdo cilësie.</p> <p>2.2. organizojnë dërgesa fiktive, marrje, lëvizje ose disponime fiktive të produkteve të akcizës ose marrin pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi në to;</p> <p>2.3. bëjnë keqpërdorime me lëvizjen e produkteve të akcizës për të treguar lëvizje ose disponime fiktive;</p> <p>2.4. marrin pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi në falsifikimin e biznesit, dokumenteve të transportit ose dokumenteve të tjera që lidhen me lëvizjen ose disponimin e produkteve të akcizës ose në përdorimin e këtyre dokumenteve të falsifikuara;</p> <p>2.5. përdorin në mënyrë të paautorizuar ose arbitrare të dhënat e personave të tjerë fizikë ose juridikë me qëllim të kryerjes ose krijimit të kushteve për kryerjen e</p> | <p>appearance related to the movement or possession of excise products or take part in bonding/closing or execution of those legal transactions of every capacity.</p> <p>2.2. organize fictitious deliveries, receptions, movement or fictitious possessions of excise products or take part directly or indirectly;</p> <p>2.3. misuse the movement of excise goods to present fictitious movement or possession;</p> <p>2.4. participate directly or indirectly in falsifying business, transport or other documents related to the movement or possession of excise products or using these falsified documents;</p> <p>2.5. unauthorized or arbitrary use of data from other legal or natural persons with the purpose of committing or creating conditions to commit actions, treatments,</p> | <p>kretanjem ili raspolaganjem akciznim proizvodima ili sudeluju u sklapanju ili izvršavanju takvih pravnih poslova u bilo kojem svojstvu.</p> <p>2.2. organiziraju fiktivne isporuke, primitke, kretanja ili fiktivna raspolaganja akciznim proizvodima ili direktno ili indirektno učestvuju u tome.</p> <p>2.3. zloupotrebljavaju kretanje akciznih proizvoda za prikazivanje fiktivnih kretanja ili raspolaganja.</p> <p>2.4. direktno ili indirektno učestvuju u krivotvorenju poslovne, prevozne ili druge dokumentacije u vezi s kretanjem ili raspolaganjem akciznim proizvodima ili u korištenju takve krivotvorene dokumentacije.</p> <p>2.5. neovlašćeno ili samovoljno koriste podatke drugih fizičkih ili pravnih osoba radi obavljanja ili stvaranja uslova za obavljanje radnji, tretiranja, kretanja ili</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>veprimeve, trajtimeve, lëvizjeve ose disponim të produkteve të akcizës;</p> <p>2.6. duke keqpërdorur besimin, me veprime mashtruese, të rreme ose lajthitëse, kryejnë veprime, trajtime, lëvizje ose disponojnë me produkte të akcizës ose krijojnë kushte për veprime, trajtime, lëvizje ose posedime të tilla.</p> <p>3. Disponim me produkte të akcizës sipas këtij neni konsiderohet të jetë çdo posedim faktik ose ligjor, duke përfshirë ekskluzivisht kryerjen e transaksioneve financiare ose veprimet që përfshijnë lëshimin, certifikimin ose verifikimin të çfarëdo dokumenti për mbajtjen e kontabilitetit ose për kontabilitet, lidhjen e kontratave ose pjesëmarrjen, respektivisht edhe lëshimin e kontratave të transportit ose dokumente të tjera në cilësinë e blerësit, shitësit, ndërmjetësit, transportuesit, marrësit ose dërguesit.</p> <p>4. Nëse baza për përcaktimin e detyrimit për llogaritjen dhe pagesën e akcizës është keqpërdorimi i të drejtave në lëvizjen ose disponimin me produkte të akcizës dhe nëse konstatohet ekzistimi i një</p> | <p>movement or possession of excise products;</p> <p>2.6. by abusing the trust, fraudulent actions, false or deceptive, committing actions, treatments, movements or possessions of excise products or creating conditions for such actions, treatments, movements or possessions.</p> <p>3. Possession of excise products within the meaning of this article will be deemed every factual or legal possession, including exclusively commitment of financial transactions or actions that involve exemption, certificate or verification or every document for accounting maintenance or accounting, contracts binding or participation, respectively issuing transport contracts or other documents in capacity of consignee, consignor, intermediary, transporter, recipient or dispatcher.</p> <p>4. If the base to determine the obligation for excise calculation and payment is misusing the rights for movement or possession of excise products and if existence of a fictitious legal</p> | <p>raspolaganja akciznim proizvodima.</p> <p>2.6. zloupotrebom poverenja, prevarnim, lažnim ili obmanjujućim radnjama obavljaju radnje, postupanja, kretanja ili raspolaganja akciznim proizvodima ili stvaraju uslove za takve radnje, postupanja, kretanja ili raspolaganja.</p> <p>3. Raspolaganjem akciznim proizvodima u smislu ovoga člana smatra se svako činjenično ili pravno raspolaganje, uključujući i isključivo obavljanje finansijskih transakcija ili radnji koje podrazumvaju izdavanje, potvrđivanje ili overavanje bilo koje knjigovodstvene ili računovodstvene isprave, sklapanje ugovora ili učešće u ugovornim odnosima ili izdavanje, potvrđivanje ili overavanje prevozne ili neke druge isprave u svojstvu kupca, prodavca, posrednika, prevoznika, primatelja ili pošiljatelja akciznih proizvoda.</p> <p>4. Ako je osnova za utvrđivanje obveze obračunavanja i plaćanja akcize zloupotreba prava u kretanju ili raspolaganju akciznim proizvodima i ako se s time u vezi utvrdi postojanje fiktivnog</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>transaksioni juridik fiktiv ose jo të drejtë ose dorëzimit, marrjes, lëvizjes ose asgjësimit fiktiv të produkteve të akcizës, atëherë baza për përcaktimin e detyrimeve të akcizës është puna fiktive ose jo e drejtë, respektivisht dorëzimi, marrja, lëvizja ose disponimi fiktiv i produkteve të akcizës.</p> <p>5. Çdo person që merr pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi në keqpërdorim e të drejtave në lidhjen ose ekzekutimin e një transaksioni juridik fiktiv ose jo të drejtë ose dorëzimit, marrjes, lëvizjes ose disponimit fiktiv me produkte të akcizës, është përgjegjës si garantues i pagesës për pagesën e akcizës.</p> <p>6. Çdo person për të cilin nga rrethana objektive rezulton se ai e dinte ose duhet ta dinte se me veprimet e tij ose me mos marrjen e masave të duhura merr pjesë në keqpërdorimin e të drejtave të lëvizjes ose posedimit të produkteve të akcizës, është përgjegjës si garantues i pagesës për pagesën e akcizës së lindur.</p> <p>7. Nëse baza për përcaktimin e detyrimit për llogaritjen dhe pagimin e</p> | <p>transaction is ascertained or unfair, respectively delivery, reception, movement or fictitious possession of excise products. Every person that directly or indirectly takes part in misusing the rights in relation to or execution of fictitious legal transaction or unfair or delivery, reception, movement or fictitious possession of excise products, is responsible as payment warrantor for excise payment.</p> <p>5. Every person who results by objective circumstances of being aware or should have been aware that his actions or failure to take right measures, participates in misusing the rights of movement or disposal with excise products, is responsible by guarantee for excise payment born/created.</p> <p>6. Every person on whom from objective circumstances it results that they were aware or should have been aware of their actions or inactions to properly undertake measures, takes part in misusing the right of movement or possession of excise products, they are responsible as payment warrantor for the excise payment that have risen.</p> <p>7. If the base to determine the obligation for excise calculation and</p> | <p>ili prividnog pravnog posla ili fiktivne isporuke, primitka, kretanja ili raspolaganja akciznim proizvodima, tada je osnova za utvrđivanje akcizne obveze fiktivni ili prividni pravni posao odnosno fiktivna isporuka, primitak, kretanje ili raspolaganje akciznim proizvodima.</p> <p>5. Svaka osoba koja direktno ili indirektno učestvuje zloupotrebi prava u sklapanju ili izvršavanju fiktivnog ili prividnog pravnog posla ili fiktivne isporuke, primitka, kretanja ili raspolaganja akciznim proizvodima odgovora kao jemac platilac za plaćanje nastale akcizne obveze.</p> <p>6. Svaka osoba za koju iz objektivnih okolnost proizlazi da je znala ili morala znati da svojim radnjama ili propuštanjem poduzimanja dužnih radnji učestvuje zloupotrebi prava u kretanju ili raspolaganju akciznim proizvodima odgovara kao jemac platilac za plaćanje nastale akcizne obveze.</p> <p>7. Ako je osnova za utvrđivanje obveze obračunavanja i plaćanja akcize</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>akcizës është keqpërdorimi i të drejtave në lëvizjen ose disponimin me produkte të akcizës, anëtarët e shoqërive tregtare dhe personat që drejtojnë punët e shoqërisë nuk mund të thirren në atë se në bazë të ligjit nuk janë përgjegjës për obligimet e shoqërisë, dhe personat e tillë janë personalisht përgjegjës për borxhin e akcizës, bashkërisht dhe veçmas me gjithë pasurinë e tyre.</p> <p>8. Personi që përfiton nga persona të tjerë që veprojnë si administrues të tij apo saj është gjithashtu përgjegjës personalisht, në mënyrë solidare dhe individualisht për borxhin e akcizës me gjithë pasurinë e tij apo saj, në mënyrë që dikush tjetër të veprojë si anëtar i shoqërisë, por këtë e bën me urdhër dhe udhëzimet e atij personi.</p> <p>9. Dogana do të përdorë të gjitha provat për të vërtetuar fakte të rëndësishme për tatimin në procesin e përcaktimit të keqpërdorimit të drejtave në lëvizjen ose disponimin me produkte të akcizës, duke përfshirë njoftime dhe informacione të mbledhura në përputhje me dispozitat që rregullojnë bashkëpunimin administrativ dhe shkëmbimin e informacionit me vendet e tjera.</p> | <p>payment is misusing the rights to movement or possession of excise goods, the member of trade associations and persons managing the association's works cannot invoke that based on the Law they are not responsible for association's obligations and such persons are personally responsible for the excise debt, jointly and individually with their entire assets.</p> <p>8. The person that benefits from other persons acting as his/her administrator is also personally responsible, jointly and individually for the excise debt with his/her entire assets, in order that somebody else shall act as member of association, but this is performed by order and instructions of that person.</p> <p>9. The Customs will use all the evidence to verify the important facts for taxation in the process of determining the misuse of rights on movement or possession of excise products, by including information collected in accordance to regulations regulating the administrative cooperation and exchange of information with other countries.</p> | <p>zloupotreba prava u kretanju ili raspolaganju akciznim proizvodima, članovi trgovačkih društava i osobe koje vode poslove društva ne mogu se pozvati na to da po zakonu ne odgovaraju za obveze društva i takve osobe za akcizni dug odgovaraju lično, solidarno i neograničeno celom svojom imovinom.</p> <p>8. Za akcizni dug lično, solidarno i neograničeno celom svojom imovinom odgovara i osoba koja se koristi drugim osobama koje deluju kao njezini poverenici tako da se u društvu kao član iskazuje netko drugi, ali to čini po nalogu i uputama te osobe.</p> <p>9. Carina će koristiti sva dokazna sredstva za utvrđivanje činjenica bitnih za oporezivanje u postupku utvrđivanja zloupotrebe prava u kretanju ili raspolaganju akciznim proizvodima, uključujući obavesti i informacije prikupljene u skladu s propisima kojima se uređuje administrativna saradnja i razmena informacija s drugim državama.</p> |
|--|--|---|

| <p align="center">Neni 232 Sigurimi i mbledhjes të akcizës duke konfiskuar sende dhe mjete</p> | <p align="center">Article 232 Ensuring the collection of excise by seizure of items and means</p> | <p align="center">Član 232 Osiguranje naplate akcize oduzimanjem predmeta i sredstva</p> |
|--|---|--|
| <p>1. Nëse ekziston rreziku që me posedim të pronës, marrëveshje me palët e treta ose ndryshe do të pengohet ose pengohet ndjeshëm arkëtimi i akcizës, ose nëse rrethanat e tjera tregojnë se arkëtimi i akcizës mund të jetë i pasigurt, Dogana mund, me qëllim të sigurimit të arkëtitimit dhe nëse është proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet, të ndaloj dhe konfiskoj të gjitha sendet dhe mjetet e destinuar ose të përdorura për trajtim të paligjshëm dhe sendet që rezultojnë nga veprime të paligjshme, duke përfshirë konfiskimin dhe shitjen e mjeteve motorike, motorëve të tjerë ose makinerive që i janë nënshtruar inspektimit ose verifikimit në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.</p> <p>2. Ekzistimi i rrezikut nga paragrafi 1 i këtij neni veçanërisht konsiderohet rrethanë:</p> <p>2.1. nëse obliguesi i akcizës ose personi i detyruar për të paguar akcizën është një person që ka shkelur rëndë ose ka shkelur në mënyrë të përsëritur dispozitat e legjislacionit akcizor, tatimor ose doganor;</p> | <p>1. If risk exists on possessing property, agreement with third parties or otherwise will hinder or significantly impede excise collection, or if other circumstances show that excise collection may be insecure, Customs may ensure collection and if in proportion with the purpose that needs to be achieved, shall seize all the items and means destined or used in illegal handling and items that result in illegal actions, including sequestration and selling motor vehicles, other motors or machineries subjected to inspection or verification in accordance to provisions of this Code.</p> <p>2. The existence of risk from paragraph 1 of this article is especially considered a circumstance:</p> <p>2.1. If the person liable for excise or person liable for excise payment is a person with grievous violation or repeated violations of excise, tax or customs regulations provisions;</p> | <p>1. Ako postoji opasnost da će se raspolaganjem imovinom, dogovorom s trećim osobama ili na drugi način sprečiti ili znatno otežati izvršenje naplate akcize odnosno ako iz drugih okolnosti proizlazi da bi naplata akcize mogla biti neizvesna, Carina može, radi osiguranja naplate i ako je to srazmerno svrsi koja se želi postići, oduzeti sve predmete i sredstva koji su namenjeni ili upotrebljeni za nezakonito postupanje te predmete koji su nastali kao posljedica nezakonitog postupanja, uključujući i oduzimanje i prodaju motornih vozila, drugih motora ili mašina koji su bili predmet nadzora ili provere prema odredbama ovoga Zakonika.</p> <p>2. Postojanjem opasnosti iz stava 1. ovoga člana osobito se smatra okolnost:</p> <p>2.1. da je akcizni obveznik ili obveznik plaćanja akcize je osoba koja je teže kršila ili ponavljano kršila odredbe akciznih, poreznih ili carinskih propisa.</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>2.2. nëse për shkak të shumës së borxhit të akcizës, me të drejtë pritet të vështirësohet arkëtimi;</p> <p>2.3. nëse obliguesi akcizor ose obliguesi për pagesën e akcizës, është një person i cili nuk ka fonde ose pasuri të tjera që do të siguronin arkëtimin e borxhit të akcizës ose është një person aftësia financiare e të cilit nuk ofron garanci të mjaftueshme për sigurinë e arkëtimit të borxhit të akcizës;</p> <p>2.4. nëse obliguesi akcizor ose obliguesi për pagesën e akcizës është një person që nuk ka vendbanim ose vendqëndrim të zakonshëm në Republikën e Kosovës, ose</p> <p>2.5. nëse obliguesi akcizor ose obliguesi për pagesën e akcizës është personi i cili nuk ka seli të regjistruar në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Sendet dhe mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni në veçanti konsiderohen produktet e akcizës, aparatet dhe pajisjet tjera për prodhimin, përpunimin dhe</p> | <p>2.2. If due to the amount of excise debt, it is rightly expected that collection will become more difficult;</p> <p>2.3. If the person liable for excise or person liable for excise payment is a person who has no funds or other assets to ensure the collection of excise debt or a person whose financial capacity doesn't provide for sufficient guarantee for the excise debt collection;</p> <p>2.4. If the person liable for excise or the person liable for excise payment is a person who does not reside or permanently reside in the Republic of Kosovo, or</p> <p>2.5. If the person liable for excise or person liable for excise payment is a person who does not have a registered residency in Republic of Kosovo.</p> <p>3. The items and assets from paragraph 1 of this article especially are deemed as excise products, devices and other equipment for production, processing</p> | <p>2.2. da se zbog visine akciznog duga opravdano očekuje otežano izvršenje naplate.</p> <p>2.3. da je akcizni obveznik ili obveznik plaćanja akcize osoba koja ne raspolaže drugim sredstvima ili imovinom koja bi osiguravala izvesnost naplate akciznog duga ili osoba čija finansijska sposobnost ne daje dovoljnu garanciju sigurnosti naplate akciznog duga.</p> <p>2.4. da je akcizni obveznik ili obveznik plaćanja akcize osoba koja nema stalno prebivalište ili običan boravak u Republici Kosovo. Ili</p> <p>2.5. da je akcizni obveznik ili obveznik plaćanja akcize osoba koja nema registrovano sedište u Republici Kosovo.</p> <p>3. Predmetima i sredstvima iz stava 1. ovoga člana posebno se smatraju akcizni proizvodi, uređaji i druga oprema za proizvodnju, prerađu i skladištenje</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>strehimin e produkteve të akcizës, mjeteve të transportit dhe të ngjashme. Për qëllimet e këtij paragrafi, mjet transporti konsiderohet çdo mjet transporti për njerëz ose mallra.</p> <p>4. Dogana lëshon vërtetim për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dhe mjeteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e lëshimit të vërtetimit lëshon vendim me të cilin urdhëron vendosjen e tyre nën mbikëqyrje doganore deri në ekzekutimin e vendimit për arkëtimin e akcizës. Vendimi për vënien nën mbikëqyrje i dorëzohet edhe pronarit të mjeteve motorike, nëse personi i kapur në keqpërdorim ose disponim të energjentëve nuk është edhe pronar.</p> <p>5. Nëse dorëzohet garancioni përkatës i sigurimit në shumën e borxhit përkatës të akcizës, sendet dhe mjetet e sekuestruara përkohësisht nga paragrafi 1 i këtij neni i kthehen personit të cilit i janë sekuestruar. Garancioni i sigurimit të borxhit mund të depozitohet edhe nga një person tjetër.</p> <p>6. Kur pas ekzekutimit të vendimit për arkëtimin e akcizës konstatohet se akciza nuk është paguar, borxhi do të arkëtohet nga garancioni i sigurimit nga paragrafi 5 i këtij neni. Nëse garancioni i sigurimit nuk është</p> | <p>and maintenance/storage of excise products, means of transport and similar. For the purposes of this paragraph, transport means mean every transport means for persons or goods.</p> <p>4. Customs issues a verification for temporary sequestration of items and means mentioned in paragraph 1 of this article and in period of thirty (30) days after issuing the verification shall issue a decision by which orders placing their control on excise until the execution of decision for excise collection. Decision for placement under supervision is delivered to the owner of motor vehicles, if the person caught on act of abusing or in possession of energetics occurs not to be the owner.</p> <p>5. If certain instrument of insurance is submitted for the certain excise debt, the temporarily sequestered items and means from paragraph 1 of this article will be returned to the person sequestered from. Another person may deposit the debt insurance instrument as well.</p> <p>6. When post execution of decision for collection of excise, comes to the ascertainment that excise is not paid, the insurance instrument will collect the debt from paragraph 5 of this article. If the</p> | <p>akciznih proizvoda, transportnih sredstva i slično. Transportno sredstvo u smislu ovoga stava smatra se svako sredstvo koje služi prevozu ljudi ili robe.</p> <p>4. O privremenom oduzimanju predmeta i sredstav iz stava 1. ovoga člana Carina izdaje potvrdu i u roku od trideset (30) dana od dana izdavanja potvrde donosi rešenje kojim se određuje njihovo stavljanje pod akcizni nadzor do izvršenja rešenja o naplati akcize. Rešenje o stavljanju pod nadzor dostavlja se i vlasniku motornih vozila, ako osoba koja je zatečena u nenamenskom korištenju ili raspolaganju energentima nije ujedno i vlasnik.</p> <p>5. Ako se podnese primereni instrument osiguranja plaćanja u visini pripadajućeg akciznog duga, privremeno oduzeti predmeti i sredstva iz stava 1. ovoga člana biće vraćeni licu od koga su uzeti. Instrument osiguranja duga može se deponovati i od strane neke druge osobe.</p> <p>6. Kada se nakon izvršnosti rešenja o naplati akcize utvrdi da akciza nije plaćena, dug će se naplatiti iz instrumenta osiguranja iz stava 5. ovoga člana. Ako instrument osiguranja nije podnesen ili nije</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>dorëzuar ose nuk është dorëzuar në shumën e borxhit përkatës të akcizës, Dogana me vendim do t'i konfiskoj sendet dhe mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni dhe do t'i caktoj ato për shitje.</p> | <p>insurance instrument is not submitted or not submitted for actual amount of excise debt, the customs office by decision for collection will forever seize the items and means from paragraph 1 of this article and shall appoint them for sale.</p> | <p>podnesen u visini pripadajućeg akciznog duga, Carina će rešenjem o izvršenju trajno oduzeti predmete i sredstva iz stava 1. ovoga člana i odrediti njihovu prodaju.</p> |
| <p>7. Fondet e krijuara nga likuidimi i instrumentit të sigurisë dhe nga shitja e sendeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni do të shpërndahen në mënyrë që në fillim të ngarkohen interesat dhe shpenzimet e procedurës përkatëse, të grumbullimit, ruajtjes dhe shitjes, të pasuara nga shuma e borxhit të akcizës, ku borxhi në bazë të akcizës konsiderohet i shuar në një pjesë të ardhurave nga shitja.</p> | <p>7. The funds created by liquidation of insurance instruments and sale of items mentioned in clause 1 of this article will be distributed in such order that initially the interest and certain procedure costs are charged (collection costs, maintenance and sale), followed by the amount of excise obligation, where the debt based on excise is considered paid off for one part of revenues from the sale.</p> | <p>7. Sredstva ostvarena unovčenjem instrumenta osiguranja i prodajom predmeta sredstava iz stava 1. ovoga člana raspoređuju se tako da se najpre naplaćuju kamate i troškovi predmetnog postupka - troškovi prikupljanja, čuvanja i prodaje, a nakon toga iznos dužne akcize, nakon toga visina duga akcize, gde dug na osnovu akcize smatra će se ugašenim u delu prihoda ostvarenog prodajom.</p> |
| <p>8. Nëse fondet e krijuara nga likuidimi i garancionit të sigurisë ose nga shitja nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar interesin, kostot e procedurës përkatëse dhe shumën e detyrimit të akcizës, pjesa e pa arkëtuar do t'i nënshtrohet arkëtimit të detyruar në përputhje me dispozitat për mbledhjen e detyruar sipas legjislacionit në fuqi.</p> | <p>8. If the funds created by liquidation of insurance instrument or by the sale are not sufficient to cover the interest, certain procedure costs and the amount of excise obligation, the uncollected part will be subject to mandatory collection in accordance to regulations for obligatory collection regulations from public profits.</p> | <p>8. Ako sredstva ostvarena unovčenjem instrumenta osiguranja ili prodajom nisu dovolna za podmirenje kamata, troškova predmetnog postupka i iznosa duga za akcizu, za nenaplaćeni deo će se provesti postupak prisilne naplate prema propisima za prisilnu naplatu javnih davanja.</p> |
| <p>9. Nëse të ardhurat nga shitja i tejkalojnë mjetet e nevojshme për pagesën e interesit, shpenzimet e procedurës përkatëse dhe shumën e akcizës që duhet paguar, fondet e mbetura pas mbledhjes i kthehen</p> | <p>9. If the sale from sale revenues exceed the necessary means for interest payment, certain procedure costs and the amount of excise to be paid, the remaining funds after collection will be returned to</p> | <p>9. Ako su sredstva ostvarena prodajom veća od potrebnih sredstava za podmirenje kamata, troškova predmetnog postupka i iznosa duga za akcizu koji treba da se plati, nakon naplate ostatak sredstava</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>akcizë ose shkarkimin e ndonjë produkti me akcizë nga sistemi i pezullimit me qëllim që t'i shmangët rritjes së ardhshme të mundshme të normës së akcizës për atë produkt, Dogana nxjerrë urdhrin i cili i komunikohet me shkrim personit përkatës.</p> <p>3. Me aprovimin e Doganës, personi nga nën paragrafi 1.1 deri 1.3 të këtij neni mund të importoj ose shkarkojë nga sistemi i pezullimit të akcizës ndonjë produkt me akcizë të emërtuar në urdhër mbi mesataren mujore të përllogaritur nga nëntë (9) muajt paraprak me norme të reja të akcizës se rritur të planifikuar ose propozuar nëse plotësojnë kushtet si në vijim:</p> <p>3.1. në zyrën doganore kompetente deponojnë garancionin e sigurisë për diferencën e tatimeve që parashihen me rritjen e ardhshme të normës së akcizës për atë produkt dhe</p> <p>3.2. deklarohen me shkrim se do të përmbushin detyrimet doganore në ditën e parë të punës kur hyn në fuqi rritja e normës së tatimit të akcizës.</p> | <p>product or discharge any excise product from the suspension system in order to avoid the possible future increase of the excise duty rate for that product, the Customs shall issue the order which is communicated in writing to the relevant person.</p> <p>3. With the approval of the Customs, the person from under paragraph 1.1 to 1.3 of this article can import or download from the excise duty suspension system any product with excise duty named in the order above the monthly average calculated from the previous nine (9) months at the rate of the planned or proposed increased excise duty if they meet the following conditions:</p> <p>3.1. in the competent customs office deposit the security guarantee for the tax difference that is expected with the future increase in the excise rate for that product and</p> <p>3.2. declare in writing that they will fulfill customs obligations on the first working day when the increase in the excise tax rate comes into force</p> | <p>ispusti bilo koji akcizni proizvod iz sistema suspenzije kako bi se izbjeglo moguće buduće povećanje stope akcize za taj proizvod, Carina će izdati nalog koji se dostavlja pismeno relevantnom licu.</p> <p>3. Lice iz stava 1.1. do 1.3. ovog člana, uz odobrenje Carine, može uvesti ili preuzeti iz sistema odlaganja akcize bilo koji proizvod sa akcizom naveden redosledom iznad mesečnog proseka izračunatog iz prethodnih devet (9) meseci po stopi planirane ili predložene povećane akcize ako ispunjavaju sledeće uslove:</p> <p>3.1. u nadležnoj carinarnici položiti garanciju za poresku razliku koja se očekuje budućim povećanjem akcizne stope za taj proizvod i</p> <p>3.2. pismeno izjavljuju da će ispuniti carinske obaveze prvog radnog dana kada na snagu stupi povećanje stope akcize.</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>4. Garancioni i sigurisë lirohet pas përmbushjes së detyrimeve të importit që parashihen sipas paragrafit 3 të këtij neni.</p> | <p>4. The security guarantee will be released after the fulfillment of the customs obligations provided for in paragraph 3 of this article.</p> | <p>4. Garancija obezbeđenja se oslobađa nakon ispunjenja carinskih obaveza iz stava 3. ovog člana.</p> |
| <p>5. Importi ose shkarkimi nga sistemi i pezullimit të akcizës i ndonjë produkti me akcizë të emërtuar në urdhër mbi mesataren mujore të përlogaritur nga nëntë (9) muajt paraprak pa i përmbushur kushtet e parapara sipas paragrafit 3 të këtij neni do të konsiderohet si veprim i paligjshëm.</p> | <p>5. The import or discharge from the excise duty suspension system of any excise product named in the order above the monthly average calculated from the previous nine (9) months without fulfilling the conditions set forth in paragraph 3 of this article shall be considered as an act of illegal.</p> | <p>5. Uvoz ili ispuštanje iz sistema suspenzije akcize bilo kog akciznog proizvoda navedenog po redosledu iznad mesečnog proseka izračunatog iz prethodnih devet (9) meseci bez ispunjavanja uslova iz stava 3. ovog člana smatra se kao delo nezakonitog.</p> |
| <p>6. Me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa përcaktohen rregulla shtese në rast të ndryshimit të përlogaritjes së taksës së akcizës dhe ato procedurale për zbatim të këtij neni.</p> | <p>6. By a sublegal act of the relevant Minister for Finance, additional rules are defined in the event of a change in the calculation of the excise tax and procedural ones for the implementation of this article.</p> | <p>6. Podzakonskim aktom nadležnog ministra finansija utvrđuju se dodatna pravila u slučaju promene obračuna akcize i proceduralna pravila za sprovođenje ovog člana.</p> |

**LIBRI I TRETË
LIGJI PËR SHKELJET
NË FUSHËN
DOGANORE DHE
SANKSIONET**

**KAPITULLI I
QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI**

**Neni 239
Qëllimi**

Qëllimi i këtij libri është përcaktimi i shkeljeve në fushën doganore dhe akcizore si dhe sanksioneve për këto shkelje, për të inkurajuar zbatimin e legjislacionit doganor dhe akcizor në fuqi.

**Neni 240
Fushëveprimi**

Ky libër vlen për të gjithë personat fizik dhe personat juridik të cilët janë të detyruar të zbatojnë legjislacionin doganor dhe akcizor.

**THIRD BOOK
LAW ON CUSTOMS
INFRINGEMENTS AND
FINES**

**CHAPTER I
THE PURPOSE AND THE
SCOPE**

**Article 239
Purpose**

The purpose of this book is determining infringements in the customs and excise field as well as fines for these infringements, so to encourage the implementation of the customs and excise legislation in force.

**Article 240
The scope**

This book serves for all the natural and legal persons who are obliged to implement the customs and excise legislation.

**TREĆA KNJIGA
ZAKON O
PREKRŠAJIMA U
OBLASTI CARINE I
SANKCIJE**

**POGLAVLJE I
CILJ I OBLAST**

**Član 239
Cilj zakona**

Svrha ovog knjige je da se odrede prekršaji u oblasti carina i akciza, kao i sankcije za te prekršaje, da se podstakne primena važećeg carinskog i akciznog zakonodavstva.

**Član 240
Oblast**

Ova knjiga važi za sva fizička i pravna lica koja su dužna da primenjuju carinsko i akcizno zakonodavstvo.

| | | |
|--|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 241 Zbatimi përshtatshmërisht i Ligjit për Kundërvajtje</p> <p>Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, në procedurën e kundërvajtjes, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e ligjit përkatës për kundërvajtje.</p> | <p style="text-align: center;">Article 241 Appropriate implementation of the Law on Minor Offences</p> <p>If not otherwise provided by this Code, in the offence procedure, appropriately the pertinent law on offences provisions shall apply.</p> | <p style="text-align: center;">Član 241 Odgovarajuća primena Zakona o prekršajima</p> <p>Ako ovim zakonikom nije drugačije određeno, u prekršajnom postupku na odgovarajući način se primenjuju odredbe odgovarajućeg zakona o prekršajima.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 242 Klasifikimi i shkeljeve</p> <p>1. Shkelje në fushën doganore dhe të akcizave janë:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. kundërvajtjet administrative, dhe</p> <p style="padding-left: 40px;">1.3. veprat penale të sanksionuara në Kodin Penal të Kosovës</p> | <p style="text-align: center;">Article 242 Infringements classification</p> <p>1. The infringements in the customs and excise domain are:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. administrative offences, and</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. criminal acts sanctioned by Kosovo Penal Code.</p> | <p style="text-align: center;">Član 242 Klasifikacija prekršaja</p> <p>1. Prekršaji u oblasti carina i akciza su:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. administrativni (upravni) prekršaji, i</p> <p style="padding-left: 40px;">1.2. krivična dela sankcionisana Krivičnim Zakonom Kosova.</p> |
| <p style="text-align: center;">KAPITULLI II KUNDËRVAJTJET DOGANORE DHE SANKSIONET</p> | <p style="text-align: center;">CHAPTER II CUSTOMS OFFENSES AND SANCTIONS</p> | <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II CARINSKI PREKRŠAJI I SANKCIJE</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 243 Kundërvajtjet më të rënda</p> <p>1. Me gjobë në shumë prej dymijë (2,000) euro deri njëzetmijë euro (20,000)</p> | <p style="text-align: center;">Article 243 Strict liability offences</p> <p>1. A fine in amount of one twothousand (2,000) euros up to thirty</p> | <p style="text-align: center;">Član 243 Najteži prekršaji</p> <p>1. Novčanom kaznom u iznosu od dvehiljadu (2,000) evra do dvadeset hiljada</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>euro dënohet për kundërvajtje doganore, personi juridik, nëse:</p> <p>1.1. sjellë apo tenton të sjellë mallin, në mënyrë të fshehur, pa i paraqitur ato tek Dogana, në territorin doganor të Republikës së Kosovës ose nxjerrë apo tenton ta nxjerrë mallin nga territori doganor i Republikës së Kosovës; në kundërshtim me paragrafin 1 te nenit 95;</p> <p>1.2. largon mallrat me status jo vendor nga mbikëqyrja doganore, pa lejen e doganës, në kundërshtim me paragrafin 2 te nenit 95;</p> <p>1.3. nuk depoziton deklaratën doganore për mallrat ose një pjesë të mallrave ne hyrje ose dalje nga territori doganor i Republikës së Kosovës, për mallra me natyrë tregtare ose mallra që i nënshtrohen ndalesave ose kufizimeve të importit ose eksportit, në kundërshtim me neni 95 dhe Nenit 112.</p> <p>2. Me gjobë në shumë prej katërqindë (400) euro deri katërmijë (4,000) euro, dënohet personi përgjegjës në personin juridik dhe</p> | <p>thousand (20,000) euros for legal subjects for customs offences, if:</p> <p>1.1. brings or attempts to bring goods, secretly, without submitting them to Customs, in the customs territory of Republic of Kosovo or removes or attempts to remove the goods from customs territory of Republic of Kosovo; defines by paragraph 1 of Article 95;</p> <p>1.2. removes goods with non domestic status from customs supervision, without customs permit as per paragraph 2 of Article 95;</p> <p>1.3. fails to deposit the customs declaration for goods or part of goods in entry or exit from the customs territory of Republic of Kosovo, for goods of commercial nature or goods subject to import or export prohibitions or restrictions, as per article 95 and article 112.</p> <p>2. A fine in amount of four hundred (400) euros up to four thousand (4,000) euros, for the legal person's liable person</p> | <p>(20,000) evra kazniçe se za carinski prekršaj pravno lice, ako:</p> <p>1.1. unosi ili pokušava da unese robu, na skriven način, bez prijavljivanja carini, na carinsku teritoriju Republike Kosovo ili da iznosi ili pokuša da iznese robu sa carinske teritorije Republike Kosovo; određeno stavom 1, članom 95;</p> <p>1.2. uklanja iz carinskog nadzora robu koja nije domaće proizvodnje, bez dozvole carine, određeno stavom 2, člana 95;</p> <p>1.3. ne podnosi carinsku deklaraciju za robu ili deo robe koji ulazi ili izlazi iz carinske teritorije Republike Kosovo, za robu komercijalne prirode ili robu koja podleže zabrani ili ograničenjima uvoza ili izvoza, prema članu 95. i članu 112.</p> <p>2. Novčanom kaznom u iznosu od četiri stotine (400) evra do četiri hiljade (4,000) evra kazniçe se za prekršaj</p> |
|---|---|---|

personi fizik, për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 244
Kundërvajtjet doganore të kryera me dashje

1. Me gjobë në shumë prej një mijë e pesëqind (1,500) euro deri pesëmbëdhjetë mijë (15,000) euro dënohet për kundërvajtje doganore, personi juridik, nëse:

1.1. me kërkesë të Doganës, nuk siguron ose ofron të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm në një formë të përshtatshme ose në çdo formë tjetër të kërkuar, nuk ofron të gjithë ndihmën e nevojshme për të përmbushur formalitetet doganore ose kontrollet doganore, në kundërshtim me paragrafët 1, 3 dhe 4 të Nenit 12;

1.2. paraqet deklaratën doganore, deklaratën për strehim të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën për riekспорт, ose njoftimin për riekспорт, aplikimin për autorizim ose për një vendim tjetër, me të

and the natural person, for offences from paragraph 1 of this article.

Article 244
Customs offenses committed intentionally

1. A fine in amount of one thousand and five hundred (1,500) euros up to fifteen thousand (15,000) euros for customs offence, for a legal person, if:

1.1. by request from Customs, fails to provide or doesn't provide all the necessary documents and information in an appropriate manner or any other requested manner, fails to provide all the necessary assistance to accomplish customs formalities or customs controls, contrary to paragraphs 1, 3 and 4 of Article 12;

1.2. submits a customs declaration, a declaration for temporary storage, the summarized entry declaration, summarized exit declaration, re-export declaration, or notice for re-export, application for authorization or for another decision, with inaccurate or

odgovorno lice u pravnom licu i fizičko lice, za prekršaj iz stava 1 ovog člana.

Član 244
Carinski prekršaji učinjeni sa umišljajem

1. Novčanom kaznom u iznosu od hiljadu i pet stotina (1,500) evra do petnaest hiljada (15,000) evra kazniće se za carinski prekršaj pravno lice, ako:

1.1. na zahtev Carine, ne obezbedi ili pruži svu potrebnu dokumentaciju i informacije u odgovarajućem obliku ili u bilo kom drugom traženom obliku, ne pruži svu neophodnu pomoć za obavljanje carinskih formalnosti ili carinskih kontrola, suprotno stavovima 1, 3. i 4. člana 12;

1.2. podnosi carinsku deklaraciju, deklaraciju za privremeni smeštaj, ulaznu zbirnu deklaraciju, izlaznu deklaraciju, deklaraciju za ponovni izvoz, odnosno obaveštenje o ponovnom izvozu, zahtev za izdavanje odobrenja ili drugo rešenje, sa

| | | |
|--|--|--|
| <p>dhëna të pasakta ose jo të plota ose përshkrim të pamjaftueshëm të mallrave, në kundërshtim me nën paragrafin 2.1 dhe paragrafin 4 të Nenit 12;</p> <p>1.3. bashkëngjit dokument jo të besueshëm, të pasaktë ose të pavlefshëm në deklaratën doganore, në deklaratën e strehimit të përkohshëm, në deklaratën përmbledhëse të hyrjes, në deklaratën përmbledhëse të daljes, në deklaratën e ri eksportit, në njoftimin e ri eksportit ose bashkë me aplikimin për autorizim ose për një vendim tjetër, në kundërshtim me nën paragrafin 2.2 dhe paragrafin 4 të Nenit 12;</p> <p>1.4. për deklaratën doganore të paraqitur, ose deklaratën për strehim të përkohshëm, deklaratën përmbledhëse të hyrjes, deklaratën përmbledhëse të daljes, deklaratën për riekспорт, njoftimin për riekспорт, aplikimin për autorizim ose për një vendim tjetër, nëse është e nevojshme, nuk përmbush detyrimin në lidhje me vendosjen e mallrave nën procedurë doganore ose me kryerjen e operacioneve të autorizuar, në kundërshtim me nën</p> | <p>incomplete data or insufficient description of goods, contrary to sub-paragraph 2.1 and paragraph 4 of Article 12;</p> <p>1.3. encloses not so credible document, inaccurate or invalid document in the customs declaration, in the temporary storage declaration, in the summarized entry declaration, the summarized exit declaration, the notice for re-export or along with the application for authorization or another decision, contrary to sub-paragraph 2.2 and paragraph 4 of Article 12;</p> <p>1.4. on the submitted customs declaration, or the temporary storage declaration, the summarized entry declaration, the summarized exit declaration, re-export declaration, application for authorization or another decision, if necessary, fails to fulfil the obligation on placing the goods under a customs procedure or by performing authorized operations, contrary to sub-paragraph 2.3 and paragraph 4 of Article 12;</p> | <p>netačnim ili nepotpunim podacima ili nedovoljnim opisom robe, suprotno podstavu 2.1 i stavu 4. člana 12.;</p> <p>1.3. priložiti nepouzdan, netačan ili nevažeći dokument uz carinsku deklaraciju, deklaraciju za privremeni smeštaj, ulaznu zbirnu deklaraciju, izlaznu zbirnu deklaraciju, deklaraciju za ponovni izvoz, obaveštenje o ponovnom izvozu ili zajedno sa zahtevom za odobrenje ili za drugo rešenje, suprotno podstavu 2.2 i stavu 4. člana 12.;</p> <p>1.4. za podnesenu carinsku deklaraciju ili deklaraciju za privremeni smeštaj, ulaznu zbirnu deklaraciju, izlaznu zbirnu deklaraciju, deklaraciju za ponovni izvoz, obaveštenje o ponovnom izvozu, zahtev za odobrenje ili drugo rešenje, ako je potrebno, ne ispunjava obavezu stavljanjem robe u carinski postupak ili vršenjem ovlašćenih radnji, suprotno podstavu 2.3 i stavu 4. člana 12.;</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|---|--|
| <p>paragrafin 2.3 dhe paragrafin 4 të Nenit 12;</p> <p>1.5. nuk respekton obligimin që rrjedh nga autorizimi ose vendimi tjetër, në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 16 ;</p> <p>1.6. nuk informon menjëherë Doganën për një situatë që krijohet, pas sjelljes së autorizimit ose vendimit tjetër dhe që mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e tij, në kundërshtim me paragrafin 2 të Nenit 16;</p> <p>1.7. nuk ruan dokumentin ose informacionin nga paragrafi 1 i nenit 12 , ose nuk e ruan atë në një mënyrë të qasshme dhe të pranueshme për Doganën, ose nuk e ruan atë në përputhje me afatin e përcaktuar nga legjislacioni doganor, sipas nenit 33;</p> <p>1.8. plotëson ose mundëson plotësimin e dokumentit me informacion të pasaktë për origjinën e mallit të përcaktuar me nenin 39 dhe nenin 42;</p> | <p>1.5. fails to respect the obligation deriving from the authorization or another decision, contrary to paragraph 1 of Article 16;</p> <p>1.6. fails to immediately inform Customs on a situation created, after bringing the authorization or other decision and which can affect in its continuity or contents, contrary to paragraph 2 of Article 16;</p> <p>1.7. fails to store the document or information from paragraph 1 of Article 12, or fails to store it in an accessible and acceptable manner for Customs, or fails to store it in accordance to the period specified by the customs legislation, as per Article 33;</p> <p>1.8. fills in or enables filling the document with inaccurate information on goods origin determined in Article 39 and Article 42;</p> | <p>1.5. ne poštuje obavezu koja proizilazi iz ovlašćenja ili drugog rešenja, suprotno stavu 1. člana 16.;</p> <p>1.6. ne obavesti odmah Carinu o situaciji koja nastaje nakon izdavanja ovlašćenja ili drugog rešenja koje može uticati na njen kontinuitet ili sadržaj, suprotno stavu 2. člana 16.;</p> <p>1.7. ne čuva dokumente ili podatke iz stava 1. člana 12., ili ih ne čuva na način koji je dostupan i prihvatljiv za carinu, ili ih ne čuva u skladu sa rokom određenim carinskim zakonodavstvom, shodno članu 33.;</p> <p>1.8. popunjava ili omogućava popunjavanje dokumenta netačnim podacima o poreklu robe definisanim u članu 39. i članu 42.;</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>1.9. plotëson ose mundëson plotësimin e dokumentit i cili përmban informacion të pasaktë në bazë të cilit, produkteve për të cilat ka të bëjë dokumenti, u jepet në mënyrë të pajustificueshme origjina preferenciale e përcaktuar me nenin 42;</p> <p>1.10. për mallrat e sjellura në territorin doganor të Republikës së Kosovës ose të nxjerra nga territori doganor i Republikës së Kosovës, nuk e paraqet apo nuk ia paraqet zyrës doganore kompetente, nuk e paraqet gjatë orarit zyrtar të punës së zyrës doganore kompetente deklaratën përmbledhëse të hyrjes apo njoftimin për arritjen e aeroplanit, apo deklaratën doganore, deklaratën e strehimit përkohshëm, deklaratën plotësuese, deklaratën e ri eksportit, deklaratën përmbledhëse të daljes apo njoftimin e ri eksportit, të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 3 të Nenit 90, paragrafin 1 të Nenit 94, paragrafin 5 të Nenit 99, paragrafin 1 dhe 3 të Nenit 103, Nenin 112, Nenin 117, paragrafin 1 të Nenit 181, paragrafin 1 të Nenit 185, Nenin 186 dhe paragrafin 1 të nenit 188;</p> | <p>1.9. fills or enables filling the documents containing inaccurate information based on which, the products with what the documents has to do, provides an unjustifiably preferential origin as specified in Article 42;</p> <p>1.10. on goods brought in the customs territory of Republic of Kosovo or removed from the customs territory of Republic of Kosovo, fails to submit or doesn't submit the entry summarized declaration to competent customs office or the notice for airplane arrival or the customs declaration, the temporary storage declaration, supplementing declaration, re-export declaration, summarized exit declaration or re-export notice, specified in paragraphs 1 and 3 of Article 90, paragraph 1 of Article 94, paragraph 5 of Article 99, paragraphs 1 and 3 of Article 103, Article 112, Article 117, paragraph 1 of Article 181, paragraph 1 of Article 185, Article 186 and paragraph 1 of Article 188;</p> | <p>1.9. popunjava ili omogućava popunjavanje dokumenta koji sadrži netačne podatke na osnovu kojih se proizvodima, na koje se dokument odnosi, neopravdano daje preferencijalno poreklo definisano u članu 42.;</p> <p>1.10. za robu unesenu na carinsku teritoriju Republike Kosovo ili izvezenu sa carinske teritorije Republike Kosovo, ne preda ili ne preda nadležnoj carinskoj ispostavi, ne preda u službeno radno vreme nadležne carinske ispostave zbirnu deklaraciju o ulasku ili obaveštenje o dolasku aviona, ili carinsku deklaraciju, deklaraciju za privremeni smeštaj, dopunsku deklaraciju, deklaraciju za ponovni izvoz, zbirnu izlaznu deklaraciju ili obaveštenje o ponovnom izvozu, definisani u stavovima 1. i 3. člana 90., stav 1. člana 94., stav 5. člana 99., stavovi 1. i 3. člana 103., člana 112., člana 117., stav 1. člana 181., stav 1. člana 185., člana 186., i stav 1. člana 188.;</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>1.11. nuk e deklaroi mallin apo nuk e paraqet mallin, nuk i deklaroi të gjitha mallrat apo nuk i paraqet të gjitha mallrat, në kundërshtim me Nenin 95, Neni 99, paragrafin 1 të Nenit 120 dhe Neni 183;</p> <p>1.12. nuk transporton menjëherë mallrat e sjellura në territorin doganor të Republikës së Kosovës në zyrën doganore të caktuar nga Dogana apo në çdo vend tjetër të caktuar apo miratuar nga Dogana, në zonë të lirë apo nuk i transporton në rrugën e përcaktuar nga Dogana dhe në përputhje me udhëzimet e dhëna, në kundërshtim me paragrafin 1 të Nenit 96 dhe paragrafin 3 të Nenit 98.</p> <p>1.13. nuk e ka informuar menjëherë Doganën për një rrethanë të paparashikuar apo forcë madhore për shkak të së cilës nuk mund të përmbushë detyrimin e përmendur në paragrafin 1 të Nenit 96 apo Doganën nuk e ka informuar për vendndodhjen e saktë të mallit nëse rrethana e paparashikuar apo fuqia madhore për shkak të së cilës nuk mund të përmbushë detyrimin e referuar në paragrafin 1 të Nenit 96</p> | <p>1.11. failure to declare the goods or doesn't declare the goods, doesn't declare all the goods or doesn't submit all the goods, contrary to Article 95, Article 99, paragraph 1 of Article 120 and Article 183;</p> <p>1.12. failure to transport immediately the goods brought in the customs territory of Republic of Kosovo to the customs office assigned or approved by Customs, in a free zone or fails to transport them on the road specified by Customs and in accordance to instructions provided, contrary to paragraph 1 of Article 96 and paragraph 3 of Article 98.</p> <p>1.13. failure to inform Customs immediately for an unforeseen circumstance or force majeure due to which cannot fulfil the obligation mentioned in paragraph 1 of Article 96 or fails to inform Customs about the exact location of goods if the unforeseen circumstance or force majeure due to which cannot fulfil the obligation referred to in paragraph 1 of Article 96 didn't cause a</p> | <p>1.11. ne deklaroi robu ili ne prijavi robu, ne deklaroi svu robu ili ne prijavi svu robu, suprotno članu 95., članu 99., stav 1. člana 120. i članu 183.;</p> <p>1.12. ne transportuje odmah robu unesenu na carinsku teritoriju Republike Kosovo do carinske ispostave koju odredi Carina ili na bilo koje drugo mesto koje odredi ili odobri Carina, u slobodnoj zoni ili je ne prevozi putem koji je odredila Carina u skladu sa datim uputstvima, suprotno stavu 1. člana 96. i stavu 3. člana 98.;</p> <p>1.13. nije odmah obavestio Carinu o nepredviđenoj okolnosti ili višoj sili zbog koje nije mogao da ispuni obavezu iz stava 1. člana 96. ili nije obavestio Carinu o tačnoj lokaciji robe ako je nepredviđena okolnost ili veća sila zbog čega ne može da izvrši obavezu iz stava 1. člana 96. nije prouzrokovala potpuni gubitak robe, suprotno stavu 1. člana 98.;</p> |
|--|---|---|

| | | |
|---|--|--|
| <p>nuk ka shkaktuar humbje të plotë të mallit, në kundërshtim me paragrafin 1 të Nenit 98 ;</p> <p>1.14. nuk e njofton menjëherë Doganën për situatën në të cilën aeroplani i përmendur në paragrafin 6 të Nenit 96 për shkak të rrethanave të paparashikuara ose forcës madhore është detyruar të ulet përkohësisht në tokë, në territorin doganor të Republikës së Kosovës, në kundërshtim me paragrafin 2 të Nenit 98;</p> <p>1.15. nuk paraqet mallin e sjellur në territorin doganor të Republikës së Kosovës në zyrën doganore të caktuar ose në një vend tjetër të caktuar ose miratuar nga Dogana, ose në zonën e lirë, ose mallin e sjellur në territorin doganor të Republikës së Kosovës nga ajri dhe që mbetet në atë mjet transporti, nuk ia paraqet Doganës në aeroportin ku shkarkohet ose ringarkohet, në kundërshtim me Nenin 99;</p> <p>1.16. pa lejen e Doganës, largon ose përpiqet t'i largojë mallrat e paraqitura në Doganë nga vendi ku janë paraqitur, në kundërshtim me paragrafin 7 të Nenit 99;</p> | <p>complete loss of goods, contrary to paragraph 1 of Article 98;</p> <p>1.14. failure to inform immediately the Customs on the situation where the airplane mentioned in paragraph 6 of Article 96 due to the unforeseen circumstances or the force majeure is forced to temporarily land on the ground, in the customs territory of Republic of Kosovo, contrary to paragraph 2 of Article 98;</p> <p>1.15. failure to submit the goods brought in the customs territory of Republic of Kosovo to the appointed customs office or another appointed or approved location by Customs, or in the free zone, or the goods brought in the customs territory of Republic of Kosovo by air and which remains on those transport means, fails to submit to Customs at the airport where its unloaded or reloaded, in contrary to Article 99;</p> <p>1.16. without Customs permit, removes or attempts to remove the goods submitted in Customs from</p> | <p>1.14. ne obavesti odmah Carinu o situaciji u kojoj je avion iz stava 6. člana 96. usled nepredviđenih okolnosti ili više sile prinuđen da privremeno sleti na carinsku teritoriju Republike Kosovo, suprotno stavu 2. člana 98.;</p> <p>1.15. ne prijavljuje robu unesenu na carinsku teritoriju Republike Kosovo u određenoj carinskoj ispostavi ili na nekom drugom mestu koje odredi ili odobri Carina, ili u slobodnoj zoni, ili robu unesenu na carinsku teritoriju Republike Kosovo vazдушnim putem i koja ostane na tom prevoznom sredstvu ne prijavi carini na aerodromu gde se istovara ili pretovaruje, suprotno članu 99;</p> <p>1.16. bez dozvole Carine, ukloni ili pokuša da ukloni robu koja je prijavljena Carini sa mesta gde je</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>1.17. pa autorizimin apo njoftimin e Doganës shkarkon ose ringarkon mallrat nga mjetet e transportit që i transportojnë ato ose mallrat nga mjetet e transportit duke i shkarkuar ose ringarkuar në një vend që nuk është caktuar ose miratuar nga Dogana, në kundërshtim me Nenin 100;</p> <p>1.18. nuk informon menjëherë Doganën për një rast rreziku të pashmangshëm që kërkon shkarkimin e menjëhershëm të gjithë mallit ose një pjese të mallit, në kundërshtim me paragrafin 2 të Nenit 100;</p> <p>1.19. nuk shkarkon ose ç ‘paketon mallrat me kërkesë të Doganës për të bërë ekzaminimin e tyre ose marrjen e mostrave ose ekzaminimin e mjeteve të transportit që transportojnë mallrat, në kundërshtim me paragrafin 3 të Nenit 100;</p> <p>1.20. mallrat në strehim të përkohshëm nuk i vendos në ambientet për strehim të përkohshëm në përputhje me nenin</p> | <p>the destined location, in contrary to paragraph 7 of Article 99;</p> <p>1.17. without authorization or Customs notification unloads or reloads the goods from the transport means transporting them or the goods from transport means by unloading or reloading them to another location which is not appointed or approved by Customs, in contrary to Article 100;</p> <p>1.18. failure to inform Customs immediately in case of inevitable danger which requires an immediate unloading of all the goods or part of the goods, in contrary to paragraph 2 of Article 100;</p> <p>1.19. failure to unload or unpack the goods with Customs request in order to examine them or take samples or examine the transport means transporting goods, in contrary to paragraph 3 of Article 100;</p> <p>1.20. failure to place the goods on temporary storage in locations for temporary storage in accordance</p> | <p>prijavljena, suprotno stavu 7. člana 99.;</p> <p>1.17. bez odobrenja ili obaveštenja Carine istovaruje ili pretovaruje robu iz prevoznog sredstva koje je prevozi ili robu iz prevoznog sredstva istovara ili pretovara na mestu koje nije odredila ili odobrila Carina, suprotno članu 100.;</p> <p>1.18. ne obavesti odmah Carinu o neposrednoj opasnosti koja zahteva hitan istovar cele ili dela robe, suprotno stavu 2. člana 100.;</p> <p>1.19. ne istovara ili raspakuje robu na zahtev Carine radi njenog pregleda ili radi uzimanje uzoraka ili radi pregleda prevoznog sredstva koje prevozi robu, suprotno stavu 3. člana 100.;</p> <p>1.20. robu na privremenom smeštaju ne smesti u prostorijama za privremeni smeštaj u skladi sa</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>106 ose në një zonë tjetër të caktuar ose të miratuar nga Dogana, sipas paragrafit 1 të Nenit 105 dhe Nenit 106;</p> <p>1.21. nuk siguron që mallrat në strehim të përkohshëm i nënshtrohen vetëm atyre formave të trajtimit që janë të destinuara të sigurojnë ruajtjen e tyre në një gjendje të pandryshuar, pa i modifikuar pamjen e tyre ose karakteristikat teknike, ose trajton mallrat në strehim të përkohshëm në një formë trajtimi që është i kundërt me formën e trajtimit të destinuara për të siguruar ruajtjen e tyre në një gjendje të pandryshuar, pa i modifikuar pamjen ose karakteristikat teknike të tyre, në kundërshtim me paragrafin 2 të Nenit 105;</p> <p>1.22. nuk mban evidencë ose nuk mban evidencë në një formë të miratuar nga Dogana ose mban shënime në mënyrë të pasaktë ose të paplotë ose në kohë, në kundërshtim me paragrafin 5 të Nenit 106 dhe Nenit 145;</p> <p>1.23. nuk siguron dokumentet mbështetëse të nevojshme për</p> | <p>with article 106 or another zone appointed or approved by Customs, as per paragraph 1 of Article 105 and Article 106;</p> <p>1.21. failure to insure that goods on temporary storage are subject only to those forms of treatment destined to ensure their protection in an unaltered state, without modifying their appearance or their technical characteristics, or treats the goods in temporary storage in a manner which is contrary to the treatment destined to ensure their protection in an unaltered state, without modifying their appearance or technical characteristics, in contrary to paragraph 2 of Article 105;</p> <p>1.22. fails to keep records or doesn't keep records in an approved form by Customs or keeps records in an inaccurate form or incomplete or in time, in contrary to paragraph 5 of Article 106 and Article 145;</p> <p>1.23. fails to provide necessary accompanying documents for</p> | <p>članom 106. ili u drugom prostoru koji odredi ili odobri Carina u skladu sa stavom 1. člana 105. i člana 106.;</p> <p>1.21. ne obezbeđuje da roba u privremenom smeštaju podleže samo onim oblicima tretmana koji imaju za cilj da obezbede njihovo očuvanje u nepromenjenom stanju, bez promene njihovog izgleda ili tehničkih karakteristika, ili tretira robu u privremenom smeštaju u obliku tretmana koji je suprotan oblik tretmana kojim se obezbeđuje njihovo očuvanje u nepromenjenom stanju, bez da se promene njihov izgled ili tehničke karakteristike, suprotno stavu 2. člana 105.;</p> <p>1.22. ne vodi evidenciju ili ne vodi evidenciju u formi koju je odobrila Carina ili netačno ili nepotpuno ili neblagovremeno vodi evidenciju, suprotno stavu 5. člana 106. i člana 145.;</p> <p>1.23. ne priloži prateću dokumentaciju neophodnu za</p> |
|---|--|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>zbatimin e dispozitave që rregullojnë procedurën doganore për të cilën janë deklaruar mallrat, kur një shërbim i tillë kërkohet nga legjislacioni vendor ose është i nevojshëm për kontrollet doganore sipas paragrafit 2 të Nenit 115;</p> <p>1.24. disponon mallrat që nuk janë lëshuar nga Dogana, sikur të ishin lëshuar nga Dogana sipas Nenit 132;</p> <p>1.25. nuk e shkarkon procedurën e posaçme në mënyrën e caktuar ose në afatin e caktuar sipas Neni 146;</p> <p>1.26. nuk i paraqet mallrat ose informatave të nevojshme në zyrën doganore të destinacionit, nuk i paraqet në gjendje të pandryshuar, nuk i paraqet brenda afatit të caktuar ose nuk i paraqet në përputhje me masat për të mundësuar njohjen e tyre, apo nuk zbaton dispozitat e tjera doganore për procedurën e transitit kombëtar sipas Nenit 154;</p> <p>1.27. mallrat e vendosura nën procedurën e magazinimit doganor,</p> | <p>implementation of provisions regulating the customs procedure for which the goods are declared, when such service is requested by domestic legislation or is necessary for customs controls as per paragraph 2 of Article 115;</p> <p>1.24. has possession of goods which are not exempt by Customs, as being exempt by Customs as per Article 132;</p> <p>1.25. fails to discharge the special procedure in the specific manner or in the specific period as per Article 146;</p> <p>1.26. failure to submit the goods or necessary information to the customs office of destination, doesn't submit them in an unaltered state, doesn't submit them within the specified period or doesn't submit them in accordance to measures to enable their recognition, or fails to implement other customs provisions for the national transit procedure as per Article 154;</p> <p>1.27. goods placed under the customs warehousing procedure,</p> | <p>sprovođenje odredaba kojima se uređuje carinski postupak za koji je roba prijavljena, kada je takva usluga propisana domaćim zakonodavstvom ili je neophodna za carinske kontrole iz stava 2. člana 115.;</p> <p>1.24. raspolaže sa robom koju nije pustila carina, kao da je puštena od carine shodno članu 132.;</p> <p>1.25. ne razdužuje poseban postupak na određeni način ili u određeno vreme shodno članu 146.;</p> <p>1.26. ne prijavljuje robu ili potrebne podatke određenoj carinskoj ispostavi, ne prijavljuje ih u neizmenjenom stanju, ne prijavljuje ih u ostavljenom roku, ili ih ne prijavljuje u skladu sa merama za omogućavanje njihovog prepoznavanja ili ne primenjuju druge odredbe carinskog postupka za domaći tranzitni postupak shodno članu 154.;</p> <p>1.27. roba stavljena u postupak carinskog skladištenja, privremeno</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p>përkohësisht i nxjerr nga ajo magazinë doganore pa autorizimin paraprak të Doganës të kërkuar me paragrafin 3 të Nenit 158;</p> <p>1.28. nuk siguron që mallrat nën procedurën e magazinimit doganor të mos largohen nga mbikëqyrja doganore ose të mos përmbushin obligimin që rrjedh nga strehimi i mallrave në kuadër të procedurës së magazinimit doganor ose të mos përmbushin obligimin që rrjedh nga vendosja e mallrave nën procedurën e magazinimit doganor, të përcaktuar me Neni 160;</p> <p>1.29. fillon ndërtimin e një ndërtese ose ndërton një objekt në zonë të lirë pa miratimin paraprak të Doganës, të kërkuar me paragrafin 1 të Nenit 162;</p> <p>1.30. nuk respekton legjislacionin doganor në kryerjen e aktivitetit industrial, tregtar ose shërbimi të lejuar në një zonë të lirë ose nuk njofton Doganën paraprakisht për kryerjen e një veprimtarie të tillë në një zonë të lirë, si kërkohet nga paragrafi 2 i Nenit 162;</p> | <p>are temporarily removed from the customs warehouse without prior authorization by Customs requested as per paragraph 3 of Article 158;</p> <p>1.28. failure to ensure that goods under customs warehousing procedure are not to be removed from customs supervision or not to fulfil the obligation deriving from goods storage within the customs warehousing procedure or not to fulfil the obligation deriving from goods being placed under customs warehousing procedure, determined by Article 160;</p> <p>1.29. starts constructing a building or constructs an object in the free zone without prior approval by Customs, requested as per paragraph 1 of Article 162;</p> <p>1.30. doesn't respect the customs legislation in performing industrial activities, commercial or service authorized in a free zone or fails to notify Customs preliminarily for performing such activity in the free zone, as requested by paragraph 2 of Article 162;</p> | <p>uklonjena iz tog carinskog skladišta bez prethodnog odobrenja Carine shodno stavu 3. članu 158;</p> <p>1.28. ne obezbedi da roba u postupku carinskog skladištenja ne izađe iz carinskog nadzora ili da ne ispuni obavezu koja proističe iz skladištenja robe u postupku carinskog skladištenja ili da ne ispuni obavezu iz stavljanja robe u postupak carinskog skladištenja shodno članu 160.;</p> <p>1.29. otpočne izgradnju zgrade ili izgradi objekat u slobodnoj zoni bez prethodnog odobrenja Carine iz stava 1. člana 162.;</p> <p>1.30. ne poštuje carinsko zakonodavstvo u obavljanju industrijske, komercijalne ili uslužne delatnosti dozvoljene u slobodnoj zoni ili ne obaveštava Carinu unapred o obavljanju te delatnosti u slobodnoj zoni, u skladu sa stavom 2. člana 162.;</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>1.31. nuk respekton ndalesat ose kufizimet në lidhje me aktivitetet e përmendura në paragrafin 2 të Nenit 162, të vendosura nga Dogana, duke marrë parasysh natyrën e mallrave ose kërkesat e mbikëqyrjes doganore, kërkesat e sigurisë dhe mbrojtjes ose nuk respekton ndalimin e Doganës për shkak të mos marrjes së certifikatave të nevojshme për përmbushjen e dispozitave doganore për kryerjen e veprimtarisë në zonën e lirë, të përcaktuar me paragrafin 3 dhe 4 të Nenit 162;</p> <p>1.32. nuk i paraqet mallrat në Doganë me rastin e futjes në zonën e lirë për të iu nënshtruar formaliteteve doganore të përcaktuara me Nenin 163;</p> <p>1.33. i trajton mallrat sikur t'i plotësojnë kushtet për import të përkohshëm, e që ky trajtim është në kundërshtim me kushtet për import të përkohshëm të mallrave, ose i trajton mallrat e vendosura nën procedurën e importit të përkohshëm në kundërshtim me kushtet ose detyrimet ose qëllimin e procedurës së miratuar të importit të</p> | <p>1.31. failure to respect the prohibitions or restrictions regarding the activities mentioned in paragraph 2 of Article 162, placed by Customs, having to consider the nature of goods or requests by customs supervision, security requirements and protection or failure to respect Customs prohibition due to failure to obtain necessary certificates for completing customs provisions to perform the activity in the free zone, determined in paragraphs 3 and 4 of Article 162;</p> <p>1.32. fails to submit the goods to Customs when entering them into free zone to be subject to customs formalities determined by Article 163;</p> <p>1.33. handles the goods as they would be fulfilling the terms for temporary importation, a treatment which is against the terms for temporary import of goods or handles the goods placed under the temporary import procedure with terms or duties or purpose of the approved temporary import in accordance with Article 168;</p> | <p>1.31. ne poštuje zabrane ili ograničenja u vezi sa radnjama pomenutim u stavu 2. člana 162. koje nameće Carina, uzimajući u obzir prirodu robe ili zahteve carinskog nadzora, uslove bezbednosti i zaštite, ili ne poštuje carinsku zabranu zbog nepribavljanja potrebnih sertifikata o ispunjenosti carinskih propisa za obavljanje delatnosti u slobodnoj zoni iz stavova 3. i 4. člana 162.;</p> <p>1.32. ne prijavi robu carini pri ulasku u slobodnu zonu da bi podlegla carinskim formalnostima definisana članom 163.;</p> <p>1.33. postupa sa robom kao da ispunjava uslove za privremeni uvoz, što takvo postupanje sa robom je suprotno uslovima za privremeni uvoz robe, ili postupa sa robom stavljenom u postupak privremenog uvoza suprotno uslovima ili obavezama ili svrsi odobrenog postupka privremenog uvoza u skladu sa članom 168.;</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|---|
| <p>përkohshëm në përputhje me Nenin 168;</p> <p>1.34. nuk i rieksporiton mallrat e importuara përkohësisht ose nuk i vendos në procedurën doganore pasuese, si përcaktohet me Nenin 169;</p> <p>1.35. nuk i riimporton mallrat e eksportuara përkohësisht sipas procedurës së përpunimit të jashtëm, në territorin doganor të Republikës së Kosovës, si përcaktohet me paragrafin 3 të Nenit 176;</p> <p>1.36. pasi që Dogana e ka pranuar deklaratën për lëshim në qarkullim të lirë, nuk i eksporton mallrat me defekt brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 3 të Nenit 180.</p> <p>1.37. nuk vepron me urdhër të oficerit doganor të autorizuar ose nuk vepron brenda afatit të përcaktuar në urdhër, si përcaktohet me nenin 295,296, 297 dhe 298.</p> <p>1.38. nuk deklaron mallrat të cilat i bart në bagazh siç përcaktohet me Nenin 302.</p> | <p>1.34. failure to re-export the temporary imported goods or failure to place them under following customs procedure, as determined by Article 169;</p> <p>1.35. failure to re-import the temporary exported goods as per the outward processing procedure, in the customs territory of Republic of Kosovo, as determined by paragraph 3 of Article 176;</p> <p>1.36. after Customs receives the declaration for release to free circulation, failure to export the goods with defect within the period determined in paragraph 3 of Article 180.</p> <p>1.37. does not act by order of the authorized customs officer or does not act within the time limit specified in the order, as defined in Articles 295, 296 and 297.</p> <p>1.38. does not declare the goods which he carries in the luggage as defined by article 99.</p> | <p>1.34. ne izvrši ponovni izvoz privremeno uvezene robe ili je ne stavi u naredni carinski postupak kako je definisano članom 169.;</p> <p>1.35. ne uvozi ponovo privremeno izvezenu robu prema postupku eksterne (spoljne) obrade, na carinsku teritoriju Republike Kosovo, kako je definisano u stavu 3. člana 176.;</p> <p>1.36. nakon što je Carina prihvatila deklaraciju za puštanje u slobodan promet, ne izveze neispravnu robu u roku kako je definisano u stavu 3. člana 180.;</p> <p>1.37. ne postupi po nalogu ovlašćenog carinskog službenika ili ne postupi u roku određenom naredbom iz čl. 295, 296. i 297.</p> <p>1.38. Robu koju nosi u prtljagu ne deklarise u skladu sa članom 99.</p> |
|--|--|---|

2. Me gjobë në shumë prej treqind (300) euro deri tremijë (3,000) euro, dënohet personi përgjegjës në personin juridik dhe personi fizik, për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij Neni.

Neni 245

Kundërvajtje të kryera nga pakujdesia

1. Me gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro deri pesëmijë euro (5,000) euro dënohet për kundërvajtje doganore, personi juridik, nëse:

1.1. Doganës nuk i ofron gjithë asistencën e nevojshme, për të përfunduar formalitetet dhe kontrollat doganore të përcaktuara në paragrafin 1 të Nenit 12;

1.2. me depozitimin e një deklarate doganore, deklarate të strehimit të përkohshëm, deklarate përmbledhëse të hyrjes, deklarate përmbledhëse të daljes, deklarate të ri eksportit ose njoftimit të ri eksportit ose një aplikimi për autorizim ose për një vendim tjetër, kur është e zbatueshme, brenda afatit kohor nuk përmbush një detyrim në lidhje me vendosjen e mallrave në fjalë nën procedurën

2. By fine in amount of three hundred (300) euros up to three thousand (3,000) euros, for the legal and natural liable person, for the offence from paragraph 1 of this Article.

Article 245

Other offences committed by negligence

1. By fine in amount of one five hundred (500) euros up to five thousand (5,000) euros for the customs offence, for the legal person in case:

1.1. fails to provide all the necessary assistance to Customs, in order to complete the customs formalities and controls as determined by paragraph 1 of Article 12;

1.2. by depositing a customs declaration, temporary storage declaration, entry summarized declaration, exit summarized declaration, re-export declaration or notice for re-export or application for authorization or another decision, when applicable, within the time limit fails to fulfil the obligation in relation to performing authorized operations determined by sub-paragraph 2.3 and paragraph 4 of Article 12;

2. Novčanom kaznom u iznosu od tri stotine (300) evra do tri hiljade (3,000) evra, kažnjava se odgovorno lice u pravnom licu i fizičko lice za prekršaj iz stava 1. ovog član.

Član 245

Ostali prekršaji učinjeni nepažnjom

1. Novčanom kaznom u iznosu od pet stotina (1.000) evra do pet hiljada (5,000) evra kazniće se za carinski prekršaj pravno lice, ako:

1.1. ne pruža carini svu neophodnu pomoć za obavljanje carinskih formalnosti i kontrola navedenih u stavu 1. člana 12.;

1.2. po podnošenju carinske deklaracije, deklaracije o privremenom smeštaju, zbirne ulazne deklaracije, zbirne izlazne deklaracije, deklaracije o ponovnom izvozu ili obaveštenja o ponovnom izvozu ili zahteva za izdavanje odobrenja ili druge odluke, gde je primenljivo, u roku ne ispuni obavezu u vezi sa stavljanjem relevantne robe u predmetni carinski postupak ili

| | | |
|---|---|---|
| <p>doganore përkatëse apo nën kryerjen e operacioneve të autorizuar të përcaktuar me nën paragrafin 2.3 dhe paragrafin 4 të Nenit 12;</p> <p>1.3. për mallrat e sjellura apo të nxjerra nga territori doganor i Republikës së Kosovës nuk dorëzon në kohë e përcaktuar deklaratën përmbledhëse të hyrjes, njoftimin për mbërritjen e një apo aeroplani, deklaratë të strehimit të përkohshëm, njoftimin për aktivitetet në zonat e lira, deklaratë të para nisjes, deklaratë ri eksporti, deklaratë përmbledhëse të daljes, ose një njoftim ri eksporti, të përcaktuara me paragrafin 1 dhe 3 të Nenit 90, paragrafin 1 të Nenit 94, paragrafin 5 të Nenit 99, paragrafin 1 dhe 3 të Nenit 103, Nenin 112, Nenin 117, paragrafin 1 të Nenit 181, paragrafin 1 të Nenit 185, Nenin 186 dhe paragrafin 1 të Nenit 188;</p> <p>1.4. nuk paraqet brenda afatit të përcaktuar mallrat të cilat janë sjelle në territorin doganor të Republikës së Kosovës në një zyrë doganore të caktuar ose në një vend tjetër të caktuar ose të miratuar nga Dogana</p> | <p>1.3. on goods brought in or removed from the customs territory of Republic of Kosovo fails to submit in time the specific entry summarized declaration, the notice on arrival of marine ships or airplane, temporary storage declaration, notice for activities in free zones, pre-emption declaration, re-export declaration, exit summarized declaration, or re-export notice, determined in paragraphs 1 and 3 of Article 90, paragraph 1 of Article 94, paragraph 5 of Article 99, paragraphs 1 and 3 of Article 103, Article 112, Article 117, paragraph 1 of Article 181, paragraph 1 of Article 185, Article 186 and paragraph 1 of Article 188;</p> <p>1.4. failure to present the goods within the time limit introduced in the customs territory of Republic of Kosovo in a specific customs office or another specific place or</p> | <p>obavljanje ovlašćenih radnji navedenih u podstavu 2.3 i stavu 4. člana 12.;</p> <p>1.3. za robu unesenu ili izvezenu sa carinske teritorije Republike Kosovo ne dostavi blagovremeno zbirnu ulaznu deklaraciju, obaveštenje o dolasku pomorskog broda ili aviona, deklaraciju o privremenom smeštaju, obaveštenje o aktivnostima u slobodne zone, deklaraciju pre polaska, deklaraciju o ponovnom izvozu, zbirnu izlaznu deklaraciju ili obaveštenje o ponovnom izvozu, kako je definisano u stavovima 1. i 3. člana 90., stav 1. člana 94., stav 5. člana 99., stav 1. i 3 člana 103., člana 112., člana 117., stav 1. člana 181., stav 1. člana 185., člana 186. i stav 1. člana 188.;</p> <p>1.4. ne prijavi u određenom roku robu koja je unesena na carinsku teritoriju Republike Kosovo određenoj carinskoj ispostavi ili drugom mestu koje je</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>përdorur për transportin e produkteve me akcizë të cilat janë objekt i kundërvajtjes, konfiskohet, pa marrë parasysh vlerën e mallit.</p> <p>6. Për kundërvajtjen nga nën-paragrafi 1.27 i nenit 247, të kryer përsëri në afat prej tre (3) vjet, bashkë me gjobë, konfiskohet mjeti motorik ose makineria ose motori tjetër në të cilin është kryer kundërvajtja e tillë.</p> <p>7. Mjetet e transportit dhe mjetet lëvizëse që përdoren për transportin ose transferimin e produkteve të akcizës dhe lëndëve të para dhe materialeve të tjera të përdorura për prodhimin e produkteve të akcizës që nuk konsiderohen produkte të akcizës në kuptim të këtij Kodi, por që mund të përdoren si produkte të akcizës që i nënshtrohen masave të veçanta të kontrollit nga Dogana, të cilat janë objekt i kundërvajtjes nga nën-paragrafi, 1.1, 1.3, 1.4, 1.5, 1.39, 1.40, 1.42, 1.46 dhe 1.47 i Nenit 246 dhe për të cilat parashikohet detyrimi për pagesën e akcizës, konfiskohet nëse vlera e produkteve të akcizës që janë objekt i kundërvajtjes është më e madhe se një e treta (1/3) e vlerës së mjeteve të transportit ose mjeteve lëvizëse.</p> | <p>which is used for the transport of excise products which are subject of the offense, is confiscated, regardless of the value of the goods.</p> <p>6. For the contravention from sub-paragraph 1.27 of article 247, committed again within a period of three (3) years, together with the fine, the motor vehicle or the machinery or other engine in which such contravention has been committed shall be confiscated.</p> <p>7. The transport means and mobile means used for transport or transfer of excise products and raw materials and other materials used for production of excise products, which are not considered excise products in view of this Code, but can be used as excise products being subject to special control measures by Customs, which are object of an offence from sub-paragraph Article 246 1.1, 1.3, 1.4, 1.5, 1.39, 1.40, 1.42, 1.46 and 1.47 of Article 246 and for which the excise payment duty is set out, is seized if the value of excise products being object of the offence is higher than one third (1/3) of the value of transport means or mobile means.</p> | <p>proizvoda koji podležu krivičnog dela, oduzima se, bez obzira na vrednost robe.</p> <p>6. Za prekršaj iz podstav 1.27 člana 247, ponovo učinjen u roku od tri (3) godine, zajedno sa novčanom kaznom, oduzeće se motorno vozilo ili mašina ili drugi motor u kome je ta povreda učinjena.</p> <p>7. Prevozna sredstva i ruga prevozna sresstva koji se koriste za prevoz ili prenos akciznih proizvoda i sirovina i drugih materijala koji se koriste za proizvodnju akciznih proizvoda koji se ne smatraju akciznim proizvodima u smislu ovog zakonika, ali se mogu koristiti kao akciza, proizvodi koji podležu posebnim merama carinske kontrole, a za koje su u suprotnosti podstava 1.1, 1.3, 1.4, 1.5, 1.39, 1.40, 1.42, 1.46 i 1.47 člana 246 pod uslovom, oduzima se ako je vrednost akciznih proizvoda koji su predmet prekršaja veća od jedne trećine (1/3) vrednosti prevoznog sredstva ili druga transportna sredstva.</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|---|---|
| <p>8. Mjetet e transportit ose mjetet e lëvizëse të përdorura për transportin ose lëvizjen e produkteve të duhanit të natyrës komerciale që janë objekt i kundërvajtjes konfiskohen. Për qëllimet e këtij paragrafi, produktet e përpunuara të duhanit të natyrës komerciale konsiderohen si produktet e përpunuara të duhanit, lloji dhe sasia e të cilave tregojnë se ato nuk janë të destinuara ekskluzivisht për përdorim individual, personal ose për përdorim shtëpiak nga kryesi i kundërvajtjes.</p> <p>9. Mjeti motorik ose makineria tjetër ose motori ose mjeti transportues ose mjeti i lëvizshëm nga paragrafi 5, 6, 7 dhe 8 të këtij neni, konfiskohet edhe kur nuk janë në pronësi të kryerësit të kundërvajtësit.</p> <p>10. Zbatimi i dispozitave të këtij neni nuk cenon të drejtat e palëve të treta për kompensim të dëmit nga ana e kryesit të kundërvajtjes.</p> <p>11. Malli i cili është objekt i konfiskimit sipas dispozitave tjera në fuqi, mund të ndalet deri në përfundimin e asaj procedure përkatëse.</p> <p>12. Malli që është objekt i shkeljes kundërvajtëse, për të cilin është parapare konfiskimi i mallit, do të ndalet deri në përfundimin e procedurës kundërvajtëse.</p> | <p>8. The transport means or mobile means used for transport or movement of tobacco products of commercial nature, which are object of the offence, are seized. For the purposes of this paragraph, the processed tobacco products of commercial nature are considered as processed tobacco products, type and quantity of which shows that the offender does not destine them exclusively for individual, personal or household use.</p> <p>9. The motorvehicle or other machinery or motor vehicle or transport mean or mobile mean from paragraphs 5, 6, 7 and 8 of this Article are seized even when not under possession by the offender.</p> <p>10. The implementation of provisions from this Article does not affect the third parties rights for compensation by the offender's side.</p> <p>11. Goods which are subject to confiscation according to other provisions in force, may be detained until the completion of that relevant procedure.</p> <p>12. The goods that are the object of the minor offense violation, for which the confiscation of the goods is foreseen, will</p> | <p>8. Oduzimaju se prevozna sredstva ili vozna sredstva koja se koriste za prevoz ili kretanje duvanskih proizvoda komercijalne prirode koji su predmet povrede. Prerađenim duvanskim proizvodima komercijalne prirode, u smislu ovog stava, smatraju se prerađeni duvanski proizvodi čija vrsta i količina ukazuje da nisu namenjeni isključivo za ličnu, ličnu ili domaću upotrebu učinioca.</p> <p>9. Motorno vozilo ili druga mehanizacija ili motorno ili transportno vozilo ili pokretno vozilo iz st. 5, 6, 7 i 8 ovog člana, oduzimaju se i kada nisu u svojini učinioca prekršaja.</p> <p>10. Primenom odredaba ovog člana ne vređaju se prava trećih lica na naknadu štete od učinioca prekršaja.</p> <p>11. Roba koja podleže oduzimanju prema drugim važećim odredbama, može biti zadržana do okončanja tog relevantnog postupka.</p> <p>12. Roba koja je predmet prekršajnog postupka, za koju je predviđeno oduzimanje robe, obustavlja se do okončanja prekršajnog postupka.</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>13. Dogana mund, në raste të arsyeshme, pas deponimit të garancionit në shumën e vlerës së mallit të ndaluar, atë ta vendosë te personi përkatës me paralajmërim se mallin nuk guxon ta përdorë, ta shesë, apo të disponojë me mallin, në mënyrë tjetër.</p> <p>14. Me rastin e ndalimit të mallit përpilohet procesverbali me përshkrimin e hollësishëm të mallit. Një kopje e këtij procesverbali dhe vërtetimin mbi pranimin e mallit, Dogana duhet t'ia dorëzojë personit, të cilit i është ndaluar malli.</p> <p>15. Dogana mund, deri në përfundimin e procedurës doganore, ta ndalojë mallin i cili nuk është përfshirë në paragrafin 12 të këtij neni, nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm, se malli ka qene i përdorur ose i destinuar për kryerjen e shkeljes administrative, përkatësisht është siguruar me shkelje administrative ose është fituar me ndërrim me mallin e siguruar me shkelje administrative.</p> <p>16. Nëse, ndalimi i mallit nuk është më i nevojshëm për procedurën e mëtutjeshme, malli duhet t'i kthehet personit nga i cili është marrë.</p> | <p>be stopped until the end of the minor offense procedure.</p> <p>13. Customs may, in reasonable cases, after depositing the guarantee in the amount of the value of the prohibited goods, place it with the relevant person with a warning that the goods may not be used, sold, or disposed of in another way .</p> <p>14. In the case of detention of goods, a report is compiled with a detailed description of the goods. A copy of these minutes and the certificate on the receipt of the goods, the Customs must deliver to the person to whom the goods were seized.</p> <p>15. The customs may, until the completion of the customs procedure, seize the goods which are not included in paragraph 12 of this Article, if there is a reasonable suspicion that the goods have been used or intended to commit an administrative violation, respectively are secured by administrative breach or acquired in exchange for goods secured by administrative breach.</p> <p>16. If the seizure of the goods is no longer necessary for further proceedings, the goods must be returned to the person from whom they were taken.</p> | <p>13. Carina može, u razumnim slučajevima, nakon polaganja garancije u visini vrednosti zabranjene robe, da je stavi kod relevantnog lica uz upozorenje da se roba ne sme koristiti, prodavati ili na drugi način raspolagati.</p> <p>14. U slučaju zadržavanja robe sastavlja se zapisnik sa detaljnim opisom robe. Kopiju ovog zapisnika i potvrdu o prijemu robe, Carina mora dostaviti licu kome je roba oduzeta.</p> <p>15. Carina može, do okončanja carinskog postupka, oduzeti robu koja nije obuhvaćena stavom 12. ovog člana, ako postoji osnovana sumnja da je roba korišćena ili nameravana da se izvrši upravni prekršaj, odnosno obezbeđena administrativnom povredom ili stečena u zamenu za robu obezbeđenu administrativnom povredom.</p> <p>16. Ako oduzimanje robe više nije potrebno za dalji postupak, roba se mora vratiti licu od koga je oduzeta.</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>17. Dogana mund të ndalojë mallin në pajtim me paragrafin 12 dhe 16 të këtij neni, pa marre parasysh të drejtat e personave të tretë.</p> <p>18. Mallin e konfiskuar në procedurën e shkëljes administrative, Dogana mund t'ia kthejë pronarit apo kryesit të shkëljes administrative, sipas kërkesës, në qoftë se është fjala për mallin, për të cilin janë plotësuar kushtet e importit dhe me kusht që paraqitësi i kërkesës paguan vlerën e mallit dhe detyrimet importuese/eksportues.</p> | <p>17. Customs may seize goods in accordance with paragraphs 12 and 16 of this Article, without regard to the rights of third parties.</p> <p>18. The goods confiscated in the administrative violation procedure may be returned by the Customs to the owner or the perpetrator of the administrative violation, upon request, if it is the goods for which the import conditions are met and provided that the claimant pays the value of the goods and import / export duties.</p> | <p>17. Carina može oduzeti robu u skladu sa stavovima 12 i 16 ovog člana, bez obzira na prava trećih lica.</p> <p>18. Robu oduzetu u upravnom prekršajnom postupku Carina može vratiti vlasniku ili učiniocu upravnog prekršaja, na zahtev, ako se radi o robu za koju su ispunjeni uslovi uvoza i pod uslovom da podnosilac zahteva plati vrednost robe i uvoznih/izvoznih dažbina.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 252 Shitja, shpërndarja falas dhe asgjësimi i mallrave doganore</p> | <p style="text-align: center;">Article 252 Sale, free distribution and disposal of customs goods</p> | <p style="text-align: center;">Član 252 Prodaja, besplatna distribucija i raspolaganje carinskom robom</p> |
| <p>1. Shitja e mallit të konfiskuar sipas dispozitave të këtij kodi, kryhet përmes shitjes publike, pasi vendimi të jetë bërë i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm dhe mjetet janë të hyra për buxhetin e Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Dogana mund t'i shesë menjëherë mallrat që prishen lehte, kafshët e gjalla, mall me afat të shkurt të skadencës, mallin i cili për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tij krijon shpenzime që e kalojnë vlerën e mallit dhe në rastet tjera të veçanta të arsyetuara.</p> | <p>1. The sale of confiscated goods according to the provisions of this code, is carried out through public sale after the decision has become enforceable and revenues are poured in the budget of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. With the exception of paragraph 1 of this article, customs may immediately sell perishable goods, live animals, goods with a short expiration date or goods which for its storage and maintenance, create expenses that exceed the value of goods and other special justified cases.</p> | <p>1. Prodaja oduzete carinske robe prema odredbama ovog zakona, vrši se javnom prodajom nakon pravnosnažnosti. a prihvati se prelivaju u budžet Republike Kosovo.</p> <p>2. Izuzev stava 1. ovog člana, carina može odmah prodati kvarljivu robu, žive životinje, robu sa kratkim rokom trajanja ili robu koja za skladištenje i održavanje stvara troškove koji prelaze vrednost robe i drugi posebni opravdani slučajevi.</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>3. Dispozitat e paragrafit 2 dhe 5 te këtij neni, përshtatshëm mund të aplikohen edhe për mallra e sekuestruara si rezultat i veprës penale, nëse paraprakisht merret konfirmimi nga institucionet kompetente gjyqësore.</p> <p>4. Mallrat e konfiskuara, të cilat nuk shiten në territorin doganor të Republikës së Kosovës, mund të shpërndahen falas pa paguar kundërvlerën dhe detyrimet e importit tek organet shtetërore, institucionet mjekësore, kulturore, shkencore dhe organizatat humanitare ose të përdoren për qëllime të tjera të arsyetuara nga institucionet shtetërore.</p> <p>5. Mallrat që nuk mund të shiten sipas paragrafit 1 dhe 2, ose përdoren për arsye shëndetësore, veterinare, fitosanitare, sigurie, ose të tjera të përcaktuara me ligj, asgjësohen nën mbikëqyrjen doganore, në përputhje me rregullat e veçanta.</p> <p>6. Shpenzimet e asgjësimit mbulohen nga pronari ose importuesi i mallit në bazë të vendimit me shkrim, dhe nëse ato janë të panjohura ose të padisponueshme, shpenzimet e asgjësimit mbulohen nga Dogana, përveç nëse parashikohet ndryshe me dispozita të veçanta.</p> | <p>3. The provisions of paragraph 2 and 5 of this article, shall be appropriately applied to goods seized as a result of a criminal offense, if prior confirmation is obtained from the competent judicial institutions.</p> <p>4. Confiscated goods which are not sold in the customs territory of the Republic of Kosovo, can be distributed for free without paying the equivalent value of the goods and import duties, to state bodies, medical, cultural and scientific institutions and humanitarian organizations or to be used for other justified purposes by state institutions.</p> <p>5. Goods that cannot be sold or used according to paragraph 1 and 2, or for reasons of health, veterinary, phytosanitary, security, or others defined by law, are disposed of under customs supervision, in accordance with special rules.</p> <p>6. Disposal costs are covered by the owner or importer of the goods based on written decision, and if they are unknown or unavailable, disposal costs are covered by Customs, unless otherwise provided by special provisions.</p> | <p>3. Odredbe stava 2 i 5 ovog clana, mogu odgovarajuće se primenjuju i na robu oduzetu usled krivičnog dela ako se prethodno dobije potvrda od nadležnih pravosudnih institucija.</p> <p>4. Oduzeta roba, koja se ne prodaje na carinskoj teritoriji Republike Kosovo, može se besplatno bez palcanja vrednosti robe I uvoznih dazbina, deliti državnim organima, medicinskim, kulturnim i naučnim institucijama i humanitarnim organizacijama, ili koristiti u druge svrhe opravdane od državnih institucija.</p> <p>5. Roba koja se ne može prodati prema stav 1 i 2 ili koristiti iz zdravstvenih, veterinarskih, fitosanitarnih, bezbednosnih ili drugih razloga definisanih zakonom, odlaže se pod carinski nadzor, u skladu sa posebnim pravilima.</p> <p>6. Troškove zbrinjavanja snosi vlasnik ili uvoznik robe na osnovu pismene odluke, a ako su nepoznati ili nedostupni, troškove zbrinjavanja snosi carina, osim ako posebnim odredbama nije drugačije određeno.</p> |
|--|---|--|

7. Rregullat procedurale dhe kushtet për shitjen e mallit, shpërndarja falas dhe përdorimin e tij, asgjësimin dhe pagesën e shpenzimeve, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.

Neni 253

Juridiksioni, procedura mandatore dhe parashkrimi për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes

1. Procedurën për kundërvajtjet e parapara me këtë Kod e zhvillon Dogana.
2. Për kundërvajtjet e parapara me këtë Kod, kur vlera e mallrave nuk kalon shumen prej pesëqind (500) euro, nga oficeri doganor në vendngjarje do shqiptohet gjobe mandatore në shumë prej njëqind (100) euro.
3. Dogana mund të ndalojë përkohësisht mallrat, mjetin e transportit dhe çdo pajisje tjetër të përdorur në kryerjen e kundërvajtjeve të përcaktuara derisa të depozitohet një garanci ose të paguhet shumën e gjobës dhe detyrimeve përkatëse.

7. Procedural rules and conditions for the sale of goods, their donation and use, disposal and payment of expenses, are determined by a sub-legal act of the relevant Minister for Finance.

Article 253

Jurisdiction, mandatory procedure and statute of limitations for the development of the minor offense procedure

1. Customs conducts the offence procedure for offences set out by this Code.
2. For the contraventions foreseen by this Code, when the value of the goods does not exceed the amount of five hundred (500) euros, the customs officer at the scene will impose a mandatory fine in the amount of one hundred (100) euros.
3. The customs may temporarily suspend the goods, means of transport and any other equipment used in the commission of the prescribed contraventions until a guarantee is deposited or the amount of the relevant fine and duties is paid.

7. Pravila i ushtrimit dhe kushtet për shitjen e mallit, donacionin dhe përdorimin e tij, asgjësimin dhe pagesën e shpenzimeve, përcaktohen me akt nënligjor të ministrit përkatës për Financa.

Član 253

Nadležnost, mandatorna procedura i zastarelost razvoja prekršajnog postupka

1. Prekršajni postupak za prekršaje predviđene ovim zakonikom sprovodi Carina.
2. Za prekršaje predviđene ovim zakonikom, kada vrednost robe ne prelazi iznos od petsto (500) evra, novčanu kaznu izriče carinski službenik na licu mesta u iznosu od sto (100) evra.
3. Carina može privremeno oduzeti robu, prevozna sredstva i svaku drugu opremu korišćenu u izvršenju utvrđenih prekršaja do polaganja garancije ili plaćanja iznosa novčane kazne i pripadajućih dažbina.

| | | |
|---|---|--|
| <p>4. Procedura mandatore përcaktohet me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> <p>5. Struktura kompetente për zhvillimin e procedurës së rregullt kundërvajtëse në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni përcaktohet me strukturën organizative të Doganës.</p> <p>6. Procedura për shkelje administrative doganore, nuk mund të iniciohet pas kalimit të afatit prej tre (3) vjet nga dita e kryerjes së shkeljes administrative.</p> <p>7. Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit të autorizuar që ndërmerret për ndjekjen e kryesit të kundërvajtjes.</p> <p>8. Me çdo ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, por parashkrimi bëhet në çdo rast kur kalojnë pesë (5) vjet nga data kur është kryer kundërvajtja.</p> | <p>4. The mandatory procedure is determined by an internal act of the Ministry of finance.</p> <p>5. The competent structure for the development of the regular misdemeanor procedure referred to paragraph 1 of this article is determined by the organizational structure of the Customs.</p> <p>6. The procedure for customs administrative violation may not be initiated after the expiration of the period of three (3) years from the day of committing the administrative violation.</p> <p>7. The statute of limitations shall be interrupted by any action of the competent body related to the prosecution of the offender.</p> <p>8. After every interruption, the statutory limitation shall recommence, however prescription shall be effective when five (5) years have passed from the date when a minor offence was committed.</p> | <p>4. Obavezni postupak utvrđuje se internim aktom ministra finansije.</p> <p>5. Nadležna struktura za razvoj redovnog prekršajnog postupka prema staa 1 ovog člana utvrđuje se organizacionom strukturom Carine.</p> <p>6. Postupak za carinski upravni prekršaj ne može se pokrenuti nakon proteka roka od tri (3) godine od dana izvršenja upravnog prekršaja.</p> <p>7. Zastarelost se prekida svakom radnjom nadležnog organa koja se preduzima radi gonjenja izvršioca prekršaja.</p> <p>8. Svakim prekidom se zastarelost počinje ponovo, ali je zastarelost u svakom slučaju kada prolaze pet (5) godine od datuma kada je izvršen prekršaj.</p> |
|---|---|--|

**KAPITULLI V
DISPOZITAT KALIMTARE PËR
LIBRIN E TRETË**

**Neni 254
Përfundimi i procedurave të
kundërvajtjes**

1. Procedurat për kundërvajtjet e filluara para hyrjes në fuqi të këtij Kodi do të përfundojnë në pajtim me dispozitat në fuqi deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Kodi.
2. Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, të gjitha procedurat për kundërvajtje të filluara para hyrjes në fuqi të këtij Kodi do të zhvillohen në pajtim me dispozitat e këtij Kodi nëse kjo është më e favorshme për kryesin.
3. Të gjitha procedurat për kundërvajtje të filluara para hyrjes në fuqi të këtij Kodi, e që nuk janë paraparë me këtë Kod do të ndërpriten.

**CHAPTER V
TRANSITIONAL PROVISIONS
FOR THE THIRD BOOK**

**Article 254
Completion of offence procedures**

1. The offence procedures initiated prior to entry of provisions into force until the date of entry into force of this Code.
2. With exception by paragraph 1 of this article, all the procedures for offence initiated prior to entry into force of this Code will be conducted in accordance to provisions of this Code if this more favourable for the offender.
3. All the offence procedures initiated prior to entry into force of this Code, which are not set out by this Code will be terminat

**POGLAVLJE V
PRELAZNE ODREDBE ZA
TREĆU KNJIGU**

**Član 254
Završetak prekršajnih postupaka**

1. Postupci za prekršaje započeti do stupanja na snagu ovog zakonika okončaće se u skladu sa odredbama na snazi koje su važile do dana stupanja na snagu ovog zakonika.
2. Izuzetno od stava 1. ovog člana, svi prekršajni postupci pokrenuti do stupanja na snagu ovog zakonika vodiće se po odredbama ovog zakonika ako je to povoljnije za počinioca.
3. Svi prekršajni postupci pokrenuti do stupanja na snagu ovog zakonika, a koji nisu predviđeni ovim zakonikom, biće obustavljeni.

**LIBRI I KATËRT
LIGJI PËR
ORGANIZIMIN E
DOGANËS,
KOMPETENCAT DHE
MARRËDHËNIEN E
PUNËS**

**KAPITULLI I
DISPOZITA TË
PËRGJITHSHME**

**Neni 255
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë të organizimit të Doganës së Kosovës, kategorizimi dhe funksionet e vendeve të punës, kompetencat e Doganës dhe oficerëve doganor, të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, pranimi, emërimi në detyrë, avancimi, transferimi, procedurat disiplinore si dhe çështjet tjera që lidhen me funksionimin e Doganës.

**FOURTH BOOK
LAW ON CUSTOMS
ORGANIZATION,
COMPETENCES AND
WORK RELATION**

**CHAPTER I
GENERAL PROVISIONS**

**Article 255
Purpose**

The purpose of this law is determination of basic principles on Customs organization, categorization and functioning of working places, Customs and customs officials competencies, the rights and obligations from work relation, admission, appointment to duty, promotion, transfers, disciplinary procedure as well as other matters in relation to the Customs functioning.

**ÇETVRTA KNJIGA
ZAKON O
ORGANIZOVANJU
CARINE, OVLASCENJA
I RADNIM ODNOSIMA**

**POGLAVLJE I
OPŠTE ODREDBE**

**Član 255
Cilj zakona**

Cilj ovog zakona je da se uređuju osnovni principi organizovanja Carine, kategorizaciju i funkcije radnih mesta, nadležnosti carina i carinskih službenika, prava i obaveze iz radnog odnosa, prijema, imenovanja, unapređenje, transfera, disciplinskog postupka i druga pitanja vezano za funkcionisanje Carine.

| <p style="text-align: center;">Neni 256 Fushëveprimi</p> | <p style="text-align: center;">Article 256 Scope</p> | <p style="text-align: center;">Član 256 Oblast</p> |
|---|---|---|
| <p>Ky ligj zbatohet për Doganën dhe të gjithë personat fizik dhe juridik që i nënshtrohen dispozitave të këtij Kodi.</p> | <p>This law is implemented for Customs and all the legal and natural persons subjected to provisions of this Code.</p> | <p>Ovaj zakon se primenjuje na carinu i sva fizička i pravna lica na koja se primenjuju odredbe ovog zakonika.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 257 Përkufizimet</p> | <p style="text-align: center;">Article 257 Definitions</p> | <p style="text-align: center;">Član 257 Definicije</p> |
| <p>1. Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:</p> <p>1.1. Punonjës të Doganës – të gjithë të punësuarit në strukturat e Doganës.</p> <p>1.2. Oficer doganor – zyrtar me gradë doganore i punësuar nga Dogana e Kosovës i autorizuar për kryerje të detyrave nga fushëveprimi doganor.</p> <p>1.3. Kadet doganor – kandidat i pranuar në Doganë që ndjek trajnimin bazik për oficer doganor.</p> <p>1.4. Gradë doganore – shprehje e hierarkisë doganore, shenjë e caktuar gradimi dhe koeficienti përkatës, shprehje e cilësive individuale, përvojës dhe</p> | <p>1. In this law, the following terms have these meanings:</p> <p>1.1. Customs employees – all the employees in Customs structures.</p> <p>1.2. Customs officer – official with customs rank employed by Kosovo Customs authorized to perform customs duties from the scope of customs.</p> <p>1.3. Customs cadet – a candidate admitted in Customs following a basic training for customs official.</p> <p>1.4. Customs rank – customs hierarchy expression, designation within the work category and distinctive symbols, individual quality expression, of experience and</p> | <p>1. Pojedini pojmovi u smislu ovog zakona, imaju sledeća značenja:</p> <p>1.1. Radnici Carine - svi zaposleni u carinskim strukturama.</p> <p>1.2. Carinski službenik - službenik sa carinskim činom zaposlen u Carini Kosova ovlašćen za obavljanje poslova iz oblasti carine.</p> <p>1.3. Carinski kadet - kandidat primljen u Carinu koji pohađa osnovnu obuku za carinskog službenika.</p> <p>1.4. Carinski čin - izraz carinske hijerarhije, naimenovanje u okviru kategorije rada i znak razlikovanja, izraz ličnih kvaliteta, iskustva i odgovornosti u obavljanju poslova u</p> |

përgjegjësisë në ushtrimin e detyrave të nivelit përkatës, që fitohet nga oficeri doganor nëpërmjet një procesi konkurrues nga një gradë doganore më e ultë, në një gradë doganore më të lartë.

1.5. **Mjet transporti** – çdo mjet që përdoret për transportin e njerëzve ose mallrave.

1.6. **Hetim** – ndërmarrjen e masave dhe veprimeve hetimore si dhe masave tjera vëzhguese, mbledhjen e informatave inteligjente, përpunimin dhe shpërndarjen e tyre nga oficeri doganor, konform kompetencave në legjislacionin doganor dhe në ligjet tjera të veçanta.

1.7. **Mbikëqyrje** nënkupton çdo veprim i ndërmarrë nga Dogana sipas këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi, i cili siguron zbatimin e drejtë të rregullave doganore, akcizore, tatimore dhe të tjera në kompetencën e saj, si dhe ndalimin, parandalimin dhe zbulimin e veprave të sanksionuara në bazë të dispozitave ligjore.

accountability in exercising functions in Customs, which is obtained through a competitive process, from a lower rank to a higher customs rank.

1.5. **Transport mean** – every means used for the transport of persons or goods.

1.6. **Investigation** – undertaking measures and investigative actions as well as other observing measures, collecting intelligency information, their processing and dissemination by the authorized customs official, commensurate to competencies in customs legislation and other special laws.

1.7. **Supervision** means every action taken by the customs according to this Code and the legislation in force, which ensures the correct implementation of customs, excise, tax and other rules within its competence, as well as the prohibition, prevention and detection of sanctioned offenses based on those legal provisions.

carini, koje carinski službenik stiče na konkursu, iz nižeg carinskog čina, na viši carinski čin.

1.5. **Transportno sredstvo** - svako sredstvo koje se koristi za prevoz ljudi ili robe.

1.6. **Istraga** - preduzimanje istražnih mera i radnji, kao i drugih mera nadzora, prikupljanje obaveštajnih podataka, njihova obrada i distribucija od strane ovlašćenog carinskog službenika, u skladu sa nadležnostima iz carinskih propisa i drugim posebnim zakonima.

1.7. **Nadzor** je svaka radnja koju carina preduzima u skladu sa ovim zakonikom i važećim zakonima, a koja obezbeđuje pravilno sprovođenje carinskih, akciznih, poreskih i drugih propisa iz svoje nadležnosti, kao i zabranu, sprečavanje i otkrivanje dela sankcionisano po osnovu zakonskih odredba.

| | | |
|--|---|--|
| <p>1.8. Vendi i mbikëqyrjes është secila hapësirë e mbyllur, e hapur ose objekt ku kryhet mbikëqyrja.</p> <p style="text-align: center;">Neni 258 Parimet udhëzuese</p> <p>1. Veprimet e Doganës udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:</p> <p>1.1. trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave;</p> <p>1.2. respektimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore;</p> <p>1.3. barazia dhe mos-diskriminimi;</p> <p>1.4. objektiviteti dhe paanësia lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike dhe të tjera të personave;</p> <p>1.5. transparenca, duke ofruar informata dhe të qenit të hapur ndaj publikut;</p> <p>1.6. legjitimiteti, përshtatshmëria dhe proporcionaliteti;</p> | <p>1.8. The place of supervision is any closed, open space or object in which the surveillance is carried out.</p> <p style="text-align: center;">Article 258 Guiding principles</p> <p>1. Customs actions are led by the following principles:</p> <p>1.1. Equal and fair treatment of all persons;</p> <p>1.2. Respecting human rights and fundamental freedoms;</p> <p>1.3. Equality and non-discrimination;</p> <p>1.4. Objectivity and impartiality regarding beliefs and views and political views and others of persons;</p> <p>1.5. Transparency, providing information and being open to the public;</p> <p>1.6. Legitimacy, suitability and proportionality;</p> | <p>1.8. Mesto nadzora je svaki zatvoreni, otvoreni prostor ili objekat u kome se vrši nadzor</p> <p style="text-align: center;">Član 258 Osnovna načela</p> <p>1. Carina radi po ovim principima:</p> <p>1.1. jednak i pravičan tretman svih lica;</p> <p>1.2. poštovanje ljudskih prava i osnovnih sloboda;</p> <p>1.3. jednakost i nediskriminacija;</p> <p>1.4. objektivnost i nepristrasnost u pogledu političkih i drugih uverenja i stavova lica;</p> <p>1.5. transparentnost, pružanje informacija i otvorenost za javnost;</p> <p>1.6. legitimnost, prikladnost i proporcionalnost;</p> |
|--|---|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>1.7. integriteti, ndershmëria dhe përgjegjshmëria në shërbimin publik;</p> <p>1.8. përkushtimi ndaj punës, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar diversitetin etnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi;</p> <p>2. Oficerët doganor ushtrojnë autorizimet e tyre dhe kryejnë detyrat e tyre, në përputhje me legjislacion doganor, Kodin e Mirësjelljes dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI II STATUSI DHE SIMBOLET E DOGANËS</p> <p style="text-align: center;">Neni 259 Statusi</p> | <p>1.7. Integrity, honesty and responsibility in public service;</p> <p>1.8. Commitment toward work, advance and overall appointment of duties, with merit and non-discriminating, reflecting ethnical diversity in the Republic of Kosovo and recognizing the gender equality principles and human rights set out in the Republic of Kosovo Constitution and legislation in force;</p> <p>2. Customs officials exercise their authorizations and perform their duties, in accordance with the customs legislation, the Code of Ethics and the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II CUSTOMS STATUS AND SYMBOLS</p> <p style="text-align: center;">Article 259 Status</p> | <p>1.7. integritet, poštenost i odgovornost u javnoj službi;</p> <p>1.8. posvećenost radu, unapređenju i raspoređivanju na sveobuhvatan, meritoran i nediskriminatoran način, odražavajući etničku raznolikost u Republici Kosova i priznajući principe rodne ravnopravnosti i ljudskih prava sadržanih u Ustavu Republike Kosovo i zakonima na snazi;</p> <p>2. Carinski službenici vrše svoja ovlašćenja i obavljaju svoje dužnosti u skladu sa carinskim propisima, Kodeksom ponašanja i zakonima na snazi.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II STATUS I SIMBOLI CARINE</p> <p style="text-align: center;">Član 259 Status</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>1. Dogana është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave.</p> <p>3. Dogana është person juridik, ka autonomi operationale dhe është i vetmi institucion në Kosovë, që ushtron autorizime dhe kompetenca doganore të përcaktuara me legjislacionin doganor dhe legjislacionin në fuqi duke përfshirë ushtrimin e çfarëdo detyre apo funksioni tjetër që mund t'i caktohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.</p> | <p>1. Customs is a executive agency within the Ministry of Finances.</p> <p>2. Customs is a legal entity, has operational autonomy and is the sole institution in Kosovo exercising customs authorizations and competencies determined by the customs legislation and other special laws, including exercising any other duty or function that might be assigned by the Government of Republic of Kosovo.</p> | <p>1. Carina je executive agency u okviru Ministarstva finansija.</p> <p>2. Carina je pravno lice, ima operativnu autonomiju i jedina je institucija na Kosovu koja vrši carinska ovlašćenja i nadležnosti definisane carinskim propisima i drugim relevantnim zakonima, uključujući vršenje bilo koje druge dužnosti ili funkcije koje joj mogu biti dodeljene od strane Vlada Republike Kosova.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 260 Simbolet</p> | <p style="text-align: center;">Article 260 Symbols</p> | <p style="text-align: center;">Član 260 Simboli</p> |
| <p>1. Dogana ka shenjen, flamurin, uniformën, shenjat e gradave, vulën, emblemat e njësive dhe simbolet tjera me të cilat përcaktohet identiteti i institucionit. Me propozim të Ministrit përkatës të Financave, Qeveria miraton përmasat, përmbajtjen, dukjen e stemës, emblemave dhe gradave të Doganës.</p> <p>2. Dita e Doganës së Republikës së Kosovës është data 31 gusht.</p> <p>3. Përdorimi i simboleve nga paragrafi 1 i këtij neni dhe përmbajtja dhe përdorimi i kartës zyrtare së identitetit dhe distinktivit, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit</p> | <p>1. Customs has the emblem, flag, uniform, rank insignia, stamp and other symbols by what the institutions identity is determined. By proposal from the Minister of Finances, the Government approves the dimensions, content, emblem appearance and Customs ranks.</p> <p>2. The Customs day is the 31st of August.</p> <p>3. The use of symbols from paragraph 1 of this Article and the content and use of identity card and badge, are determined by a legal act from the Minister of Finances.</p> | <p>1. Carina ima grb, zastavu, uniformu, oznake činova, pečat, ambleme jedinica i druge simbole kojima se utvrđuje identitet institucije. Na predlog ministra finansija, Vlada daje saglasnost na veličinu, sadržaj, izgled grba, amblema i činove Carine.</p> <p>2. Dan Carine Republike Kosova je 31. avgust.</p> <p>3. Upotrebu simbola iz stava 1. ovog člana, kao i sadržaj i upotrebu identifikacione kartice i značke, podzakonskim aktom propisuje ministar finansija.</p> |

përkatës për Financa, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

KAPITULLI III DETYRAT, ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I DOGANËS

Neni 261 Detyrat e Doganës

1. Dogana ushtron mbikëqyrje dhe kontrollë doganore me qëllim të sigurimit të zbatimit të legjislacionit doganor dhe legjislacionit në fuqi, për të siguruar mbledhjen e detyrimeve doganore dhe të hyrave tjera që mbledhen nga Dogana, ndërmerr veprime në interes të sigurisë, mbrojtjes së shëndetit dhe jetës së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe zbaton masat e politikës tregtare;

2. Përgjegjësitë e Doganës në veçanti janë:

2.1. mbikëqyrja, vlerësimi, llogaritja dhe mbledhje e detyrimeve doganore, akcizave, tatimit mbi vlerën e shtuar, taksave

CHAPTER III DUTIES, CUSTOMS ORGANIZATION AND FUNCTIONING

Article 261 Customs duties

1. Customs exercises a customs supervision with the purpose of ensuring the correct implementation of the customs legislation and the legislation in force, to ensure the collection of customs taxes and other revenues collected by Customs, undertaking actions in the security interest, protection of human health and life, animals and plants, protection of environment, cultural heritage, intellectual property and enforces trade policy measures;

2. Customs responsibilities in particular are:

2.1. Supervision, valuation, accounting and collection of customs duties, excise, and special taxes, taxes on the valued added and other evenues collected by Customs;

POGLAVLJE III DUŽNOSTI, ORGANIZOVANJE I FUNKCIONISANJE CARINE

Član 261 Dužnosti Carine

1. Carina vrši carinski nadzor i kontrolu u cilju obezbeđivanja primene carinskih propisa i zakona na snazi, radi obezbeđivanja prikupljanja carinskih dažbina i drugih prihoda koje prikuplja carina, preduzima radnje u interesu bezbednosti, zaštite zdravlja i života ljudi, životinja i biljaka, zaštite životne sredine, zaštite kulturnog nasleđa, zaštite intelektualne svojine i sprovodi mere trgovinske politike;

2. Posebne dužnosti Carine su:

2.1. nadzor, vrednovanje, obračun i prikupljanje carinskih dažbina, akcize, poreza na dodatu vrednost, posebnih poreza i drugih prihoda koje prikuplja carina;

| | | |
|---|--|--|
| <p>të veçanta, dhe të hyrave tjera që mblidhen nga Dogana;</p> <p>2.2. mbikëqyrja e hyrjes, daljes dhe transitit të mallrave në përputhje me rregullat dhe procedurat doganore;</p> <p>2.3. konstatimi, verifikimi dhe sanksionimi i shkeljeve të parashikuara në legjislacionin doganor dhe ligjet tjera të veçanta, kur Dogana është e ngarkuar për zbatimin e tyre;</p> <p>2.4. mbikëqyrja e hyrjes, daljes dhe tranzitit të qarkullimit të mjeteve monetare;</p> <p>2.5. mbikëqyrja e udhëtarëve dhe bagazhit të tyre me rastin e hyrjes, daljes dhe tranzitit;</p> <p>2.6. kontrolli i objekteve afariste, private dhe mjeteve të transportit sipas autorizimeve përkatëse;</p> <p>2.7. mbikëqyrja, kontrolli dhe ekzaminimi i mallrave në të gjitha procedurat doganore dhe vendosja e shenjave të mbikëqyrjes doganore</p> | <p>2.2. Entry and exit supervision and transit of goods in accordance with the customs rules and procedures;</p> <p>2.3. Ascertainment, verification and sanctioning of violations set out in the customs legislation and other special laws, where Customs is in charge of their implementation;</p> <p>2.4. Entry and exit supervision and transit of monetary means circulation;</p> <p>2.5. Supervision of passengers and their luggage in the event of entry, exit and transit;</p> <p>2.6. control of business premises, private and means of transport as per specific authorizations;</p> <p>2.7. Supervision, control and examination of goods in all customs procedures and placing customs supervision insignia in transport means, goods and facilities;</p> | <p>2.2. nadzor ulaska, izlaska i tranzita robe u skladu sa carinskim pravilima i procedurama;</p> <p>2.3. utvrđivanje, proveru i sankcionisanje prekršaja predviđenih carinskim propisima i drugim posebnim zakonima, kada je carina nadležna za njihovo sprovođenje;</p> <p>2.4. nadgledanje ulaska, izlaza i tranzita prometa gotovine;</p> <p>2.5. nadzor putnika i njihovog prtljaga pri ulasku, izlasku i tranzitu;</p> <p>2.6. kontrola komercijalnih i privatnih objekata i transportnih sredstava prema odgovarajućim ovlašćenjima;</p> <p>2.7. nadzor, kontrola i pregled robe u svim carinskim postupcima i postavljanje oznaka carinskog nadzora na prevozna sredstva, robu i predmete;</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>në mjete transporti, mallra dhe objekte;</p> <p>2.8. zbatimi i politikave të tregtisë së jashtme;</p> <p>2.9. ruajtja, shitja dhe asgjësimi i mallrave të konfiskuara, sekuestruara, braktisura ose që u janë shmangur kontrollit të mallrave;</p> <p>2.10. bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me autoritetet kompetente në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare si dhe shoqatat profesionale që punojnë në fushën përkatëse kompetente;</p> <p>2.11. mbledhja, verifikimi, analiza dhe ruajtja e të dhënave statistikore mbi tregtinë e mallrave me shtetet tjera;</p> <p>2.12. përfaqësimi në procedura ligjore dhe gjyqësore para Gjykatave dhe autoriteteve tjera;</p> <p>2.13. mbajtja e dokumentacionit dhe regjistrimeve në mbledhjen e të</p> | <p>2.8. Implementation of foreign trade policies;</p> <p>2.9. Storage, sale and disposal of seized goods, abandoned goods or goods evading control;</p> <p>2.10. Cooperation and exchange of information with competent authorities in the national and international level and cooperation with international organizations as well as professional associations working in the certain competent field;</p> <p>2.11. Collection, verification, analysing and storage of statistical data on trade of goods with other countries;</p> <p>2.12. Representation in legal and court procedures to Courts and other authorities;</p> <p>2.13. Maintenance of documents and registrations in collection of revenues and other obligations which are Customs obligation;</p> | <p>2.8. sprovođenje spoljnotrgovinske politike;</p> <p>2.9. skladištenje, prodaja i uništavanje robom koja je zaplenjena, napuštena ili nije podvrgnuta kontroli;</p> <p>2.10. saradnja i razmenu informacija sa nadležnim organima na nacionalnom i međunarodnom nivou i saradnju sa međunarodnim organizacijama, kao i profesionalnim udruženjima koja rade u predmetnoj oblasti;</p> <p>2.11. prikupljanje, verifikacija, analiza i čuvanje statističkih podataka o robnoj razmjeni sa drugim zemljama;</p> <p>2.12. zastupanje u pravnim i sudskim postupcima pred sudovima i drugim organima;</p> <p>2.13. vođenje dokumentacije i evidencije u prikupljanju prihoda i</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>hyrave dhe obligimeve të tjera që i ngarkohen Doganës;</p> <p>2.14. zbatimi i drejtpërdrejt i masave të sigurimit dhe ekzekutimit të detyrimit, me qëllim të pagesës së detyrimit sipas këtij Kodi;</p> <p>2.15. zhvillimi, menaxhimi dhe aplikimi i kornizës së menaxhimit të riskut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në bazë të këmbimit të informatave mbi riskun dhe analizën e tij me qëllim të përcaktimit të kriterëve për vlerësimin e riskut, masave mbrojtëse dhe fushave prioritare të kontrollit;</p> <p>2.16. zhvillimi, vënia në funksion dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit dhe infrastrukturës së komunikimeve në bazë të kërkesave specifike të Doganës, duke qenë i pavarur nga institucionet tjera dhe njëkohësisht duke bashkë shfrytëzuar dhe ndërvepruar me sistemet përkatëse pa cenuar integritetin e vet;</p> <p>2.17. mbledhja, regjistrimi, përpunimi, shkëmbimi dhe mbrojtja e të dhënave personale dhe të</p> | <p>2.14. Direct application of security measures and duty execution, with the purpose of payment obligation as per this Code;</p> <p>2.15. Development, management and application of risk management framework in the national and international level, based on the exchange of information over risk and analysis on it, with the purpose of criteria determination on risk assessment, protection measures and control priority fields;</p> <p>2.16. Development, putting into function and maintenance of information system and communications infrastructure based on specific requests from Customs, having been independent from other institutions and in the same time joint use and interoperability with certain systems without affecting its integrity;</p> <p>2.17. Collection, registration, processing, exchange and protection of personal data and other data and</p> | <p>drugih obaveza kojima se carina zadužuje;</p> <p>2.14. neposredno sprovođenje mera obezbeđenja i izvršenje obaveze, radi plaćanja obaveze iz ovog zakonika;</p> <p>2.15. razvoj, upravljanje i primena okvira za upravljanje rizicima na nacionalnom i međunarodnom nivou, na osnovu razmene informacija o riziku i njegove analize u cilju utvrđivanja kriterijuma za procenu rizika, zaštitnih mera i prioriternih oblasti kontrole;</p> <p>2.16. razvoj, rad i održavanje informacionog sistema i komunikacione infrastrukture zasnovane na specifičnim zahtevima Carine, nezavisno od drugih institucija i istovremeno sarađujući sa relevantnim sistemima bez ugrožavanja njenog integriteta;</p> <p>2.17. prikupljanje, knjiženje, obrada, razmena i zaštita ličnih podataka i drugih podataka od strane</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>dhënave tjera nga personat dhe regjistrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi;</p> <p>2.18. informimi i personave në lidhje me zbatimin e legjislacionit;</p> <p>2.19. kryerja e të gjitha kontrolleve, që Dogana i konsideron të nevojshme, për t'u siguruar se legjislacioni doganor po zbatohet drejtë;</p> <p>2.20. kryerja e detyrave tjera të përcaktuara me legjislacionin doganor dhe ligjet tjera të veçanta.</p> | <p>registers, in accordance to the legislation in force;</p> <p>2.18. Informing persons regarding the legislation implementation;</p> <p>2.19. Performing all controls, that Customs deems necessary, in order to ensure the correct application of customs legislation;</p> <p>2.20. Performance of other duties determined by the customs legislation and other special laws.</p> | <p>lica i registara, u skladu sa važećim zakonom;</p> <p>2.18. informisanje lica o primeni zakona;</p> <p>2.19. vršenje svih kontrola koje Carina smatra neophodnim da bi se osiguralo da se carinski propisi pravilno primenjuju;</p> <p>2.20. obavljanje drugih poslova utvrđenih carinskim propisima i drugim posebnim zakonima.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 262 Organizimi i Doganës</p> | <p style="text-align: center;">Article 262 Customs organizing</p> | <p style="text-align: center;">Član 262 Organizovanje Carine</p> |
| <p>1. Organizimi dhe funksionimi i Doganës përcaktohet me legjislacionin doganor dhe legjislacionin ne fuqi.</p> <p>2. Dogana vepron përmes zinxhirit hierarkik në tërë territorin doganor të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Dogana është e organizuar në nivel qendror dhe operativ.</p> | <p>1. Customs organizing and functioning is determined by customs legislation and other special laws.</p> <p>2. Customs acts through a hierarchy line in the entire customs territory of Republic of Kosovo.</p> <p>3. Customs is organized in a central and operational level.</p> | <p>1. Organizovanje i funkcionisanje Carine utvrđuje se carinskim propisima i drugim posebnim zakonima.</p> <p>2. Carina radi shodno hijerarhijskog lanca na celoj carinskoj područji Republike Kosova.</p> <p>3. Carina je organizovana na centralnom i operativnom nivou.</p> <p>4. Carina je organizovana kako sledi:</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>4. Dogana është e organizuar ne strukturat si ne vijim:</p> <p>4.1. Drejtori i Përgjithshëm;</p> <p>4.2. Drejtoritë;</p> <p>4.3. Departamentet Qendrore dhe Operative;</p> <p>4.4. Zyrat Doganore qendrore;</p> <p>4.5. Zyrat doganore ne Pikë Kalime Kufitar;</p> <p>4.6. Zyrat e Brendshme Doganore;</p> <p>4.7. Njësitet dhe Ekipet.</p> | <p>4. Customs is organized in the following structures:</p> <p>4.1. Director General;</p> <p>4.2. Directorates;</p> <p>4.3. Central and Regional Departments;</p> <p>4.4. Central Customs offices;</p> <p>4.5. Border Crossing Point Customs offices;</p> <p>4.6. Internal Customs Offices;</p> <p>4.7. Units and Teams.</p> | <p>4.1. Generalni direktor;</p> <p>4.2. Direkcije;</p> <p>4.3. Centralni i regionalni departmani;</p> <p>4.4. Centralne carinarnice;</p> <p>4.5. Carinarnice na graničnim prelazima;</p> <p>4.6. Carinske ispostave;</p> <p>4.7. Jedinice i ekipe.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 263 Detyrat e nivelit qendror dhe operativ</p> | <p style="text-align: center;">Article 263 Central and regional level duties</p> | <p style="text-align: center;">Član 263 Dužnosti na centralnom i regionalnom nivou</p> |
| <p>1. Detyrat brenda kompetencës së saj Dogana i kryen në nivel qendror dhe operativ.</p> <p>2. Dogana ne nivel qendror drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe organizohet në struktura organizative hierarkike në nivel: drejtoritë, departamentet, zyrat qendrore, njësitë ose ekipet.</p> | <p>1. Customs performs its duties within the competencies in central and operational level.</p> <p>2. Customs is led by Director General and is organized in hierarchy organizational structures in the level of: directorates, departments, central offices, units and teams.</p> | <p>1. Dužonsti iz svoje nadležnosti Carina obavlja na centralnom i operativnom nivou.</p> <p>2. Carinu na centralnom nivou rukovodi generalni direktor i organizovana je u hijerarhijske organizacione strukture poput: direkcije, departmani, centralne kancelarije, jedinice i timovi.</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>huaja dhe administratave të tjera dhe organizatave profesionale, oficeri doganor mund të merr pjesë në cilësi të pjesëmarrësit, ekspertit, apo trajnerit.</p> <p>5. Mënyra dhe kushtet e pjesëmarrjes së oficerit doganor sipas paragrafit 4 të këtij neni, përcaktohen me akt të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 282 Hetuesi doganor</p> <p>Zyrtari i autorizuar i policisë në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale është edhe oficeri doganor, i cili ka kompetencë, përgjegjësi dhe detyrë për hetimin, vëzhgimin dhe zbulimin e veprave penale nga fushë veprimtaria e Doganës së Republikës së Kosovës, të parapara me Kodin Penal të Kosovës si dhe dispozitat tjera penale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 283 Inicimi i procedurës kundërvajtës dhe hetimore</p> <p>1. Për kundërvajtjet e parapara me këtë Kod dhe kundërvajtjet e përcaktuara me ligje të veçanta nga kompetenca e Doganës, oficeri doganor është i autorizuar të zbatojë procedurën kundërvajtëse mandatore ose të iniciojë procedurën e rregullt pranë</p> | <p>and professional organizations, the customs officer may participate in projects work as an expert or a trainer.</p> <p>5. The manner and terms of participation of the customs officer as per paragraph 4 of this Article are determined by an internal act from Director General.</p> <p style="text-align: center;">Article 282 Customs investigators</p> <p>The authorized police official in view of provisions from the Penal Procedure Code, the customs officer is authorized by the same Code, with competencies, responsibility and duties to investigate, observe and discover criminal acts from the scope of Customs, set out by the Kosovo Penal Code and other criminal provisions.</p> <p style="text-align: center;">Article 283 Initiation of misdemeanour and investigative procedure</p> <p>1. On offences set out by this Code and misdemeanours determined by special laws by Customs competencies, the customs officer is authorized to enforce the mandatory offence procedure or to initiate a regular procedure beside the competent</p> | <p>može učestvovati u radu projekata kao ekspert ili instruktor.</p> <p>5. Način i uslovi učešća carinskog službenika iz stava 4. ovog člana utvrđuju se internim aktom generalnog direktora.</p> <p style="text-align: center;">Član 282 Carinski istražitelji</p> <p>Ovlašćeni policijski službenik, shodno odredbama Zakona o krivičnom postupku, je i carinski istražitelj, koji ima nadležnost, odgovornost i dužnost da istražuje, posmatra i otkriva krivična dela iz delatnosti Carine Republike Kosova, predviđena Krivičnim zakonom Kosova, kao i druge krivične odredbe.</p> <p style="text-align: center;">Član 283 Pokretanje prekršajnog i istražnog postupka</p> <p>1. Za prekršaje predviđene ovim zakonikom i za prekršaje utvrđene posebnim zakonima iz nadležnosti Carine, carinski službenik je ovlašćen da sprovede postupak za mandatni prekršaj ili da pokrene redovan postupak kod nadležnog</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>strukturës kompetente për zhvillim të procedurës kundërvajtjes ose hetimore.</p> <p>2. Me qëllim që të sigurohet ekzekutimi i dënimit në procesin e kundërvajtjes, oficeri doganor në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, mund t'ia marrë shtetasit të huaj përkohësisht pasaportën, gjegjësisht ndonjë dokument tjetër, në kohëzgjatje deri në tri (3) ditë dhe të njëjtit i lëshohet dëshmi për marrjen e dokumentit të udhëtimit.</p> <p>3. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, shtetasi i huaj ose ndonjë person tjetër në emër të tij, mund të depozitoj një garancion të sigurisë të barasvlershëm me pagesën e gjobës.</p> <p>4. Oficeri doganor në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, mund të ndaloj mjetin transportues edhe nëse nuk është objekt i kundërvajtjes deri në përfundimin e procedurës kundërvajtëse dhe pagesën së gjobës.</p> <p>5. Struktura kompetente e cila zhvillon procedurën kundërvajtëse, mund të vazhdoj afatin dhe lëshoj dëshminë sipas paragrafit 2 të këtij neni deri në marrjen e vendimit përfundimtar dhe pagesën e gjobës.</p> | <p>structure for conducting the misdemeanour or penal procedure.</p> <p>2. With the purpose of ensuring the sentence execution or the protection measure, respectively due to the participation in the misdemeanour process, the authorized customs officer pursuant to paragraph 1 of this Article, may temporarily take the passport from the foreign citizen, respectively another document, in duration of up to three (3) days and proof on travel document being taken is given to the citizen.</p> <p>3. Exclusively from paragraph 2 of this Article, the foreign citizen or another person on his/her behalf, may deposit an insurance instrument equivalent with the fine payment.</p> <p>4. Customs officer pursuant to paragraph 1 of this Article, may stop the means of transport even they are not object of the misdemeanour until the completion of offence procedure and fine payment.</p> <p>5. The competent structure which conducts the misdemeanour procedure, may extend the period and issue a fine as per paragraph 2 of this Article until promulgation of final decision and fine payment.</p> | <p>organa koji vodi prekršaj ili krivični postupak.</p> <p>2. Radi obezbeđenja izvršenja kazne ili zaštitne mere, odnosno zbog učešća u prekršajnom postupku, ovlašćeni carinski službenik iz stava 1. ovog člana može privremeno oduzeti pasoš stranog državljanina, odnosno bilo koju drugu ispravu, u trajanju do tri (3) dana i istom se izdaje dokaz o uzimanju putne isprave.</p> <p>3. Izuzetno iz stava 2. ovog člana, strani državljanin ili drugo lice u njegovo ime može položiti instrument obezbeđenja koji je jednak plaćanju novčane kazne.</p> <p>4. Carinski službenik iz stava 1. ovog člana može zaustaviti prevozno sredstvo i ako ono nije predmet prekršaja do okončanja prekršajnog postupka i plaćanja novčane kazne.</p> <p>5. Nadležni organ koji vodi prekršajni postupak može produžiti rok i izdati dokaze iz stava 2. ovog člana do donošenja konačne odluke i plaćanja novčane kazne.</p> |
|---|--|--|

**KAPITULLI VI
DISPOZITA TË VEÇANTA PËR
KOMPETENCAT DOGANORE**

**Neni 284
Mbledhja dhe përpunimi i
informacionit**

1. Dogana mbledhë të dhëna dhe informacione personale dhe të tjera me qëllim të përpunimit dhe kryerjes së detyrave doganore nga burimet ekzistuese të dhënave, drejtpërdrejt nga personi me të cilin kanë të bëjnë këto të dhëna dhe nga persona të tjerë të cilët kanë gjasa të kenë njohuri për këto të dhëna.
2. Mbledhja e të dhënave dhe informacioneve personale nga fëmijët bëhet në prani të prindit, kujdestarit, prindit kujdestar, personit të cilit i është besuar kujdesi dhe edukimi i fëmijës ose personit profesional të qendrës për mirëqenie sociale.
3. Oficeri doganor i cili mbledh të dhëna personale dhe të tjera dhe informacione nga burimet ekzistuese të dhënave ose nga persona të tjerë, nuk është i obliguar t'i informojë personat me të cilët kanë të bëjnë këto të dhëna nëse kjo do ta

**CHAPTER VI
SPECIAL PROVISIONS FOR
CUSTOMS COMPETENCIES**

**Article 284
Collection and processing of information**

1. Customs collects data and personal information and other with the purpose of processing and performing customs duties from the existing data sources, directly from the person having to do with the data and other persons who might be aware about these data.
2. Collection of data and personal information from children is performed in the presence of a parent, a guardian, guardian parent, the person to whom the custody or child's education is entrusted or professional person from the social welfare centre.
3. Customs officer who collects personal data and other information from existing data sources or other persons, is not obligated to inform the persons who have to do with these records if this would render

**POGLAVLJE VI
POSEBNE ODREDBE O
CARINSKIM
NADLEŽNOSTIMA**

**Član 284
Prikupljanje i obrada informacija**

1. Carina prikuplja lične i druge podatke i informacije u svrhu obrade i obavljanja carinskih obaveza iz postojećih izvora podataka, direktno od lica na koje se ti podaci odnose i od drugih lica za koja je verovatno da imaju saznanja o ovim podacima.
2. Prikupljanje ličnih i drugih podataka od dete vrši se u prisustvu roditelja, staratelja, roditelja staratelja, lica kome je povereno čuvanje i vaspitanje deteta ili stručnog lica centra za socijalni rad.
3. Carinski službenik koji prikuplja lične i druge podatke i informacije iz postojećih izvora podataka ili drugih lica, nije dužan da obavesti lica na koja se ti podaci odnose ako to onemogućava ili otežava obavljanje određenog posla.

| | | |
|--|--|---|
| <p>bënte të pamundur ose të vështirë kryerjen e një detyre të caktuar.</p> <p>4. Autoritetet, institucionet dhe subjektet tjera të cilat në bazë të ligjit dhe në kuadër të veprimtarisë së tyre kanë në dispozicion të dhëna personale dhe të tjera informacione, janë të obliguar që me kërkesë të oficerit doganor t'i dorëzojnë të dhënat dhe informacionet e kërkuara.</p> <p>5. Oficeri doganor mund të mbledhë të dhëna, informacione personale dhe njoftime të tjera në lokalet zyrtare, në vendin e punës së personit, në një vend tjetër të përshtatshëm dhe me pëlqimin paraprak të personit edhe në shtëpinë e tij.</p> <p>6. Ne zbatim të këtij neni, Dogana zbaton parimet e përpunimit të dhënave personale të cilat parashihen me legjislacionin përkatës në fuqi.</p> | <p>impossible or difficult to perform a certain duty.</p> <p>4. Authorities, institutions and other subjects which based on the law or within their scope of activities have personal data and other information available, are obliged by request from the authorized customs officer to submit the requested data and information.</p> <p>5. Customs officer may collect data, personal information and other notices from official facilities, at the person's workplace, another suitable place and with prior consent from the person in their house as well.</p> <p>6. Pursuant to this article, Customs applies the principles of personal data processing provided for by the relevant legislation in force.</p> | <p>4. Organi, institucijue i drugi subjekti koji u skladu sa zakonom i u okviru svoje delatnosti raspolažu ličnim i drugim podacima i informacijama dužni su da dostave informacije i tražene podatke na zahtev ovlašćenog carinskog službenika.</p> <p>5. Carinski službenik može prikupljati podatke, lične informacije i druga obaveštenja u službenim prostorijama, na radnom mestu lica, na drugom pogodnom mestu i uz prethodnu saglasnost lica i u njegovoj kući.</p> <p>6. U skladu sa ovim članom, Carina primenjuje principe obrade ličnih podataka predviđene relevantnim zakonodavstvom na snazi.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 285</p> <p>Vlerësimi dhe regjistrimi i informacionit</p> <p>1. Para futjes së të dhënave dhe informacioneve personale dhe të tjera në regjistër, oficeri doganor vlerëson besueshmërinë e burimit dhe e vërtetësisë së të dhënave dhe informacioneve.</p> | <p style="text-align: center;">Article 285</p> <p>Evaluation and records of information</p> <p>1. Prior to entering the data and personal information and other in the records, the authorized customs officers shall assess the source credibility and data and information authenticity.</p> | <p style="text-align: center;">Član 285</p> <p>Procena i evidentiranje informacija</p> <p>1. Pre unošenja ličnih i drugih podataka i informacija u evidenciju, ovlašćeni carinski službenik procenjuje pouzdanost izvora i verodostojnost podataka i informacija.</p> |

| | | |
|--|---|---|
| <p>2. Dogana mban regjistër për të dhënat dhe informacionet që i mbledh në lidhje me kryerjen e detyrave nga kompetencat e saj.</p> <p>3. Lloji dhe sasia e kategorive të dhënave personale që përpunohen përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> <p style="text-align: center;">Neni 286 Përdorimi i informacionit</p> <p>1. Të dhënat personale të ruajtura në regjistra mund të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është krijuar regjistri, ndërsa për qëllime tjera vetëm nëse parashihet me ligj të veçantë.</p> <p>2. Dogana mund të krahasojë të dhënat personale dhe të dhënat dhe informacionet tjera të mbledhura në pajtim me legjislacionin doganor, me të dhëna personale dhe informacione të tjera të autorizuara për të mbledhur.</p> <p>3. Të dhënat dhe informacionet e pasakta të ruajtura në regjistra korrigjohen pa vonesë dhe korrigjimi duhet të evidentohet.</p> | <p>2. Customs keeps records of the date and information collected in relation to performing duties as per the competencies.</p> <p>3. The type and amount of categories of personal data that are processed are determined by a sub-legal act of the relevant Minister for Finance.</p> <p style="text-align: center;">Article 286 Use of information</p> <p>1. The personal data stored in registers may be used for the purposes for which the records were created, whereas for other purposes only when provided by a special law.</p> <p>2. Customs may compare the personal data and other data and information collected in accordance with the customs legislation, with other personal data and information authorized to collect.</p> <p>3. The inaccurate data and information stored in the registers, shall without delay be corrected and the correction shall be recorded.</p> | <p>2. Carina vodi evidenciju o podacima i informacijama koje prikuplja u vezi sa obavljanjem poslova iz svoje nadležnosti.</p> <p>3. Vrsta i količina kategorija ličnih podataka koji se obrađuju utvrđuju se podzakonskim aktom nadležnog ministra finansija</p> <p style="text-align: center;">Član 286 Upotreba informacija</p> <p>1. Lični podaci koji se čuvaju u registrima mogu se koristiti samo u svrhu za koju je evidencija stvorena, a u druge svrhe samo ako je to predviđeno posebnim zakonom.</p> <p>2. Carina može uporediti lične podatke i druge podatke i informacije prikupljene u skladu sa carinskim propisima, sa ličnim podacima i drugim informacijama koje su ovlašćene za prikupljanje.</p> <p>3. Netačni podaci i informacije uskladištene u registrima se ispravljaju bez odlaganja i ispravka se mora evidentirati.</p> |
|--|---|---|

| <p align="center">Neni 287 Mbrojtja e informacionit</p> | <p align="center">Article 287 Information protection</p> | <p align="center">Član 287 Zaštita informacija</p> |
|--|--|--|
| <p>1. Në mbledhjen, regjistrimin, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave personale dhe të tjera dhe informative, Dogana kujdeset posaçërisht për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të tjera, fshehtësinë dhe konfidencialitetin e tyre.</p> <p>2. Me rastin e zbatimit të kompetencave nga neni 284 i këtij kodi, zbatohen legjislacioni ne fuqi që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që përbëjnë sekrete afariste dhe sekrete të tjera.</p> <p>3. Dogana është e obliguar t'i mbaj të fshehta të dhënat nga sistemi i analizës dhe menaxhimit të riskut dhe identitetin e parashtruesit të kërkesës.</p> <p>4. Dokumentacionin dhe të dhënat e mbledhura ose të vërtetuara gjatë mbikëqyrjes dhe identitetin e parashtruesit të kërkesës, Dogana mund t'ua ofrojë gjykatave, prokurorisë, organeve të administratës shtetërore dhe organeve të tjera shtetërore, me kërkesë të tyre të arsyetuar me shkrim për procedurat që janë në kompetencë të tyre.</p> | <p>1. When collecting, registering, processing and using personal data and other information, Customs shall especially be attentive to other personal data, their secrecy and confidentiality.</p> <p>2. In the event of implementing competencies from article 284 of this code, the legislation in force regulating the protection of personal data and data consisting of business secrets and other secrets shall be enforced.</p> <p>3. Customs is obliged to keep the data secret from the risk analysis and management system and the applicant's identity as well.</p> <p>4. The documentation and the collected data or verified during the supervision and the applicant's identity, Customs may offer to courts, prosecution, state administration organs and other state institutions, with a written well argued request for the procedures under their competency.</p> | <p>1. U prikupljanju, unošenju, obradi i korišćenju ličnih i drugih i informativnih podataka, Carina će posebnu pažnju posvetiti zaštiti ličnih i drugih podataka, njihovoj poverljivosti.</p> <p>2. Prilikom sprovođenja nadležnosti iz člana 284. ovog zakonika, primenjuju se važeći propisi kojima se uređuje zaštita ličnih podataka i podataka koji čine poslovnu i drugu tajnu.</p> <p>3. Carina je dužna da čuva u tajnosti podatke iz sistema analize i upravljanja rizikom i identitet podnosioca zahteva.</p> <p>4. Dokumentaciju i podatke prikupljene ili proverene tokom nadzora i identitet podnosioca zahteva, Carina može dostaviti sudovima, tužilaštvu, organima državne uprave i drugim državnim organima, na njihov pismeno obrazloženi zahtev za sprovođenje postupaka u njihovoj nadležnosti.</p> |

| <p align="center">Neni 288 Mbikëqyrja e regjistrave</p> | <p align="center">Article 288 Register's supervision</p> | <p align="center">Član 288 Nadzor nad registrima</p> |
|---|---|--|
| <p>1. Mbikëqyrjen mbi regjistrat e të dhënave të Doganës, në të cilën ruhen të dhënat personale, e kryen organi përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me legjislacionin në fuqi me të cilin rregullohet mbrojtja e të dhënave personale dhe ruhen në afat deri në tri (3) vjet i cili mund të zgjatet për qëllime legjitime të arsyetuara.</p> <p>2. Të dhënat e ruajtura në regjistra mund të përdoren për qëllime shkencore dhe statistikore në përputhje me rregulloret e veçanta.</p> <p>3. Të dhëna të ndryshme numerike nga regjistrat mund të përdoren për qëllime statistikore dhe analitike nga Dogana dhe Ministria përkatëse për Financa.</p> <p>4. Lloji, mënyra e mbajtjes dhe shfrytëzimit të regjistrave të Doganës, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.</p> | <p>1. Supervision of Customs records data, where personal data are stored, is performed by the responsible institution for protection of personal data in accordance with the legislation in force, which regulates the protection of personal data and are stored for up to three (3) years, which can be extended for justified legitimate purposes.</p> <p>2. The data stored in the register may be used for scientific and statistical purposes in accordance with special regulations.</p> <p>3. Various numerical data from register may be used for statistical and analytical purposes by Customs and the Ministry of Finances.</p> <p>4. The type, manner of storage and use and terms for keeping registers in Customs is determined by a sublegal act from the Minister of Finances, with suggestion by the Director General.</p> | <p>1. Nadzor nad carinskim registrima podataka u kojima se čuvaju podaci o ličnosti vrši organ nadležan za zaštitu ličnih podataka u skladu sa važećim propisima kojima se uređuje zaštita ličnih podataka i čuvaju se do tri (3) godine, što se može produžiti u opravdane legitimne svrhe.</p> <p>2. Podaci koji se čuvaju u registrima mogu se koristiti u naučne i statističke svrhe u skladu sa posebnim propisima.</p> <p>3. Carina i Ministarstvo finansija mogu koristiti različite numeričke podatke iz registara u statističke i analitičke svrhe.</p> <p>4. Vrsta, način vođenja i korišćenja, kao i rokovi za vođenje carinskih registara, utvrđuju se podzakonskim aktom ministra finansija, na predlog generalnog direktora.</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 289 Shiqimi i dokumentacionit dhe verifikimi i besueshmërisë dhe vërtetësisë të dokumenteve</p> <p>Oficeri doganor kontrollon pajtueshmërinë e punës së personave fizik dhe juridik në pajtim me legjislacionin doganor në bazë të librave afarist, regjistrave dhe dokumenteve tjera.</p> | <p style="text-align: center;">Article 289 Documentation inspection and verification of documents credibility and authenticity</p> <p>Customs officer checks the work compliance of natural and legal persons in accordance with the customs legislation based on business books, registers and other documents.</p> | <p style="text-align: center;">Član 289 Pregled dokumentacije i provera pouzdanosti i autentičnosti</p> <p>Carinski službenik proverava usklađenost rada fizičkih i pravnih lica u skladu sa carinskim propisima na osnovu poslovnih knjiga, registara i drugih dokumenata.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 290 Kontrolli dokumentar</p> <p>1. Oficeri doganor kontrollon dokumentet e dorëzuara në procedurat doganore dhe të dhënat e paraqitura në ato dokumente, përfshirë dokumentet tjera dhe të dhënat e mbledhura gjatë zbatimit të kontrollës.</p> <p>2. Oficeri doganor kërkon nga personi, i cili sipas legjislacionit në fuqi është i obliguar të japë informacion ose të përmbushë një detyrim të caktuar, që në afat dhe vend të caktuar t'i dorëzojë çfarëdo dokumenti të kontabilitetit, kontratë, korrespondencë afariste, regjistra ose çdo dokument tjetër që oficeri doganor e konsideron të nevojshëm për zbatimin e kontrollës.</p> | <p style="text-align: center;">Article 290 Documents control</p> <p>1. Customs officer checks the documents submitted in customs procedures for which Customs is competent and the data submitted in those documents, including other documents and data collected while enforcing the supervision.</p> <p>2. Customs officer may request from the person, who as per the legislation in force, is obliged to provide the information or complete a certain obligation, to submit in certain period and specific place any accounting document, business correspondence, registers or any other document that customs officer deems necessary for supervision enforcement.</p> | <p style="text-align: center;">Član 290 Provera dokumenata</p> <p>1. Carinski službenik proverava dokumentaciju dostavljenu u carinskim postupcima za koje je nadležna Carina i podatke prikazane u tim dokumentima, uključujući i drugu dokumentaciju i podatke prikupljene tokom vršenja nadzora.</p> <p>2. Carinski službenik može zahtevati od lica, koje je prema važećim propisima dužno da pruži informacije ili da ispuni određenu obavezu, da u određenom roku i na određenom mestu dostavi bilo koji računovodstveni, ugovorni, poslovni dokument, prepisku, upisnike ili bilo koji drugi dokument koji carinski službenik smatra neophodnim za sprovođenje nadzora.</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>3. Dokumentet, të dhënat ose përmbushja e një detyrimi të caktuar nga paragrafi 2 i këtij neni mund të kërkohen nga çdo person i cili disponon dokumentacionin ose të dhënat e kërkuara ose duhet t'i ketë dokumentet ose të dhënat e tilla.</p> <p>4. Nëse librat afarist dhe evidencat e përcaktuara mbahen në medium elektronik, oficeri doganor mund të kontrollojë bazën e të dhënave të sistemit kompjuterik dhe të kërkojë përgatitjen ose dorëzimin e ndonjë dokumenti ose deklarate që konfirmon të dhënat e regjistruara në mediumin elektronik.</p> | <p>3. The documents, the data or completion of a specific obligation from paragraph 2 of this Article may be requested from every person who possesses the documentation or the data requested or should be having such documents or data.</p> <p>4. If the specific business books and registers are kept in an electronic medium, the authorized customs officer may check the computer system database and request preparation or submission of a document or declaration that confirms the registered data in the electronic medium.</p> | <p>3. Dokumente, evidenciju ili ispunjenje obaveze iz stava 2 ovog člana može zahtevati od bilo koje osobe koja poseduje potrebnu dokumentaciju ili evidenciju ili mora da ima takvu evidenciju ili evidenciju.</p> <p>4. Ako se pomenute poslovne knjige i evidencije vode u elektronskom mediju, ovlašćeni carinski službenik može izvršiti proveru baze podataka računarskog sistema i zahtevati pripremu ili dostavljanje bilo kog dokumenta ili deklaracije kojom se potvrđuju podaci evidentirani na elektronskom mediju.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 291 Verifikimi i identitetit të personave</p> | <p style="text-align: center;">Article 291 Person's identity verification</p> | <p style="text-align: center;">Član 291 Provera identiteta lica</p> |
| <p>1. Oficeri doganor gjatë zbatimit të mbikëqyrjes mund të verifikoj identitetin e personave.</p> <p>2. Verifikimi i identitetit të personit bëhet me këqyrjen e letërnjoftimit, dokumentit të udhëtimit ose dokumentit tjetër publik me fotografi.</p> <p>3. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, verifikimi i identitetit mund të bëhet në bazë të dëshmisë së personit, identiteti i të cilit është vërtetuar.</p> | <p>1. Customs officer while enforcing supervision may verify the person's identity.</p> <p>2. The person's identity verification is done by looking at the identification card, a travel document or any other public document with a photo.</p> <p>3. By exclusion from paragraph 2 of this Article, the identity verification is done based on the person's testimony, whose identity has been verified.</p> | <p>1. Carinski službenik ovlašćen za sprovođenje nadzora može da proveri identitet lica.</p> <p>2. Provera identiteta lica vrši se uvidom u ličnu kartu, putnu ispravu ili drugu javnu ispravu sa fotografijom.</p> <p>3. Izuzetno od stava 2. ovog člana, provera identiteta može se izvršiti na osnovu svedočenja lica čiji je identitet utvrđen.</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>4. Me rastin e verifikimit të identitetit të personit, oficeri doganor informon personin për arsyen e verifikimit të identitetit të tij.</p> <p>5. Oficeri doganor mund të mos informoj personin për arsyen e vërtetë të verifikimit të identitetit dhe qëllimin, nëse kjo mund të rrezikoj arritjen e qëllimit të mbikëqyrjes.</p> <p>6. Nëse identiteti i personit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të vërtetohet në bazë të dhënave në dispozicion, identifikimi i atij personi kërkohet nga strukturat kompetente policore.</p> | <p>4. In the event of person's identity verification, the authorized customs officers shall inform the person about the reason of his identity verification.</p> <p>5. Customs officer may refuse to inform the person about the real reason of identity verification and the purpose, if this would endanger the supervision purpose achievement.</p> <p>6. If the person's identity from paragraph 1 of this Article cannot be verified based on the available data, identification of that person is requested from the police competent structures.</p> | <p>4. Prilikom provere identiteta lica, ovlašćeni carinski službenik će obavestiti lice o razlogu za proveru njegovog identiteta.</p> <p>5. Carinski službenik može odbiti da obavesti lice o pravom razlogu provere identiteta i cilju, ako bi to moglo da ugrozi postizanje svrhe nadzora.</p> <p>6. Ako se identitet lica iz stava 1. ovog člana ne može utvrditi na osnovu raspoloživih podataka, za identifikaciju tog lica zahteva od policije.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 292</p> <p style="text-align: center;">Verifikimi i statusit doganor dhe natyrës së mallrave</p> <p>Verifikimi i statusit dhe i natyrës së mallit bëhet në zbatim të Nenit 291, kur në procedurë është e nevojshme të përcaktohen karakteristikat dhe natyra e mallit dhe të përcaktohet marrëdhënia ndërmjet një personi ose ngjarje me mallin.</p> | <p style="text-align: center;">Article 292</p> <p style="text-align: center;">Goods status and nature verification</p> <p>Goods status and nature verification is done in view of Article 291, when necessary to determine in the procedure the goods characteristics and nature and the relation between the person or the goods events.</p> | <p style="text-align: center;">Član 292</p> <p style="text-align: center;">Provera statusa i prirode robe</p> <p>Provera statusa i prirode dobara vrši se u primeni člana 291 kada je u postupku potrebno utvrditi svojstva i prirodu robe i utvrditi odnos lica ili događaja sa robom.</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 293</p> <p>Thirrja dhe orari i thirrjes për intervistë</p> <p>1. Nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe, personi i cili ka gjasa të ketë informata të dobishme për zbatimin e mbikëqyrjes mund të thirret nga Dogana në intervistë për mbledhjen e të dhënave personale dhe tjera.</p> <p>2. Në ftesë shënohet emri dhe adresa e njësisë organizative të Doganës, arsyeja, vendi dhe koha e ftesës.</p> <p>3. Personi që i është përgjigjur thirrjes dhe refuzon të jap informacion, nuk mund të thirret përsëri për të njëjtën arsye.</p> <p>4. Personi thirret në intervistë gjatë orarit administrativ të punës.</p> <p>5. Nëse ekziston rreziku që mbledhja e të dhënave të vonohet, Dogana mund të ftoj të njëjtin jashtë afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij Neni</p> | <p style="text-align: center;">Article 293</p> <p>Call and schedule for an interview</p> <p>1. Unless otherwise provided by special law, the person who is likely to have useful information for the implementation of supervision may be summoned by Customs to an interview for the collection of personal and other data.</p> <p>2. In the invitation the name and address of the Customs organizational unit is written down, the reason, place and time of the invitation.</p> <p>3. The person responding to the call and refuses to provide information, cannot be called again for the same reason.</p> <p>4. The person may be called during working hours as per administrative schedule.</p> <p>5. If there is a risk that collection of data is delayed, customs may invite the same out of period as determined in paragraph 4 of this Article.</p> | <p style="text-align: center;">Član 293</p> <p>Poziv i vreme poziva na intervju</p> <p>1. Osim ako posebnim zakonom nije drugačije određeno, lice za koje postoji verovatnoća da ima korisne informacije za sprovođenje nadzora može biti pozvano od strane Carine na razgovor radi prikupljanja ličnih i drugih podatak.</p> <p>2. U pozivu se navodi naziv i adresa organizacione jedinice Carine, razlog, mesto i vreme poziva.</p> <p>3. Osoba koja se odazvala pozivu i odbije da pruži informacije, ne može biti ponovo pozvana iz istog razloga.</p> <p>4. Lice može se pozvati tokom rada po administrativnom rasporedu.</p> <p>5. Ako postoji opasnost da će prikupljanje podataka biti odloženo, ovlašćeni carina može pozvati van roka iz stava 4 ovog člana.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 294</p> <p>Forma e thirrjes</p> <p>1. Oficeri doganor thërret personin me shkrim, gojarisht ose me mjet përkatës për</p> | <p style="text-align: center;">Article 294</p> <p>Invitation form</p> <p>1. Customs officer shall invite the person in writing, verbally or via a certain</p> | <p style="text-align: center;">Član 294</p> <p>Način pozivanja</p> <p>1. Carinski službenik poziva lice pismeno, usmeno ili odgovarajućim sredstvima komunikacije i dužan je da</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>komunikim dhe është i obliguar që t'ia komunikojë arsyen e thirrjes. Me pëlqimin e personit mund ta shoqëroj atë në ambientet zyrtare.</p> <p>2. Përjashtimisht mund të thirret personi përmes mjeteve të informimit kur kjo është e nevojshme për shkak të rrezikut të vonesës, sigurisë ose kur thirrja u drejtohet një numri më të madh të personave.</p> <p>3. Me kërkesë të personit i cili është përgjigjur ftesës, lëshohet vërtetim për përgjigje në ftesë të Doganës.</p> | <p>communication tool and is obliged to communicate the call reason. With person's consent, he may accompany him to the official premises.</p> <p>2. With exclusion the person may be called through information medium when this is absolutely necessary due to reasons of delay, arriving safety or when the call is directed to a huge number or people.</p> <p>3. By request from the invited person, who responded to the call, the certificate is issued for Customs invitation response.</p> | <p>saopšti razlog pozivanja. Uz saglasnost lica može da ga prati u službene prostorije.</p> <p>2. Izuzetno, lice se može pozvati putem sredstava javnog informisanja kada je to neophodno zbog opasnosti od zakašnjenja, bezbednosti ponašanja ili kada je poziv upućen većem broju lica.</p> <p>3. Na zahtev pozvanog lica koje se odazvalo pozivu, izdaje se uverenje o odazivanju na poziv Carine.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 295 Dhënia e paralajmërimeve dhe urdhrave</p> <p>1. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, oficeri doganor paralajmëron personin i cili me sjelljen, veprimin ose mosveprimin e tij mund të rrezikojë sigurinë e tij ose të një personi tjetër ose kur me arsye beson që ai person mund të kryejë ose të shtyj një person tjetër të kryejë vepër penale.</p> <p>2. Oficeri doganor lëshon urdhër gjatë zbatimit të autorizimeve sipas këtij Kodi në rastet si në vijim:</p> | <p style="text-align: center;">Article 295 Giving warnings and orders</p> <p>1. While performing the supervision, the authorized customs officers shall give a warning to the person who with his behaviour, action or inaction may endanger his security or other persons safety or when reasonably believes that the person may commit or may coerce another person to commit a criminal act.</p> <p>2. Customs officer issues an order, while enforcing the authorizations as per this Code in the following events:</p> | <p style="text-align: center;">Član 295 Davanje upozorenja i naređenja</p> <p>1. U vršenju nadzora, ovlašćeni carinski službenik će upozoriti lice koje svojim ponašanjem, činjenjem ili nečinjenjem može ugroziti svoju ili bezbednost drugog lica ili za koga osnovano veruje da to lice može da izvrši ili primorio drugog lica da izvrši krivično delo.</p> <p>2. Carinski službenik izdaje nalog za sprovođenje ovlašćenja prema ovom zakonu u sledećim slučajevima:</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>2.1. kur eliminon rrezikun për jetën dhe mbikëqyrjen e mallrave;</p> <p>2.2. për të parandaluar kryerjen e veprës penale ose për të parandaluar rezistencën ose arratisjen e personit;</p> <p>2.3. për të parandaluar asgjësimin e provave dhe dëshmive që mund të shërbejnë si provë;</p> <p>2.4. me qëllim të kontrollit të papenguar të personave, mallrave, mjeteve të transportit, objekteve afariste, lokaleve dhe objekteve tjera që janë objekt i mbikëqyrjes, dhe</p> <p>2.5. në raste të tjera në përputhje me akte te veçanta.</p> <p>3. Urdhri nga paragrafi 2 i këtij Neni mund të lëshohet edhe për një numër më të madh të personave.</p> | <p>2.1. Eliminating the risk toward people's lives and goods supervision;</p> <p>2.2. In order to prevent committing a criminal act or to prevent resistance or person's escape;</p> <p>2.3. Preventing destruction of evidence and tracks that might serve as evidence;</p> <p>2.4. With the purpose of unhindered control on persons, goods, means of transport and business facilities, premises and other supervision subjects, and</p> <p>2.5. In other events in accordance with special acts.</p> <p>3. The order from paragraph 2 of this Article may be issued for a bigger number of persons as well.</p> | <p>2.1. prilikom otklanjanja rizika po živote ljudi i nadzora robe;</p> <p>2.2. da spreči izvršenje krivičnog dela ili da spreči otpor ili bekstvo lica;</p> <p>2.3. da spreči uništavanje dokaza i tragova koji mogu služiti kao dokaz;</p> <p>2.4. radi nesmetane kontrole lica, robe, prevoznih sredstava i poslovnih prostorija, radionicama i drugih objekata koji su predmet nadzora, i</p> <p>2.5. u drugim slučajevima u skladu sa posebnim aktima.</p> <p>3. Nalog iz stava 2. ovog člana može se izdati za veći broj lica.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 296 Kufizimi dhe ndalimi i veprimtarisë</p> <p>1. Përveç urdhrave nga Neni 295, oficeri doganor, kur këtë e kërkojnë rrethanat e rastit, mund të kufizojë ose ndalojë përkohësisht kryerjen e veprimtarisë duke plumbosur dhe vendosur</p> | <p style="text-align: center;">Article 296 Limitation and prohibition of activity</p> <p>1. Except the orders from Article 295, the authorized customs official, when the case circumstances so require, may limit or temporarily prohibit performing the activities by sealing and placing insignia in</p> | <p style="text-align: center;">Član 296 Ograničenje i zabrana aktivnosti</p> <p>1. Pored naloga iz člana 295, ovlašćeni carinski službenik, kada to okolnosti slučaja nalažu, može privremeno ograničiti ili zabraniti obavljanje delatnosti žigosanjem i označavanjem poslovnih prostorija,</p> |

| | | |
|---|---|---|
| <p>shenja ne lokalet afariste, magazinat, impiantet, pjesë të impianteve, makineritë, pajisje ose ambiente të tjera apo pamundësoj përdorimin e impianteve, makinerive dhe pajisjeve të tjera për punë ose në mënyra të tjera të përshtatshme.</p> | <p>business premises, warehouses, manufactories, parts of manufactories, machineries, equipment or other premises or render impossible using the manufactories, machineries and other equipment for work or in other appropriate manners.</p> | <p>skladišta, postrojenja, delova postrojenja, mašina, opreme ili drugih prostorija ili onemogući korišćenje postrojenja, mašina i druge opreme za rad ili na drugi odgovarajući način.</p> |
| <p>2. Oficeri doganor mund të urdhërojë masa për pamundësimin, parandalimin dhe zbulimin e veprimeve të paligjshme në vendet e caktuara si tregje, panaire, ekspozita, manifestime dhe vende të tjera. Në përputhje me urdhrin, janë të detyruar të veprojnë personat fizikë dhe juridikë që drejtojnë veprimtarinë e tregjeve ose që organizojnë tregti të rastit.</p> | <p>2. Customs officer may order measures to render impossible, prevent and discover illegal actions in certain places such as markets, fairs, exhibitions, manifestations and other places. In accordance with the order, the natural and legal persons leading the market activities or organizing market events are obliged to act upon it.</p> | <p>2. Carinski službenik može narediti mere za onemogućavanje, sprečavanje i otkrivanje nezakonitih aktivnosti na određenim mestima kao što su pijace, sajmovi, izložbe, događaji i druga mesta. U skladu sa nalogom, dužni su da postupaju fizička i pravna lica koja obavljaju delatnost pijaca ili koja organizuju povremenu trgovinu.</p> |
| <p>3. Masat nga paragrafi 2 i këtij Neni mund të konsistojnë në shënjimin dhe rrethimin fizik ose bllokimin e hyrjes në objekt, vendosjen e shenjave paralajmëruese dhe veprime të tjera që kanë për qëllim pamundësimin, parandalimin ose zbulimin e veprimeve të kundërligjshme.</p> | <p>3. The measures from paragraph 2 of this Article may consist of physical marking or blocking the entrance to the facility, placing warning signs and other actions intended for rendering impossible, preventing or discovering illegal actions.</p> | <p>3. Mere iz stava 2. ovog člana mogu se sastojati od obeležavanja i fizičke ograde ili blokiranja ulaza u objekat, postavljanja znakova upozorenja i drugih radnji u cilju onemogućavanja, sprečavanja ili otkrivanja nezakonitih radnji.</p> |
| <p>4. Urdhri nga ky Nen do të zgjasë deri në largimin e shkakut për të cilin është sjell, më së largu deri në tridhjetë (30) ditë nga dita e sjellës së tij.</p> | <p>4. The order from this Article shall continue until the cause is removed, not later than thirty (30) days from the day of the order is brought.</p> | <p>4. Nalog iz ovog člana traje do otklanjanja uzroka zbog koje je izdat, a najkasnije do trideset (30) dana od dana donošenja naloga.</p> |
| <p>5. Pas afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni Dogana sjell vendim me të</p> | <p>5. After the deadline set in paragraph 4 of this article, the Customs brings a decision</p> | <p>5. Po isteku roka iz stava 4. ovog člana, Carina donosi rešenje kojim se utvrđuju</p> |

cilin përcakton kushtet ligjore qe duhet të përmbushen për zbatim të legjislacionit në fuqi dhe ankesa kundër këtij vendimi nuk e pezullon ekzekutimin e tij.

Neni 297

Ndalimi i veprimtarisë që zhvillohet me media

1. Kur e kërkojnë rrethanat e rastit Dogana, mund të parandalojë sjelljen e mëtejshme të kundërligjshme të personit fizik dhe juridik i cili porosit, ndërmjetëson ose publikon reklamë në shtyp, televizion, radio, internet dhe media të tjera ose njoftimet reklamuese në çfarëdo mënyre tjetër të disponueshme për publikun, duke lëshuar urdhër me shkrim me të cilën kufizohet ose ndalohet përkohësisht publikimi i reklamave dhe të gjitha aktiviteteve që synojnë shpalljen publike.

2. Në kuptim të këtij Neni, sjellje e kundërligjshme konsiderohet kryerja ose pjesëmarrja në kryerjen e veprimtarisë së paregjistruar ne pajtim më dispozitat që rregullojnë ndalimin dhe parandalimin e veprimtarisë së paregjistruar dhe reklamimin e shitjes ose disponimit tjetër të mallrave doganore në kundërshtim me kushtet, ndalesat dhe kufizimet sipas legjislacionit në fuqi.

that defines the legal conditions that must be met for the implementation of the legislation in force, and the appeal against this decision does not suspend its execution.

Article 297

Prohibition of activity taking place in the media

1. When the circumstances of the case so require, Customs may prevent further illegal behaviour of the natural and legal person, intermediates or publishes a print advertisement, television, radio, internet and other media or advertising notices in any other available way for the public, issuing a written order by which the publication of advertisement and all other activities aiming the public announcement are temporarily restricted or prohibited.

2. In view of this Article, an illegal behaviour is considered committing or participating in committing an unregistered activity in the meaning of provisions regulating the prohibition and prevention of unregistered activity and sale advertisement or other possession of customs goods in contrary to the terms, prohibitions and restrictions as per the legislation in force.

zakonski uslovi koji moraju biti ispunjeni za sprovođenje propisa koji su na snazi, a žalba na ovo rešenje ne odlaže njegovo izvršenje.

Član 297

Zabrana aktivnosti koje se odvijaju sa medijima

1. Kada to zahtevaju okolnosti slučaja, Carina, može sprečiti dalje protivpravno postupanje fizičkog ili pravnog lica koje naručuje, posreduje ili objavljuje oglase u štampi, televiziji, radiju, internetu i drugim medijima ili reklamnim obaveštenjima na bilo koji drugi način dostupan javnosti, izdavanjem pisanog naloga kojim se ograničava ili privremeno zabranjuje objavljivanje reklama i svih aktivnosti namenjenih javnom oglašavanju.

2. Protivpravnim ponašanjem u smislu ovog člana smatra se obavljanje ili učešće u obavljanju neregistrovane delatnosti u smislu odredaba kojima se uređuje zabrana i sprečavanje neregistrovane delatnosti i oglašavanje prodaje ili drugog raspolaganja carinskom robom, u suprotnosti sa uslovima, zabranama i ograničenjima prema važećem zakonu.

| | | |
|--|---|--|
| <p>3. Urdhri nga paragrafi 1 i këtij Neni ekzekutohet me zbatim të nenit 296 dhe ndërmarrje te veprimeve tjera proporcionale, me qëllim të pamundësimit dhe parandalimit të sjelljes së kundërligjshme.</p> <p>4. Kundër urdhrit nga paragrafi 1 i këtij Neni mund të parashtrohet ankesë e cila nuk e pezullon ekzekutimin e tij.</p> <p>5. Urdhri nga ky Nen do të zgjasë deri në largimin e shkakut për të cilin është sjell, e më së largu deri në tridhjetë (30) ditë nga dita e sjellës së tij.</p> <p>6. Pas afatit të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni Dogana sjell vendim me të cilin përcakton kushtet ligjore që duhet të përmbushen për zbatim të legjislacionit në fuqi dhe ankesa kundër këtij vendimi nuk e pezullon ekzekutimin.</p> | <p>3. The order from paragraph 1 of this Article is executed with the relevant application of Article 296 and other relevant actions proportionally, with the purpose of rendering impossible and preventing the illegal behaviour.</p> <p>4. An appeal against this order in paragraph 1 of this Article may be submitted which doesn't suspend its execution.</p> <p>5. The order from this Article shall last until the cause removal for which it was taken, not later than thirty (30) days from the day the order is brought.</p> <p>6. After the deadline of the term referred to in paragraph 5 of this article, Customs issues a decision determining the legal conditions that must be met for the implementation of the law in force, and an appeal against this decision does not delay the execution</p> | <p>3. Naredba iz stava 1. ovog člana izvršiće se uz odgovarajuću primenu člana 296 i drugim relevantnim radnjama na srazmeran način, u cilju onemogućavanja i sprečavanja nezakonitog ponašanja.</p> <p>4. Protiv naredbe iz stava 1. ovog člana može se podneti žalba, koja ne odlaže njegovo izvršenje.</p> <p>5. Naredba iz ovog člana traje do otklanjanja uzroka zbog kojeg je doneta, a najkasnije do trideset (30) dana od dana donošenja naredbe.</p> <p>6. Po isteku roka iz stava 5. ovog člana, Carina donosi rešenje kojim se utvrđuju zakonski uslovi koji moraju biti ispunjeni za sprovođenje zakona na snazi, a žalba na ovo rešenje ne odlaže izvršenje</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 298 Lëshimi i urdhrit</p> <p>1. Nëse oficeri doganor konstaton se janë shkelur dispozitat e ligjeve dhe rregullave të veçanta të nxjerra në bazë të tyre, përveç dhënies së urdhrave nga Neni</p> | <p style="text-align: center;">Article 298 Issuing an order</p> <p>1. If the customs officer comes to the conclusion that legal provisions and special regulations issued on their basis have been violated, except giving orders from Articles</p> | <p style="text-align: center;">Član 298 Izdavanje naredbe</p> <p>1. Ako ovlašćeni carinski službenik utvrdi da su prekršene odredbe posebnih zakona i pravila donetih na osnovu njih, pored izdavanja naredbe iz člana 295, 296. i</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>295, 296 dhe 297 dhe varësisht nga rrethanat e rastit lëshon urdhër me te cilin mund të:</p> <p>1.1. urdhërojë që parregullsitë e vërtetuara te eliminohen brenda një periudhe të caktuar;</p> <p>1.2. urdhërojë kthimin e mjeteve të përfituara në mënyrë të paligjshme;</p> <p>1.3. ndalojë zbatimin e veprimeve që janë në kundërshtim me legjislacionin doganor ose ligjet e veçanta;</p> <p>1.4. merr masa të tjera, përkatësisht të kryejë veprime të tjera për të cilat është i autorizuar me legjislacionin doganor ose ligje të veçanta.</p> <p>2. Urdhërin nga paragrafi 1 i këtij neni, oficeri doganor lëshon pa vonesë, më së voni në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e përfundimit të mbikëqyrjes.</p> <p>3. Kundër urdhërit nga paragrafi 1 i këtij Neni mund të parashtrohet ankesë, e cila nuk e pezullon ekzekutimin e tij.</p> | <p>295, 296 and 297 and depending on the case circumstances, may:</p> <p>1.1. Order elimination of verified irregularities within a certain period;</p> <p>1.2. Order the return of means obtained illegally;</p> <p>1.3. Stop application of actions against the customs legislation or special laws;</p> <p>1.4. Take other measures, respectively perform other actions for which is authorized by customs legislation or special laws;</p> <p>2. The order from paragraph 1 of this article, the authorized customs officers shall issue without delay, not later than thirty (30) days from the completion of supervision.</p> <p>3. An appeal may be submitted against the order from paragraph 1 of this Article, which doesn't suspend its execution.</p> | <p>297 i u zavisnosti od okolnosti slučaja, može da:</p> <p>1.1. naredi da se dokazane nepravilnosti otklone u određenom roku;</p> <p>1.2. naredi vraćanje nezakonito stečenih sredstava;</p> <p>1.3. zabrani sprovođenje radnji koje su suprotne carinskom zakonodavstvu ili posebnim zakonima;</p> <p>1.4. preduzima druge mere, odnosno da izvrši druge radnje za koje je ovlašćen carinskim ili posebnim zakonima.</p> <p>2. Naredba iz stava 1. ovog člana ovlašćeni carinski službenik izdaje bez odlaganja, a najkasnije u roku od trideset (30) dana od dana završetka nadzora.</p> <p>3. Protiv naredbe iz stava 1. ovog člana može se podneti žalba, koja ne odlaže njegovo izvršenje.</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 299 Mos zbatimi i urdhrit</p> <p>Nëse personi ndaj të cilit është lëshuar urdhri nuk vepron sipas urdhrit nga Neni 295, 296, 297 dhe 298, inicohet procedura kundërvajtëse, përkatësisht penale, varësisht nga kualifikimi i veprës sipas legjislacionit në fuqi.</p> | <p style="text-align: center;">Article 299 Non-execution of the order</p> <p>If the person toward whom the order is issued fails to act as per the order from Article 295, 296, 297 and 298, a misdemeanour procedure is initiated, particularly criminal procedure, depending on the offence qualification as per the legislation in force.</p> | <p style="text-align: center;">Član 299 Neizvršenje naredbe/naredenja</p> <p>Ako lice protiv koga je izdata naredba ne postupi po naredbi iz člana 295, 296, 297 i 298, pokreće se prekršajni postupak, odnosno krivični, u zavisnosti od kvalifikacije dela prema važećem zakonodavstvu.</p> |
| <p>Pergjithshem i Doganes vepron në perputhje me këtë nen.</p> <p>6. Pozitave drejtuese sipas paragrafeve 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 te ketij neni, te cileve nuk ju vazhdohet mandati rikthehen ne pozitën paraprake në rast se kanë pasur pozitë paraprake në Doganë.</p> <p>7. Rregullat e hollësishme për zbatimin e këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa.</p> | <p>Director of Customs acts in accordance with article.</p> <p>6. Management positions according to paragraphs 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 and 1.5 of this article, whose mandate is not extended, are returned to their previous position in case they had a previous position in Customs.</p> <p>7. The detailed rules for the implementation of this article are determined by a sub-legal act of the relevant Minister for Finance.</p> | <p>6. Rukovodeća radna mesta iz st. 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 i 1.5 ovog člana, kojima se ne produžava mandat, vraćaju se na pređašnje radno mesto u slučaju da su imali prethodnu poziciju u carini.</p> <p>7. Detaljna pravila za sprovođenje ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom nadležnog ministra finansija.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 332 Pezullimi i marrëdhënies së punës</p> <p>1. Oficeri doganor mund të pezullohet nga puna deri në gjashtë (6) muaj, nëse:</p> <p>1.1. ndaj tij ose saj është ngritur aktakuzë për vepër penale;</p> <p>1.2. i është caktuar masa e arrestit shtëpiak ose e paraburgimit; dhe</p> <p>1.3. dyshohet për shkelje të detyrave dhe prania e tij mund të ndikojë në hetime disiplinore ose penale.</p> | <p style="text-align: center;">Article 332 Suspension of work relation</p> <p>1. The customs officer may be suspended from work up to six (6) months, if:</p> <p>1.1. An indictment for criminal act has been filed against him or her;</p> <p>1.2. He or she has been under a house arrest or detention; and</p> <p>1.3. Is suspicious for breach of duties and his or her presence may affect in disciplinary or criminal investigations.</p> | <p style="text-align: center;">Član 332 Suspenzija radnog odnosa</p> <p>1. Carinski službenik može biti suspendovan sa rada/posla do šest (6) meseci, ako:</p> <p>1.1. je njemu ili njoj podignuta optužnica za krivično delo;</p> <p>1.2. mu/joj je određen kućni pritvor ili pritvor; i</p> <p>1.3. je osumnjičen za povredu dužnosti i njegovo ili njeno prisustvo može uticati na disciplinske ili krivične istrage.</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>2. Në rast se kundër oficerit doganor është ngritur aktakuzë dhe procedura penale nuk përfundon brenda gjashtë (6) muajve, pezullimi vazhdohet sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>3. Gjatë periudhës së pezullimit nga detyra, oficeri doganor merr pesëdhjetë (50) % të pagës bazë së tij.</p> <p>4. Nëse oficeri i pezulluar, shpallet i pafajshëm, periudha e pezullimit llogaritet si shërbim në detyrë për të gjitha qëllimet dhe oficeri merr pagën e plotë dhe shtesat e tjera të zbatueshme, të cilat do të ishin paguar sikur të mos ishte shqiptuar pezullimit nga shërbimi.</p> <p>5. Rregullat procedurale për zbatim të këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të Ministrisë përkatëse për Financa, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm</p> | <p>2. In case against the customs officer an indictment has been filed and the criminal procedure doesn't end within six (6) months, the suspension may continue until the final verdict from competent court.</p> <p>3. During the suspension period, customs officer gets fifty (50) % of his or her base salary without other additions.</p> <p>4. If the suspended official, is acquitted, the suspension period will be treated as service on duty for all the purposes and the official gets the full salary and other applicable allowances, which would have been paid if suspension from service wouldn't occur.</p> <p>5. Procedural rules for the implementation of this article are determined by a sub-legal act of the relevant Minister for Finance, by proposal of the General Director</p> | <p>2. Ako je protiv carinskog službenika podignuta optužnica, a krivični postupak nije okončan u roku od šest (6) meseci, suspenzija može da se nastavlja do konačne odluke nadležnog suda.</p> <p>3. Tokom perioda suspenzije, carinski službenik prima pedeset (50)% svoje osnovne plate bez primenjenih dodatka.</p> <p>4. Ako se suspendovani službenik proglasi nevinim, period suspenzije će se tretirati kao služba na dužnosti za sve svrhe i službenik će dobiti punu platu i druge primenljive naknade koje bi bile isplaćene da suspenzija nije izrečena od strane službe.</p> <p>5. Proceduralna pravila za sprovođenje ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom nadležnog ministra finansija, na predlog generalnog direktora.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 333 Përfundimi i marrëdhënies së punës</p> <p>1. Marrëdhënia e punës së oficerit doganor përfundon me:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. dorëheqje, me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditë;</p> | <p style="text-align: center;">Article 333 Termination of work relation</p> <p>1. The customs official's work relation ends with:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. Resignation, with prior notification of thirty (30) days;</p> | <p style="text-align: center;">Član 333 Prestanak radnog odnosa</p> <p>1. Carinskom službeniku prestaje radni odnos:</p> <p style="padding-left: 40px;">1.1. ostavkom, uz prethodnu najavu od trideset (30) dana;</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>1.2. arrijten e moshës së pensionimit;</p> <p>1.3. humbjen e shtetësisë apo zotësisë së veprimit;</p> <p>1.4. për shkak të pamundësisë ose paaftësisë së ushtrimit të detyrës më gjatë se gjashtë (6) muaj;</p> <p>1.5. pas dy (2) vlerësimeve periodike “jo kënaqshëm”, të rezultateve në punë;</p> <p>1.6. në rast të shkeljeve të rënda disiplinore, kur shqiptohet masa e largimit nga vendi i punës;</p> <p>1.7. vendim me dënim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;</p> <p>1.8. vdekje;</p> | <p>1.2. Reaching retirement age;</p> <p>1.3. Loss of citizenship or ability to act;</p> <p>1.4. Due to the inability of incompetence of performing duties longer then six (6) months;</p> <p>1.5. After two (2) “unsatisfying” assessments, of work results;</p> <p>1.6. In the event of serious disciplinary violations, when the measure of dismissal from work is imposed;</p> <p>1.7. with a decision with a final sentence for the commission of an intentional criminal offense;</p> <p>1.8. death;</p> | <p>1.2. postizanjem starosne dobi za penzionisanje;</p> <p>1.3. gubitakom državljanstva ili radne sposobnosti;</p> <p>1.4. zbog nemogućnosti ili nesposobnosti obavljanja dužnosti duže od šest (6) meseci;</p> <p>1.5. zbog dve (2) „nezadovoljavajuće“ evaluacije, rezultata na radu;</p> <p>1.6. u slučaju težih disciplinskih prekršaja, kada se izriče mera razrešenja sa radnog mesta;</p> <p>1.7. rešenjem sa pravosnažnom kaznom za izvršenje krivičnog dela sa umišljajem</p> <p>1.8. zbog smrti;</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|--|---|
| <p>1.9. në çdo rast tjetër, të parashikuar me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 334 Përgjegjësia disiplinore</p> <p>1. Oficeri doganor mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësive, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim ose mosveprim.</p> <p>2. Përgjegjësia penale nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore, nëse arsyeja e ngritjes se kallëzimit penal përbën edhe shkeljen e detyrave apo përgjegjësive të punës.</p> <p>3. Lirimi nga përgjegjësia penale nuk nënkupton përjashtim nga përgjegjësia disiplinore, nëse vepra e kryer paraqet shkelje detyrave apo përgjegjësive të punës.</p> | <p>1.9. in any other event, provided by legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 334 Disciplinary liability</p> <p>1. Customs officer shall bear the disciplinary responsibility for violation of duties and responsibilities, in cases where he/she does not perform assigned the duties, when he/she performs them improperly or when during their exercise he/she acts contrary to the laws and other sub-legal acts in force. Disciplinary violation can be done by action or inaction.</p> <p>2. The criminal responsibility does not exclude the disciplinary responsibility, if the cause of the criminal charge constitutes a violation of work duties and responsibilities.</p> <p>3. Exemption from criminal responsibility does not mean exemption from disciplinary responsibility, if the offense committed represents a violation of work duties and responsibilities.</p> | <p>1.9. u svakom drugom slučaju, predviđenom važećim zakonima.</p> <p style="text-align: center;">Član 334 Disciplinska odgovornost</p> <p>1. Carinski službenik snosi disciplinsku odgovornost zbog povrede dužnosti i odgovornosti, u slučajevima kada ne obavlja zadatke koji su mu povereni, kada ih neuredno obavlja ili kada u toku njihovog vršenja postupa u suprotnosti sa zakonima i drugim važećim podzakonskim aktima. Disciplinski prekršaj se može učiniti činjenjem ili nečinjenjem.</p> <p>2. Krivična odgovornost ne isključuje disciplinsku odgovornost, ako uzrok krivične prijave predstavlja i povredu radnih dužnosti ili odgovornosti.</p> <p>3. Oslobođanje od krivične odgovornosti ne znači oslobođanje od disciplinske odgovornosti, ako učinjeno delo predstavlja povredu radnih dužnosti ili odgovornosti.</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 335 Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi</p> <p>1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë:</p> <p>1.1. shkelje të lehta;</p> <p>1.2. shkelje të rënda.</p> <p>2. Klasifikimi i shkeljeve të lehta dhe të rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.</p> | <p>responsibilities.in force provides for the customs officials work performance.</p> <p style="text-align: center;">Article 335 Violation of duties and responsibilities</p> <p>1. Violation of duties and responsibilities can be:</p> <p>1.1. minor violations;</p> <p>1.2. serious violation.</p> <p>2. The classification of minor and serious violations of work duties and responsibilities are determined by a sub-legal act of the relevant Minister for Finance by proposal of the General Director.</p> | <p style="text-align: center;">Član 335 Povrede dužnosti i odgovornosti</p> <p>1. Povrede radnih dužnosti i odgovornosti mogu biti:</p> <p>1.1. lakše povrede;</p> <p>1.2. teške povrede.</p> <p>2. Klasifikacija lakših i teških povreda radnih obaveza i odgovornosti utvrđuje se podzakonskim aktom nadležnog ministra finansija na predlog generalnog direktora.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 336 Kompetenca për shqiptimin e masës disiplinore</p> <p>1. Procedura disiplinore për shkelje të lehta zhvillohet nga eprori i drejtpërdrejtë i oficerit doganor.</p> | <p style="text-align: center;">Article 336 Competence for imposing of disciplinary measures</p> <p>1. Disciplinary measures for minor violations shall be imposed by the immediate supervisor of customs officer.</p> | <p style="text-align: center;">Član 336 Nadležnost za izricanje disciplinske mere</p> <p>1. Disciplinske mere za lakše povrede izrice neposredni rukovodilac carinskog oficira.</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>2. Procedura disiplinore për shkelje të rënda zhvillohet nga Komisioni Disiplinor.</p> <p>3. Për shqyrtimin e rasteve të drejtorëve të drejtorive, Drejtori i Përgjithshëm sipas rastit emëron komision prej tre (3) anëtarëve në përbërje prej: një (1) përfaqësues i menaxhmentit të lartë të Doganës, një (1) përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe një (1) përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës, varësisht nga natyra e rastit të cilët do të jenë të pavarur në shqyrtimin e çështjes.</p> <p>4. Rregullat procedurale për iniciimin e procedurës, shqyrtimin e masave, dhe përbërja e komisionit disiplinor përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit për Financa me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.</p> | <p>2. The disciplinary procedure for serious violations is carried out by the Disciplinary Commission.</p> <p>3. To review the cases of directors of directorates or equivalent positions, the director general, depending on the case, appoints a committee of three (3) members composed of: one (1) representative of the senior management of customs, one (1) representative of the Ministry of Finance and one (1) representative of the Tax Administration of Kosovo, depending on the nature of the case, who will be independent in examining the case.</p> <p>4. Procedural rules for the initiation of the procedure, the creation and composition of the disciplinary commission are determined by a sub-legal act of the relevant Minister for Finance by proposal of the General Director.</p> | <p>2. Disciplinski postupak za teže prekršaje sprovodi Disciplinska komisija.</p> <p>3. Za ispitivanje slučajeva direktora direkcija ili ekvivalentnih pozicija, generalni direktor, zavisno od slučaja, imenuje komisiju od tri (3) člana sastavljenu od: jednog (1) predstavnika višeg rukovodstva carine, jedan (1) predstavnik Ministarstva finansija i jedan (1) predstavnik Poreske uprave Kosova, u zavisnosti od prirode slučaja, koji će biti nezavisni u ispitivanju slučaja.</p> <p>4. Pravila postupka za pokretanje postupka, formiranje i sastav disciplinske komisije utvrđuju se podzakonskim aktom nadležnog ministra finansija na predlog generalnog direktora.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 337 Masat disiplinore</p> <p>1. Për shkelje të lehtë mund të shqiptohet masat disiplinore vërejtje me gojë ose vërejtje me shkrim ndaj oficerit doganor, në kohëzgjatje prej një (1) muaj deri në gjashtë (6) muaj.</p> <p>2. Për shkelje të rëndë Komisioni Disiplinor, bazuar në hetimet dhe provat e</p> | <p style="text-align: center;">Article 337 Disciplinary measures</p> <p>1. For minor violations a verbal reprimand or written reprimand may be issued to the customs officer, for a period of one (1) month to six (6) months.</p> <p>2. For a serious violation, the Disciplinary Commission, based on the investigations</p> | <p style="text-align: center;">Član 337 Disciplinske mere</p> <p>1. Za lakši prekršaj carinskom službeniku se može izreći usmena ili pismena opomena u trajanju od jednog (1) meseca do šest (6) meseci.</p> <p>2. Za teži prekršaj, Disciplinska komisija, na osnovu uviđaja i dokaza</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>ofruara nga njësia organizative përkatëse mund të shqiptoj një nga masat e mëposhtme:</p> <p>2.1. Ndalimi në pagë prej njëzetë (20) % deri pesëdhjetë (50) % të pagës mujore bazë për një periudhë deri ne gjashte (6) muaj;</p> <p>2.2. Ndalim avancimi për një periudhë nga një (1) deri ne pesë (5) vjet;</p> <p>2.3. Ulje në gradë, jo më shumë se një (1) gradë, pa te drejte avancimi për një periudhë prej dy (2) deri ne tri (3) vjet;</p> <p>2.4. Para përjashtim, për një periudhë prej gjashtë (6) muaj deri ne dy (2) vjet dhe</p> <p>2.5. Ndërprerje të marrëdhënies së punës.</p> <p>3. Procedura disiplinore mund të zhvillohet krahas procedurës penale, vetëm nëse nuk dëmtohen hetimet në procedurë penale. Në rastet kur zhvillimi i procedurës disiplinore mund të dëmtojë zhvillimin e hetimeve penale, me njoftim të prokurorit të çështjes, veprimet e procedurës</p> | <p>and evidence provided by the relevant organizational unit, can pronounce:</p> <p>2.1. Salary deduction from twenty (20)% to fifty (50)% of gross monthly salary for a period of up to (6) month;</p> <p>2.2. Promotion ban for a period of one (1) to five(5) years;</p> <p>2.3. Lower post or degradation, not more then one (1) rank, without the right to promotion for a period of two (2) to three (3) years;</p> <p>2.4. Pre-dismissal, for a period form six (6) month (2) to two (2) years, and</p> <p>2.5. Termination of employment.</p> <p>3. The disciplinary procedure may be conducted along the criminal procedure, only if investigations in criminal procedure are not affected. In cases when conducting the disciplinary procedure may affect negatively the criminal investigations, by an notification from the case prosecutor, the</p> | <p>nadležne organizacione jedinice, može izreći:</p> <p>2.1. Odbitak plate od dvadeset (20)% do pedeset (50)% bruto mesecne plate za period do šest (6) meseci;</p> <p>2.2. Zabrana promocije na period od jedne (1) do pet (5) godine;</p> <p>2.3. Smanjenje položaja / čina, ne više od jednog (1) čina, bez prava napredovanja u trajanju od dve (2) do tri (3) godine;</p> <p>2.4. Pre-otpustanja, za period od šest (6) meseci do dve (2) godine, i</p> <p>2.5. Prestanak radnog odnosa.</p> <p>3. Disciplinski postupak može se voditi pored krivičnog postupka, samo ako se ne ugrožava istraga u krivičnom postupku. U slučajevima kada vođenje disciplinskog postupka može ugroziti vođenje krivične istrage, sa tužioca predmeta, radnje disciplinskog postupka se</p> |
|---|--|--|

| | | |
|--|---|---|
| <p>disiplinore mund të mbahen të pezulluara, derisa procedura penale të ketë përfunduar, apo të ketë arritur në shkallën kur zbatimi i masave disiplinore mund të jetë efektiv.</p> | <p>disciplinary procedures may be suspended, until the criminal procedure isn't complete or until it doesn't reach the stage when disciplinary measures enforcement might be effective.</p> | <p>mogu obustaviti dok se krivični postupak ne okonča, ili dok ne dospe u fazu gde sprovođenje disciplinskih mera mogu biti delotvorne.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 338 Fshirja e masës disiplinore nga evidencat</p> | <p style="text-align: center;">Article 338 Deletion of the disciplinary measures from the evidence</p> | <p style="text-align: center;">Član 338 Brisanje disciplinske mere iz dokaza</p> |
| <p>1. Masat disiplinore në dosjen e burimeve njerëzore fshihen, pas kalimit të këtyre afateve:</p> <p>1.1. një (1) vjet nga njoftimi për masën e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 337 të këtij Kodi;</p> <p>1.2. dy (2) vjet nga mbarimi i afatit për të cilin është zbatuar masa e përcaktuar në nën paragrafin 2.1 të nenit 337 të këtij Kodi;</p> <p>1.3. tri (3) vjet nga mbarimi i afatit, për të cilin është zbatuar masa e përcaktuar në nën paragrafin 2.2 dhe 2.3 të nenit 337 të këtij Kodi;</p> <p>1.4. katër (4) vjet nga njoftimi për masën e përcaktuar sipas nën paragrafit 2.4 të nenit 337 të këtij Kodi dhe</p> | <p>1. Disciplinary measures in the human resources file are terminated, after the expiration of these deadlines:</p> <p>1.1. one (1) year from the from the notification of the measure provided in paragraph 1 of article 337 of this law;</p> <p>1.2. two (2) years from the expiry of the implementation of the measures provided in subparagraphs 2.1 of article 337 of this law;</p> <p>1.3. three (3) years from the expiry of the measure provided in sub-paragraphs 2.2 and 2.3. has been applied. of article 337 of this law;</p> <p>1.4. four (4) years from the expiry of the measure provided according to subparagraph 2.4 of article 337 of this code and</p> | <p>1. Disciplinske mere u kadrovskom dosijeu prestaju, nakon isteka ovih rokova:</p> <p>1.1. godinu dana od dana od obaveštenja merama iz stava 1. člana 337. ovog zakona;</p> <p>1.2. dve (2) godine od od isteka roka za meru predviđenim podstavom 2.1 člana 337 ovog zakona;</p> <p>1.3. tri (3) godine od od isteka roka za mer predviđenim u podstavu 2.2 i 2.3. člana 337. ovog zakona;</p> <p>1.4. cetiri (4) godine od od početka isteka mera prema podstavovima 2.4 člana 337 ovog zakonika i</p> |

| | | |
|--|---|---|
| <p>1.5. tetë (8) vjet nga njoftimi për masën e përcaktuar sipas nga nën paragrafi 2.5 të nenit 337 të këtij Kodi.</p> <p>2. Fshirja e masës disiplinore nga evidencat bëhet sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore. Masa fshihet nga dosja e BNj dhe nga regjistri përkatës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 339 E drejta në ankesë</p> <p>1. I punësuarit në Doganë mund të ankohet kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankesës e kanë dhe kandidatët në procedurë rekrutuese në Doganën e Kosovës.</p> <p>2. Nëse ndaj vendimit të pranuar sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk janë ushtruar mjetet juridike brenda afatit të përcaktuar, vendimi merr formën e prerë dhe ekzekutohet menjëherë sipas dispozitave në fuqi.</p> <p>3. Për shqyrtimin e ankesave të drejtorëve të drejtorive, Drejtori i Përgjithshëm sipas rastit emëron komision</p> | <p>1.5. eight (8) years from the notification of the measure determined according to subsection 2.5 of article 337 of this Code.</p> <p>2. The declaration of termination is made ex officio or upon request, by decision of the human resources unit. The measure is deleted from the personnel file and from the relevant register.</p> <p style="text-align: center;">Article 339 The right of appeal</p> <p>1. Customs employees can complain when they claim that their rights have been violated in the employment relationship. Candidates in the recruitment procedure at the Kosovo Customs have the right to appeal.</p> <p>2. If legal remedies have not been exercised against the decision received according to paragraph 1 of this article within the specified period, the decision takes the final form and is executed immediately according to the provisions in force.</p> <p>3. For the examination of the complaints of the directors of the directorates, the General Director, as the</p> | <p>1.5. osam (8) godina od obaveštenja o merama utvrđenim u skladu sa stavom 2.5 člana 337. ovog zakonika.</p> <p>2. Izjava o raskidu se daje po službenoj dužnosti ili na zahtev, odlukom jedinice za ljudske resurse. Mera se briše iz kadrovskog dosijea i iz odgovarajućeg registra.</p> <p style="text-align: center;">Član 339 Pravo na žalbu</p> <p>1. Zaposleni u carini mogu da se žale kada tvrde da su im povređena prava iz radnog odnosa. Kandidati u postupku zapošljavanja u Carini Kosova imaju pravo žalbe.</p> <p>2. Ako protiv odluke donete u skladu sa stavom 1. ovog člana nisu upotrebljeni pravni lekovi u određenom roku, odluka dobija konačan oblik i odmah se izvršava prema odredbama na snazi.</p> <p>3. Za razmatranje žalbi direktora direkcija, generalni direktor, zavisno od slučaja, imenuje komisiju od tri (3) člana, u</p> |
|--|---|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>prej tre (3) anëtarë, në këtë përbërje: një (1) përfaqësues i menaxhmentit të lartë të Doganës, një (1) përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe një (1) përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës.</p> <p>4. Kundër vendimit të Komisionit të Ankesave, oficeri doganor ka të drejtën e ushtrimit të mjetit juridik në gjykatën kompetente, në përputhje me ligjin përkatës për konflikt administrative.</p> <p>5. Rregullat procedurale të ankesës, emërimi i komisioneve të ankesave, afatet dhe çështjet tjera përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 340 Parashkrimi i shkeljeve disiplinore</p> <p>1. Shkeljet e lehta disiplinore parashkruhen nëse nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore, kanë kaluar një (1) vjet.</p> | <p>case may be, appoints a committee of three (3) members, in this composition: one (1) representative of the senior management of Customs, one (1) representative of the Ministry of Finance and one (1) representative from the Tax Administration of Kosovo.</p> <p>4. Against the decision of the Complaints Commission, the customs officer has the right to exercise a legal remedy in the competent court, in accordance with the relevant law on administrative conflict.</p> <p>5. The procedural rules of the appeal, the appointment of the appeals commissions, deadlines and other issues are determined by a sub-legal act of the relevant Minister for Finance on the proposal of the General Director.</p> <p style="text-align: center;">Article 340 Disciplinary violations prescription</p> <p>1. The minor disciplinary violations are prescribed if a period of one (1) year passed from the time of disciplinary violation is committed.</p> | <p>ovom sastavu: jedan (1) predstavnik višeg rukovodstva Carine , jedan (1) predstavnik Ministarstva finansija i jedan (1) predstavnik Poreske uprave Kosova.</p> <p>4. Protiv odluke Žalbene komisije, carinski službenik ima pravo da koristi pravni lek kod nadležnog suda, u skladu sa relevantnim zakonom o upravnom sporu.</p> <p>5. Proceduralna pravila žalbe, imenovanje komisija za žalbe, rokovi i druga pitanja utvrđuju se podzakonskim aktom nadležnog ministra finansija na predlog generalnog direktora.</p> <p style="text-align: center;">Član 340 Zastarevanje disciplinskih prekršaja</p> <p>1. Manji disciplinski prekršaji zastarevaju ako su protekle jedna (1) godine od izvršenja disciplinskog prekršaja.</p> |
|---|--|---|

| | | |
|--|--|--|
| <p>2. Shkeljet e rënda disiplinore, parashkruhen nëse nga koha e kryerjes së shkeljes disiplinore kanë kaluar katër (4) vjet.</p> <p>3. Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim të organit kompetent që ndërmerret për hetimin e rastit.</p> <p>4. Vepra parashkruhet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit për veprat si në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni.</p> <p>5. Masat disiplinore ekzekutohen pasi që të marrin plotfuqishmërinë administrative të vendimit disiplinor.</p> | <p>2. Serious disciplinary violations, are prescribed if a period of four (4) years passed from the time of committing the disciplinary violation.</p> <p>3. The prescription is stopped with every action from the competent organ undertaking the case investigations.</p> <p>4. The act is prescribed in every event when it passes double the period of prescription for acts as in paragraph 1 and 2.</p> <p>5. The disciplinary measures are executed after the disciplinary decision obtains full administrative power.</p> | <p>2. Teži disciplinski prekršaji, zastarevaju ako je proteklo četiri (4) godina od izvršenja disciplinskog prekršaja.</p> <p>3. Period zastarevanje se prekida svakom radnjom nadležnog organa koja se preduzima radi istrage slučaja.</p> <p>4. Prekršaj zastareva u svakom slučaju kada prođe dupli vremenski period od roka zastarelost za dela iz stava 1. i 2 ovog člana .</p> <p>5. Disciplinske mere se sprovode po dobijanju administrativne pravosnažnosti disciplinskog rešenja/odluke.</p> |
| <p>Neni 341 Ndihma juridike</p> | <p>Article 341 Legal assistance</p> | <p>Član 341 Pravna pomoć</p> |
| <p>1. Në rast se kundër oficerit doganor fillon procedurë penale për shkak të përdorimit të armëve të zjarrit, veprimeve të tjera gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, ose aksidentit të trafikut gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, me kërkesë të oficerit doganor, Dogana ofron ndihmë juridike-për oficerin doganor.</p> <p>2. Komisioni i formuar nga drejtori i përgjithshëm vlerëson kërkesën e oficerit doganor dhe i rekomandon drejtorit te</p> | <p>1. In the event a criminal procedure is initiated against the customs officer due to use of firearms or other actions while performing official duties or traffic accident while performing official duties, by request from the customs official, Customs shall provide legal assistane for the customs official.</p> <p>2. The commission established by Director General assesses the custom official's request and recommends to the</p> | <p>1. U slučaju da se protiv carinskog službenika pokrene krivični postupak zbog upotrebe vatrenog oružja ili drugih radnji u vršenju službene dužnosti, odnosno saobraćajne nezgode u vršenju službene dužnosti, na zahtev carinskog službenika, Carina pruža pravnu pomoć carinskom službeniku.</p> <p>2. Komisija koju formira Generalni Direktor ocenjuje zahtev carinskog službenika i preporučuje generalnom</p> |

përgjithshëm vendimin për aprovim ose refuzim.

Neni 342
Gatishmëria për të punuar

1. Oficeri doganor, i cili është paralajmëruar për gjendje gatishmërie dhe emergjente, është i obliguar të jetë në pritje për të punuar jashtë orarit zyrtar dhe gjatë kohës së pushimeve, kur nevojat e Doganës kërkojnë një gjë të tillë.

2. Oficeri doganor në pritje për të punuar, duhet që sa më shpejt të jetë e mundur të dalë në vendin e punës ose në vendin ku duhet të kryhen detyrat.

3. Rregullat procedurale dhe kushtet e zbatimit të këtij Neni përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës për Financa, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 343
Trajnimi dhe zhvillimi profesional

1. Për ngritje të kompetencës profesionale, Oficeri doganor kryen trajnime dhe merr pjesë në ngritjen e kompetencës profesionale të organizuar nga Dogana.

Director General the decision for approval or refusal.

Article 342
Willingness to work

1. The customs officer, who is warned about willingness to work, is obliged to be on hold for off schedule official work and also during leaves, when institutions needs require so.

2. The customs officer on hold to work, shall as soon as possible get to the working place or at the place where duties will be performed.

3. The procedural rules and terms of implementing this Article are determined by a legal act from the Minister of Finances with suggestion from Director General.

Article 343
Professional training and advancement

1. Customs officer shall continue completing professional knowledges, trained and take part in developing the professional competency organized by Customs.

direktoru odluku kojom se zahtev odobrava ili odbija.

Član 342
Spremnost za rad

1. Carinski službenik, koji je obavješten o stanju pripravnosti, dužan je da bude na čekanju za rad van službenog radnog vremena i u vreme odmora, kada institucionalne potrebe to nalažu potrebe tako nešto zahtevaju.

2. Carinski službenik koji je na čekanju za rad, mora što je pre moguće da izađe na radno mesto ili na mesto gde treba da se obave poslovi.

3. Pravila postupka i uslovi za sprovođenje ovog člana utvrđuju se podzakonskim aktom Ministra Finansija na predlog Generalnog Direktora.

Član 343
Obuka i profesionalni razvoj

1. Carinski službenik mora kontinuirano dopunjavati svoja stručna znanja, usavršavati se i učestvovati u uspostavljanju stručne osposobljenosti koje organizuje Carina.

| | | |
|---|---|---|
| <p>2. Trajnimi dhe zhvillimi profesional i referohen:</p> <p>2.1.zhvillimit dhe zbatimit të programeve për aftësim profesional te vazhdueshëm të oficerëve doganor;</p> <p>2.2.zhvillimin dhe zbatimin e programeve për trajnimin e kadetëve doganor;</p> <p>2.3.organizimin e kurseve, seminareve dhe punëtorive, dhe</p> <p>2.4.publikimeve profesionale për punën e Doganës dhe për nevojat e aftësimin profesional të oficerëve doganor.</p> <p>3. Përmbajtja, mënyra dhe kriteret për ngritjen profesionale, trajnimeve, aftësimin dhe verifikimin e kompetencës profesionale të oficerëve doganor përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës të Financave me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.</p> | <p>2. The activities of professional forming and advancement refer to:</p> <p>2.1. Development and application of training programs and continuous professional advancement of customs officials;</p> <p>2.2. Developing and application of professional training programs and advanced training programs for customs cadets and customs officials;</p> <p>2.3. Organizing courses, seminars and workshops, and</p> <p>2.4. Releasing necessary professional publications for Customs work and for the needs of professional training for customs officials.</p> <p>3. Contents, manner and criteria of professional advancement, training and verification of professional competency of customs officials and customs cadets are determined by an internal act by Director General.</p> | <p>2. Aktivnosti stručnog osposobljavanja i usavršavanja odnose se na:</p> <p>2.1. izradu i realizaciju programa obuke za osposobljavanje i stalnog stručnog usavršavanja carinskih službenika;</p> <p>2.2. izrada i realizacija programa za stručno osposobljavanje i više usavršavanje carinskih kadeta i usavršavanje carinskih službenika;</p> <p>2.3. organizovanje kurseva, seminara i radionica, i</p> <p>2.4. izdavanje stručnih publikacija neophodnih za rad Carine i za potrebe stručnog usavršavanja carinskih službenika.</p> <p>3. Sadržaj, način i kriterijumi stručnog usavršavanja, osposobljavanja i provere stručne osposobljenosti carinskih službenika i carinskih kadeta utvrđuju se internim/unutrašnjim aktom Generalnog Direktora.</p> |
|---|---|---|

| | | |
|--|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 344 Arsimimi dhe trajnimet ne institucione tjera</p> <p>1. Dogana në bazë të marrëveshjes ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Doganës dhe udhëheqësit të organit tjetër, mund të dërgoj oficerin doganor për arsimim ose trajnim specifik në ndonjë institucion tjetër shtetëror në Republikën e Kosovës ose jashtë saj.</p> <p>2. Në bazë të marrëveshjes ndërmjet Ministrit përkatës të Financave dhe udhëheqësit të një institucioni tjetër, në Doganë mund të shkollohen dhe aftësohen profesionalisht zyrtarë nga institucioni tjetër shtetëror, me qëllim të marrjes së njohurive nga kompetenca dhe fushëveprimi i Doganës.</p> | <p style="text-align: center;">Article 344 Education and training in other institutions</p> <p>1. Customs based on the agreement between the Minister of Finances and head of another organ, may make possible for the customs officer for education and training in another state institution of Republic of Kosovo or abroad.</p> <p>2. Based on the agreement between the Minister of Finances and head of another institution, professional officials from another state institution may get education and professional training in Customs, with the purpose of getting knowledge from Customs competency and scope of activities.</p> | <p style="text-align: center;">Član 344 Obrazovanje i obuka u drugim institucijama</p> <p>1. Carina, na osnovu sporazuma između Ministra Finansija i rukovodioca drugog organa, može poslati carinskog službenika na školovanje ili obuku u drugu državnu instituciju u Republici Kosovo ili u inostranstvu.</p> <p>2. Na osnovu sporazuma između Ministra Finansija i rukovodioca druge institucije, službenici druge državne institucije mogu se stručno obrazovati i osposobljavati u Carini, radi sticanja znanja iz nadležnosti i delokruga Carine.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 345 Aktivitetet që përbëjnë konflikt interesi</p> <p>1. Oficeri doganor ushtron funksionin e tij në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe Kodin e Mirësjelljes, dhe shmang çfarëdo konflikti të interesit në përputhje me ligjin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit.</p> | <p style="text-align: center;">Article 345 Activities that constitute a conflict of interests</p> <p>1. The customs officer performing his function in accordance to the legislation in force and the Code of Ethics and avoids any kind of conflict of interest in accordance to a certain law for prevention of conflict of interest.</p> | <p style="text-align: center;">Član 345 Aktivnosti koje predstavljaju sukob interesa</p> <p>1. Carinski službenik obavlja svoju funkciju u skladu sa zakonima na snazi i Etičkim Kodeksom i izbegava svaki sukob interesa u skladu sa relevantnim zakonom o sprečavanju sukoba interesa.</p> |

| | | |
|---|---|--|
| <p>2. Oficeri doganor gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, detyrohet që të bëjë vetë deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.</p> <p>3. Veprimet që kategorizohen si konflikt interesi në fushëveprimin e Doganës, mënyra e raportimit, afatet dhe procedurat për parandalimin e konfliktit të interesit, përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës të Financave me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.</p> | <p>2. The customs officer while performing his public function, is obliged to make a pre-declaration, case by case, of the existence of his private interest or that of relatives of his regarding the decision taking for a certain issue, that might become a reason for a conflict of interest and for this decision taking shall be withdrawn.</p> <p>3. Actions that are categorised as conflict of interest in the scope of Customs, the manner of reporting, deadlines and procedures for preventing the conflict of interest are determined by an internal act from Customs Director General.</p> | <p>2. Carinski službenik je dužan da se, u vršenju svoje javne funkcije, prethodno samoizjašnjava, od slučaja do slučaja, o postojanju svog privatnog interesa ili interesa njemu bliskih lica u vezi sa odlučivanjem u određenom pitanju, koje može biti uzrok da nastane sukob interesa i da odustane od tog odlučivanja.</p> <p>3. Radnje koje su kategorisane kao sukob interesa u oblast Carine, način izveštavanja, rokovi i postupci za sprečavanje sukoba interesa utvrđuju se internim aktom Generalnog Direktora Carine.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 346 Kufizimi i shfrytëzimit të informatave</p> <p>1. Oficeri doganor nuk mund të përdorë informatat, të dhënat ose njohuritë, në të cilat ka qasje gjatë punëve të Doganës, për qëllime jo zyrtare, përveç me pëlqim të Drejtorit të Përgjithshëm, për qëllime hulumtimi apo arsimore, me kusht që nuk zbulon të dhëna, informata personale, fshehtësi tatimore, sekrete të biznesit dhe informacione të tjera të mbrojtura.</p> <p>2. Oficeri doganor nuk mund të shfrytëzojë dhe të jap informata, të dhëna</p> | <p style="text-align: center;">Article 346 Restriction of use of information</p> <p>1. The customs officer cannot use information, data or knowledge, that has access on while working in Customs, for non-official purposes, except with consent from Director General, for research or educational purposes, provided that doesn't disclose data, personal information, tax secrets, business secrets and other protected information.</p> <p>2. The customs officer cannot use or give information, data and knowledge with</p> | <p style="text-align: center;">Član 346 Ograničenje korišćenja informacija</p> <p>1. Carinski službenik ne može koristiti informacije, podatke ili znanja kojima ima pristup u toku rada u Carini, u neformalne svrhe, osim uz saglasnost Generalnog Direktora, u istraživačke ili obrazovne svrhe, pod uslovom da ne odaje podatke, lične informacije, poreske tajne, poslovne tajne i druge zaštićene podatke.</p> <p>2. Carinski službenik ne može koristiti i pružati informacije, podatke i znanja u</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>dhe njohuri me qëllim të arritjes së ndonjë përfitimi financiar për vete apo për ndonjë person tjetër.</p> <p>3. Pas ndërprerjes ose përfundimit të marrëdhënies së punës, oficeri doganor mbron të dhënat e cekura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni.</p> | <p>the purpose of achieving a financial profit for themselves or other persons.</p> <p>3. After termination or completion of work relation, the customs officer remains saving the data mentioned in paragraph 1 and 2 of this Article.</p> | <p>cilju ostvarivanja bilo kakve finansijske koristi za sebe ili za neko drugo lice.</p> <p>3. Po prekidu ili prestanku radnog odnosa, carinski službenik štiti podatke iz stavova 1. i 2. ovog člana.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 347 Kufizimet gjatë grevës</p> <p>1. E drejta e grevës për oficerët doganor rregullohet me Ligjin përkatës për grevën dhe merr parasysh funksionimin e domosdoshëm të Doganës.</p> <p>2. Gjatë kohëzgjatjes së grevës Drejtori i Përgjithshëm përcakton rrjedhën e punës dhe aktivitetet e domosdoshme që duhet të zhvillohen.</p> | <p style="text-align: center;">Article 347 Restrictions on strike</p> <p>1. The right on strike for customs officials is regulated by certain Law on strike and takes under advisement the need functioning of Customs.</p> <p>2. During strike duration Director General determines the work flow and necessary activities that must be performed.</p> | <p style="text-align: center;">Član 347 Ograničenja za vreme štrajka</p> <p>1. Pravo na štrajk za carinske službenike regulisano je relevantnim Zakonom o štrajku i uzima u obzir neophodno funkcionisanje carine.</p> <p>2. Tokom trajanja štrajka, Generalni Direktor određuje tok rada i neophodne aktivnosti koje treba sprovesti.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 348 Tërheqja e kartelës, uniformës, armës, si dhe pamundësia e qasjes</p> <p>Oficerit doganor te cilit i është pezulluar ose ndërprere marrëdhënia e punës, i merren kartela zyrtare, uniforma, arma e zjarrit dhe pajisjet tjera, si dhe i ndalohet qasja në sistemet informatike të Doganës dhe sipas rastit edhe ne objektet e Doganës.</p> | <p style="text-align: center;">Article 348 Card withdrawal, uniforms and weapons as well as inability to access</p> <p>If the customs officer is suspended or dismissed, his service card, uniform and firearm are taken for the duration of suspension or dismissal, as well as access to Customs systems is disabled.</p> | <p style="text-align: center;">Član 348 Oduzimanje kartice, uniforme i oružja, kao i nemogućnost pristupa</p> <p>Ako je carinski službenik suspendovan ili otpušten, njemu se oduzima službena kartica, uniforma i vatreno oružje za vreme suspenzije ili udaljenja sa posla, kao i zabranjuje mu se pristup carinskim sistemima.</p> |

| <p align="center">Neni 349 Mirënjohjet për kontribute të veçanta</p> | <p align="center">Article 349 Acknowledgements for special contributions</p> | <p align="center">Član 349 Priznanja za posebne doprinose</p> |
|--|--|--|
| <p>1. Për arritje të sukseseve në fusha të caktuara të punës apo në kryerjen e detyrave, si dhe për kontribute në fuqizimin e reputacionit të Doganës, mund t'u jepen mirënjohje oficerëve doganor apo njërive organizative brenda saj, organeve tjera shtetërore, autoriteteve lokale, autoriteteve të tjera publike si dhe individëve që bashkëpunojnë me Doganën.</p> | <p>1. For the achievement of successes in certain areas of work or duties performance, as well as contributes in strengthening Customs reputation, acknowledgements can be given to customs officials or organizational units within, other state organs, local authorities, other public authorities as well as individuals cooperating with Customs.</p> | <p>1. Za dostignuća u pojedinim oblastima rada ili u obavljanju poslova, kao i za doprinose jačanju ugleda Carine, mogu se izdavati Priznanja carinskim službenicima ili organizacionim jedinicama u njenom sastavu, drugim državnim organima, lokalnim vlastima, drugim javnim vlastima i pojedincima koji saraduju sa Carinom.</p> |
| <p>2. Çmimet ose mirënjohjet e Doganës janë:</p> | <p>2. The awards or acknowledgements from Customs are:</p> | <p>2. Carinske nagrade ili priznanja su:</p> |
| <p>2.1 çmimi i parë vjetor;</p> | <p>2.1. First annual price;</p> | <p>1.1. prva godišnja nagrada;</p> |
| <p>2.2 çmimi i rastit, dhe</p> | <p>2.2. Random price, and</p> | <p>1.2. slučajna nagrada, i</p> |
| <p>2.3 falënderimet.</p> | <p>2.3. Appreciations.</p> | <p>1.3. zahvalnice.</p> |
| <p>3. Oficerit doganor me rastin e pensionimit mundet t'i dhurohet një simbol i Doganës.</p> | <p>3. The customs officer may be presented with a Customs symbol upon retirement.</p> | <p>3. Carinski službenik može dobiti carinski simbol nakon penzionisanja.</p> |
| <p>4. Mirënjohjet dhe çmimet e përmendura në paragrafin 2 të këtij Neni, si rregull, jepen me rastin e Ditës së Doganës.</p> | <p>4. The acknowledgements and awards mentioned in paragraph 2 of this Article, as a rule, are given on the Customs Day.</p> | <p>4. Priznanja i Nagrade iz stava 2. ovog člana, po pravilu, se dodeljuju povodom Dana Carine.</p> |
| <p>5. Mirënjohje jepen për kontribut të rëndësishëm në bashkëpunim me Doganën</p> | <p>5. Acknowledgements are given for a special contribution in cooperation with</p> | <p>5. Priznanja se dodeljuju za značajan doprinos u saradnji sa Carinom za organe</p> |

për organet e administratës shtetërore, shërbimet publike ose subjektet ekonomike.

6. Rregullat procedurale për dhënien e mirënjohjeve, llojet e tyre, si dhe kushtet dhe mënyra e dhënies së një simboli përkujtimor përcaktohen me akt nënligjor të Ministrit përkatës të Financave me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

KAPITULI VIII DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 350

Ndalimi i imitimit dhe përdorimit të uniformave, shenjave dhe simboleve të Doganës

1. Ndalohet prodhimi dhe përdorimi i uniformave dhe distinktivëve të cilat kanë ngjyrë, janë disenjuar, apo kanë shenja të pozicionimit dhe shënjime tjera identike apo të ngjashme me uniformat e oficerëve doganor të Doganës.

2. Ndalohet imitimi dhe përdorimi i automjeteve të cilat grafikisht janë të ngjashme me veturat dhe mjetet tjera zyrtare të Doganës.

3. Automjetet dhe pajisjet tjera që janë disenjuar apo që përdoren në kundërshtim

Customs for state administrative organs, public services or economic subjects.

6. Proceduratl rules for giving acknowledgements, their types and terms and way of giving the commemorative symbol are determined by a legal act by Minister of Finances with the proposal of the General Director..

CHAPTER VIII SPECIAL PROVISIONS

Article 350

Prohibition of imitating and using uniforms, Customs insignia and symbols

1. Production and use of uniforms and badges is prohibited, badges with colours, designed, or having positioning insignia and other identical markings or similar ones with Customs officials uniforms.

2. Prohibition of imitating and using vehicles which are graphically similar with Customs vehicles and other official means.

3. Vehicles and other equipment which are designed or used in contrary to

državne uprave, javne službe ili privredne subjekte.

6. Pravila postupka za dodelu priznanja, njihove vrste, kao i uslovi i način dodele jednog simbola obeležja utvrđuju se podzakonskim aktom Ministra Finansija na predlog generalnog direktora..

POGLAVLJE VIII POSEBNE ODREDBE

Član 350

Zabrana imitacije i upotrebe carinskih uniformi, znakova i simbola

1. Zabranjena je izrada/proizvodnja i upotreba uniformi i bedževa koji imaju boju, dizajnirani su, ili imaju oznake položaja i druge oznake identične ili slične uniformama carinskih službenika.

2. Zabranjena je imitacija i upotreba/korišćenje vozila koja su grafički slična vozilima i drugim službenim sredstvima Carine.

3. Vozila i druga oprema koja je dizajnirana ili korišćena suprotno stavovima 1. i 2. ovog

| | | |
|--|---|---|
| <p>me paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni ndalen përkohësisht dhe rasti procedohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 351 Masat Emergjente</p> <p>Në rast të situatave të jashtëzakonshme, vështirësive në qarkullim përmes vendkalimeve kufitare apo ngecjeve në kryerjen e procedurave doganore në brendi të territorit doganor të Republikës së Kosovës, Ministrit përkatës për Financa, me propozim të Drejtorit të përgjithshëm, mundet përkohësisht të përcaktojë masa të thjeshtëzuara për aplikimin e mbikëqyrjesm dhe kontrolleve doganore.</p> | <p>paragraph 1 and 2 of this Article are temporarily stopped and the case is processed in accordance with the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;">Article 351 Emergency measures</p> <p>In the event of extraordinary situations, difficulties in circulation via border crossing points or delays in performing customs procedures within the customs territory of Republic of Kosovo, the Minister of Finances, with suggestion by Director General, may temporarily assign simplified measures for application of customs supervision and controls.</p> | <p>člana privremeno se zadržavaju i predmet se procesuiru u skladu sa važećim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Član 351 Hitne mere</p> <p>U slučaju vanrednih situacija, teškoća u saobraćaju preko graničnih prelaza ili zastoja u obavljanju carinskih postupaka unutar carinske teritorije Republike Kosovo, Ministar Finansija, na predlog Generalnog Direktora, može privremeno odrediti pojednostavljene mere za primenu carinskog nadzora i kontrola.</p> |
|--|---|---|

| | | |
|--|--|--|
| | | |
|--|--|--|

DRAFT

**LIBRI I PESTË
LIGJI PËR LIRIMET**

PJESA E PARË

**KAPITULLI I
QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI
DHE PËRKUFIZIMET**

**Neni 352
Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Me këtë Ligj përcaktohen rastet dhe kushtet në të cilat lejohet lirimi nga detyrimet e importit dhe detyrimet e eksportit, kur mallrat lëshohen në qarkullim të lirë apo eksportohen nga territori doganor i Republikës së Kosovës.

2. Ky Ligj është në përputhje të pjesshme me:

2.1. Rregulloren e Këshillit (EC) nr. 1186/2009 të 16 nëntor 2009 për ngritjen e sistemit të Komunitetit për lirimet nga detyrimet doganore (versioni i kodifikuar).

2.2. Direktivën 2007/74/EC të 20 dhjetor 2007 për lirimet nga tatimi

**FIFTH BOOK
LAW ON RELIEFS**

FIRST PART

**CHAPTER 1
PURPOSE, SCOPE AND
DEFINITIONS**

**Article 352
Purpose and scope**

1. This Law sets out those cases in which, owing to special circumstances, relief from import duties, export duties when goods are released for free circulation or are exported from the customs territory of the Republic of Kosovo.

2. This Law is partially compliant with:

| <p>1.1. produkte të duhanit:</p> <p>1.1.1. pesëdhjetë (50) cigare,</p> <p>1.1.2. njëzetepesë (25) cigarillos - puro e hollë e vogël me peshë maksimale deri në tre (3) gramë secila,</p> <p>1.1.3. dhjetë (10) cigare puro,</p> <p>1.1.4. pesëdhjetë (50) gramë duhan për tymosje, ose</p> <p>1.1.5. një përzierje proporcionale nga këto produkte të ndryshme;</p> <p>1.2. alkool dhe pije alkoolike:</p> <p>1.2.1. pije të distiluara dhe pije të forta alkoolike me përbërje alkooli mbi 22 %; etil alkool i pa denatyrizuar me vëllim 80% e më tepër: një (1) litër, ose</p> | <p>1.1. tobacco products:</p> <p>1.1.1. Fifty (50) cigarettes,</p> <p>1.1.2. Twenty-five (25) cigarillos - cigars of a maximum weight of three (3) grams each;</p> <p>1.1.3. Ten (10) cigars,</p> <p>1.1.4. Fifty (50) grams of smoking tobacco, or</p> <p>1.1.5. a proportional assortment of these different products;</p> <p>1.2. alcohols and alcoholic beverages:</p> <p>1.2.1. distilled beverages and spirits of an alcoholic strength by volume exceeding 22 % volume; non-denatured ethyl alcohol of 80 % volume and over: one (1) litre, or</p> | <p>1.1. Duvanski proizvodi:</p> <p>1.1.1. pedeset (50) cigareta,</p> <p>1.1.2. dvadeset pet (25) cigarilosa - male tanke cigare (puro) maksimalne težine do tri (3) grama svaka,</p> <p>1.1.3. deset (10) puro cigara,</p> <p>1.1.4. pedeset (50) grama duvana za pušenje, ili</p> <p>1.1.5. proporcionalna mešavina ovih različitih proizvoda;</p> <p>1.2. alkohol i alkoholna pića:</p> <p>1.2.1. destilovana pića i jaka alkoholna pića sa sadržajem alkohola preko 22%; Nedenaturalni etil alkohol zapremine 80% ili više: jedan (1) litar, ili</p> |
|--|---|---|

1.2.2. pije të distiluara dhe pije të forta alkoolike, si dhe aperitivë me bazë vere apo alkooli, pije tafia, sake apo pije të ngjashme alkoolike me përbërje alkooli deri në 22%; verëra shkumëzuese, verëra likerit: një (1) litër, apo një përzierje proporcionale nga këto produkte të ndryshme dhe

1.3. Verë e pa gazuar: dy (2) litra;

1.4. Parfume: pesëdhjetë (50) gramë, ose ujëra tualeti: 0,25 litra.

**KAPITULLI VII
MJETE THEMELORE TË
PRODHIMIT DHE PAJISJE
TJERA TË IMPORTUARA ME
RASTIN E BARTJES SË
VEPRIMTARISË NGA NJË
VEND TJETËR NË KOSOVË**

Neni 379

1. Pavarësisht masave ligjore në fuqi në Kosovë për politikën industriale dhe

1.2.2. distilled beverages and spirits, and aperitifs with a wine or alcoholic base, tafia, saké or similar beverages, of an alcoholic strength by volume not exceeding 22 % volume; sparkling wines, liqueur wines: one (1) litre, or a proportional assortment of these different products, and

1.3. still wines: two (2) litres;

1.4. perfumes: fifty (50) grams, or toilet waters: 0,25 litre.

**CHAPTER 7
CAPITAL GOODS AND OTHER
EQUIPMENT IMPORTED ON
THE TRANSFER OF
ACTIVITIES FROM OTHER
COUNTRY INTO THE
KOSOVO**

Article 379

1. Without prejudice to the measures in force in the Kosovo with regard to

1.2.2. destilovana pića i jaka alkoholna pića, kao i aperitivi na bazi vina ili alkohola, tafia pića, sake ili slična alkoholna pića sa sadržajem alkohola do 22%; penušava vina, likerska vina: jedan (1) litar, ili proporcionalna mešavina ovih različitih proizvoda, i

1.3. Negazirano vino: dva (2) litra;

1.4. Parfemi: pedeset (50) grama, ili toaletna voda: 0,25 litara.

**POGLAVLJE 7
OSNOVNI PROIZVODNI
SREDSTVA I DRUGA OPREMA
UVEZENA U SLUČAJU
PRENOSA DELATNOSTI IZ
JEDNE DRUGE ZEMLJE NA
KOSOVO**

Član 379

1. Bez obzira na zakonske mere koje su na snazi na Kosovu za industrijsku i

| | | |
|---|---|--|
| <p>tregtare, dhe në zbatim të neneve 380 deri në 384, mjetet themelore dhe pajisjet tjera që u përkasin ndërmarrjeve që definitivisht, ndërpresin veprimtarinë e tyre në një vend tjetër dhe zhvendosen në territorin doganor të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të kryejnë një veprimtari të ngjashme, lirohen nga detyrimet e importit. Në rastet kur ndërmarrja e zhvendosur është investim bujqësor, atëherë edhe bagëtia e cila i përket, po ashtu lirohet nga detyrimet e importit.</p> <p>2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij Neni, ndërmarrje nënkupton një njësi të pavarur ekonomike që merret me veprimtari prodhuese ose shërbyese.</p> <p style="text-align: center;">Neni 380</p> <p>1. Lirimi kufizohet për mjetet themelore dhe pajisje tjera të cilat:</p> <p>1.1. përveç rasteve të veçanta që arsyetohen nga rrethanat, janë shfrytëzuar në ndërmarrje më së paku dymbëdhjetë (12) muaj para datës, kur ndërmarrja ka pushuar veprimtarinë në vendin tjetër jashtë Republikës së Kosovës prej ku i ka zhvendosur aktivitetet;</p> | <p>industrial and commercial policy, and subject to Articles 380 to 384, the capital goods and other equipment belonging to undertakings which definitively cease their activity in other country and move to the customs territory of the Republic of Kosovo in order to carry on a similar activity there, shall be admitted free of import duties. Where the undertaking transferred is an agricultural holding, its livestock shall also be admitted free of import duties.</p> <p>2. For the purposes of paragraph 1, ‘undertaking’ means an independent economic unit of production or of the service industry.</p> <p style="text-align: center;">Article 380</p> <p>1. Relief shall be limited to capital goods and other equipment which:</p> <p>1.1. except in special cases justified by the circumstances, have actually been used in the undertaking for a minimum of twelve (12) months before the date on which the undertaking ceased to operate in the country outside Republic of Kosovo from which it has transferred its activities;</p> | <p>komercijalnu politiku, a u skladu sa članovima 380 do 384, osnovna sredstva i druga oprema u vlasništvu preduzeća koja definitivno prestaju sa svojom delatnošću u drugoj zemlji i presele se na carinsku teritoriju Republike Kosovo, u cilju obavljanja slične delatnosti, oslobađaju se uvoznih dažbina. U slučajevima kada je preduzeće koje se seli poljoprivredna investicija, tada je i stoka koja pripada preduzeću, takođe je oslobođena od plaćanja uvoznih dažbina.</p> <p>2. U smislu stava 1. ovog člana, preduzeće je samostalni privredni subjekat koje se bavi proizvodnim ili uslužnim delatnostima.</p> <p style="text-align: center;">Član 380</p> <p>1. Oslobođanje od plaćanja je ograničeno na osnovna sredstva i drugu opremu koja:</p> <p>1.1. osim u posebnim slučajevima opravdanim okolnostima, korišćeni u preduzeću najmanje dvanaest (12) meseci pre datuma kada je preduzeće prestalo sa radom u drugoj zemlji van Republic of Kosova iz koje je premestilo svoje aktivnosti;</p> |
|---|---|--|

| | | |
|--|--|--|
| <p>1.2. synohen të përdoren për të njëjtin qëllim pasi të zhvendosen;</p> <p>1.3. i përshtaten natyrës dhe madhësisë së ndërmarrjes në fjalë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 381</p> <p>Lirimi nuk lejohet për ndërmarrjen, zhvendosja e të cilës në territorin doganor të Republikës së Kosovës vjen si rrjedhojë ose si qëllim, i bashkimit me, ose përvetësimit nga, një ndërmarrje të vendosur në territorin doganor të Republikës së Kosovës, pa filluar veprimtarinë e re.</p> <p style="text-align: center;">Neni 382</p> <p>1. Lirimi nuk lejohet për:</p> <p>1.1. mjetet e transportit që nuk janë mjete për prodhim apo të industrisë shërbyese;</p> <p>1.2. furnizimet e çfarëdo lloji që janë të destinuara për konsum njerëzor apo për ushqim të kafshëve;</p> | <p>1.2. are intended to be used for the same purposes after the transfer;</p> <p>1.3. are appropriate to the nature and size of the undertaking in question.</p> <p style="text-align: center;">Article 381</p> <p>No relief shall be granted to undertakings the transfer of which into the customs territory of the Republic of Kosovo is consequent upon or is for the purpose of merging with, or being absorbed by, an undertaking established in the customs territory of the Republic of Kosovo, without a new activity being set up.</p> <p style="text-align: center;">Article 382</p> <p>1. No relief shall be granted for:</p> <p>1.1. means of transport which are not of the nature of instruments of production or of the service industry;</p> <p>1.2. supplies of all kinds intended for human consumption or for animal feed;</p> | <p>1.2. predviđeno da se koristi u istu svrhu nakon preseljenja;</p> <p>1.3. odgovaraju prirodi i veličini dotičnog preduzeća.</p> <p style="text-align: center;">Član 381</p> <p>Oslobađanje od plaćanja dažbina nije dozvoljeno za preduzeće čije preseljenje na carinsku teritoriju Republike Kosovo dolazi kao rezultat ili kao cilj pridruživanja sa, ili sticanja preduzeća osnovanog na carinskoj teritoriji Republike Kosovo, bez pokretanja novu aktivnost.</p> <p style="text-align: center;">Član 382</p> <p>1. Oslobađanje od plaćanja nije dozvoljeno za:</p> <p>1.1. prevozna sredstva osim onih iz proizvodne ili uslužne industrije;</p> <p>1.2. snabdevanja bilo koje vrste koja su namenjene za ljudsku ishranu ili za stočnu hranu;</p> |
|--|--|--|

| | | |
|--|--|---|
| <p>1.3. karburantet dhe rezerva të lëndës së parë apo të produkteve finale, apo gjysmë-produkteve;</p> <p>1.4. bagëtinë që posedohet nga tregtarët.</p> | <p>1.3. fuel and stocks of raw materials or finished or semi-finished products;</p> <p>1.4. livestock in the possession of dealers.</p> | <p>1.3. goriva/karburanti ili zalihe sirovina ili finalnih proizvoda, odnosno poluproizvoda;</p> <p>1.4. stoku u vlasništvu trgovaca.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 383</p> | <p style="text-align: center;">Article 383</p> | <p style="text-align: center;">Član 383</p> |
| <p>Përveç në raste të veçanta që arsyetohen nga rrethanat, lirimi i paraparë në Nenin 379 lejohet vetëm për mjetet themelore dhe pajisjet tjera, që janë vendosur në qarkullim të lirë para kalimit të afatit prej dymbëdhjetë (12) muaj, nga data kur ndërmarria ka shuar veprimtarinë në vendin tjetër prej nga vjen në territorin doganor të Republikës së Kosovës.</p> | <p>Except in special cases justified by the circumstances, the relief referred to in Article 379 shall be granted only for capital goods and other equipment entered for free circulation before the expiry of a period of twelve (12) months from the date when the undertaking ceased its activities in other country from which it comes to the customs territory of the Republic of Kosovo.</p> | <p>Osim u posebnim slučajevima opravdanim okolnostima, oslobođanje iz člana 379. dozvoljeno je samo za osnovna sredstva i drugu opremu, koji su stavljeni u slobodan promet pre isteka roka od dvanaest (12) meseci, od dana kada je preduzeće prestalo sa radom u drugoj zemlji iz koje dolazi na drugu zemlju iz koje dolazi na carinsko područje Republike Kosovo.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 384</p> | <p style="text-align: center;">Article 384</p> | <p style="text-align: center;">Član 384</p> |
| <p>1. Pa kaluar periudha prej dymbëdhjetë (12) muaj nga data kur është pranuar deklarata për lëshim në qarkullim të lirë, mjetet themelore dhe pajisjet tjera të liruara nga detyrimet e importit nuk mund të huazohen, të jepen si garancion, të jepen ne shfrytëzim, qira ose të barten, qoftë me pagesë apo pa pagesë, pa e njoftuar paraprakisht Doganën. Kjo periudhe mund të zgjatet deri në tridhjetegjashtë (36) muaj, në rastet e dhënies ne shfrytëzim /qira ose</p> | <p>1. Until twelve (12) months have elapsed from the date on which their entry for free circulation was accepted, capital goods and other equipment which have been admitted duty-free may not be lent, given as security, hired out or transferred, whether for a consideration or free of charge, without prior notification to the competent authorities. This period may be extended to up to thirty six months (36) months as concerns hiring out or transfer where there is a risk of abuse.</p> | <p>1. U periodu od dvanaest (12) meseci od dana prijema deklaracije za puštanje u slobodan promet, osnovna sredstva i druga oprema oslobođena plaćanja uvoznih dažbina ne mogu se pozajmljivati, davati kao garancija, davati na korišćenje ili prenositi, bilo da je to plaćeno ili neplaćeno, bez prethodnog obaveštenja carini. Ovaj period se može produžiti do trideset šest (36) meseci, u slučajevima davanja na korišćenje/iznajmljivanja ili prenosa, kada postoji rizik od zloupotrebe.</p> |

bartjes, kur ekziston rreziku për keqpërdorim.

2. Çfarëdo huazimi, dhënie si garancion, dhënie në dhënies ne shfrytëzim /qira apo bartje para kalimit të afatit të përmendur në paragrafin 1 të këtij Neni, shkakton pagesën e detyrimeve përkatëse të importit për mallrat përkatëse, sipas normës që zbatohet në datën e dhënies së huazimit, dhënies së garancionit, dhënies në përdorim apo bartjes, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga Dogana.

Neni 385

Nenet 379 deri në 384 zbatohen përshtatshëm për mjetet themelore dhe pajisjet e tjera që u përkasin personave të angazhuar në veprimtari të lirë dhe personave juridikë të angazhuar në aktivitete jo fitimprurëse që e zhvendosin këtë aktivitet nga një vend tjetër në territorin doganor të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI VIII PRODUKTET E FITUARA NGA BUJQIT KOSOVARË NË TOKA QË NDODHEN NË VENDE TJERA

2. Any loan, giving as security, hiring out or transfer before the expiry of the period referred to in paragraph 1, shall entail payment of the relevant import duties on the goods concerned, at the rate applying on the date of such loan, giving as security, hiring out or transfer, on the basis of the type of goods and the customs value ascertained or accepted on that date by the Customs.

Article 385

Articles 379 to 384 shall apply mutatis mutandis to capital goods and other equipment belonging to persons engaged in a liberal profession and to legal persons engaged in a non-profit making activity who transfer this activity from other country into the customs territory of the Reepublic of Kosovo.

CHAPTER VIII PRODUCTS OBTAINED BY KOSOVO FARMERS ON PROPERTIES LOCATED IN OTHER COUNTRY

2. Svako pozajmljivanje, davanje kao garancija, davanje davanja na korišćenje ili prenos pre isteka roka navedenog u stavu 1. ovog člana, izaziva plaćanje odgovarajućih uvoznih dažbina za odgovarajuću robu, prema normi koja se primenjuje na dan davanja zaloga, davanja garancije, davanje na korišćenje ili prenosa, na osnovu vrste robe i carinske vrednosti koju je carina overila ili prihvatila tog dana.

Član 385

Članovi 379 do 384 primenjuju se mutatis mutandis na osnovna sredstva i drugu opremu koja pripada licima koja se bave slobodnim aktivnostima i pravnim licima koja se bave neprofitnim delatnostima koja ovu delatnost premeštaju iz druge zemlje na carinsku teritoriju Republike Kosovo.

POGLAVLJE VIII PROIZVODI DOBIJENI OD STRANE KOSOVSKIH FARMERA NA ZEMLJIŠTU KOJE SE NALAZI U DRUGIM ZEMLJAMA

| | | |
|--|---|--|
| <p style="text-align: center;">Neni 386</p> <p>1. Në zbatim të neneve 387 dhe 388, produktet bujqësore, blegtorale, bletare, kopshtare dhe pylltare të përfituara nga pronat që janë në fqinjësi me territorin doganor të Republikës së Kosovës, të cilat drejtohen nga prodhues bujqësor që kanë ndërmarrjen e tyre kryesore brenda territorit doganor të Republikës së Kosovës dhe në fqinjësi me vendin tjetër përkatës, lirohen nga detyrimet e importit.</p> <p>2. Për të përfituar nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij Neni, produktet blegtorale duhet të fitohen nga shtazët që janë me origjinë nga Kosova apo të cilat janë vendosur në qarkullim të lirë në Kosovë.</p> | <p style="text-align: center;">Article 386</p> <p>1. Subject to Articles 387 and 388, agricultural, stock-farming, bee-keeping, horticultural and forestry products from properties located in other country adjoining the customs territory of the Kosovo, which are operated by agricultural producers having their principal undertaking within the customs territory of Republic of Kosovo and adjacent to the country concerned shall be admitted free of import duties.</p> <p>2. To benefit from the provisions of paragraph 1, stock farming products must be derived from animals which originated in the Kosovo or have entered into free circulation therein.</p> | <p style="text-align: center;">Član 386</p> <p>1. U skladu sa članovima 387. i 388., poljoprivredni, stočarski, pčelarski, baštovanski i šumski proizvodi dobijeni sa imanja u blizini carinske teritorije Republike Kosovo, koje vode poljoprivredni proizvođači koji imaju svoje glavno preduzeće na carinskoj teritoriji Republike Kosovo i u susedstvu druge dotične zemlje, oslobođeni su od plaćanja uvoznih dažbina.</p> <p>2. Da bi se koristile odredbe stava 1. ovog člana, stočni proizvodi se moraju dobiti od životinja koje su kosovskog porekla ili koje su stavljene u slobodan promet na Kosovu.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 387</p> <p>Lirimi kufizohet për produktet të cilat nuk i janë nënshtruar trajtimeve tjera përveç atyre që zakonshëm pasojnë pas korrjes apo prodhimit të tyre.</p> | <p style="text-align: center;">Article 387</p> <p>Relief shall be limited to products which have not undergone any treatment other than that which normally follows their harvest or production.</p> | <p style="text-align: center;">Član 387</p> <p>Oslobađanje od plaćanja je ograničeno na proizvode koji nisu bili podvrgnuti nikakvom drugom tretmanu osim onog koji obično sledi nakon žetve ili proizvodnje.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 388</p> <p>Lirimi lejohet vetëm për produktet që sjellën në territorin doganor të Republikës</p> | <p style="text-align: center;">Article 388</p> <p>Relief shall be granted only for products brought into the customs territory of the</p> | <p style="text-align: center;">Član 388</p> <p>Oslobađanje od plaćanja je dozvoljeno samo za proizvode koje poljoprivredni proizvođač</p> |

së Kosovës nga prodhuesi bujqësor apo në llogari të tij.

Neni 389

Nenet 386, 387 dhe 388 zbatohen përshtatshëm për produktet e peshkimit apo të veprimtarive të kultivimit të peshkut në liqe apo rrugë ujore, që ndodhen përkaj kufirit ndërmjet Kosovës dhe vendit tjetër, nga peshkatarë kosovarë apo edhe për produktet e veprimtarisë së gjuetisë, që zhvillohen në liqe apo rrugë ujore të tilla nga sportistët e Kosovës.

KAPITULLI IX FARËRAT, PLEHRAT DHE PRODUKTET PËR PUNIMIN E TOKËS DHE KULTURAVE BUJQËSORE TË IMPORTUARA NGA PRODHUES BUIQËSORË NË VENDET TJERA PËR PËRDORIM NË TOKAT QË KUFIZOHEN ME ATO VENDE

Neni 390

Në zbatim të Nenit 391, farërat, plehrat dhe produktet për punimin e tokës dhe kulturave bujqësore, që destinohen për t'u përdorur në

Kosovo by the agricultural producer or on his behalf.

Article 389

Articles 386, 387 and 388 shall apply mutatis mutandis to the products of fishing or fish-farming activities carried out in the lakes or waterways bordering a Kosovo and other country by Kosovo fishermen and to the products of hunting activities carried out on such lakes or waterways by Kosovo sportsmen.

CHAPTER IX SEEDS, FERTILIZERS AND PRODUCTS FOR THE TREATMENT OF SOIL AND CROPS IMPORTED BY AGRICULTURAL PRODUCERS IN FOREIGN COUNTRIES FOR USE IN PROPERTIES ADJOINING THOSE COUNTRIES

Article 390

Subject to Article 391, seeds, fertilizers and products for treatment of soil and crops, intended for use on property located in the

unese na carinsku teritoriju Republike Kosovo, ili za njegov račun.

Član 389

Članovi 386, 387 i 388 primenjuju se mutatis mutandis na proizvode ribarstva ili aktivnosti uzgoja ribe na jezerima ili vodenim putevima, koji se nalaze duž granice između Kosova i druge zemlje, od strane kosovskih ribara ili na proizvode lovačke delatnosti, koji se odvijaju u tim jezerima ili vodenih puteva kosovskih sportista.

POGLAVLJE IX SEME, ĐUBRIVO I PROIZVODI ZA OBRADU ZEMLJIŠTA I POLJOPRIVREDNI USEVI UVEZENI OD POLJOPRIVREDNIH PROIZVOĐAČA IZ DRUGIH ZEMALJA ZA UPOTREBU NA ZEMLJIŠTIMA KOJA SE GRANIČE SA TIM ZEMLJAMA

Član 390

U skladu sa članom 391, seme, đubrivo i proizvodi za obradu zemljišta i poljoprivrednih useva, namenjeni za

pronën e cila gjendet në territorin doganor të Republikës së Kosovës në fqinjësi me një vend tjetër, e cila punohet nga një prodhues bujqësor që veprimtarinë kryesore e ka përbrenda vendit të lartcekur në fqinjësi me territorin doganor të Republikës së Kosovës, lirohen nga detyrimet e importit.

Neni 391

1. Lirimi kufizohet për ato sasi të farërave, plehrave dhe produkteve të tjera që nevojiten për punimin e pronës.

2. Lirimi lejohet vetëm për ato farëra, plehra apo produkte të tjera të importuara drejtpërdrejt në territorin doganor të Republikës së Kosovës nga prodhuesi bujqësor apo në llogari të tij.

3. Dogana mund të kushtëzojë lirimin në bazë të reciprocitetit.

KAPITULLI X MALLRAT QË BARTEN NË BAGAZHIN PRIVAT TË UDHËTARËVE

customs territory of the Republic of Kosovo adjoining other country and operated by agricultural producers having their principal undertaking within the said other country and adjacent to the customs territory of the Republic of Kosovo, shall be admitted free of import duties.

Article 391

1. Relief shall be limited to the quantities of seeds, fertilizers or other products required for the purpose of operating the property.

2. It shall be granted only for seeds, fertilizers or other products imported directly into the customs territory of the Republic of Kosovo by the agricultural producer or on his behalf.

3. Customs may make relief conditional upon the granting of reciprocal treatment.

CHAPTER X GOODS CONTAINED IN TRAVELLERS' PERSONAL LUGGAGE

korišćenje na imanju koje se nalazi na carinskoj teritoriji Republike Kosovo u susedstvu druge zemlje, koje uzgaja poljoprivredni proizvođač čiji je glavni delatnost u okviru gore navedene zemlje u blizini carinske teritorije Republike Kosovo, oslobođeni su plaćanja uvoznih dažbina.

Član 391

1. Oslobođanje od plaćanja ograničuje se na one količine semena, đubriva i drugih proizvoda potrebnih za preradu imovine.

2. Oslobođanje od plaćanja je dozvoljeno samo za ono seme, đubrivo ili druge proizvode uvezene direktno na carinsku teritoriju Republike Kosovo od strane poljoprivrednog proizvođača ili za njegov račun.

3. Carina može uslovljavati oslobođanje od plaćanja reciprocitetom.

POGLAVLJE X ROBA KOJA SE PREVOZI U PRIVATNOM PRTLJAGU PUTNIKA

| Neni 392 | Article 392 | Član 392 |
|---|--|--|
| <p>1. Mallrat në bagazhet personale të udhëtarëve që vijnë nga një vend tjetër jashtë Kosovës lirohen nga detyrimet e importit, me kusht që importet e tilla të përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe tatimi i akcizës sipas legjislacionit ne fuqi, për mallrat e importuara nga personat që udhëtojnë nga vendet tjera jashtë Kosovës.</p> <p>2. Për qëllime të paragrafit 1 të këtij Neni:</p> <p>2.1. bagazh personal nënkupton tërësinë e valixheve, të cilat udhëtari është në gjendje t'i paraqesë Doganës me rastin e arritjes se tij në territorin doganore të Republikës së Kosovës, si dhe çdo valixhe që i paraqitet Doganës në data të mëvonshme me kusht që kjo dëshmi të mund të sigurohet për të dëshmuar se është regjistruar, me rastin e nisjes së udhëtarit, si bagazh shoqëruar me kompaninë që e ka transportuar në Kosovë nga vendi i nisjes.</p> <p>Pa rënë ndesh me nën paragrafin 1.2 të nenit 462, kontejnerët portabël që mbajnë karburante nuk bëjnë pjesë në bagazhin personal;</p> | <p>1. Goods contained in the personal luggage of travellers coming from other country shall be admitted free of import duties, provided such imports are exempt from value added tax and excise duty under provisions of national law of goods imported by persons travelling from other countries.</p> <p>2. For the purposes of paragraph 1:</p> <p>2.1. personal luggage - means the whole of the luggage which a traveler is in a position to submit to Customs on his arrival to customs territory of Republic of Kosovo, as well as any luggage submitted to this same authority at a later date, provided that evidence can be produced to prove that it was registered, at the time of the traveler's departure, as accompanied luggage with the company which transported it into Kosovo from the country of departure.</p> <p>Without prejudice to Article 462, subparagraph 1.2, portable</p> | <p>1. Roba u ličnom prtljagu putnika koji dolaze iz druge zemlje van Kosova oslobođena je plaćanja uvoznih dažbina, pod uslovom da je takav uvoz oslobođen od poreza na dodatu vrednost i akcizne obaveze prema važećem zakonodavstvu za uvezenu robu od strane lica koja putuju iz drugih zemalja van Kosova.</p> <p>2. Za potrebe stava 1:</p> <p>2.1. Lični prtljag - podrazumeva sav prtljag koji putnik može da predoči carinskim organima po dolasku na carinskoj teritoriji Republike Kosovo, kao i svaki prtljag koji je kasnije predočen ovom organu pod uslovom da se ovaj dokaz može obezbediti da bi se dokazalo da je registrovan prilikom polaska putnika kao prateći prtljag kod preduzeća koje ga je prevezlo na Kosovo iz mesta polaska.</p> <p>Ne dovodeći u pitanje član 462, podstavka 1.2, prenosivi kontejneri koji sadrže gorivo neće biti deo ličnog prtljaga;</p> |

| | | |
|--|--|--|
| <p>2.2. Importe të natyrës jo-tregtare nënkupton importet të cilat:</p> <p>2.2.1. Kanë natyrë të rastit</p> <p>2.2.2. përbëhet ekskluzivisht nga mallra për përdorim personal të udhëtarëve apo të familjeve të tyre apo të mallrave të destinuara për dhurata, natyra dhe sasia e të cilave nuk lënë dyshim se janë duke u importuar për qëllime tregtare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 393</p> <p>1. Lirimi i përmendur në paragrafin 1 të nenit 392, për mallrat e shënuara më poshtë zbatohet varësisht nga kufijtë sasiorë për udhëtarë, me sa vijon:</p> <p>1.1. produkte duhani:</p> <p>1.1.1. 200 cigare, ose</p> <p>1.1.2. 100 cigarillos (cigare</p> | <p>containers holding fuel shall not constitute personal luggage;</p> <p>2.2. ‘imports of a non-commercial nature’ means imports which: -</p> <p>2.2.1. are of an occasional nature, and</p> <p>2.2.2. consist exclusively of goods for the personal use of the travelers or their families, or of goods intended as presents; the nature and quantity of such goods should not be such as might indicate that they are being imported for commercial reasons.</p> <p style="text-align: center;">Article 393</p> <p>1. The relief referred to in Article 392, paragraph 1, shall in respect of the goods listed below, apply subject to the following quantitative limits per traveler:</p> <p>1.1. tobacco products:</p> <p>1.1.1. 200 cigarettes, or</p> | <p>2.2. Uvoz nekomercijalne prirode - podrazumeva uvoz koji:</p> <p>2.2.1. Je nasumične prirode.</p> <p>2.2.2. se sastoji isključivo od robe za ličnu upotrebu putnika ili njihovih porodica ili od robe namenjene poklonima, čija priroda i količina ne ostavljaju sumnju da se uvoze u komercijalne svrhe.</p> <p style="text-align: center;">Član 393</p> <p>1. Oslobađanje od plaćanja carinskih dažbina iz člana 392 stav 1. za dole navedenu robu primenjuje se u skladu sa količinskim ograničenjima za putnike, i to:</p> <p>1.1. duvanski proizvodi:</p> <p>1.1.1. 200 cigareta, ili</p> |
|--|--|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>që peshojnë më së shumti 3 gramë secila) ose</p> <p>1.1.3. 50 puro ose,</p> <p>1.1.4. 50 gramë duhan për tymosje ose,</p> <p>1.1.5. Një përzierje proporcionale e këtyre produkteve të ndryshme;</p> <p>1.2. alkool dhe pije alkoolike:</p> <p>1.2.1. pije të distiluara dhe alkoolike me përbërje alkooli mbi 22%; alkool etilik i pa-denaturuar me përbërje alkooli 80% e mbi: një litër ose</p> <p>1.2.2. pije të distiluara alkoolike dhe alkool, si dhe aperitivë me bazë vere apo alkooli, pije tafia, sake apo pije të ngjashme alkoolike me përbërje alkooli deri ne 22%; verëra shkumëzuese, verëra likereri: një litër apo një përzierje proporcionale nga</p> | <p>1.1.2. 100 cigarillos (cigars of a maximum weight of 3 grams each), or</p> <p>1.1.3. 50 cigars, or</p> <p>1.1.4. 50 grams of smoking tobacco, or</p> <p>1.1.5. a proportional assortment of these different products;</p> <p>1.2. alcohols and alcoholic beverages:</p> <p>1.2.1. distilled beverages and spirits of an alcoholic strength by volume exceeding 22 % volume; non-denatured ethyl alcohol of 80% volume and over: one liter, or</p> <p>1.2.2. distilled beverages and spirits, and aperitifs with a wine or alcoholic base, tafia, saké or similar beverages, of an alcoholic strength by volume not exceeding 22 % volume; sparkling wines, liqueur wines: two liters, or a</p> | <p>1.1.2. 100 cigarilosa (cigarette do 3 grama svaka) ili</p> <p>1.1.3. 50 puro cigara ili,</p> <p>1.1.4. 50 grama duvana za pušenje ili,</p> <p>1.1.5. proporcionalna mešavina ovih različitih proizvoda;</p> <p>1.2. alkohol i alkoholna pića:</p> <p>1.2.1. destilovana i alkoholna pića sa sadržajem alkohola preko 22%; Nedenaturalni etil alkohol sa sadržajem alkohola od 80% ili više: jedan litar, ili</p> <p>1.2.2. destilovana alkoholna pića i alkohol, kao i aperitivi na bazi vina ili alkohola, tafija pića, sake ili slična alkoholna pića sa sadržajem alkohola do 22%; penušava vina, likerska vina: jedan litar ili proporcionalna mešavina ovih različitih proizvoda, i</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|--|---|
| <p>këto produkte të ndryshme dhe</p> <p>1.2.3. Verë e pa-gazuar: dy litra;</p> <p>1.3. parfume: 50 gramë, ose ujë tualeti: 0,25 litra.</p> <p>1.4. medikamente mjekësore: sasia e nevojshme që i përgjigjet nevojave personale të udhëtarit.</p> <p>2. Lirimet për mallrat e përmendura në nën-paragrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij Neni, nuk lejohen për udhëtarët nën moshën shtatëmbëdhjetë (17) vjeçare.</p> <p>3. Me vendim të Qeverisë, i cili propozohet nga ministria përgjegjëse për Financa, mund të ndryshohen kufijtë sasior të përcaktuara sipas këtij neni dhe atij monetar sipas nenit 394.</p> | <p>proportional assortment of these different products and</p> <p>1.2.3. still wines: two liters;</p> <p>1.3. perfumes: 50 grams and toilet waters: 0,25 liter;</p> <p>1.4. medicinal products: the quantity required to meet travelers' personal needs.</p> <p>2. No relief for the goods referred to in subparagraph 1.1 and 1.2 of this article shall be granted to travelers under seventeen (17) years old.</p> <p>3. By decision of the Government, which is proposed by the ministry responsible for Finance, the quantitative limits determined according to this article and the monetary limits according to article 394 can be changed.</p> | <p>1.2.3. Negazirano vino: dva litra;</p> <p>1.3. parfemi: 50 grama, ili toaletna voda: 0,25 litara.</p> <p>1.4. Medicinski lekovi: potrebna količina koja odgovara ličnim potrebama putnika.</p> <p>2. Oslobađanje od plaćanja dažbina za robu iz podstava 1.1 i 1.2 ovog člana nisu dozvoljeni za putnike mlađe od 17 godina.</p> <p>3. Odlukom Vlade, koju predlaže ministarstvo nadležno za poslove finansija, mogu se menjati kvantitativni limiti utvrđeni ovim članom i novčani limiti iz člana 394.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 394</p> <p>1. Lirimet e përmendura në Nenin 392, përveç atyre të cekura në Nenin 393, lejohen si ne vijim:</p> <p>1.1. deri në shumën treqind (300) € për çdo udhëtar në rrugë tokësor</p> | <p style="text-align: center;">Article 394</p> <p>1. Reliefs referred to in Article 392, other than those referred to in Article 393, shall be permitted as follows:</p> <p>1.1. up to the amount of three hundred (300) € for each traveler by land;</p> | <p style="text-align: center;">Član 394</p> <p>1. Oslobađanje od plaćanja dažbina iz člana 392, osim onih navedenih u članu 393, biće dozvoljeni na sledeći način:</p> <p>1.1. do iznosa od tri stotine (300) € za svakog putnika kopnom;</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>1.2. deri në shumën katërqind e tridhjetë (430) € për çdo udhëtar në rrugë ajrore dhe</p> <p>1.3. për udhëtarët nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç deri në shumën njëqindpesëdhjetë (150) €.</p> <p>2. Vlera e mallrave të përmendura në nenet 393 dhe 462 nuk do të merret parasysh për qëllimet e zbatimit të përjashtimit të parashikuar në nenin 394.</p> | <p>1.2. up to the amount of four hundred thirty (430) € for each passenger by air, and</p> <p>1.3. for travelers under 15 years up to the amount of one hundred and fifty (150) €.</p> <p>2. The value of goods referred to in Articles 393 and 462 shall not be taken into consideration for the purposes of applying the exemption provided for in Article 394.</p> | <p>1.2. do iznosa od četiri stotine trideset (430) € za svakog putnika u vazdušnom saobraćaju, i.</p> <p>1.3. za putnike mlađe od 15 godina do iznosa od stopedeset (150) €.</p> <p>2. Vrednost robe iz članova 393 i 462 neće se uzeti u obzir u svrhu primene izuzeća predviđenog članom 394</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 395</p> | <p style="text-align: center;">Article 395</p> | <p style="text-align: center;">Član 395</p> |
| <p>Kur vlera e përgjithshme e dy a më shumë artikujve tejkalon shumën e cekur në nenin 394, lirimi për ato shuma lejohet njëjtë sikur këta artikuj të ishin importuar ndaras, duke marrë parasysh se vlera e një artikulli të vetëm nuk mund të ndahet.</p> | <p>Where the total value per traveler of two or more items exceeds the amounts referred to in Article 394, relief up to those amounts shall be granted for such of the items as would, if imported separately, have been granted relief, it being understood that the value of an individual item cannot be split up.</p> | <p>Kada ukupna vrednost dva ili više predmeta premašuje iznos pomenut u člana 394, oslobođanje od plaćanja za te iznose biće dozvoljene isto kao da su ti predmeti uvezeni odvojeno, s tim da se vrednost jedne stvari ne može deliti.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 396</p> | <p style="text-align: center;">Article 396</p> | <p style="text-align: center;">Član 396</p> |
| <p>1. Dogana mund ta reduktojë vlerën dhe/ose sasi të mallrave që sjellin pa paguar detyrimet, nëse importohen nga:</p> <p>1.1. persona që banojnë në zona kufitare;</p> | <p>1. The Customs may reduce the value and/or the quantities of goods allowed entering duty-free if they are imported by:</p> <p>1.1. persons residing in the frontier zone</p> | <p>1. Carina može smanjiti vrednost i/ili količinu robe koja se donosi bez plaćanja dažbina, ako je uvezena od:</p> <p>1.1. lica sa prebivalištem u pograničnim područjima,</p> |

| | | |
|---|--|---|
| <p>1.2. punëtorë kufitar;</p> <p>1.3. stafi që operon mjetet e transportit në përdorim ndërmjet Kosovës dhe vendeve tjera.</p> <p>2. Këto kufizime nuk zbatohen kur personat që banojnë në zonën kufitare dëshmojnë se nuk po kthehen nga zona kufitare e vendit fqinj. Megjithatë, këto kufizime gjithsesi zbatohen për punëtorë që punojnë në kufij dhe stafin që operojnë mjetet e transportit në përdorim ndërmjet Kosovës dhe vendeve tjera, kur ata importojnë mallra derisa udhëtojnë gjatë punës së tyre.</p> <p>3. Me qëllim të zbatimit të dispozitave të paragrafit 1 të këtij Neni:</p> <p>3.1. zonë kufitare nënkupton, pa rënë ndesh me konventat ekzistuese në këtë drejtim, një zonë e cila, nuk shtrihet më tepër se pesëmbëdhjetë (15) kilometra nga kufiri. Qarqet administrative lokale, një pjesë territoriale e të cilave shtrihet përbrenda kësaj zone, po ashtu do të konsiderohen pjesë e kësaj zone kufitare. Dogana mund të lejojë përjashtime prej kësaj;</p> | <p>1.2. frontier workers</p> <p>1.3. the crews of means of transport used between other countries and Kosovo.</p> <p>2. These restrictions shall not apply where persons having their residence in the frontier zone prove that they are not returning from the frontier zone of the adjacent country. They shall, however, still apply to frontier workers and to the crew of means of transport used between other countries and Kosovo where they import goods when traveling in the course of their work.</p> <p>3. For the purposes of applying the provisions of paragraph 1:</p> <p>3.1. ‘frontier zone’ means, without prejudice to existing conventions in this respect, a zone which, does not extend more than fifteen (15) kilometers from the frontier. The local administrative districts, part of whose territory lies within the zone, shall also be considered to be part of this frontier zone. The Customs may grant exemptions there from;</p> | <p>1.2. pograničnih radnika</p> <p>1.3. osoblja koje upravlja prevoznim sredstvima u upotrebi između Kosova i drugih zemalja.</p> <p>2. Ova ograničenja ne važe kada lica koja borave u pograničnom području dokažu da se ne vraćaju iz pograničnog područja susedne države. Međutim, ova ograničenja se i pored toga primenjuju na pogranične radnike i osoblje koje upravljaju transportnim vozilima u upotrebi između Kosova i drugih zemalja kada oni uvoze robu dok putuju tokom njihovog posla.</p> <p>3. Za potrebe primene odredaba stava 1:</p> <p>3.1. Granično područje - označava, bez prejudiciranja postojećih konvencija u ovom pravcu, područje koje se ne proteže više od petnaest (15) kilometara od granice. U okviru ovog pograničnog područja smatraće se i lokalni administrativni okruzi, čiji teritorijalni deo leži u okviru ovog područja. Carina može dozvoliti izuzetke od ovoga;</p> |
|---|--|---|

3.2. punëtor kufitar, që punojnë në kufij, nënkupton çdo person aktivitetet e zakonshme e të cilit kërkojnë që ai person të shkojë në anën tjetër të kufirit gjatë ditëve të punës.

**KAPITULLI XI MATERIALET
ARSIMORE, SHKENCORE DHE
KULTURORE;
INSTRUMENTET DHE
APARATET SHKENCORE**

Neni 397

Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore siç percaktohen të radhitura në Shtojcën I të aktit nënligjor për zbatimin e këtij neni, lirohen nga detyrimet e importit, pavarësisht se kush është pranuesi i dërgesës apo për çfarë përdorimi janë të dedikuara ato materiale.

Neni 398

1. Materialet arsimore, shkencore dhe kulturore të radhitura në Shtojcën II të aktit nënligjor për zbatimin e këtij neni, lirohen nga detyrimet e importit me kusht që ato janë të dedikuara për:

3.2. 'frontier worker' means any person whose normal activities require that he should go to the other side of the frontier on his work days.

**CHAPTER XI
EDUCATIONAL, SCIENTIFIC
AND CULTURAL MATERIALS;
SCIENTIFIC INSTRUMENTS
AND APPARATUS**

Article 397

The educational, scientific and cultural materials listed in Annex I of the sublegal act for the implementation of this article, shall be admitted free of import duties whoever the consignee and whatever the intended use of such materials may be.

Article 398

1. The educational, scientific and cultural materials listed in Annex II of the sublegal act for the implementation of this article, shall be admitted free of import duties provided they are intended either:

3.2. Radnik na granci, -koji radi na granici, označava svako lice čije uobičajene aktivnosti zahtevaju odlazak na drugu stranu granice tokom radnih dana.

**POGLAVLJE XI
OBRAZOVNI, NAUČNI I
KULTURNI MATERIJALI;
NAUČNI INSTRUMENTI I
APARATI**

Član 397

Obrazovni, naučni i kulturni materijali navedeni u Prilogu I podzakonskog akta za sprovođenje ovog člana, oslobođeni su plaćanja uvoznih dažbina, bez obzira na to ko je primalac pošiljke i za koju upotrebu su ti materijali namenjeni.

Član 398

1. Obrazovni, naučni i kulturni materijali navedeni u Aneksu II podzakonskog akta za sprovođenje ovog člana, oslobođaju se plaćanja uvoznih dažbina pod uslovom da su namenjeni za:

| | | |
|--|--|---|
| <p>1.1. Institucione apo organizata publike arsimore, shkencore apo kulturore; ose</p> <p>1.2. Institucione apo organizata që i përkasin kategorive të specifikuara në kolonën e tretë të Shtojcës II të aktit nënligjor për zbatimin e këtij neni, me kusht që ato të jenë të miratuara nga organi kompetent për të pranuar artikuj të tillë të liruara nga detyrimet.</p> | <p>1.1. for public educational, scientific or cultural establishments or organizations; or</p> <p>1.2. for the establishments or organizations in the categories specified opposite each article in column 3 of Annex II of the sublegal act for the implementation of this article, on condition that they have been approved by the competent authorities to receive such articles duty-free.</p> | <p>1.1. Javne obrazovne, naučne ili kulturne institucije ili organizacije; ili</p> <p>1.2. Institucije ili organizacije koje pripadaju kategorijama navedenim u trećoj koloni Aneksa II podzakonskog akta za sprovođenje ovog člana, pod uslovom da im nadležni organ odobri da prihvataju takve artikle oslobođene od plaćanja obaveza.</p> |
| <p>Neni 399</p> | <p>Article 399</p> | <p>Član 399</p> |
| <p>1. Në zbatim të neneve 400 deri në 404, instrumentet dhe aparatet shkencore, të cilat nuk janë përfshirë në nenin 398, lirohen nga detyrimet e importit, nëse ato importohen ekskluzivisht për qëllime jo-tregtare.</p> <p>2. Lirimi nga paragrafi 1 i këtij Neni kufizohet për instrumentet dhe aparatet shkencore të cilat kanë për qëllim të përdoren nga:</p> <p>2.1. institucionet publike që merren kryesisht me hulumtime arsimore apo shkencore dhe për ato njësi të institucioneve publike, që merren kryesisht me hulumtime</p> | <p>1. Subject to Articles 400 to 404, scientific instruments and apparatus, which are not included in Article 398, shall be admitted free of import duties when they are imported exclusively for noncommercial purposes.</p> <p>2. The relief referred to in paragraph 1 shall be limited to scientific instruments and apparatus which are intended for either:</p> <p>2.1. public establishments principally engaged in education or scientific research and those departments of public establishments which are</p> | <p>1. U skladu sa članovima 400 do 404, naučni instrumenti i aparati koji nisu obuhvaćeni članom 398, biće oslobođeni plaćanja uvoznih dažbina ako se uvoze isključivo u nekomercijalne svrhe.</p> <p>2. Oslobođanje plaćanja dažbina iz stava 1. ovog člana ograničeno je na naučne instrumente i aparate koji su namenjeni da ih koriste:</p> <p>2.1. javne ustanove koje se bave pretežno obrazovnim ili naučnim istraživanjima i za one jedinice javnih ustanova koje se bave</p> |

| | | |
|--|---|--|
| <p>arsimore apo shkencore, ose</p> <p>2.2. institucione private që merren kryesisht me hulumtime arsimore apo shkencore dhe të autorizuar nga organet kompetente për të pranuar artikuj të tillë të liruara nga detyrimet.</p> <p style="text-align: center;">Neni 400</p> <p>1. Lirimi sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 399, po ashtu zbatohet për:</p> <p>1.1. Pjesët rezervë, pjesët përbërëse apo pjesët ndihmëse që enkas i përshtaten instrumenteve apo aparateve shkencore, me kusht që këto pjesë rezervë, pjesë përbërëse apo pjesë ndihmëse importohen në të njëjtën kohë, kur importohen edhe instrumentet apo aparatet e tilla ose, nëse ato importohen më pas, mund të identifikohen si pjesë që i përkasin dhe janë të destinuar për instrumentet apo aparatet:</p> <p style="text-align: center;">1.1.1. të cilat më herët janë liruar nga detyrimet e importit, me kusht që këto</p> | <p>principally engaged in education or scientific research; or</p> <p>2.2. private establishments principally engaged in education or scientific research and authorised by the competent authorities to receive such articles duty free.</p> <p style="text-align: center;">Article 400</p> <p>1. The relief referred to in paragraph 1 of Article 399 shall also apply to:</p> <p>1.1. spare parts, components or accessories specifically suitable for scientific instruments or apparatus, provided that such spare parts, components or accessories are imported at the same time as such instruments or apparatus or, where they are imported subsequently, that they can be identified as being intended for instruments or apparatus:</p> <p style="text-align: center;">1.1.1. which have previously been admitted duty free, provided that</p> | <p>pretežno obrazovnim ili naučnim istraživanjima, ili</p> <p>2.2. privatne ustanove koje se bave uglavnom obrazovnim ili naučnim istraživanjima i koje su od nadležnih organa ovlastile da prihvataju takve artikle oslobođene od plaćanja obaveza.</p> <p style="text-align: center;">Član 400</p> <p>1. Oslobađanje od plaćanja dažbina prema odredbama stava 1. člana 399. primenjuje se i na:</p> <p>1.1. Rezervni delovi, komponente ili pomoćni delovi posebno prilagođeni za naučne instrumente ili aparate, pod uslovom da se ti rezervni delovi, komponente ili pomoćni delovi uvoze istovremeno sa uvozom instrumenata ili aparata ili, ako se naknadno uvezu, da mogu biti identifikovani kao delovi koji pripadaju njima i da su namenjeni instrumentima ili aparatima:</p> <p style="text-align: center;">1.1.1. koji su prethodno bili oslobođeni uvoznih dažbina, pod uslovom da su takvi</p> |
|--|---|--|

| | | |
|---|---|--|
| <p>instrumente apo aparate janë ende të një natyre shkencore në momentin kur kërkohet lirimi për pjesët rezervë, pjesët përbërëse apo ato ndihmëse specifike, ose;</p> <p>1.1.2. të cilat do të kishin të drejtë në lirim në momentin kur kërkohet një lirim i tillë për pjesët rezervë, pjesët përbërëse apo ato ndihmëse specifike;</p> <p>1.2. Veglat për t'u përdorur për mirëmbajtjen, kontrollimin, kalibrimin apo riparimin e instrumenteve apo aparateve shkencore, me kusht që këto vegla të importohen në të njëjtën kohë sikur instrumentet apo aparatet e tilla ose, nëse ato importohen më pas, mund të identifikohen si pjesë që i përkasin dhe janë të destinuara për instrumentet apo aparatet:</p> <p>1.2.1. të cilat më herët janë liruar nga detyrimet e importit, me kusht që këto instrumente apo aparate janë ende të një natyre shkencore në momentin kur kërkohet</p> | <p>such instruments or apparatus are still of a scientific nature at the time when relief is requested for the specific spare parts, components or accessories; or</p> <p>1.1.2. which would be entitled to relief at the time when such relief is requested for the specific spare parts, components or accessories;</p> <p>1.2. tools to be used for the maintenance, checking, calibration or repair of scientific instruments or apparatus, provided that these tools are imported at the same time as such instruments and apparatus or, where they are imported subsequently, that they can be identified as being intended for instruments or apparatus:</p> <p>1.2.1. which have previously been admitted duty free, provided that such instruments or apparatus are still of a scientific nature at the time</p> | <p>instrumenti ili aparati još uvek naučne prirode u vreme kada se traži oslobađanje od plaćanja dažbina za određene rezervne delove, komponente ili pomoćne specifične delove, ili;</p> <p>1.1.2. koji bi imali pravo na oslobađanje od plaćanja dažbina u trenutku kada se takvo izuzeće traži za određene rezervne delove, komponente ili pomoćne specifične delove;</p> <p>1.2. Alati koji se koriste za održavanje, inspekciju, kalibraciju ili popravku naučnih instrumenata ili aparata, pod uslovom da se takvi alati uvoze istovremeno sa takvim instrumentima ili aparatima ili, ako se naknadno uvezu, da mogu biti identifikovani kao delovi koji pripadaju i da su namenjeni za instrumente ili aparate:</p> <p>1.2.1. koji su prethodno bili oslobođeni uvoznih dažbina, pod uslovom da su ovi instrumenti ili aparati još uvek naučne prirode u vreme</p> |
|---|---|--|

| | | |
|---|--|--|
| <p>2. Mallrat dhe pajisjet që mbeten në posedim të organizatave që nuk përmbushin kushtet sipas të cilave kanë përfituar lirimin, do t'i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit, sipas normës që zbatohet në datën kur ato kushte nuk vazhdojnë të përmbushen, në bazë të llojit të mallrave dhe pajisjeve dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga Dogana.</p> | <p>2. Goods and equipment remaining in the possession of organizations which cease to fulfil the conditions giving entitlement to relief shall be liable to the relevant import duties at the rate applying on the date on which those conditions cease to be fulfilled, on the basis of the type of goods and equipment and the customs value as ascertained or accepted on that date by Customs.</p> | <p>2. Roba i oprema koja ostaje u posedu organizacija koje i dalje ne ispunjavaju uslove za koje je odobreno oslobađanje od plaćanja dažbina, podležu odgovarajućim uvoznim dažbinama, u skladu sa stopom koja se primenjuje na dan kada ti uslovi ne nastavljaју biti ispunjeni, na osnovu vrste robe i opreme i carinske vrednosti koju su Carina overila ili prihvatili tog dana.</p> |
| <p>3. Mallrat dhe pajisjet e përdorura nga organizatat që përfitojnë nga lirimi për</p> | <p>3. Goods and equipment used by the organization benefiting from the relief for</p> | <p>3. Roba i oprema koju koriste organizacije koje koriste oslobađanje od</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>qëllime tjera nga ato të parapara me nenin 416 do t'i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas normës që zbatohet në datën kur ato janë përdor për qëllime tjetër, në bazë të llojit të mallrave dhe pajisjeve dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë datë nga Dogana.</p> <p style="text-align: center;"><u>Nënkapitulli II</u> <u>Përfitimet e personave me aftësi të kufizuara</u></p> <p>I. Artikujt për përdorim nga personat e verbër</p> <p style="text-align: center;">Neni 421</p> <p>Artikujt e dizajnuar enkas për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në Shtojcën III të aktit nënligjor për zbatimin e këtij neni, lirohen nga detyrimet e importit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 422</p> <p>1. Artikujt e dizajnuar enkas për përparimin arsimor, shkencor apo kulturor të personave të verbër, siç është specifikuar në Shtojcën IV të aktit nënligjor për zbatimin e këtij neni dhe pajiset tjera te</p> | <p>purposes other than those provided for in Article 416 shall be liable to the relevant import duties at the rate applying on the date on which they are put to another use, on the basis of the type of goods and equipment and the customs value as ascertained or accepted on that date by the Customs.</p> <p style="text-align: center;"><u>Sub-chapter II</u> <u>For the benefit of persons with disabilities</u></p> <p>I. Articles for the use of the blind</p> <p style="text-align: center;">Article 421</p> <p>Articles specially designed for the educational, scientific or cultural advancement of blind persons, as specified in Annex III of sublegal act for implementing this article, shall be admitted free of import duties.</p> <p style="text-align: center;">Article 422</p> <p>1. Articles specially designed for the educational, scientific or cultural advancement of blind persons, as specified in Annex IV of sublegal act for implementing this article, shall be admitted</p> | <p>plaćanja dažbina u svrhe koje nisu predviđene članom 416. podležu odgovarajućim uvoznim dažbinama po stopi koja se primenjuje na dan kada se koriste u druge svrhe, u zavisnosti od vrste robe i opreme i carinske vrednosti koje je carina overila ili prihvatila tog dana.</p> <p style="text-align: center;"><u>Podpodglavlje II</u> <u>U korist osoba sa ogranicenim sposobnostima</u></p> <p>I. Artikli za upotrebu slepih</p> <p style="text-align: center;">Član 421</p> <p>Artikli posebno dizajnirani za obrazovno, naučno ili kulturno unapređenje slepih osoba, kako je navedeno u Aneksu III podzakonskog akta za sprovođenje ovog člana, oslobođeni su uvoznih dažbina.</p> <p style="text-align: center;">Član 422</p> <p>1. Artikli posebno dizajnirani za obrazovno, naučno ili kulturno unapređenje slepih osoba, kako je navedeno u Aneksu IV podzakonskog akta za sprovođenje ovog</p> |
|--|--|---|

| | | |
|---|---|---|
| <p>dizajnuara enkas për përdorimin nga personat e verbër, lirohen nga detyrimet e importit, me kusht që ato importohen qoftë nga:</p> <p>1.1. personin i verbër për nevojat e tij; ose</p> <p>1.2. Institucionet apo organizatat që merren me arsimimin apo dhënien e ndihmës për persona të verbër, të autorizuar nga autoriteti kompetent për atë qëllim në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Lirimi sipas paragrafit 1 të këtij Neni zbatohet edhe për pjesët rezervë, pjesët përbërëse apo pajisjet përcjellëse enkas për artikujt në fjalë, dhe për veglat që do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen, kontrollimin, kalibrimin apo riparimin e këtyre artikujve, me kusht që këto pjesë rezervë, pjesë përbërëse, pajisje ndihmëse apo vegla importohen në të njëjtën kohë me artikujt në fjalë ose, nëse importohen më pas, mund të identifikohen se janë të destinuar për artikujt që janë liruar më parë nga detyrimet e importit, apo të cilat do të përfitonin nga lirimi në momentin kur një lirim i tillë, kërkohet për pjesët specifike rezervë, komponentët apo pajisjet ndihmëse dhe veglat në fjalë.</p> | <p>free of import duties provided that they are imported by either:</p> <p>1.1. blind persons themselves for their own use; or</p> <p>1.2. Institutions or organizations concerned with the education of or the provision of assistance to the blind, authorized by the competent authorities of the Republic of Kosovo to receive such articles duty free.</p> <p>2. The relief referred to in paragraph 1 shall apply to spare parts, components or accessories specifically for the articles in question, and to the tools to be used for the maintenance, checking, calibration or repair of the said articles, provided that such spare parts, components, accessories or tools are imported at the same time as the said articles or, if imported subsequently, that they can be identified as being intended for articles previously admitted duty-free, or which would be entitled to relief at the time when such relief is requested for the specific spare parts, components or accessories and tools in question.</p> | <p>člana, biće oslobođeni uvoznih dažbina, pod uslovom da su uvezeni od strane:</p> <p>1.1. same slepe osobe za svoje potrebe; ili</p> <p>1.2. Institucije ili organizacije koje se bave obrazovanjem ili pružanjem pomoći slepima, ovlašćene od nadležnog organa za tu svrhu na Republici Kosova.</p> <p>2. Oslobođanje od plaćanja dažbina prema stavu 1. ovog člana takođe se primenjuje i na rezervne delove, komponente ili prateću opremu posebno za predmetne artikule, kao i na alate koji će se koristiti za održavanje, inspekciju, kalibraciju ili popravku tih artikal, pod uslovom da se ovi delovi rezervni delovi, komponente, prateća oprema ili alati uvoze istovremeno sa predmetnim artiklima ili, ako se uvezu naknadno, mogu se identifikovati kao namenjeni predmetima koji su prethodno bili oslobođeni uvoznih dažbina, ili koji bi imali koristi od oslobođanje plaćanja dažbina u vreme kada je takvo oslobođanje je potrebno za određene</p> |
|---|---|---|

| | | |
|---|--|--|
| <p>II. Për përdorim nga personi me aftësi të kufizuara</p> <p>Neni 423</p> <p>1. Artikujt e dizajnuar enkas për arsimimin, punësimin apo për avancim shoqëror të personit me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, të tjerë nga personi i verbër, lirohen nga detyrimet e importit me kusht që janë importuar qoftë nga:</p> <p>1.1. personi me aftësi të kufizuara për nevojat e tij personale; ose</p> <p>1.2. Institucionet apo organizatat e autorizuar nga autoriteti kompetent që merren në radhë të parë me arsimimin apo dhënien e ndihmës për persona me aftësi të kufizuara për t'i pranuar ato me lirim.</p> <p>2. Lirimi në paragrafin 1 të këtij Neni zbatohet edhe për pjesët rezervë, pjesët përbërëse apo pajisjet përcjellëse enkas për artikujt në fjalë dhe për veglat, që do të shfrytëzohen për mirëmbajtjen, kontrollimin, kalibrimin apo riparimin e</p> | <p>II. Articles for the use of other persons with disabilities</p> <p>Article 423</p> <p>1. Articles specially designed for the education, employment or social advancement of physically or mentally persons with special needs, other than blind persons shall be admitted free of import duties where they are imported by either:</p> <p>1.1. persons with special needs themselves for their own use; or</p> <p>1.2. Institutions or organizations authorized by the competent authority that primarily deal with education or providing assistance to persons with disabilities to accept them for free.</p> <p>2. The relief referred to in paragraph 1 shall apply to spare parts, components or accessories specifically for the articles in question, and to the tools to be used for the maintenance, checking, calibration or repair of the said articles provided that such</p> | <p>rezervne delove, komponente ili predmetnu, opremu i alate.</p> <p>II. Artikli za upotrebu drugih osoba sa ogranicenim sposobnostima</p> <p>Član 423</p> <p>1. Artikli posebno namenjeni za obrazovanje, zapošljavanje ili socijalno napredovanje lica sa posebnim fizičkim ili mentalnim potrebama, osim slepih lica, oslobođeni su plaćanja uvoznih dažbina pod uslovom da se uvoze od strane:</p> <p>1.1. Osobe sa posebnim potrebama same za svoje lične potrebe; ili</p> <p>1.2. Institucije ili organizacije ovlašćene od nadležnog organa koje se prvenstveno bave obrazovanjem ili pružanjem pomoći osobama sa invaliditetom da ih besplatno prihvate.</p> <p>2. Oslobođanje od plaćanja dažbina iz stava 1. ovog člana primenjuju se i na rezervne delove, komponente ili prateću opremu posebno za predmetne artikule i na alate koji se koriste za održavanje, inspekciju, kalibraciju ili popravku tih</p> |
|---|--|--|

| | | |
|---|---|---|
| <p>këtyre artikujve, me kusht që këto pjesë rezervë, pjesë përbërëse, pajisje ndihmëse apo vegla importohen në të njëjtën kohë me artikujt në fjalë ose, nëse importohen më pas, mund të identifikohen se janë të destinuara për artikujt që janë liruar më parë nga detyrimet e importit, apo të cilat do të përfitonin nga lirimi në momentin kur një lirim i tillë kërkohet për pjesë rezervë, komponentë apo pajisje ndihmëse dhe vegla specifike në fjalë.</p> | <p>spare parts, components, accessories or tools are imported at the same time as the said articles, or, where they are imported subsequently, that they can be identified as being intended for articles which were previously admitted duty free, or which would be entitled to relief at the time when such relief is requested for the specific spare parts, components or accessories and tools in question.</p> | <p>predmeta, pod uslovom da se ovi rezervni delovi, komponente, prateća oprema ili alati da se uvoze istovremeno sa predmetnim artiklima ili, ako se uvezu kasnije, mogu se identifikovati kao namenjeni predmetima koji su prethodno bili oslobođeni uvoznih dažbina, ili koji će imati koristi od oslobođen od plaćanja dažbina u trenutku kada je takvo oslobađanje potrebno za rezervne delove, komponente ili prateću opremu i specifične predmetne alate.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 424</p> | <p style="text-align: center;">Article 424</p> | <p style="text-align: center;">Član 424</p> |
| <p>1. E drejta për lirimi nga detyrimet e importit të artikujve të caktuar në nenin 422 dhe 423 të këtij Kodi, mund të përjashtohen nëse vërtetohet se lirimi i tyre dëmton interesat e industrisë të sektorëve prodhues të caktuar në Kosovë.</p> <p>2. Rastet me të cilat përjashtohet lirimi nga detyrimet e importit përcaktohen me vendim nga Qeveria.</p> | <p>1. The right to exemption from import duties of articles specified in Article 422 and 423 of this Code can be excluded if it is proven that their exemption damages the interests of the industry of certain productive sectors in Kosovo.</p> <p>2. The cases in which exemption from import duties is exempted are determined by a decision of the Government.</p> | <p>1. Pravo na oslobađanje od uvoznih dažbina artikala navedenih u članu 422 i 423 ovog zakonika može se isključiti ako se dokaže da njihovo oslobađanje šteti interesima industrije određenih proizvodnih sektora na Kosov.</p> <p>2. Slučajevi u kojima je oslobođeno od plaćanja uvoznih dažbina utvrđuju se odlukom Vlade.</p> |
| <p style="text-align: center;">III. Dispozita të përbashkëta</p> | <p style="text-align: center;">III. Common provisions</p> | <p style="text-align: center;">III. Zajedničke odredbe</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 425</p> | <p style="text-align: center;">Article 425</p> | <p style="text-align: center;">Član 425</p> |
| <p>1. Lirimi nga detyrimet e importit për artikujt e dizajnuar enkas për arsimimin, punësimin apo për avancim shoqëror siç është specifikuar në nën-paragrafin 1.1 të</p> | <p>1. The relief from import duties for articles designed solely for education, employment or social advancement as specified in subparagraph 1.1 of Article 422 and sub-</p> | <p>1. Oslobađanje od uvoznih dažbina za artikle namenjene isključivo obrazovanju, zapošljavanju ili socijalnom napredovanju, kao što je navedeno u podstavu 1.1 člana 422</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>Nenit 422 dhe nën-paragrafin 1.1 të Nenit 423 të këtij Kodi, do të zbatohet në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p> <p>2. Automjeti ose ndonjë lloj tjetër i transportit për përdorim nga personi me aftësi të kufizuar duhet të jetë posaçërisht i dizajnuara apo i përshtatur në mënyrë të veçantë për nevojat e tij.</p> <p>2.1. Lirimi nga detyrimi doganor lejohet një herë në pesë (5) vjet;</p> <p>2.2. Borxhi doganor shuhet pas kalimit të afatit prej shtatë (7) vjet nga data e përfitimit të lirimit.</p> <p>2.3. Dokumenti i regjistrimit të automjetit përmban shënimet si në vijim:</p> <p>2.2.1. - “Automjet për persona me aftësi të kufizuara</p> <p>- “Nuk mund të huazohen, të jepen me qira apo të transferohen te personat e tjerë”;</p> <p>dhe</p> <p>2.2.3. - “përfituesi i lirimit: (emri, mbiemri, numri i patentë shoferit dhe nr. i vendimit të lirimit);</p> | <p>paragraph 1.1 of Article 423 of this Code, will be applied in accordance with the legislation in force.</p> <p>2. The vehicle or any other type of transport for use by the person with disabilities must be specially designed or specially adapted to his needs.</p> <p>2.1. Relief from customs duty is allowed once in five (5) years;</p> <p>2.2. The customs debt is extinguished after the expiry of the period of seven (7) years from the date of benefit of the exemption.</p> <p>2.3. The vehicle registration document contains the following notes:</p> <p>2.2.1. - "Vehicles for people with disabilities</p> <p>- "They cannot be borrowed, rented or transferred to other persons"; and</p> <p>2.2.3. - "beneficiary of release: (name, surname, driver's license number and number of release decision);</p> | <p>i podstavu 1.1 člana 423 ovog zakonika, primenjivaće se u skladu sa zakonima na snazi.</p> <p>2. Vozilo ili bilo koji drugi vid prevoza za korišćenje osobe sa invaliditetom mora biti posebno projektovan ili posebno prilagođen njegovim potrebama.</p> <p>2.1. Oslobađanje od plaćanja carine je dozvoljeno jednom u pet (5) godina;</p> <p>2.2. Carinski dug se gasi nakon isteka roka od sedam (7) godina od dana sticanja pogodnosti oslobađanja.</p> <p>2.3. Dokument o registraciji vozila sadrži sledeće napomene:</p> <p>2.2.1. – „Vozila za osobe sa invaliditetom</p> <p>- „Ne mogu se pozajmljivati, iznajmljivati ili prenositi na druga lica“; i</p> <p>2.2.3. - „korisnik otpusta: (ime, prezime, broj vozačke dozvole i broj rešenja o otpustu);</p> |
|---|--|--|

3. Për zbatim të paragrafit 2 të këtij Neni Ministri përkatës për Financa nxjerr akt nënligjor.

Neni 426

1. Artikujt e importuar pa detyrime importi nga një person i përmendur në nenet 422, 423 dhe 425 nuk mund të huazohen, jepen në shfrytëzim apo të transferohen, qoftë me pagesë apo pa pagesë, pa e njoftuar paraprakisht Doganën.

2. Nëse një artikull huazohet, jepet në përdorim apo transferohet tek një person, institucion apo organizatë që ka të drejtë të përfitojë nga lirimi në pajtim me nenet 422, 423 dhe 425, lirimi vazhdon të jepet me kusht që ai person, institucion apo ajo organizatë e shfrytëzon artikullin për qëllime, për të cilin i është dhënë e drejta për atë lirim.

3. Në raste të tjera, huazimi, dhënia në përdorim apo transferi i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, në normën që zbatohet në ditën e huazimit, dhënies në përdorim apo transferit, në bazë të llojit të mallrave apo pajisjeve dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë ditë nga Dogana.

3. For the implementation of paragraph 2 of this Article, the relevant Minister for Finance issues a sub-legal act.

Article 426

1. Articles imported duty-free by the persons referred to in Articles 422, 423 and 425 may not be lent, hired out or transferred, whether for a consideration or free of charge, without prior notification thereof to the Customs.

2. Should an article be lent, hired out or transferred to a person, institution or organization entitled to benefit from relief pursuant to Articles 422, 423 and 425, the relief shall continue to be granted provided the person, institution or organization uses the article for purposes which confer the right of such relief.

3. In other cases, loan, hiring out or transfer shall be subject to prior payment of import duties, at the rate applying on the date of the loan, hiring out or transfer, on the basis of the type of goods or equipment and the customs value ascertained or accepted on that date by Customs.

3. Za sprovođenje stava 2. ovog člana, nadležni ministar za finansije donosi podzakonski akt.

Član 426

1. Predmeti uvezeni bez uvoznih dažbina od strane lica iz članovima 422, 423 i 425 ne mogu se pozajmljivati, davati na korišćenje ili prenositi, bilo sa plaćanjem ili besplatno, bez prethodnog obaveštenja Carine.

2. Ako je predmet pozajmljen, dat na korišćenje ili prenet licu, instituciji ili organizaciji koja ima pravo na oslobođanje od plaćanja dažbine u skladu sa članovima 422, 423 i 425, oslobođanje od plaćanja dažbine će se i dalje odobravati pod uslovom da to lice, institucija ili organizacija koristi predmet za svrhe, za koje se daje pravo na to oslobođanje.

3. U drugim slučajevima, pozajmljivanje, davanje na korišćenje ili prenos podleže avansnom plaćanju uvoznih dažbina, po stopi koja se primenjuje na dan pozajmljivanja, davanja na korišćenje ili prenosa, na osnovu vrste robe ili opreme i carinske vrednosti overene ili prihvaćene tog dana od strane Carine.

| Neni 427 | Article 427 | Član 427 |
|--|--|--|
| <p>1. Artikujt e importuar nga institucionet apo organizatat që gëzojnë të drejtën për liruar në pajtim me kushtet e parashtruara në nenet 422 dhe 423, mund të huazohen, jepen në shfrytëzim apo barten, qoftë me pagesë apo pa pagesë, nga këto institucione apo organizata në baza jo fitimprurëse për persona të verbër dhe persona tjerë të hendikepuar, me të cilët ata janë të angazhuar, pa u paguar detyrimet përkatëse doganore.</p> <p>2. Asnjë huazim, dhënie në shfrytëzim apo bartje nuk mund të bëhet nën kushte tjera nga ato të parapara në paragrafin 1 të këtij Neni pa e njoftuar paraprakisht Doganën.</p> <p>3. Nëse, një artikull huazohet, jepet në shfrytëzim apo bartet te një person, institucion apo organizatë që ka të drejtë të përfitoj nga lirimi sipas paragrafit 1 të Nenit 422 ose paragrafit 1 të Nenit 423, lirimi do të vazhdojë të jepet me kusht që personi, institucioni apo organizata do ta shfrytëzojë atë artikull për qëllime, për të cilat jepet e drejta për atë lirim.</p> <p>4. Në raste të tjera, huazimi, dhënia në përdorim apo bartja i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve doganore, sipas</p> | <p>1. Articles imported by institutions or organizations eligible for relief in accordance with the conditions laid down in Articles 422 and 423 may be lent, hired out or transferred, whether for a consideration or free of charge, by these institutions or organizations on a non-profit-making basis to the blind and other handicapped persons with whom they are concerned, without payment of the corresponding customs duties.</p> <p>2. No loan, hiring out or transfer may be effected under conditions other than those provided for in paragraph 1 unless the competent authorities have first been informed.</p> <p>3. Should an article be lent, hired out or transferred to a person, institution or organization entitled to benefit from relief pursuant to paragraph 1 of Article 422 or paragraph 1 of Article 423, the relief shall continue to be granted provided the person, institution or organization uses the article for purposes which confer the right of such relief.</p> <p>4. In other cases, loan, hiring out or transfer shall be subject to prior payment of customs duties, at the rate applying on the</p> | <p>1. Predmeti uvezeni od strane institucija ili organizacija koje uživaju pravo na oslobođanje od plaćanja dažbinu skladu sa uslovima utvrđenim u članovima 422. i 423. mogu da pozajmljuju, daju na korišćenje ili prenesu, uz naknadu ili besplatno, od strane ovih institucija ili organizacija na neprofitnoj osnovi za slepa i druga hendikepirana lica, sa kojima su angažovani, bez plaćanja odgovarajućih carinskih dažbina.</p> <p>2. Nikakvo pozajmljivanje, davanje na korišćenje ili prenos ne može se vršiti pod drugim uslovima osim onih predviđenih u stavu 1. ovog člana bez prethodnog obaveštenja Carine.</p> <p>3. Ako je predmet pozajmljen, dat na korišćenje ili prenet jednom licu, instituciji ili organizaciji koja ima pravo na oslobođanje od plaćanja dažbina prema stavu 1 člana 422 ili stava 1 člana 423, oslobođanje od plaćanja dažbina će se nastaviti pod uslovom da će lice, institucija ili organizacija koristiti taj predmet u svrhe, za koje se daje pravo na to oslobođanje.</p> <p>4. U drugim slučajevima, pozajmljivanje, davanje na korišćenje ili prenos podleže avansnom plaćanju carine, u</p> |

normës që zbatohet në datën kur është bërë huazimi, dhënia në përdorim apo bartja, në bazë të llojit të mallrave apo pajisjes dhe vlerës doganore të vërtetuar apo të pranuar në atë datë nga Dogana.

Neni 428

1. Institucionet apo organizatat e përmendura në Nenin 422 dhe 423, të cilat ndërpresin përbushjen e kushteve për fitimin e drejtës për lirim nga detyrimet e importit, apo të cilat propozojnë që t'i shfrytëzojnë artikujt e liruar nga detyrimet e importit për qëllime tjera nga ato që parashihen nga ato nene, duhet të njoftojnë për këtë Doganën.

2. Artikujt që mbeten në posedim të institucioneve apo organizatave të cilat ndërpresin përbushjen e kushteve për fitimin e të drejtës në lirim, i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit në normën që zbatohet në datën kur është ndërprerë përbushja e kushteve, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore, të vërtetuar apo të pranuar në atë datë nga Dogana.

3. Artikujt e shfrytëzuar nga institucioni apo organizata përfituese nga lirimi për qëllime tjera nga ato të parapara në nenet 422 dhe 423 i nënshtrohen

date of the loan, hiring out or transfer, on the basis of the type of goods or equipment and the customs value ascertained or accepted on that date by the competent authorities.

Article 428

1. Institutions or organizations referred to in Articles 422 and 423 which cease to fulfil the conditions giving entitlement to duty-free admission, or which are proposing to use articles admitted duty-free for purposes other than those provided for by those Articles shall so inform Customs.

2. Articles remaining in the possession of institutions or organizations which cease to fulfil the conditions giving entitlement to relief shall be liable to the relevant import duties at the rate applying on the date on which those conditions cease to be fulfilled, on the basis of the type of goods and the customs value ascertained or accepted on that date by the competent authorities.

3. Articles used by the institution or organization benefiting from the relief for purposes other than those provided for in Articles 422 and 423 shall be liable to the

skladu sa stopom koja se primenjuje na datum pozajmljivanja, davanja na korišćenje ili prenosa, u zavisnosti od vrste robe ili opreme i carinsku vrednost koju je carina overila ili prihvatila tog dana.

Član 428

1. Ustanove ili organizacije iz člana 422. i 423. koje prestaju da ispunjavaju uslove za sticanje prava na oslobođanje od plaćanja uvoznih dažbina, ili koje predlažu da se predmeti oslobođeni plaćanja uvoznih dažbina koriste u druge svrhe osim one predviđene tim članovima, treba za to da obaveste Carinu.

2. Predmeti koji ostaju u posedu institucija ili organizacija kojima prestaje ispunjavanje uslova za sticanje prava na oslobođanje od plaćanje dažbina, podležu odgovarajućim uvoznim dažbinama po stopi koja se primenjuje na dan kada je ispunjenje uslova prestalo, na osnovu vrste robe i carinskoj vrednosti, overene ili prihvaćene tog dana od strane Carine.

3. Predmeti koje koristi institucija ili organizacija koja koristi oslobođanje od plaćanja dažbina u druge svrhe osim onih predviđenih u članovima 422. i 423. podležu

detyrimeve përkatëse të importit sipas normës që zbatohet në datën kur ato shfrytëzohen për qëllime tjetër, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të vërtetuar apo të pranuar në atë datë nga Dogana.

Nënkapitulli III
Për përfitim të viktimave të fatkeqësive

Neni 429

1. Në zbatim të neneve 430 deri në 435, mallrat e importuara nga institucionet shtetërore apo organizatat bamirëse ose filantropike të miratuara nga autoriteti kompetent në Kosovë, lirohen nga detyrimet e importit, kur ato destinohen:

1.1. për shpërndarje falas për viktimat e fatkeqësive që e kanë goditur territorin e Kosovës; apo

1.2. për t'u lënë në dispozicion pa kompensim viktimave të atyre fatkeqësive, përderisa mbeten pronë e organizatave në fjalë.

2. Mallrat e importuara për qarkullim të lirë nga agjencitë për ndihmë në rast të fatkeqësive për t'i përmbushur nevojat e tyre, gjatë kohës së aktivitetit të tyre,

relevant import duties at the rate applying on the date on which they are put to another use, on the basis of the type of goods and the customs value ascertained or accepted on that date by the competent authorities.

Sub-chapter III
For the benefit of disaster victims

Article 429

1. Subject to Articles 430 to 435, goods imported by State or organizations or other charitable or philanthropic organizations approved by the competent authorities shall be admitted free of import duties where they are intended:

1.1. for distribution free of charge to victims of disasters affecting the Kosovo; or

1.2. to be made available free of charge to the victims of such disasters, while remaining the property of the organizations in question.

2. Goods imported for free circulation by disaster-relief agencies in order to meet their needs during the period of their activity shall also be granted the relief

odgovarajućim uvoznim dažbinama po stopi koja se primenjuje na dan kada se ti predmeti koriste u druge svrhe, na osnovu vrste robe i carinskoj vrednosti, overene ili prihvaćene tog dana od strane Carine.

Podpoglavlje III
Za dobrobit žrtava katastrofe

Član 429

1. U skladu sa članovima 430 do 435, roba koju uvoze državne institucije ili dobrotvorne ili filantropske organizacije odobrene od nadležnog organa na Kosovu oslobađa se uvoznih dažbina kada je takva roba namenjena za:

1.1. za besplatnu distribuciju žrtvama katastrofa koje su pogodile teritoriju Kosova; ili

1.2. da im se ostavi na raspolaganju bez nadoknade žrtvama tih katastrofa, sve dok ostaju u vlasništvu dotičnih organizacija.

2. Roba uvezena za slobodan promet od strane agencija za pomoć u katastrofama radi zadovoljenja svojih potreba, tokom svoje aktivnosti, koriste oslobađanje od plaćanje

| | | |
|---|---|--|
| <p>përfitojnë nga lirimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni, me kushte të njëjta.</p> | <p>referred to in paragraph 1, under the same conditions.</p> | <p>dažbina određeno stavom 1. ovog člana, pod istim uslovima.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 430</p> <p>Lirimi nuk lejohet për lëndët dhe pajisjet që destinohen për rindërtimin e rajoneve të goditura nga fatkeqësitë.</p> | <p style="text-align: center;">Article 430</p> <p>No relief shall be granted for materials and equipment intended for rebuilding disaster areas.</p> | <p style="text-align: center;">Član 430</p> <p>Oslobađanje od plaćanja dažbina nije dozvoljeno za materijale i opremu namenjenu obnovi područja pogođenih katastrofom.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 431</p> <p>E drejta në lirim përcaktohet me vendim të Qeverisë. Ky vendim përcakton, sipas nevojës, fushëveprimin dhe kushtet të cilave i nënshtrohen lirimet.</p> | <p style="text-align: center;">Article 431</p> <p>Granting of the relief shall be subject to a decision by the Government, This decision shall, where necessary, lay down the scope and the conditions of the relief.</p> | <p style="text-align: center;">Član 431</p> <p>Pravo na oslobađanje od plaćanje dažbina zavisi od odluke Vlade. Ovom odlukom se utvrđuje, po potrebi, obim i uslovi kojima podleže oslobađanje od plaćanja dažbina.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 432</p> <p>Lirimi lejohet vetëm për ato organizata, procedurat e kontabilitetit të cilave i mundësojnë autoriteteve kompetente të mbikëqyrin veprimtaritë e tyre dhe të cilat ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme.</p> | <p style="text-align: center;">Article 432</p> <p>Relief shall be granted only to organizations the accounting procedures of which enable the competent authorities to supervise their operations and which offer all the guarantees considered necessary.</p> | <p style="text-align: center;">Član 432</p> <p>Oslobađanja od plaćanje dažbina je dozvoljeno samo za one organizacije čije računovodstvene procedure omogućavaju nadležnim organima da vrše nadzor nad njihovim radom i koje daju sve potrebne garancije.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 433</p> <p>1. Organizatat që përfitojnë nga lirimi nuk mund të huazojnë, japin në shfrytëzim apo bartin, qoftë me pagesë apo pa pagesë, mallrat e parapara në paragrafin 1 të Nenit</p> | <p style="text-align: center;">Article 433</p> <p>1. The organizations benefiting from the relief may not lend, hire out or transfer, whether for consideration or free of charge, the goods referred to in paragraph 1 of</p> | <p style="text-align: center;">Član 433</p> <p>1. Organizacije koje imaju koristi od oslobađanja od plaćanja dažbina ne mogu da pozajmljuju, daju na korišćenje ili prenose, bez obzira da li sa naplatom ili besplatno,</p> |

| | | |
|---|--|--|
| <p>429, në kushte të tjera nga ato të parapara në atë Nen, pa e njoftuar paraprakisht Doganën.</p> <p>2. Nëse mallrat huazohen, jepen në përdorim apo barten tek një organizatë që ka të drejtë të përfitoj nga lirimi në pajtim me Nenin 429, lirimi do të vazhdojë të jepet me kusht që kjo organizatë i shfrytëzon mallrat për qëllime, për të cilat jepet e drejta për atë lirim.</p> <p>3. Në raste të tjera, huazimi, dhënia në përdorim apo bartja do t'i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas normës që zbatohet në ditën e huazimit, dhënies në përdorim apo bartjes, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë ditë nga Dogana.</p> | <p>Article 429 under conditions other than those laid down in that Article without prior notification thereof to the Customs.</p> <p>2. Should goods be lent, hired out or transferred to an organization itself entitled to benefit from relief pursuant to Article 429, the relief shall continue to be granted, provided the latter uses the goods for purposes which confer the right to such relief.</p> <p>3. In other cases, loan, hiring out or transfer shall be subject to prior payment of import duties at the rate applying on the date of the loan, hiring out or transfer, on the basis of the type of goods and the customs value ascertained or accepted on that date by Customs.</p> | <p>robu iz stava 1 člana 429 pod drugim uslovima od onih predviđenih u tom članu, bez prethodnog obaveštenja Carine.</p> <p>2. Ako se roba pozajmi, daje na korišćenje ili prenese organizaciji koja ima pravo da koristi oslobođanje od plaćanja dažbina u skladu sa članom 429, oslobođanje od plaćanja dažbina će i dalje biti odobreno pod uslovom da organizacija koristi robu u svrhe, za koje se daje pravo na to oslobođanje.</p> <p>3. U drugim slučajevima pozajmljivanje, davanje na korišćenje ili prenos podleže avansnom plaćanju uvoznih dažbina, po stopi koja se primenjuje na dan pozajmljivanja, davanja na korišćenje ili prenosa, na osnovu vrste robe i carinske vrednosti koju je tog dana overila ili prihvatila Carina.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 434</p> | <p style="text-align: center;">Article 434</p> | <p style="text-align: center;">Član 434</p> |
| <p>1. Mallrat e përcaktuara në nën-paragrafin 1.2 të Nenit 429, pasi që nuk vazhdojnë të përdoren nga viktimat e fatkeqësive, nuk mund të huazohen, jepen në shfrytëzim apo barten, qoftë me pagesë apo pa pagesë, pa u njoftuar paraprakisht për këtë Dogana.</p> | <p>1. The goods referred to in sub-paragraph 1.2 of Article 429, after they cease to be used by disaster victims, may not be lent, hired out or transferred, whether for a consideration or free of charge, unless the Customs are notified in advance.</p> | <p>1. Roba iz podstava 1.2 člana 429., nakon korišćenja od strane žrtve nesreća, ne može se pozajmljivati, davati na korišćenje ili prenositi, bilo sa naplatom ili besplatno, bez prethodnog obaveštenja Carine.</p> |

| | | |
|--|--|---|
| <p>2. Nëse mallrat huazohen, jepen në përdorim apo barten tek një organizatë që ka të drejtë të përfitoj nga lirimi në pajtim me nenin 429, ose, nëse është e përshtatshme, tek një organizatë që ka të drejtë të përfitoj nga lirimi në pajtim me nën-paragrafin 1.1 të Nenit 416, lirimi do të vazhdojë të jepet me kusht që kjo organizatë i shfrytëzon mallrat për qëllime, për të cilat jepet e drejta për atë lirim.</p> <p>3. Në raste të tjera, huazimi, dhënia në përdorim apo bartja do t'i nënshtrohen pagesës paraprake të detyrimeve të importit, sipas normës që zbatohet në ditën e huazimit, dhënies në përdorim apo bartjes, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të vërtetuar apo pranuar në atë ditë nga Dogana.</p> | <p>2. Should goods be lent, hired out or transferred to an organization itself entitled to benefit from relief pursuant to Article 429 or, if appropriate, to an organization entitled to benefit from relief pursuant to sub-paragraph 1.1 of Article 416, the relief shall continue to be granted, provided such organizations use them for purposes which confer the right to such relief.</p> <p>3. In other cases, loan, hiring out or transfer shall be subject to prior payment of import duties at the rate applying on the date of the loan, hiring out or transfer, on the basis of the type of goods and the customs value ascertained or accepted on that date by the Customs.</p> | <p>2. Ako je roba pozajmljena, data na korišćenje ili prenetu organizaciji koja ima pravo na oslobođanje od plaćanja dažbina u skladu sa članom 429, ili, ako je prikladno, organizaciji koja ima pravo da koristi oslobođanje od plaćanja dažbina u skladu sa podstavom 1.1 člana 416, Oslobođanje od plaćanja dažbina će se i dalje odobravati pod uslovom da takva organizacija koristi robu u svrhe, za koje se daje pravo na to oslobođanje.</p> <p>3. U drugim slučajevima, pozajmljivanje, davanje na korišćenje ili prenos podleže avansnom plaćanju uvoznih dažbina, po stopi koja se primenjuje na dan pozajmljivanja, davanja na korišćenje ili prenosa, na osnovu vrste robe i carinske vrednosti koju je tog dana overila ili prihvatila Carina.</p> |
| <p>Neni 435</p> | <p>Article 435</p> | <p>Član 435</p> |
| <p>1. Organizatat e përmendura në nenin 429, të cilat ndërpresin përmbushjen e kushteve për fitimin e drejtës për lirim nga detyrimet e importit, apo të cilat propozojnë që t'i shfrytëzojnë artikujt e liruar nga detyrimet e importit për qëllime tjera nga ato që parashihen nga ato nene, duhet të njoftojnë për këtë Doganën.</p> <p>2. Në rastet kur mallrat mbeten në</p> | <p>1. Organizations referred to in Article 429 which cease to fulfil the conditions giving entitlement to relief, or which are proposing to use the goods admitted duty-free for purposes other than those provided for by that Article, shall so inform Customs.</p> | <p>1. Organizacije iz člana 429. koje prestanu ispunjavanje uslova za sticanje prava na oslobođanje od uvoznih dažbina ili koje predlažu da se artikli oslobođeni plaćanja uvoznih dažbina koriste u druge svrhe osim onih predviđenih tim članovima, moraju o tome da obaveste Carinu.</p> |

| | | |
|--|---|---|
| <p>posedim të organizatave të cilat ndërpresin përmbushjen e kushteve për fitimin e të drejtës në lirim, kur ato barten te një organizatë që ka të drejtë të përfitoj nga lirimi sipas Nenit 429, ose, nëse është e përshtatshme, tek një organizatë që ka të drejtë të përfitoj nga lirimi në pajtim me nën-paragrafin 1.1 të Nenit 416, lirimi do të vazhdojë të jepet me kusht që kjo organizatë i shfrytëzon mallrat për qëllime, për të cilat jepet e drejta për atë lirim. Në raste të tjera, mallrat i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit, në normën që zbatohet në datën kur është ndërprerë përmbushja e kushteve, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore, të vërtetuar apo të pranuar në atë datë nga Dogana.</p> <p>3. Mallrat e shfrytëzuar nga organizata përfituese nga lirimi për qëllime tjera nga ato të parapara në Nenin 429 i nënshtrohen detyrimeve përkatëse të importit sipas normës që zbatohet në datën kur ato shfrytëzohen për qëllime tjetër, në bazë të llojit të mallrave dhe vlerës doganore të vërtetuar apo të pranuar në atë datë nga Dogana.</p> | <p>2. In the case of goods remaining in the possession of organizations which cease to fulfil the conditions giving entitlement to relief, when these are transferred to an organization itself entitled to benefit from relief pursuant to Article 429 or, if appropriate, to an organization entitled to benefit from relief pursuant to sub-paragraph 1.1 of Article 416, relief shall continue to be granted, provided the organization uses the goods in question for purposes which confer the right to such relief. In other cases, the goods shall be liable to the relevant import duties at the rate applying on the date on which those conditions cease to be fulfilled, on the basis of the type of goods and the customs value ascertained or accepted on that date by Customs.</p> <p>3. Goods used by the organization benefiting from the relief for purposes other than those provided for in Article 429 shall be liable to the relevant import duties at the rate applying on the date on which they are put to another use, on the basis of the type of goods and the customs value ascertained or accepted on that date by Customs.</p> | <p>2. U slučajevima kada roba ostaje u posedu organizacija koje prestaju da ispunjavaju uslove za sticanje prava na oslobođanje, kada se prenesu na organizaciju koja ima pravo na oslobođanje od plaćanja dažbina prema članu 429, ili, ako odgovarajuće, organizaciji koja ima pravo da koristi oslobođanje od plaćanja dažbina u skladu sa podstavom 1.1 člana 416, oslobođanje od plaćanja dažbina će se i dalje odobravati pod uslovom da organizacija koristi robu u svrhe za koje je oslobođanje odobreno. U drugim slučajevima, roba podleže odgovarajućim uvoznim dažbinama, po stopi koja se primenjuje na dan kada su uslovi prestali, na osnovu vrste robe i carinske vrednosti koju je tog dana overila ili prihvatila Carina.</p> <p>3. Roba koju koristi organizacija koja koristi oslobođanje od plaćanja dažbina u svrhe različite od onih predviđenih u članu 429 podleže relevantnim uvoznim dažbinama po stopi koja se primenjuje na dan kada se koristi u druge svrhe, na osnovu vrste robe i carinske vrednosti koju je tog dana overila ili prihvatila Carina.</p> |
|--|---|---|

**KAPITULLI XVIII
DEKORATAT APO
SHPËRBLIMET E NDERIT**

Neni 436

1. Me paraqitje të dëshmisë së pranueshme tek Dogana nga personat përkatës, dhe me kusht që veprimet e përfshira nuk janë në ndonjë mënyrë të karakterit tregtar, lirohen nga detyrimet e importit si në vijim:

1.1. Dekoratat e akorduara nga qeveritë e huaja për ata persona vendbanimi i të cilëve është në territorin doganor të Republikës së Kosovës;

1.2. Kupat, medaljet dhe artikujt e ngjashëm të një natyre tejet simbolike të cilat i janë dhënë shpërblim në një vend jashtë Kosovës, personave që vendbanimin e tyre të zakonshëm e kanë në territorin doganor të Republikës së Kosovës, si shenjë nderi për veprimtarinë e tyre në fusha si janë arti, shkenca, sportit apo shërbimet publike, apo si një mirënjohje për suksesin e arritur në një ngjarje të veçantë, të cilat importohen në Kosovë nga vetë ata

**CHAPTER XVIII
HONORARY DECORATIONS
OR AWARDS**

Article 436

1. On production of satisfactory evidence to Customs by the persons concerned, and provided the operations involved are not in any way of a commercial character, the following shall be admitted free of import duties:

1.1. Decorations conferred by governments of foreign countries on persons whose normal place of residence is in the customs territory of the Republic of Kosovo;

1.2. cups, medals and similar articles of an essentially symbolic nature which, having been awarded in a country outside Kosovo to persons having their normal place of residence in the customs territory of the Kosovo as a tribute to their activities in fields such as the arts, the sciences, sport or the public service or as in recognition for merit at a particular event, are imported into the customs territory of the Kosovo by such persons themselves;

**POGLAVLJE XVIII
ODLIKOVANJA ILI POČASNE
NAGRADE**

Član 436

1. Nakon podnošenja prihvatljivih dokaza Carini od strane odgovarajućih lica, i pod uslovom da radnje nisu ni na koji način komercijalne prirode, oslobođene su uvoznih dažbina, kao u nastavku:

1.1. Odlikovanja koja dodeljuju strane vlade za lica čije je prebivalište na carinskoj teritoriji Republike Kosovo;

1.2. Pehari, medalje i slični predmeti veoma simbolične prirode koji su dodeljeni u zemlji van Kosova, licima koja imaju svoje uobičajeno prebivalište na carinskoj teritoriji Republike Kosovo, u znak časti za njihovu aktivnost u oblastima kao što su umetničke, naučne, sportske ili javne usluge, ili kao priznanje uspeha postignutog na određenom događaju, koje ta lica sama uvoze na Kosovo;

persona;

1.3. Kupat, medaljet dhe artikujt e ngjashëm të një natyre tejet simbolike të cilat jepen falas nga autoritete apo persona jashtë Kosovës, për t'u prezantuar në Kosovë për të njëjtat qëllime si ato të përmendura në paragrafin 1.2 të këtij Neni;

1.4. Shpërblime, trofe dhe suvenire të një natyre simbolike dhe të një vlere të kufizuar, të cilat destinohen për t'u shpërndarë falas personave me vendbanim të zakonshëm jashtë Kosovës, në konferenca afariste apo ngjarje të ngjashme ndërkombëtare, me ç'rast natyra, çmimi njësi apo tiparet tjera, nuk duhet të jenë të tilla që të sjellin konstatimin se ato janë duke u importuar për qëllime tregtare.

**KAPITULLI XIX
DHURATA TË PRANUARA NË
KONTEKST TË
MARRËDHËNIEVE
NDËRKOMBËTARE**

1.3. cups, medals and similar articles of an essentially symbolic nature which are given free of charge by authorities or persons established in a country outside Kosovo to be presented in the customs territory of the Kosovo for the same purposes as those referred to in subparagraph 1.2 of this article;

1.4. awards, trophies and souvenirs of a symbolic nature and of limited value intended for distribution free of charge to persons normally resident in countries outside Kosovo at business conferences or similar international events; their nature, unitary value or other features, must not be such as might indicate that they are being imported for commercial reasons.

**CHAPTER XIX
PRESENTS RECEIVED IN THE
CONTEXT OF
INTERNATIONAL RELATIONS**

1.3. Pehari, medalje i slični predmeti veoma simbolične prirode koji se daju besplatno od strane vlasti ili lica van Kosova, da bi se predstavili na Kosovu u iste svrhe kao i one navedene u stavu 1.2 ovog člana;

1.4. Nagrade, trofeji i suveniri simbolične prirode i ograničene vrednosti, koji su namenjeni da se besplatno podele licima sa stalnim prebivalištem van Kosova, na poslovnim konferencijama ili sličnim međunarodnim događajima, u kom slučaju priroda, jedinična cena ili druge karakteristike ne bi trebalo da budu takvi da donose konstataciju da se uvoze u komercijalne svrhe.

**POGLAVLJE XIX
POKLONI PRIMLJENI U
KONTEKSTU
MEĐUNARODNIH ODNOSA**

| Neni 437 | Article 437 | Član 437 |
|--|---|---|
| <p>1. Pavarësisht, kur është relevante, me Nenin 392, dhe në zbatim të neneve 438 dhe 439, lirimi lejohet për mallrat:</p> <p>1.1. e importuara në territorin doganor të Republikës së Kosovës nga persona që kanë bërë një vizitë zyrtare në një vend jashtë Kosovës dhe të cilët i kanë pranuar ato mallra me këtë rast si dhurata nga autoritetet mikpritëse;</p> <p>1.2. e importuara në territorin doganor të Republikës së Kosovës nga persona që vijnë në vizitë zyrtare në Kosovë, e të cilët kanë për qëllim t'i ofrojnë ato me këtë rast si dhurata për autoritetet mikpritëse;</p> <p>1.3. e dërguara si dhurata, në shenjë miqësie apo vullneti të mirë, nga një organ zyrtar, autoritet publik apo grup që kryen një veprimtari në interes publik, e cila gjendet në një vend jashtë Kosovës, për një organ zyrtar, autoritet publik apo grup që kryen një veprimtari në interes publik e cila gjendet në territorin doganor të Republikës së Kosovës</p> | <p>1. Without prejudice, where relevant, to Article 392, and subject to Articles 438 and 439, relief shall be granted for goods:</p> <p>1.1. Imported into the customs territory of the Kosovo by persons who have paid an official visit to a country outside Kosovo and who have received them on this occasion as gifts from the host authorities;</p> <p>1.2. imported into the customs territory of the Kosovo by persons coming to pay an official visit in the customs territory of the Kosovo and who intend to offer them on that occasion as gifts to the host authorities;</p> <p>1.3. sent as gifts, in token of friendship or goodwill, by an official body, public authority or group, carrying on an activity in the public interest which is located in a country outside Kosovo, to an official body, public authority or group carrying on an activity in the public interest which is located in the customs territory of the Kosovo</p> | <p>1. Bez obzira, gde je relevantno, članom 392. i u skladu sa članovima 438. i 439., oslobođanje od plaćanja dažbina se odobravaju za robu:</p> <p>1.1. uvezenu na carinsku teritoriju Republike Kosovo od strane lica koja su bila u službenoj poseti zemlji van Kosova i koja lica su tom prilikom primila tu robu kao poklon od domaćih autoriteta;</p> <p>1.2. uvezenu na carinsku teritoriju Republike Kosovo od strane lica koja dolaze u službenu posetu Kosovu, a koja nameravaju da tu robu ovom prilikom ponude kao poklon domaćim autoritetima;</p> <p>1.3. poslata kao poklon, u znak prijateljstva ili dobre volje, od strane zvaničnog organa, javnog organa ili grupe koja obavlja delatnost u javnom interesu, koja se nalazi u zemlji van Kosova, za službeni organ, javni organ ili grupu koja obavlja delatnost u javni interes koji se nalazi na carinskoj teritoriji Republike Kosovo i koji je odobren</p> |

dhe e cila është e miratuar nga autoriteti kompetent, për të pranuar artikuj të tillë pa detyrime importi.

Neni 438

Lirimi nuk lejohet për produkte alkoolike, duhan apo produkte të duhanit.

Neni 439

1. Lirimi lejohet vetëm:

1.1. Nëse artikujt e destinuar si dhurata ofrohen me një rast të veçantë,

1.2. Nëse ato nuk pasqyrojnë goftë për nga natyra, vlera apo sasia, ndonjë interes tregtar;

1.3. Nëse nuk përdoren për qëllime tregtare.

